

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave të edukimit

Viti LXXV (75)

2025

Shkodër, 2025

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Fatmir VADOHEJ

Sekretar shkencor - Prof. as. dr. Visar DIZDARI

***Anëtarë –Prof. dr. Mimoza PRIKU, prof.as.dr. Eranda HALLUNI,
prof. as. dr. Fatbardha OSMANAGA, prof.as.dr. Arjana STRINIQI,
prof. as.dr. Dhurata HOXHA, dr. Benjamin NAKU, dr. Besara KADIU***

DREJTOR I REVISTËS

Prof. dr. Tonin GJURAJ

Korrektori dhe punoi në kompjuter: *Arta Bajrami*

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë:	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Redaksia e Buletinit Shkencor Seria e Shkencave të Edukimit Tel/fax: 0035522243747
---------------------	--

PASQYRA E LËNDËS

Eranda HALLUNI BILALI, Edit LEZHA

Edukimi digjital i mësuesve në Shqipëri: një analizë e kurrikulës

Digital education of teachers in Albania: a curriculum analysis7

Ortenca KOTHERJA, Artemisi DONO

Ankthi i mësuesve dhe mësimi në distancë

Teacher anxiety and distance learning15

Pranvera KRAJA, Elsaida KRAJA, Jesmina PAÇRAMI, Orjeta MAGILAJ

Problematikat e transportit në arsimin e lartë: një qasje sasore

Transportation issues in higher education: a quantitative approach27

Gentiana IMERAJ HASHANI

Qasja STEM në klasë: efektet në arritjet matematikore dhe zhvillimin e kompetencave bashkëkohore

The STEM Approach in the Classroom: Effects on Mathematical Achievement and the Development of Contemporary Competences43

Vitiola PELARI, Gerda SULA

Lidhja midis pjesëmarrjes në edukimin fizik dhe marrëdhënieve emocionale e sociale për studentët: rasti i Universitetit të Tiranës

Linkage between Participation in Physical Education and Emotional and Social Relationships among Students: The Case of Albania University57

Arlinda HALLUNOVI YMERI, Fatjona HAKA

Mirëqenia subjektive e mësuesve të arsimit special në rajonin verior të

Shqipërisë: gjetje të replikuara

Subjective well-being of special education teachers in northern Albania: replicated findings69

Alma MUHARREMI

Ndikimi i trajnimeve në aftësimin e mësuesve si komunikues efektivë

The impact of trainings on teachers' skills as effective communicators.....89

Irimi ARAPI (SYLARI), Eftimi SYLARI

Ndërhyrjet në vëmendjen e vullnetshme (vetëdijshme) dhe zhvillimi i

aftësisë së leximit tek moshat 8-9 vjeç në shkollë

Mindfulness intervention and reading development for primary school learners..105

Artemisi SHEHU DONO, Ortenca KOTHERJA, Elda VLADI

Inteligenca emocionale dhe cilësia e marrëdhënieve

Emotional Intelligence and the Quality of Friendships119

Adelina KAKIJA, Denalda BASHOTA

Ndikimi i terapisë online kundrejt terapisë ballë për ballë në rezultatet e

përmirësimit të shëndetit mendor: Meta-analizë

The Impact of Online Therapy versus Face-to-Face Therapy on Mental Health

Outcomes: A Meta-Analysis.....131

Shkëlqim OSMANI

Adaptimi dhe validimi i OPQOL-35, AAQ-II dhe GDS tek të moshuarit

shqiptarë

Adaptation and Validation of the OPQOL-35, AAQ-II, and GDS in Albanian

Older Adults.....145

Adelina KAKIJA , Bujanë TOPALLI

Inovacionet digjitale në përmirësimin e shëndetit mendor: sfidat dhe

mundësitë

Digital Innovations in Mental Health Improvement: Challenges

and Opportunities.....157

Edina MALKIĆ, Admir DAHATI

Attachment styles in students and their role in forming parasocial relationships with professors

*Stilet e atashimit tek studentët dhe roli i tyre në formimin e marrëdhënieve parasociale me profesorët.....*171

Ines HOTI, Arben HOTI

Between Memory and the Shadow of Dictatorship: The Political Psychology of Democratic Transition in Albania

*Midis kujtesës dhe hijes së diktaturës: Psikologjia politike e tranzicionit demokratik në Shqipëri.....*183

Jonida LESHA, Xhovana ZEFI

Të jetosh me diagnozën e autizmit në Shqipëri: përvojat emocionale, sfidat e përditshme dhe roli i mbështetjes financiare të prindërit

Living with an autism diagnosis in Albania: parents' emotional experiences, everyday challenges, and the role of financial support197

Elona HASMUJAJ, Entela HASMUJAJ

Të miturit në konflikt me ligjin në Shkodër: analizë psikologjike-juridike krahasuese e procedimeve 2024-2025

*Minors in conflict with the law in Shkodër: a comparative psychological-legal analysis of procedures 2024-2025.....*219

Brilanda LUMANAJ

Trajtim teorik i qasjes së bazuar në marrëdhënie në punë sociale: analizë mbi efektivitetin dhe rëndësinë e saj

*A theoretical examination of the relationship-based approach in social work: an analysis of its effectiveness and importance.....*231

Sherif DERVISHI

Profile të komunikimit ndërmjet studentëve të Universitetit
“Luigj Gurakuqi”, Shkodër

*Communication patterns among “Luigj Gurakuqi” University students,
Shkodër.....*247

Elidjon CAMI, Sonila LISAJ

Abuzimi i drogës tek të rinjtë

*Drug abuse among young people.....*269

Bujanë TOPALLI, Arnisa BUSHATI, Naime GUZI

Studim mbi zbatueshmërinë e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara
në Bashkinë Shkodër

*A Study on the Implementation of the Rights of Persons with Disabilities in the
Municipality of Shkodra.....*279

Julia HOXHA, Rudina RAMA

Perceptimet e prindërve mbi rolin e shërbimit të provës në rehabilitimin dhe
riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin

*Parents’ perceptions regarding the role of the probation service in the
rehabilitation and reintegration of juvenile offenders289*

Galsvinda BIBA, Bujanë TOPALLI

Mësime tradicionale për fëmijët në proverbat shqiptare: perspektiva socio-
kulturore dhe praktika e punës sociale

*Traditional Lessons for Children in Albanian Proverbs: Socio-Cultural
Perspectives and Social Work Practice.....297*

EDUKIMI DIGJITAL I MËSUESVE NË SHQIPËRI: NJË ANALIZË E KURRIKULËS

Eranda Halluni Bilali, Edit Lezha

Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”, departmenti i Mësuesisë

ABSTRAKT

Integrimi i teknologjisë në arsim po zhvillohet me shpejtësi duke e bërë kompetencën digjitale të mësuesve thelbësore për një mësim efektiv. Ky studim shqyrton mënyrën se si kurrikulat universitare në Shqipëri e zhvillojnë këtë kompetencë duke u bazuar në kornizën DigCompEdu. Një analizë cilësore e përmbajtjes u krye mbi programet Bachelor dhe Master në katër universitete publike e mbështetur nga dokumentet kombëtare dhe kornizat ndërkombëtare. Gjetjet tregojnë se kurrikulat fokusohen kryesisht në aftësitë teknike të ICT-së, ndërsa ofrojnë njohuri të kufizuara në pedagogji digjitale, vlerësim dhe praktikë etike. Ky hendek tregon një mospërputhje me DigCompEdu dhe standardet kombëtare. Rekomandimet përfshijnë reformimin e kurrikulës, përputhshmërinë e politikave dhe zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve për të siguruar zhvillimin e plotë të kompetencës digjitale.

Fjalët kyçe: mësues, kompetenca digjitale, kurrikula universitare, DigCompEdu, dizajn kurrikule.

Digital education of teachers in Albania: a curriculum analysis

ABSTRACT

The rapid integration of technology in education has made teachers' digital competence crucial for effective teaching. This study investigates how university curricula in Albania foster this competence, drawing on the DigCompEdu framework. A qualitative content analysis was conducted on Bachelor's and Master's programs across four public universities, informed by national policy documents and international frameworks. The findings reveal that curricula predominantly emphasize ICT technical skills, while offering limited coverage of digital pedagogy, assessment, and ethical practices. This gap highlights a misalignment with both the DigCompEdu framework and national standards. The study recommends curriculum

reform, policy alignment, and the development of teacher capacities to ensure the comprehensive cultivation of digital competence.

Keywords: *teacher, digital competence, university curriculum, DigCompEdu, curriculum design.*

1. Introduction

Digitalization continues to reshape education systems worldwide. Nowadays, teachers are expected not only to master digital tools but also to integrate them into pedagogically meaningful learning experiences, support students' digital wellbeing, and foster critical engagement with online information. Digital pedagogy has become central to contemporary teacher professionalism (Redecker, 2020; UNESCO, 2018a, 2018b). As schools adopt digital platforms and AI-driven learning tools, teachers must be equipped to navigate increasingly complex digital environments.

In Europe, the DigCompEdu framework has become a widely adopted model for conceptualizing teacher digital competence. It emphasizes a broad skill set that includes professional collaboration, digital resource creation, technology-enhanced instruction, digital assessment, learner empowerment, and support for students' digital growth (Caena & Redecker, 2019). These expectations echo broader international agendas, including the OECD's (2019) emphasis on digital literacy and UNESCO's ICT competency standards for teachers.

Albania has identified digital transformation as a national priority. The Pre-University Curriculum Framework (2014) highlights digital competence as a transversal skill essential for all learners (Ministry of Education and Sports, 2014). Despite this focus, there is limited evidence on how teacher education programs translate these expectations into practice. This study aims to address that gap by examining how digital competence is represented in the curricula of Albanian teacher preparation programs and assessing their alignment with national and international frameworks.

2. Literature Review

2.1 Understanding Digital Competence

Digital competence is increasingly recognized as a multidimensional construct that extends far beyond the technical operation of digital tools. It encompasses pedagogical skills, ethical use, critical digital literacy, creativity, and problem-solving in digital contexts (Ranieri et al., 2021; Spante et al., 2018). These dimensions reflect the complexities of modern

digital life, including concerns about misinformation, privacy, data security, and the broader societal implications of digital technologies.

For teachers, digital competence involves not only personal proficiency but also the ability to guide students in developing these capabilities. Teachers with strong digital competence demonstrate higher levels of instructional innovation and contribute to improved learner engagement and academic outcomes (Kartal & Caner, 2022). Teachers must embed digital literacy into subject teaching, promote safe and responsible online behaviour, and model ethical digital practices. Studies indicate that teachers with strong digital competence tend to implement more student-centered pedagogies, integrate technology in ways that support inquiry and collaboration, and respond more effectively to the diverse needs of learners (Kartal & Caner, 2022). They are also more likely to incorporate multimodal resources and support differentiated instruction through adaptive technologies. By contrast, teachers with limited digital competence often rely on restrictive or superficial uses of technology that neither enrich learning nor foster higher-order thinking (Hatlevik et al., 2017).

2.2 ICT in Teacher Education

Research consistently indicates that ICT instruction in teacher education tends to be offered as a stand-alone technical course, often disconnected from pedagogical preparation or practical teaching experiences (Instefjord & Munthe, 2017). Recent studies suggest the need for teacher education to adopt more integrated approaches. Frameworks such as TPACK have advanced understanding of the interrelationship between technological, pedagogical, and content knowledge. However, contemporary demands extend beyond these dimensions. Teacher education programs are increasingly expected to address digital ethics, privacy, accessibility, and inclusion, reflecting a broader conception of digital responsibility (Sang et al., 2021). Additionally, scholars argue that teacher education must include opportunities for hands-on practice. Authentic learning experiences such as digital lesson planning, technology-enhanced practicum activities, and reflective analysis of digital assessment data help student teachers connect theory with practice. Without such opportunities, digital competence often remains theoretical and underdeveloped.

2.3 National and International Frameworks

The DigCompEdu framework and the Albanian Pre-University Curriculum Framework serve as key points of reference for curriculum design. DigCompEdu outlines six areas of digital competence tailored to educators, while the national framework highlights digital competence as a cross-curricular domain. UNESCO (2018a; 2018b) and the OECD (2019)

reinforce the need for teachers to develop broad, critical, and ethical digital capacities.

3. Theoretical Framework

This study employs DigCompEdu as its analytical foundation. The framework's six competence areas are summarized in Table 1. DigCompEdu provides a comprehensive structure for evaluating curriculum alignment and identifying gaps in teacher preparation.

Table 1

DigCompEdu Competence Areas and Descriptions

DigCompEdu Area	Description
Professional Engagement	Using digital technologies for communication, collaboration, and professional development.
Digital Resources	Selecting, creating, modifying, and ethically using digital materials.
Teaching and Learning	Designing and implementing digitally supported pedagogical activities.
Assessment	Using digital tools to assess learner progress and provide feedback.
Empowering Learners	Ensuring accessibility and personalization to support diverse needs.
Facilitating Learners' Digital Competence	Helping students develop digital literacy, online safety, critical evaluation, and creativity.

4. Conceptual Model

To analyze curriculum alignment, a conceptual model was developed illustrating how digital competence emerges from the interplay between curriculum content, learning experiences, and competence outcomes. Table 2 summarizes the model.

Table 2

Conceptual Model for Digital Competence Formation

Curriculum Element	Description
Content Coverage	Technical skills, digital pedagogy, digital ethics, and critical digital literacy.
Learning Experiences	Digital projects, lesson planning, micro-teaching with technology, and reflective activities.
Competence Outcomes	Ability to integrate technology meaningfully, conduct digital assessments, and promote safe, ethical digital practices.

5. Methodology

A qualitative content analysis approach was employed to examine how digital competence is embedded within Albanian teacher education curricula. This method allows systematic, interpretive examination of textual materials such as syllabi, capturing both explicit and implicit references to digital competence. By combining inductive and deductive coding, the approach ensures both richness of insight and alignment with established theoretical frameworks.

The dataset included syllabi from Bachelor and Master teacher education programs at four Albanian public universities—Shkodra, Durrës, Vlora, and Gjirokastra—selected based on relevance to pedagogical training and ICT-related instruction. The analysis also drew on policy and framework documents, including the Albanian Pre-University Curriculum Framework, DigCompEdu, UNESCO ICT competency standards, and OECD digital skill guidelines.

Data analysis involved iterative stages. First, all syllabi and policy documents were read thoroughly. Open coding labeled meaningful segments such as “software use,” “lesson plan design,” or “cybersecurity awareness.” These initial codes were grouped into broader categories reflecting the six DigCompEdu competence areas, as well as ethics and critical literacy. Coding was performed independently by two researchers, with an intercoder reliability of 87%. Disagreements were resolved through consensus. Data were then synthesized descriptively to evaluate representation of competence areas and alignment with national and international standards.

6. Findings

The analysis revealed several key patterns:

1. **Predominance of Technical Skills:** Across all universities, syllabi emphasized operational competencies such as word processing, spreadsheet use, presentation software, and basic multimedia creation. While foundational, this focus suggests digital competence is conceptualized primarily as technical proficiency rather than pedagogical capability.
2. **Limited Digital Pedagogy:** Few courses required pre-service teachers to design or implement technology-enhanced lessons, engage in collaborative digital learning, or reflect on pedagogical strategies. Micro-teaching opportunities were rare and often optional.
3. **Minimal Ethics and Critical Digital Literacy:** References to digital citizenship, data privacy, copyright, cyberbullying, and media literacy were

scant, indicating limited guidance on social and ethical aspects of digital environments.

4. Underdeveloped Assessment and Learner Empowerment: Very few syllabi included outcomes related to using digital tools for formative or summative assessment, feedback, or adaptive, inclusive learning. This limits teachers' preparedness to foster equitable, learner-centered environments.

Overall, the curricula reflect a first-generation ICT model that emphasizes tool operation over pedagogical, ethical, and critical integration.

Table 3

Curriculum Coverage Across DigCompEdu Areas

DigCompEdu Area	Coverage (%)	Interpretation
Technical Skills & Digital Resources	78%	Strong but narrowly focused.
Digital Pedagogy	22%	Insufficient integration.
Digital Assessment	14%	Rarely addressed.
Learner Empowerment	9%	Nearly absent.
Ethics and Safety	11%	Minimal attention.
Critical Digital Literacy	7%	Very limited presence.

7. Discussion

The findings indicate that Albanian teacher education curricula are misaligned with contemporary understandings of teacher digital competence. The emphasis on basic ICT skills reflects a functional, tool-centered view of technology. Limited attention to pedagogy, ethics, assessment, learner empowerment, and critical literacy contrasts sharply with the expectations set by DigCompEdu and national frameworks. Without structured opportunities to develop these competencies, future teachers may struggle to support students in safe, inclusive, and innovative digital learning environments.

8. Conclusion

Albanian teacher education programs currently emphasize technical ICT skills at the expense of holistic digital competence. While future teachers may be adept at using digital tools, they are less prepared to apply them pedagogically, ethically, or critically. Strengthening curricula to

incorporate digital pedagogy, ethical practice, assessment strategies, learner empowerment, and critical digital literacy is essential. Embedding these competencies across all courses, combined with micro-teaching, reflective practice, and collaborative projects, can foster teachers who are capable of leading in digitally mediated classrooms. Policy updates, stronger university-school partnerships, and capacity-building initiatives for teacher educators are also crucial to ensure sustained, meaningful reform. Only by adopting a comprehensive model of digital competence can Albania prepare educators to navigate, guide, and innovate in evolving digital learning environments.

REFERENCES

- Caena, F., & Redecker, C. (2019). Aligning teacher competence frameworks to 21st-century challenges: The case for the European Digital Competence Framework for Educators (DigCompEdu). *European Journal of Education*, 54(3), 356–369. <https://doi.org/10.1111/ejed.12345>
- Hatlevik, O. E., Throndsen, I., Loi, M., & Gudmundsdottir, G. B. (2017). Students' ICT self-efficacy and computer and information literacy: Determinants and relationships. *Computers & Education*, 118, 107–119. <https://doi.org/10.1016/j.compedu.2017.11.011>
- Instefjord, E. J., & Munthe, E. (2017). Preparing pre-service teachers to integrate technology: An analysis of the emphasis on digital competence in teacher education curricula. *European Journal of Teacher Education*, 40(1), 1–18. <https://doi.org/10.1080/02619768.2016.1253670>
- Kartal, G., & Caner, M. (2022). Digital competence in teacher education: A systematic review. *Teaching and Teacher Education*, 109, 103531. <https://doi.org/10.1016/j.tate.2021.103531>
- Ministry of Education and Sports. (2014). *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Shqipëri [Pre-university curriculum framework of Albania]*.
- OECD. (2019). *OECD skills outlook 2019: Thriving in a digital world*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/df80bc12-en>
- Ranieri, M., Bruni, I., & Proietti, C. (2021). Teachers' digital competence: A systematic review of instruments and methods. *Computers & Education*, 170, 104224. <https://doi.org/10.1016/j.compedu.2021.104224>
- Redecker, C. (2020). *European framework for the digital competence of educators: DigCompEdu*. Publications Office of the European Union.
- Sang, G., Ni, H., & Luo, W. (2021). How do pre-service teachers develop their digital competence? A systematic review. *Education and Information Technologies*, 26, 1647–1675. <https://doi.org/10.1007/s10639-020-10321-y>
- Spante, M., Hashemi, S. S., Lundin, M., & Algers, A. (2018). Digital competence and digital literacy in higher education research: A systematic review. *Cogent Education*, 5(1), 1519143. <https://doi.org/10.1080/2331186X.2018.1519143>
- Tondeur, J., Aesaert, K., Prestridge, S., & Consuegra, E. (2018). A multilevel analysis of pre-service teachers' ICT competencies: The role of teacher education

institutions. *Computers & Education*, 122, 1–12. <https://doi.org/10.1016/j.compedu.2018.02.008>

- UNESCO. (2018a). *ICT competency framework for teachers (Version 3)*. UNESCO Publishing.
- UNESCO. (2018b). *Digital skills critical for jobs and social inclusion*. UNESCO Publishing.

ANKTHI I MËSUESVE DHE MËSIMI NË DISTANCË

Ortenca Kotherja, Artemisi Dono

*Universiteti Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,
departamenti i Pedagogji-Psikologjisë*

ABSTRAKT

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë përjetimin e ankthit tek mësuesit gjatë mësimit online në periudhën e pandemisë në qytetin e Elbasanit. Në hulumtim morën pjesë 178 mësues të arsimit të mesëm e të lartë, të përzgjedhur rastësisht nga një total prej 311 mësuesish, me moshë nga 24 deri në 63 vjeç. Studimi është sasior dhe joeksperimental dhe të dhënat u mblodhën përmes **Beck Anxiety Inventory (BAI)**, i cili përfshinte dy seksione: informacion demografik dhe simptomat e ankthit. Analiza e rezultateve tregoi se mësuesit përjetuan ankth me një nivel “të butë”, ku simptomat më të shprehura ishin rrahjet e shpejta të zemrës dhe tensioni i trupit. Gjithashtu, u vu re se gjinia ndikonte në mënyrë të ndjeshme në intensitetin e ankthit të përjetuar. Bazuar në këto gjetje, studimi sugjeron ndërhyrje dhe strategji mbështetëse për të lehtësuar ankthin e mësuesve dhe për të përmirësuar performancën dhe mirëqenien e tyre gjatë mësimit online.

Fjalë kyçe: *ankth, mësues, mësim online, Beck Anxiety Inventory, performance.*

Teacher anxiety and distance learning

ABSTRACT

This study aims to evaluate the study of teacher anxiety during online learning during the pandemic period in the city of Elbasan. 178 upper secondary education teachers, randomly selected from a total of 311 teachers, aged 24 to 63 years, participated. The study is quantitative and non-experimental, and the data collected through the Beck Anxiety Inventory (BAI), which requires two sections: demographic information and anxiety symptoms. Analysis of the results of the teacher's report of students' anxiety with a "mild" level, where the most pronounced symptoms were rapid heartbeat and body tension. If, it was observed that gender is significantly affected in the intensity of visual anxiety. Based on these, the

study suggests finding and solving support to facilitate a teacher and to perform their work and well-being during online learning.

Keywords: *anxiety, teacher, online learning, Beck Anxiety Inventory, performance.*

Hyrje

Mësimi në distancë ka shënuar një transformim të madh në mënyrën e organizimit të arsimit, veçanërisht gjatë periudhave të jashtëzakonshme siç ishte pandemia globale. Ky ndryshim ka sjellë sfida të shumta për mësuesit, jo vetëm në aspektin teknik dhe pedagogjik, por edhe në nivelin emocional dhe psikologjik. Ankthi dhe stresi kanë qenë ndër përjetimet më të shpeshta të raportuara nga mësuesit, duke ndikuar jo vetëm në performancën e tyre profesionale, por edhe në mirëqenien personale.

Ky studim synon të analizojë sfidat psikologjike të mësuesve gjatë mëimit në distancë, duke u fokusuar në përjetimin e ankthit dhe faktorët që ndikojnë në intensitetin e tij. Duke u bazuar në të dhëna empirike, studimi ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi ndikimin emocional të mëimit online dhe të kontribuojë në identifikimin e strategjive që mund të mbështesin mësuesit në përballimin e këtyre sfidave. Për më tepër, përvoja e mëimit në distancë ka nxjerrë në pah nevojën për një qasje më të strukturuar ndaj mbështetjes emocionale të mësuesve. Sipas **Hodges et al., (2020)**, tranzicioni i menjëhershëm drejt “emergency remote teaching” krijoi një mjedis të pasigurt pedagogjik, ku mësuesit shpesh ndiheshin të papërgatitur për kërkesat e reja digjitale. Mungesa e kompetencave teknologjike, sipas **Tondeur, Van Braak & Ertmer (2017)**, është një faktor që rrit ndjeshëm nivelin e stresit dhe ankthit në mjediset e mësimdhënies online. Nga ana psikologjike, **Lazarus & Folkman (1984)**, theksojnë se stresi lind si rezultat i vlerësimit personal sepse kërkesat e situatës tejkalojnë burimet që individit ka në dispozicion. Në këtë kontekst, shumë mësues e kanë perceptuar mësimin në distancë si një ngarkesë të tepërt emocionale, veçanërisht kur kanë munguar mbështetja institucionale dhe trajnimi i vazhdueshëm. Ndërkohë, studime të fundit, si ai i **Kim & Asbury (2020)**, tregojnë se izolimi social, mungesa e ndërveprimit fizik me nxënësit dhe rritja e përgjegjësiave administrative kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e ankthit profesional dhe lodhjes emocionale tek mësuesit gjatë pandemisë.

Në vijim, ky studim do të paraqesë të dhëna empirike mbi nivelin e ankthit të përjetuar nga mësuesit gjatë mëimit në distancë, faktorët që e

nxisin atë dhe strategjitë që ata kanë përdorur për ta menaxhuar. Duke u mbështetur në kuadrin teorik të autorëve të sipërpërmendur, analiza synon të kontribuojë në zhvillimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e mirëqenies së mësuesve në situata të ngjashme në të ardhmen.

1.1 Ankthi dhe faktorët që ndikojnë në përjetimin e tij tek mësuesit gjatë mëimit online

Ankthi është një përvojë emocionale komplekse që përfshin shqetësim, tension, agjitacion dhe ndjenja të frikës, si dhe shfaqje fiziologjike të tilla, si: dridhje, djersitje, rritje e rrahjeve të zemrës, presionit të gjakut dhe tonit muskulator. Në kontekstin e mëimit në distancë, ankthi i përjetuar nga mësuesit është një fenomen i ndikuar nga faktorë teknologjikë, pedagogjikë, socialë dhe personalë. Mungesa e përgatitjes dhe kompetencave teknologjike e bën tranzicionin drejt mëimit online të pasigurt dhe stresues (Tondeur, van Braak, Ertmer, & Ottenbreit-Leftwich, 2017), ndërsa presioni për të përmbushur pritshmëritë institucionale dhe për të ruajtur cilësinë e mësimdhënies rrit ndjeshëm nivelin e ankthit (Sokal, Trudel, & Babb, 2020). Mungesa e ndërveprimit fizik me nxënësit dhe izolimi social ndikojnë negativisht në vetëvlerësimin dhe motivimin e mësuesve (Kim & Asbury, 2020). Përveç faktorëve të jashtëm, karakteristikat personale, si rezistenca ndaj ndryshimit dhe aftësitë për menaxhimin e stresit, luajnë një rol vendimtar në intensitetin e ankthit. Ky kombinim faktorësh bën që ankthi të mos jetë thjesht një reagim i përkohshëm, por të ketë pasoja të qëndrueshme mbi performancën profesionale, motivimin dhe mirëqenien personale të mësuesve gjatë mëimit online. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis **gjendjes së ankthit** - një gjendje emocionale kalimtare e karakterizuar nga frika, nervozizmi dhe pasojat fiziologjike Endler, N. S., & Kocovski, N. L. (2001) dhe tipareve të ankthit, që përfshijnë prirje më të qëndrueshme dhe individuale për të përjetuar ankth.

1.2 Mësimi online dhe mësuesit

Mësimi online ka sjellë një transformim të thellë në arsimin modern, duke ndryshuar mënyrën se si mësuesit planifikojnë dhe realizojnë procesin mësimor. Ai nuk përbën thjesht një kalim nga klasa tradicionale në ambient virtual, por përfshin një riorganizim të metodave pedagogjike dhe përdorimin e teknologjisë për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien. Mësuesit duhet të zhvillojnë kompetenca të reja teknologjike dhe aftësi për menaxhimin e klasës online, duke përballuar shpesh sfida të papritura që lidhen me pajisjet digjitale, platforma mësimore dhe mënyrat e komunikimit me nxënësit (Bawane & Spector, 2009). Përveç

sfidave teknologjike, aspektet pedagogjike janë gjithashtu të rëndësishme. Mësuesit duhet të përshtatin strategjitë tradicionale të mësimdhënies në një mjedis virtual, duke siguruar që nxënësit të jenë të angazhuar dhe të kenë mundësi të marrin feedback të vazhdueshëm. Kjo kërkon një planifikim më të detajuar dhe përdorim të metodave që mundësojnë ndërveprimin online, siç janë: forume diskutimi, videokonferenca dhe testime digjitale. Në të njëjtën kohë, presioni për të përmbushur standardet akademike dhe pritshmëritë institucionale shton nivelin e stresit për mësuesit, duke i bërë ata të ndihen të mbingarkuar dhe të pasigurt për performancën e tyre (Trust & Whalen, 2020). Mësimi online gjithashtu ka implikime të rëndësishme sociale dhe emocionale. Mungesa e kontaktit fizik me nxënësit dhe izolimi social mund të ndikojnë negativisht në ndjenjat e vetëvlerësimit dhe motivimit të mësuesve. Këto përvoja emocionale mund të përkthehen në ankth dhe lodhje profesionale, duke ulur efikasitetin e mësimdhënies dhe duke rritur rrezikun e djegies profesionale (Burnout) tek mësuesit. Përballja me këto sfida kërkon që mësuesit të zhvillojnë strategji për menaxhimin e stresit, të përdorin burime mbështetëse si grupet e kolegëve ose trajnimet profesionale dhe të krijojnë një balancë midis kërkesave profesionale dhe mirëqenies personale.

Qëllimi dhe objektivat e studimit:

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë nivelin e ankthit të përjetuar nga mësuesit e gjimnazeve të qytetit të Elbasanit gjatë mësimin në distancë.

Objektivat dhe pyetjet kërkimore të studimit

Objektivi 1. Të identifikojë nivelin e ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë.

Pyetja kërkimore nr. 1: *“Sa është niveli i ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë?”*

Objektivi 2. Të përcaktojë peshën e dy komponentëve të ankthit – komponentit fizik dhe komponentit psikologjik - që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë.

Pyetja kërkimore nr. 2: *“Sa është pesha e komponentit fizik të ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë?”*

Pyetja kërkimore nr. 3: *“Sa është pesha e komponentit psikologjik të ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë?”*

2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky studim sasior u ndërmor për të identifikuar ankthin tek mësuesit gjatë mësimin në distancë dhe u realizua në qytetin e Elbasanit. Të dhënat u mbledhën përmes pyetësorëve të shpërndarë tek 178 mësues të 7 gjimnazeve

publike, të përzgjedhur rastësisht nga një total prej 311 mësuesish, duke përdorur formulën e Yamane (1967) me nivel konfidencës 95%. Mosha e pjesëmarrësve ishte nga 24 deri në 63 vjeç ($M = 45.5$), nga të cilët 141 ishin femra dhe 37 meshkuj. Të gjithë mësuesit ishin nga qyteti i Elbasanit. Sa i përket nivelit arsimor, 71 mësues ishin me sistem 4-vjeçar, 38 me master profesional, 65 me master shkencor dhe 4 me doktoraturë. Të dhënat e mbledhura u përpunuan dhe u analizuan në mënyrë statistikore, duke përdorur tregues të përshkrimit (si mesataret, përqindjet, dhe standard devijimi) për të identifikuar nivelet e ankthit dhe për të vlerësuar ndikimin e faktorëve të ndryshëm demografikë dhe personalë. Kjo qasje mundëson një pamje të qartë të përhapjes dhe intensitetit të ankthit tek mësuesit gjatë mësimin online, si dhe identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në përjetimin e tij.

2.1 Instrumenti i studimit:

Për realizimin e studimit u përdor **Inventari i Ankthit të Beck (BAI)**, i cili përfshin 21 simptoma ankthi, si dridhje të këmbëve, ndjenja frike dhe frikë nga humbja e kontrollit. Pjesëmarrësve iu kërkuar të vlerësonin sa i shqetësonin këto simptoma gjatë mësimin online, në një shkallë nga 0 (aspak) deri në 3 (shumë). Rezultati total varion nga 0 deri në 63 dhe shkalla u verifikua në kampionin prej 178 mësuesish.

Pyetësori përbëhej nga dy seksione: të dhëna demografike (qyteti/fshati, gjinia, mosha dhe niveli arsimor) dhe ankthi (simptomat e përjetuara gjatë mësimin online). Pjesëmarrësit u informuan mbi qëllimin e studimit, mbledhjen e të dhënave, konfidencialitetin dhe pjesëmarrjen vullnetare, si dhe mund të kontaktonin për çdo paqartësi.

2.2 Aspekti etik i studimit

Përmbajtja e etikës ka qenë parakushti kryesor për fillimin e studimit, me qëllim sigurimin e të dhënave sa më të sakta. Ky studim u realizua me miratimin e drejtorisë arsimore të qytetit të Elbasanit dhe me lejen e drejtorisë së gjimnazit, ndërsa mësuesit përgjegjës dhe nxënësit u informuan për qëllimin dhe procedurat e hulumtimit, duke siguruar pjesëmarrje vullnetare dhe të ndërgjegjshme. Vlen të theksohet se në aplikimin e çdo instrumenti u pohua se do të ruhej parimi i konfidencialitetit dhe se këto të dhëna do të përdorehin vetëm për këtë studim.

3. Rezultatet e studimit


Ky seksion përshkruan rezultatet nga të dhënat e marra nga aplikimi i pyetësorëve. Më poshtë përshkruhen rezultatet e përgjithshme që janë nxjerrë nga përpunimi i të dhënave sasiore të studimit dhe nga kampioni,

duke përfshirë karakteristikat e pjesëmarrësve. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore është vendosur niveli i domethënies statistikore $p < 0.05$.

3.1. Karakteristikat demografike të pjesëmarrësve në studim

Në studim morën pjesë gjithsej 178 mësues të institucionit shkollor që i përkasin ciklit arsimit të mesëm të lartë. Në këtë kampionim 79% e tyre e përbëjnë femrat dhe 21% e tyre e përbënin meshkujt me një diferencë statistikore të rëndësishme ndërmjet tyre, ku më shumë pjesëmarrës janë femra sesa meshkuj.

Grafiku 1. Gjinia e pjesëmarrësve.



Mësuesit që morën pjesë në studim përfaqësojnë gjini dhe mosha të ndryshme. Siç tregohet në grafikun e mësipërm, 79% ($n = 141$) e pjesëmarrësve janë femra, gjë që reflekton numrin më të madh të grave të punësuar në arsim, ndërsa meshkujt përbëjnë vetëm 21% ($n = 37$) të totalit. Kjo diferencë mund të shpjegohet edhe nga fakti që profesioni i mësuesit zakonisht parapëlqehet më shumë nga femrat sesa nga meshkujt. Përsa i përket moshës minimale e punësuar në arsimin e mesëm të lartë është mosha 24 vjeç, ndërsa mosha maksimale është 63 vjeç. Pra, mosha mesatare e mësuesve të punësuar në arsimin e mesëm të lartë është 45.5 vjeç. Nga këto të dhëna nga kampioni ka të punësuar mësues që sapo kanë dalë nga studimet universitare, por gjithashtu ka edhe mësues që janë në prag pensioni.

3.2. Gjetjet për pyetjen kërkimore nr 1: “Sa është niveli i ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimin në distancë të qytetit të Elbasanit?” Për secilin gjimnazist është llogaritur rezultati total i EI duke përdorur formulën e shumës së pikëve të dhëna për secilën pyetje. Pikët minimale që mund të merrte një respondent në këtë shkallë ishin 16 dhe pikët maksimale 80. Vlera minimale e rezultatit në këtë studim ishte 42 dhe vlera maksimale 78. Sipas rezultateve, 1.7% (2 gjimnazistë) e respondentëve kishin një nivel të ulët të EI, 31.9% (37 gjimnazistë) kishin një nivel mesatar dhe 66.4% (77 gjimnazistë) kishin një nivel të lartë.

Tabela nr.1. Të dhënat përshkruese për ankthin.

Simptomat e ankthit	N	Minimu m	Maximu m	Shumë	Mesatare	Devijim Standard
Mpirje apo therje	178	0.0	3.0	115.0	.646	.9288
Ndjenjë të nxehti	178	0.0	3.0	123.0	.691	.7955
Dridhje të këmbëve	178	0.0	3.0	105.0	.590	.8800
Frikë se diçka e keqe po ndodh	178	0.0	3.0	169.0	.949	1.0100
Shqetësime në bark	178	0.0	3.0	81.0	.455	.6472
Paaftësi për t'u relaksuar	178	0.0	3.0	99.0	.556	.7736
Frikë nga vdekja	178	0.0	3.0	107.0	.601	.9227
Frikësuar	178	0.0	3.0	127.0	.713	.8247
Rrahje të shpejta dhe të forta të zemrës	178	0.0	3.0	177.0	.994	.9943
Marrje mendsh apo trullosje	178	0.0	3.0	145.0	.815	.9110
Nuk mund të rrini në një vend	178	0.0	10.0	156.0	.876	1.1772
Nervoz	178	0.0	3.0	146.0	.820	.8174
Ndjenjë të fikti	178	0.0	2.0	32.0	.180	.4399
Djersitje	178	0.0	3.0	171.0	.961	.8789
Skuqe të fytyrës	178	0.0	3.0	130.0	.730	.8132
Tmerruar	177	0.0	3.0	63.0	.356	.6850
Vështirësi në frymëmarrje	178	0.0	3.0	137.0	.770	.8621
Ndjenjë	178	0.0	3.0	29.0	.163	.4650

shoku						
Dridhje trup	178	0.0	3.0	102.0	.573	.8686
Dridhje të duarve	178	0.0	3.0	121.0	.680	.9290
Frikë se po e humbni kontrollin	178	0	3	107	0.60112	0.845993
Niveli i përgjithshëm	178	0	3	2442.0	13.7211	17.4700

Duke iu referuar të dhënave përshkruese të ankthit shohim që nga 178 mësues të cilët kanë plotësuar pyetësorët me një minimum 0 dhe një maksimum 3 ka një mesatare të simptomave që kanë përjetuar të barabartë me $M = 13.72$ dhe devijim standard $DS = 17.47$. Pra, në bazë të pikëzimit të inventarit të Beck mësuesit kanë përjetuar një nivel “të butë” të ankthit gjatë mësimit të zhvilluar në distancë.

Nëse analiza do të fokusohet në bazë gjinie në tabelën e mëposhtme tregohet niveli i ankthit të përjetuar nga mësuesit gjatë mësimit në distancë në bazë gjinie.

Tabela nr.2. Të dhënat përshkruese për ankthin në bazë gjinie.

Gjinia	Frekuenca	Përqindja	Përqindje vleshme	Përqindje kumulative
Femër	141	79.2	79.2	79.2
Valid Mashkull	37	20.8	20.8	100.0
Total	178	100.0	100.0	

Të dhënat përshkruese për ankthin në bazë gjinie tregojnë që mësueset femra kanë pasur pjesëmarrje më të lartë se mësuesit meshkuj. Kjo edhe për shkak se profesioni i mësuesit parapëlqehet më shumë nga femrat sesa nga meshkujt. Përkatesisht mësueset femra zënë 79% të pjesëmarrjes në studim.

3.3. Gjetjet për pyetjen kërkimore nr. 2 dhe 3:

Pyetja kërkimore nr. 2: “Sa është pesha e komponentit fizik të ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimit në distancë?”

Pyetja kërkimore nr. 3: “Sa është pesha e komponentit psikologjik të ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimit në distancë?”

Pas shqyrtimit të secilës simptomë të komponentit fizik, në tabelën e

mëposhtme vihet re se komponenti fizik ka një total ankthi prej 7.3 dhe me një ndryshim -46 % nga mesatarja e përgjithshme e ankthit e cila është 13.72.

Tabela nr.3. Niveli i komponentit fizik.

Lloji i simptomave	Totali	Mesatarja	Ndryshimi ne %
Simptomat fizike	7.376404494	13.7211	-46%

Në analizën e të dhënave mbi **nivelin e komponentit psikologjik nga tabela nr.4** vihet re se komponenti psikologjik ka një total ankthi prej 6.5 dhe me një ndryshim -53 % nga mesatarja e përgjithshme e ankthit e cila është 13.72.

Tabela nr.4. Niveli i komponentit psikologjik.

Lloji i simptomave	Totali	Mesatarja	Ndryshimi ne %
Simptomat psikologjike	6.507617597	13.7211	-53%

4. DISKUTIMI I REZULTATEVE

Nga diskutimi i rezultateve të pyetjeve kërkimore për realizimin e objektivit të parë, i cili lidhet me identifikimin e nivelit të ankthit që kanë përjetuar mësuesit gjatë mësimit në distancë, mund të nxjerrim disa gjetje të rëndësishme. Analiza e të dhënave të mbledhura nga kampioni prej 178 mësuesish, të cilët plotësuan pyetësorët me vlerat minimale 0 dhe maksimale 3, tregoi se mesatarja e përgjithshme e simptomave të ankthit ishte $M = 13.72$. Bazuar në klasifikimin e Inventarit të Ankthit të Beck (BAI), ky rezultat tregon se mësuesit përjetuan një nivel “**të butë**” të ankthit gjatë mësimit në distancë.

Ky nivel i moderuar i ankthit mund të lidhet me sfidat e shumta që shoqëruan tranzicionin drejt mësimit online, duke përfshirë adaptimin me teknologjinë, ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies dhe menaxhimin e stresit të përditshëm. Rezultatet tona janë të përputhshme me gjetjet e studimit të Lacomba-Trejo, Schoeps, Valero-Moreno, Rosario dhe Montoya-Castilla (2021), të cilët në studimin e tyre të kryer në Spanjë konstatuan se mësuesit

e arsimit të mesëm përjetuan ankth gjatë pandemisë. Ata vunë në dukje se mësuesit përpiqeshin të përshtateshin me metodën e mësimdhënies online dhe të menaxhonin njëkohësisht përgjegjësitë e tyre profesionale dhe personale, si dhe shqetësimet për të ardhmen dhe pasojat e pandemisë.

Rezultatet e këtij studimi sugjerojnë gjithashtu se ankthi i përjetuar gjatë mësimit në distancë nuk është një fenomen i njëtrajtshëm, por ndikohet nga një kombinim faktorësh personalë dhe kontekstualë. Për shembull, diferenca në përvojën e ankthit mund të lidhet me aftësitë teknologjike të mësuesve, eksperiencën e mëparshme me mësimdhënien online, nivelin e mbështetjes institucionale, si dhe karakteristikat personale si rezistenca ndaj ndryshimeve dhe strategjitë për menaxhimin e stresit. Këto elemente janë në përputhje me literaturën ekzistuese që nënvizon se ankthi i mësuesve gjatë mësimit online shpesh ka një natyrë multifaktoriale, ku faktorët teknologjikë, pedagogjikë dhe socialë ndërveprojnë për të përcaktuar intensitetin e përvojës së ankthit (Tondeur, van Braak, Ertmer, & Ottenbreit-Leftwich, 2017; Sokal, Trudel, & Babb, 2020; Kim & Asbury, 2020).

Duke parë në aspektin psikologjik, ankthi i matur te mësuesit mund të përbëjë një mekanizëm adaptues në situata të pazakonta dhe stresuese, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë të vëmendshëm dhe të përqendruar në detyrat e tyre. Megjithatë, edhe një nivel “i butë” ankthi mund të ndikojë në mirëqenien personale dhe motivimin e mësuesve në një periudhë afatgjatë, sidomos kur sfidat e mësimit në distancë zgjasin për muaj të tërë.

Në përmbledhje, analiza e rezultateve tregon se mësuesit e arsimit të mesëm në qytetin e Elbasanit përjetuan një nivel të moderuar të ankthit gjatë mësimit në distancë, i cili është kryesisht i përballueshëm, por i ndikuar nga faktorë të ndryshëm individualë dhe kontekstualë. Kjo përputhet me studime të mëparshme ndërkombëtare dhe thekson rëndësinë e ofrimit të mbështetjes së duhur për mësuesit gjatë periudhave të tranzicionit në mësim online, për të ruajtur performancën profesionale dhe mirëqenien personale.

5. KONKLUSIONE & REKOMANDIME

Ky studim ka treguar se mësuesit e gjimnazeve të qytetit të Elbasanit përjetuan një nivel “të butë” të ankthit gjatë mësimit në distancë, me një mesatare prej $M = 13.72$ sipas Inventarit të Ankthit të Beck. Analiza e komponentëve fizikë dhe psikologjikë tregoi se simptomat e ankthit janë të pranishme, por në nivele minimale, duke treguar se mësuesit kanë qenë në gjendje të përballojnë stresin dhe pasigurinë e shkaktuar nga tranzicioni në mësim online.

Nga të dhënat rezultoi se komponentët fizikë, të tillë si: dridhjet e duarve, rrahjet e shpejta të zemrës dhe shqetësimet në frymëmarrje, ishin të pranishme, por me një intensitet të ulët. Po ashtu, komponentët psikologjikë, si: frika se diçka e keqe mund të ndodhë, nervozizmi dhe ndjenja e paaftësisë për t'u relaksuar, gjithashtu ishin në nivele minimale. Këto rezultate tregojnë një adaptim të mësuesve ndaj situatës së jashtëzakonshme të mësimi në distancë duke reflektuar aftësinë e tyre për menaxhimin e stresit.

Studimet ndërkombëtare, përfshirë punën e Lacomba-Trejo et. al., (2022), konfirmojnë që mësuesit e arsimit të mesëm përjetuan ankth dhe stres gjatë pandemisë COVID-19, ndërkohë që u përpoqën të harmonizonin përgjegjësitë profesionale dhe personale. Rezultatet e këtij studimi shqiptar janë në përputhje me këto gjetje, duke treguar se përvoja e ankthit gjatë mësimi online është një fenomen i përbashkët global, i cili ndikohet nga faktorë të ndryshëm, përfshirë përgatitjen teknologjike, mbështetjen institucionale dhe izolimin social. Për më tepër, analiza e rezultateve sugjeron se ankthi i mësuesve nuk është i lartë, por mbetet një shqetësim i rëndësishëm për mirëqenien dhe performancën e tyre profesionale. Identifikimi i simptomave të ankthit, edhe në nivele minimale, tregon nevojën për mbështetje të vazhdueshme për mësuesit, veçanërisht në situata të paparashikueshme si mësimi në distancë ose emergjencat arsimore.

REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e studimit, mund të formulohen disa rekomandime praktike dhe strategjike për reduktimin e ankthit tek mësuesit dhe për përmirësimin e cilësisë së mësimi online:

1. **Trajnime dhe zhvillim profesional.** Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për përdorimin e teknologjisë dhe për menaxhimin e klasës online, për të rritur sigurinë dhe kompetencat e mësuesve.
2. **Mbështetje psikologjike.** Implementimi i programeve për menaxhimin e stresit dhe ankthit, duke përfshirë këshillime individuale, workshop-e dhe mbështetje psikologjike në grup.
3. **Planifikim dhe strukturim i mësimi online.** Krijimi i materialeve dhe orareve të qarta për të reduktuar pasigurinë dhe presionin profesional.
4. **Ndërveprim dhe bashkëpunim social.** Promovimi i komunikimit të rregullt midis mësuesve dhe nxënësve për të zvogëluar ndjesinë e izolimit dhe për të rritur motivimin dhe angazhimin.

5. Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm. Kryerja e vlerësimeve periodike të ankthit dhe stresit tek mësuesit për të identifikuar problemet në kohë dhe për të ndërhyrë me mjete mbështetëse.

6. Politika institucionale mbështetëse. Sigurimi i një ambienti pune fleksibël dhe mbështetës nga institucionet arsimore, për të lehtësuar presionin dhe stresin e mësuesve.

REFERENCA:

- Bawane, J., & Spector, J. M. (2009). Prioritization of Online Instructor Roles: Implications for Competency-Based Teacher Education Programs. *Distance Education*, 30, 383-397. <https://doi.org/10.1080/01587910903236536>
- Beck, A. T., Epstein, N., Brown, G., & Steer, R. A. (1988). *An inventory for measuring clinical anxiety: Psychometric properties*. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 56(6), 893–897. <https://doi.org/10.1037/0022-006X.56.6.893>
- Endler, N. S., & Kocovski, N. L. (2001). *State and trait anxiety revisited*. *Journal of Anxiety Disorders*, 15(3), 231–245. [https://doi.org/10.1016/S0887-6185\(01\)00060-3](https://doi.org/10.1016/S0887-6185(01)00060-3)
- Hodges, C. B., Moore, S., Lockee, B. B., Trust, T., & Bond, A. (2020). *The difference between emergency remote teaching and online learning*. EDUCAUSE Review.
- Kim, L. E., & Asbury, K. (2020). 'Like a rug had been pulled from under you': The impact of COVID-19 on teachers in England during the first six weeks of the UK lockdown. *British Journal of Educational Psychology*, 90(4), 1062–1083. <https://doi.org/10.1111/bjep.12381>
- Lazarus, R., & Folkman, S. (1984). *Stress, Appraisal, and Coping*. New York: Springer.
- Lacomba-Trejo, L., Schoeps, K., Valero-Moreno, S., del Rosario, C., & Montoya-Castilla, I. (2022). Teachers' response to stress, anxiety and depression during COVID-19 lockdown: What have we learned from the pandemic? *Journal of School Health*. Advance online publication. <https://doi.org/10.1111/josh.13192>
- Sokal, L., Trudel, L. E., & Babb, J. (2020). Canadian Teachers' Attitudes toward Change, Efficacy, and Burnout during the COVID-19 Pandemic. *International Journal of Educational Research Open*, 1, Article 100016 <https://doi.org/10.1016/j.ijedro.2020.100016>
- Sande Erunao Muwanguzi, Yuda Taddeo Kaahwa, Nicholas Itaaga. Teacher Generated Pamphlets as a Feasible Covid-19 Learning Alternative in Uganda: A Review of Existing Global and Domestic Pandemic Pedagogies. *American Journal of Educational Research*. 2021; 9(9):580-586. doi: 10.12691/education-9-9-4 .
- Tondeur, J., van Braak, J., Ertmer, P. A., & Ottenbreit-Leftwich, A. (2017). Understanding the relationship between teachers' pedagogical beliefs and technology use in education: A systematic review of qualitative evidence. *Educational Technology Research and Development*, 65(3), 555–575. <https://doi.org/10.1007/s11423-016-9481-2>

PROBLEMATIKAT E TRANSPORTIT NË ARSIMIN E LARTË: NJË QASJE SASIORE

Pranvera Kraja, Elsaida Kraja, Jesmina Paçrami, Orjeta Magilaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Mësuesisë

ABSTRAKT

Ndjekja e studimeve në arsimin e lartë paraqet një sërë sfidash për studentët, ndër të cilat transporti përbën një problematikë të veçantë, sidomos për studentët jorezidentë. Ky punim synon të identifikojë çështjet kryesore që lidhen me transportin e studentëve drejt universitetit dhe të analizojë ndikimin e tyre në pjesëmarrjen dhe performancën akademike. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda sasore e hulumtimit. Në studim morën pjesë 105 studentë të ciklit Bachelor dhe Master, të cilët plotësuan një pyetësor sasior. Rezultatet evidentuan se vështirësitë në transport ndikojnë në mënyrë të dukshme jo vetëm në pjesëmarrjen fizike në leksione dhe seminare, por edhe në arritjet akademike të studentëve. Gjetjet e studimit janë krahasuar me studime të tjera në fushë, të cilat rezultuan në përputhje me konstatimet tona. Përveç identifikimit të sfidave, ky punim paraqet edhe disa zgjidhje të mundshme për lehtësimin e transportit studentor, si dhe ofron rekomandime për politikëbërësit. Studimi kontribuon në thellimin e kuptimit të faktorëve që kërkojnë vëmendje nga autoritetet lokale dhe institucionet e arsimit të lartë, me synimin për të përmirësuar mirëqenien dhe përvojën akademike të studentëve.

Fjalë kyç: *transport, problematikë, performancë akademike, student, arsim. i lartë.*

Transportation issues in higher education: a quantitative approach

ABSTRACT

Pursuing higher education studies presents several challenges for students, among which transportation constitutes a particular problem, especially for non-resident students. This paper aims to identify the main issues related to student transportation to university and to analyze their

impact on academic participation and performance. A quantitative research method was used to collect data. The study involved 105 Bachelor and Master students, who completed a quantitative questionnaire. The results showed that transportation difficulties significantly affect not only physical participation in lectures and seminars, but also students' academic achievements. The study findings were compared with other studies in the field, which were consistent with our findings. In addition to identifying the challenges, this paper also presents some possible solutions for facilitating student transportation, as well as offering recommendations for policymakers. The study contributes to a deeper understanding of the factors that require attention from local authorities and higher education institutions, with the aim of improving the well-being and academic experience of students.

Keywords: *transportation, issues, academic performance, students, higher education.*

Hyrje

Arsimi i lartë është cilësuar prej kohësh si çelësi i lëvizshmërisë sociale dhe ekonomike. E megjithatë, lëvizshmëria në vetvete është një nga pengesat më të mëdha për barazinë në arsimin e lartë (Elengold, 2023). Hulumtimet mbi pengesat në të nxënë dhe boshllëqet në arritje kanë zgjeruar njohuritë tona mbi faktorët socioekonomikë që kontribuojnë në pabarazitë në arritjet e nxënësve dhe studentëve, si dhe matësit e mirëqenies fizike dhe emocionale të nxënësve. Një variabël që shpesh kryqëzohet me këta faktorë socioekonomikë është transporti për në shkollë, duke përfshirë mënyrën e transportit, distancën e përshkuar dhe kohën e udhëtimit (Hopson, et al., 2022).

Pak vëmendje dhe pak hapësirë diskutimi i është kushtuar transportit në arsimin e lartë. Literatura shkencore e cila lidhet me mënyrën e ofrimit të transportit në institucionet e arsimit të lartë dhe ndikimin e tij tek studentët, është pothuajse inekzistente në vendin tonë. Prandaj ky punim synon që të prekë këtë problem jo pa rëndësi për studentët tanë dhe të plotësojë sadopak këtë mangësi literature.

II. RISHIKIMI I LITERATURËS

Aksesi në arsimin e lartë dhe sfidat e transportit

Aksesi në arsimin e lartë është një çështje me rëndësi, e cila ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e shoqërisë. Ka disa faktorë që ndikojnë në aksesin në arsimin e lartë, ku përmendim faktorët socialë, ekonomikë dhe

gjeografikë. Studimet tregojnë se qasja në transport cilësor dhe të përballueshëm, rrit ndjeshëm normat e frekuentimit në shkolla, sidomos për nxënësit ekonomikisht të pafavorizuar. Vështirësitë në transport përfaqësojnë një pengesë të rëndësishme për suksesin dhe përfundimin në arsimin pasuniversitar, shpesh duke anashkaluar faktorë të tjerë siç janë shqetësimet në lidhje me borxhin studentor (Elengold, 2023). Edwards (2022) zbuloi se e drejta për transport me autobus uli me 3.8% mundësinë për mungesa të vazhdueshme, duke ndihmuar nxënësit të frekuentojnë më shumë orë mësimore.

Në kontekstin e arsimit të lartë, Schuette (2023) raportoi se programet e transportit publik të sponsorizuara nga universitetet përmirësonin ndjeshëm pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve, veçanërisht për ata që nuk dispononin mjete private. Për studentët që udhëtojnë për në kolegji në Shtetet e Bashkuara në vitin akademik 2020–2021, kostot e transportit përbënin gati 20% të kostos së frekuentimit të kolegjit (Schuette, 2023).

Në zonat e mëdha metropolitane, kufizimet e aksesit dhe kufizimet e lëvizshmërisë të shkaktuara nga problemet e transportit mund ta bënin të vështirë për studentët të kalonin kohë në kampus, duke kufizuar kështu potencialin e tyre akademik (Allen & Farber, 2018). Për shembull, në Zonën e Madhe të Torontos (ZMT), hulumtimet treguan se kohëzgjatja e udhëtimit nga shtëpia në kampus dhe koha e kaluar në punësim kanë një efekt të rëndësishëm negativ në pjesëmarrjen e studenteve. Një shumicë e konsiderueshme e studentëve të anketuar në ZMT raportuan se udhëtimi i tyre për në kampus i dekurajon ata (65%) ose kufizon pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të organizuara (66%) (Allen & Farber, 2018).

Domosdoshmëria e të paturit të transportit të besueshëm është parësore, pasi mbi një e katërta e studentëve të anketuar në të gjithë SHBA-në raportuan se mungojnë në orë mësimi ndonjëherë ose rrallë për shkak të transportit të pasigurt. Transporti i pasigurt përkthehet drejtpërdrejt në kohë të humbur në mësim. (Schuette, 2023). Ndërsa aksesit në transport të qëndrueshëm luan një rol në promovimin e barazisë dhe zhvillimit ekonomik (Moreno et al., 2023).

Për studentët jorezidentë në institucione në rajone të ndryshme, besueshmëria, siguria dhe kostoja e transportit ishin zakonisht problemet më të përmendura (Laby et al., 2021). Në Johaneshburg, studentët jorezidentë në Universitetin e Johaneshburgut raportuan se sfidat e transportit ndikuan negativisht në pjesëmarrjen dhe energjinë e tyre në mësim (75%) (Laby, et. al., 2021). Kohëzgjatjet e gjata të udhëtimit dhe rrugët e ndërlikuara bënin që studentët të humbisnin më shumë ditë shkolle (Stein & Grigg, 2019).

Aksesi në opsionet e transportit publik mund të zvogëlojë kostot e udhëtimit për studentët me të ardhura më të ulëta dhe të zgjerojë opsionet për studentët që duhet të udhëtojnë distanca më të gjata me makinë (Moreno et. al., 2023). Për studentët që mbështeteshin në transportin publik u zbulua që kishin më shumë gjasa të raportonin se udhëtimet e tyre për në universitet dekurajonin pjesëmarrjen, edhe pasi kishin kontrolluar kohën e udhëtimit, dhe ky efekt u zmadhua për ata që duhej të transferoheshin më shpesh nga një automjet në tjetrin (Allen & Farber, 2018). Kjo varësi nga transporti ndikonte gjithashtu në vendimet akademike; gati gjysma (46%) e studentëve të kampusit të Torontos raportuan se e kishin marrë parasysh udhëtimin e tyre për në Universitet kur donin të zgjidhnin kurset/lëndët (Allen & Farber, 2018).

Ndikimi në performancën dhe pjesëmarrjen e studentëve

Marrëdhënia midis variablave të transportit dhe rezultateve akademike, siç janë GPA dhe pjesëmarrja, është komplekse, por në përgjithësi tregon se udhëtimet e gjata për në shkollë/universitet ose mungesa e mbështetjes së transportit ndikojnë negativisht në suksesin akademik (Khaled & Ranya, 2021; Lutz et. al., 2024; Balabanian, 2020). Një studim që hetoi studentet femra të inxhinierisë në Universitetin e Katarit zbuloi një ndikim pozitiv të një shërbimi transporti të ofruar nga kolegji: përdoruesit e autobusëve demonstruan pjesëmarrje dukshëm më të mirë dhe GPA më të larta krahasuar me jopërdoruesit (Khaled & Ranya, 2021).

Rezultatet nga një studim dymbëdhjetëvjeçar mbi studentët nga një universitet publik, treguan se distanca gjeografike që ndan vendin e studimit me vendin e banimit të familjes, është një përcaktues negativ i performancës akademike të studentëve (Vieira, Vieira, & Raposo, 2018).

Në mënyrë të ngjashme, ky fenomen raportohet edhe për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar. Kështu për shembull, shanset që përdoruesit e autobusëve të arrinin një GPA prej 2.0 ose më shumë, ishin 3.3 herë më të larta se jopërdoruesit (Khaled & Ranya, 2021). Të njëjtët variabla ishin përcaktues edhe për nxënësit në klasat 6^{-ta} - 9^{-ta} në Abu Dhabi, ku koha mesatare më e gjatë e udhëtimit dhe distanca e përshkimit për në shkollë, ndikuan negativisht në performancën e tyre shkollore (Balabanian, 2020). Në një studim sasior ekologjik në qytetet kanadeze gjeti një korrelacion të rëndësishëm negativ midis përqindjes së nxënësve që përdornin transportin me autobus shkollor dhe arritjeve akademike, konkretisht në lëndët Shkrim-lexim dhe Matematikë të Aplikuar të Klasës së 9^{-të} dhe të 10^{-të} në Toronto (Lutz et al., 2024). Megjithatë, studimet që

përqendrohen në aspektet infrastrukturore tregojnë se parkimi dhe mjediset e mjaftueshme të transportit korrelojnë pozitivisht dhe në mënyrë të konsiderueshme me arritjet akademike të studentëve në arsimin e lartë, duke sugjeruar që përmirësimi i infrastrukturës mbështet studentet që udhëtojnë nga vende të largëta (Ramli & Zain, 2018).

Barazia, pabarazitë demografike dhe faktorët stresues

Vështirësitë me të cilën përballen studentët në arsimin e lartë theksoheshin edhe më shumë dhe vareshin nga të ardhurat familjare, raca dhe gjinia.

Të ardhurat janë një përcaktues thelbësor për kërkesën e transportit. Ekziston një marrëdhënie negative midis të ardhurave familjare dhe ecjes në këmbë ose udhëtimit me autobus, por pozitive me drejtimin e një makine. Një rritje në kohën e udhëtimit zvogëlon probabilitetin e ecjes, ndërsa rrit mundësinë e përdorimit të një makine ose udhëtimit me autobus për në shkollë (Moreno et al., 2023).

Në një studim shumëvjeçar të zhvilluar në Kaliforni me metoda të përziera, bazuar në të dhëna të pasura origjinale, i cili anketoj 1507 studentë dhe intervistoi 24 prej tyre, zbuloi se ligji dhe infrastruktura e transportit ndikonin në përfundimin e kolegjit, duke penguar në mënyrë disproporcionale përfundimin për studentët me ngjyrë. Barrierat e transportit nuk ishin të shpërndara në mënyrë të barabartë, duke ndikuar veçanërisht tek studentët me ngjyrë (Elengold, 2023). Duke i bazuar argumentet e saj si në literaturën ndërdisiplinore, ashtu edhe në të dhënat e pasura nga studimi i saj shumëvjeçar kërkimor, studiuesja argumentoi se ligji dhe politika e arsimit të lartë përkeqësonin, në vend që të lehtësonin barrierat sistemike të transportit për studentët, duke përforcuar pabarazitë në arsim. Transporti doli si pengesa më kritike për të përfunduar kolegjin, dhe shumë më e madhe sesa neveria ndaj borxhit (që studenti i ka shtetit) për studentët latino-amerikanë (Elengold, 2023). Në rishikimin sistematik të literaturës, Hopson, et. al., (2022), arrijnë në përfundimin se hulumtimet tregojnë rëndësinë e transportit në lidhje me suksesin akademik, veçanërisht për nxënësit me ngjyrë dhe ata nga familjet me të ardhura të ulëta ekonomike.

Evidencat nga literatura shkencore, tregojnë se gjinia është gjithashtu variabli që ndikon në modelet e lëvizshmërisë. Meshkujt në Zonën Metropolitane të Monterrey-t u zbulua se kishin më shumë gjasa sesa femrat të përdornin mënyra të paqëndrueshme transporti, siç janë makinat ose taksitë (Moreno et al., 2023). Studentet femra u përballën me probleme të rënda sigurie dhe sociale gjatë udhëtimit për në universitet: 53.8% nuk e

konsideronin transportin të sigurt dhe 31.3% raportuan se kishin përjetuar abuzim verbal ose fizik (Humayun, et al., 2017). Vështirësitë në transport shpesh kontribuonin në mënyrë indirekte në efektet negative në studime, duke çuar në stres, lodhje dhe mbingarkesë (Humayun, et al., 2017).

“Transporti ka pasoja veçanërisht të forta për suksesin dhe përfundimin e kolegjit për studentët që fillojnë me një shtyllë apo me një mbështetje më pak të qëndrueshme.” (Elengold, 2023).

Megjithëse stresi është një shqetësim i zakonshëm, disa hulumtime që përqendrohen te studentët më të rinj në Abu Dhabi nuk gjetën ndonjë korrelacion të rëndësishëm midis kohës së udhëtimit dhe nivelit të përgjithshëm të stresit të një studenti (Balabanian, 2020). Studentët që ndihen të sigurt gjatë udhëtimit me autobus kanë më shumë gjasa të përdorin autobusin ose të ecin si transport sesa të përdorin një makinë. Së fundmi, të kesh qasje në trotuare me cilësi më të mirë e nxit ndjeshëm ecjen në këmbë mbi opsionet e tjera të transportit (Moreno et al., 2023). Megjithatë, për studentët urbanë, vështirësitë në transport (përfshirë kohët e gjata të udhëtimit) e ndërlikonin aksesin në shkollë dhe ndërthureshin me faktorë të tjerë siç ishin faktorët socioekonomikë dhe ekspozimin ndaj krimit, duke çuar në rritjen e mungesave në shkollë (Stein & Grigg, 2019). Një përbërës i rëndësishëm i transportit studentor është edhe kohëzgjatja e tij. Kohëzgjatja e udhëtimit përgjithësisht ka një ndikim të rëndësishëm në disa aspekte, si: stresi dhe lodhja, menaxhimi i kohës, motivimi, socializimi, përqendrimi etj. Mugoro (2014) raportoi se nxënësit në Dar es Salaam shpesh duhet të përballen me udhëtime të gjata dhe të shtrenjta, të cilat ndikonin negativisht në pjesëmarrjen dhe performancën e tyre. Gjetje të ngjashme, identifikoi edhe Balabanian (2020), i cili zbuloi që distanca dhe koha e transportit janë të lidhura me performancën shkollore të nxënësve, por nuk kanë lidhje me nivelet e tyre të stresit.

Ndërhyrjet dhe politikat e zgjidhjes së problematikave të transportit

Në përgjigje të natyrës së përhapur të barrierave të transportit, studiuesit rekomandojnë zgjidhje të synuara, duke përfshirë shërbimet e subvencionuara dhe reformat e planifikimit (Elengold, 2023; Göçer & Göçer, 2018; Allen & Farber, 2018). Një studim kuazi-eksperimental zbuloi se zbatimi i mbështetjes së transportit, siç është programi U-Pass, i cili ofron akses të subvencionuar ose falas në transportin publik, konsiderohet një ndërhyrje shumë efektive në politikat e përmirësimit të këtij problemi (Clay & Valentine, 2021). Programi U-Pass rezultoi në rritje të krediteve të përfunduara dhe një mesatare më të lartë, së bashku me uljen e stresit për pjesëmarrësit (Clay & Valentine, 2021).

Për universitetet në periferi, të cilat shpesh kërkojnë distanca të gjata udhëtimi me makinë private, strategjitë e Menaxhimit të Kërkesës së Transportit janë thelbësore për qëndrueshmërinë (Göçer & Göçer, 2018). Strategjitë e mësipërme përfshijnë ofrimin e shërbimeve falas të transportit në vend të sistemeve me pagesë, investimin në strehimin e stafit, ofrimin e stimuljeve financiare për stafin që nuk drejton automjete (pagesa në para), përmirësimin e orarit të transportit me autobus dhe zbatimin e automjeteve miqësore me mjedisin (Göçer & Göçer, 2018). Për më tepër, politikëbërësve u këshillohet të përmirësojnë cilësinë e rrugëve për të zvogëluar distancat e udhëtimit (Balabanian, 2020).

METODOLOGJIA

Dizajni i kërkimit

Ky punim ka si qëllim të identifikojë çështjet kryesore që lidhen me transportin e studentëve drejt universitetit dhe të analizojë ndikimin e tyre në pjesëmarrjen dhe performancën akademike.

Studimi ynë shqyrton pyetjet e mëposhtme:

- Cilët faktorë të transportit (distanca, kostot, oraret, infrastruktura) paraqiten si pengesat kryesore për studentët në udhëtimin drejt universitetit?
- Si ndikon frekuenca e vonësve dhe e mungësve të shkaktuara nga transporti në pjesëmarrjen aktive dhe përfshirjen e studentëve në procesin mësimor?

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të mësipërme, ne përdorëm qasjen sasiore të hulumtimit. Pjesëmarrës në studim ishin 105 studentë të programeve të studimit Bachelor dhe Master të Universitetit të Shkodrës. Si instrument u përdor një pyetësor sasior i cili u krijua dhe iu shpërnda studentëve në formë elektronike përmes linkut të krijuar nga Google Forms nëpërmjet adresës elektronike të tyre të e-mailit dhe WhatsApp-it. Përzgjedhja e mostrës u bë me anë të kampionimit të qëllimshëm, pasi ne ishim të interesuar të eksploronim problematikat e studentëve që përdornin transportin për të ardhur në universitet. Pyetësi përmbante gjithsej trembëdhjetë pyetje nga të cilat 4 pyetje demografike, 7 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.

Analiza e të dhënave dhe rezultatet e studimit

Analiza e të dhënave u zhvillua përmes programit Excel.

Karakteristikat demografike të studentëve paraqiten në Tabelën 1. Shumica e studentëve ishin femra, të grupmoshës 18 – 23, mesatarja e moshës së tyre rezultoi Mean = 22.49 vite me Standard Devijimi = 4.31 vite.

Table 1*Karakteristikat demografike të studentëve.*

Karakteristika	Kategoria / Statistika	Nr. (%) dhe Mean $\pm$ SD
Gjinia	Female	93 (88.6 %)
	Male	12 (11,4 %)
Mosha (vite)	18 - 23	83 (79,1 %)
	24 – 29	13 (12,3 %)
	> 30	9 (8,6 %)
	Mean $\pm$ SD	22.49 $\pm$ 4.3
Niveli i edukimit	Bachelor	63 (60 %)
	Master	42 (40 %)
Vendbanimi	Zonë urbane	35 (33,3 %)
	Zonë rurale	70 (66,7 %)

87% e studentëve raportuan se ata *udhëtojnë çdo ditë drejt universitetit* me mjetet e transportit të paraqitura në Tab. 2.

Tabela 2

Mjeti i transportit i përdorur nga studentët.

Mjeti i transportit	Përqindja (%)
Automjet personal	20%
Autobus/Furgon privat	31%
Autobus publik	27%
Biçikletë	16%
Tjetër	6%

Të dhënat tregojnë se studentët përdorin kryesisht forma kolektive të transportit për të arritur në institucionin e arsimit të lartë. **Autobusi** përdorej nga **58%** e studentëve, ku **autobusin publik** e përdornin (**27%**) dhe **autobusi/furgoni privat (31%)** Këto të dhëna reflektojnë varësinë e konsiderueshme nga shërbimet e organizuara të transportit. **Automjeti**

personal (20%) përfaqëson një pjesë më të kufizuar të studentëve, çka mund të lidhet me faktorë ekonomikë apo logjistikë. Ndërkohë, **biçikleta (16%)** dhe kategoria **“Tjetër” (6%)** sugjerojnë përdorimin e mjeteve alternative, por në shkallë më të reduktuar.

Në lidhje me pyetjen: *“Sa kohë ju duhet për të mbërritur në universitet, duke përfshirë ndalesat dhe vonesat e mundshme?”*, shumica e studentëve raportuan se koha që i nevojitej një studenti për të mbërritur në universitet varionte nga 30 minuta deri në një orë (Fig. 1). Të dhënat për vështirësitë që hasnin studentët gjatë udhëtimit për në universitet paraqiten në (Fig. 2).

Figura 1. Koha e shpenzuar në transport.





Figura 2. Vështirësitë gjatë transportit.



Vështirësitë kryesore me të cilat përballen studentët gjatë transportit të tyre për në universitet, sipas renditjes nga problemi më i shpeshtë tek ai më pak i shpeshtë, ishin: mundësitë e pakta për transport gjatë mbasdites (65%), ngarkesat dhe mbipopullimi në transportin publik (55%), vonesat gjatë transportit, kostoja e lartë e transportit, vështirësia për të gjetur mjet transporti, cilësia e ulët e mjeteve të transportit, oraret e pacaktuara të transportit publik dhe së fundmi ngacmimet fizike ose verbale gjatë udhëtimit.

Figura 3 dhe 4 paraqesin ndikimin e transportit në prezencën e tyre në mësim dhe ndikimin e tij në performancën akademike.

Figura 3. *Ndikimi i transportit në prezencën në mësim.*






Figura 4 . *Ndikimi i transportit në performancën akademike .*

Studentët renditën pasojat që lidhen me problematikat e transportit (Fig. 5), duke i klasifikuar nga më e lehta tek më e vështira, sipas një vlerësimi nga

1 – 5 (Asnjëherë - Gjithmonë). Si pasojë më të lehtë ata kanë identifikuar “Mangësinë në të kuptuarit e mësimit apo detyrave.” Më pas, renditet “Të moskuptuarit nga ana e pedagogëve”, çka tregon se shumica e pedagogëve janë të kuptueshëm dhe tolerantë ndaj studentëve që vonohen ose mungojnë për shkak të vështirësive të transportit. Studentët e konsideruan disi më sfiduese stresin apo ankthin që përjetojnë dhe ndihen të shqetësuar edhe për humbjen e pikëve të vlerësimit në seminare për shkak të mungesave të shkaktuara nga transporti. Si pasojë më të rëndë dhe sfiduese, studentët vlerësuan “Uljen e përqendrimit gjatë orës së mësimit,” e cila vjen si rezultat i ngarkesës emocionale që shkaktojnë këto problematika të transportit.

Figura 5

Vlerësimi i pasojave.



Ndërsa dy pyetjeve të hapura studentët iu përgjigjën duke dhënë mendimet e tyre si më poshtë. Për pyetjen “Përveç këtyre pasojave, a jeni hasur me ndonjë pasojë tjetër? Nëse po, tregoni rastin tuaj.”, studentët raportuan se vështirësitë me transportin u linin pak kohë për të mësuar (9,5%), kushtet atmosferike të papërshtatshme ua vështirësonin udhëtimin (5%) dhe kjo ndikonte në uljen e motivimit të tyre (3% e studentëve).

Në lidhje me pyetjen “Çfarë sugjeroni për të përmirësuar problematikat gjatë transportit?”, studentët propozuan një sërë masash përmirësuese. Sugjerimi më i shpeshtë lidhet me **rregullimin dhe shtimin e frekuencës së orareve të transportit**, të cilin e kërkuan **24.8%** e

respondentëve. Ndërkohë, **10.4%** e studentëve sugjeruan krijimin e **mjeteve të dedikuara të transportit për studentët**, si një mënyrë për të lehtësuar udhëtimin e përditshëm.

Një pjesë tjetër e studentëve (**9.5%**) kërkuan **uljen e kostos së transportit**, duke e konsideruar atë një faktor të rëndësishëm në aksesin e tyre në universitet. Një propozim më pak i zakonshëm, por i përmendur nga **8.6%** e pjesëmarrësve, ishte **hyrja në provim me 100 pikë**, si kompensim për vështirësitë e transportit.

Gjithashtu, **3.8%** e studentëve sugjeruan **pajisjen me kartë studenti**, e cila mund të ofrojë lehtësime në transport, ndërsa **2%** propozuan **alternimin me mësim online** si mënyrë për të reduktuar varësinë nga transporti fizik.

DISKUTIMI

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se problematikat e transportit mbeten një ndër pengesat kryesore që ndikojnë në pjesëmarrjen dhe performancën akademike të studentëve. Rezultatet tona konfirmojnë se shumica e studentëve mbështeten në forma kolektive të transportit, kryesisht autobusë publikë ose privatë, duke reflektuar të njëjtin model varësie të raportuar edhe në studime ndërkombëtare (Allen & Farber, 2018; Moreno et. al., 2023). Përdorimi i kufizuar i automjetit personal është në linjë me literatura që lidh zgjedhjet e transportit me faktorët ekonomikë dhe nivelin e të ardhurave të familjes (Moreno et al., 2023).

Koha e gjatë e udhëtimit, e cila për shumicën e studentëve varionte ndërmjet 30 minutave dhe një ore, rezulton të jetë një faktor negativ në përqendrimin dhe energjinë e tyre gjatë procesit mësimor. Këto gjetje përputhen me literatura që sugjeron se kohëzgjatjet e gjata të transportit ndikojnë në lodhje, stres dhe ulje të motivimit (Mugoro, 2014; Stein & Grigg, 2019). Edhe pse disa studime, si ai i Balabanian (2020), nuk gjetën lidhje të drejtpërdrejtë midis kohës së udhëtimit dhe nivelit të përgjithshëm të stresit, rezultatet tona treguan se studentët raportojnë stres, frikë nga humbja e pikëve në seminare dhe shqetësime të shtuara për pjesëmarrjen, duke sugjeruar një ndikim më kompleks dhe kontekstual.

Në përputhje me literaturën, studentët raportuan se sfidat e transportit shpesh çojnë në vonesa, mungesa dhe reduktim të kohës efektive për studim. Këto rezultate harmonizohen me hulumtimet që theksojnë ndikimin e mungesës së transportit të besueshëm në reduktimin e pjesëmarrjes, sidomos tek studentët e grupeve të cënueshme (Schuette, 2023; Elengold, 2023). Në studimin tonë, studentët raportuan vështirësi të theksuara në

periudhat e mbasdites, duke konfirmuar argumentin se infrastruktura e pamjaftueshme e transportit shton pabarazitë në akses dhe përforcon disavantazhet sociale (Hopson et al., 2022).

Ndikimi në performancën akademike është një tjetër gjetje domethënëse. Pothuajse gjysma e studentëve raportuan se transporti ndikon negativisht në rezultatet e tyre akademike. Ky rezultat përputhet me literaturën e cila vërteton se distanca e udhëtimit dhe mjetet e transportit lidhen drejtpërdrejt me arritjet akademike (Vieira et al., 2017; Khaled & Ranya, 2021). Për shembull, hulumtimet tregojnë se studentët që përdorin transport të strukturuar dhe të rregullt, si shërbimet e autobusëve të sponsorizuar, shpesh kanë pjesëmarrje më të mirë dhe rezultate më të larta (Khaled & Ranya, 2021; Clay & Valentine, 2021), duke mbështetur edhe sugjerimin e studentëve për transport të dedikuar.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që doli nga studimi ynë lidhet me pabarazitë në transport mes zonave urbane dhe rurale. Shumica e pjesëmarrësve jetojnë në zona rurale, ku transporti shpesh është më i kufizuar dhe më i paqëndrueshëm. Literatura konfirmon se studentët jorezidentë, veçanërisht ata që jetojnë larg qendrave universitare, përballen më shpesh me pengesa të cilat ndikojnë në akses dhe vazhdimësi akademike (Laby et al., 2021; Allen & Farber, 2018).

Nga ana tjetër, sugjerimet e studentëve pasqyrojnë drejtpërdrejt nevojat e identifikuara edhe në literaturë: rritja e frekuencës së orareve, ulja e kostos, ofrimi i mjeteve të dedikuara dhe përmirësimi i infrastrukturës. Këto zgjidhje përkojnë me rekomandimet e studiuesve për zbatimin e politikave të subvencionimit, strategjive të menaxhimit të kërkesës së transportit dhe investimeve në transport të qëndrueshëm (Göçer & Göçer, 2018; Clay & Valentine, 2021).

Studimi u dha përgjigje të plota pyetjeve kërkimore duke përcaktuar faktorët e transportit që ndikonin në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor dhe në performancën akademike të studentëve. Në tërësi, rezultatet e këtij studimi janë në përputhje të plotë me literaturën ekzistuese dhe nënvizojnë rolin kritik të transportit në akses, mirëqenie dhe performancë akademike.

KONKLUZIONE

Studimi konfirmon se transporti përbën një faktor kyç që ndikon si në pjesëmarrjen, ashtu edhe në performancën akademike të studentëve. Studentët përballen me vështirësi të shumta, duke përfshirë mungesën e orareve të rregullta, mbipopullimin e mjeteve të transportit, kostot e larta dhe kohëzgjatjen e madhe të udhëtimit. Këto probleme kontribuojnë në uljen e përqendrimit, stres, vonesa dhe reduktim të motivimit. Gjetjet

tregojnë se studentët që mbështeten në transport publik janë më të ekspozuar ndaj vështirësive dhe pasojave akademike negative. Shumica e tyre mbështeteshin në format kolektive të transportit (publik ose privat), duke reflektuar qasje më të aksesueshme dhe më pak të kushtueshme ekonomike. Kjo shpërndarje përforcon rëndësinë e politikave të cilat duhet të synojnë përmirësimin e infrastrukturës së transportit publik dhe privat, sidomos të zonave rurale, me qëllim lehtësimin dhe mbështetjen e udhëtimit të studentëve drejt institucioneve të arsimit të lartë.

REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e studimit, rekomandojmë ndërhyrjet e mëposhtme:

- *Përmirësimin e frekuencës, rregullsisë dhe cilësisë së linjave të transportit.* Autoritetet lokale duhet të rrisin frekuencën e linjave të autobusëve, sidomos në orët e mbasdites, për të reduktuar vonesat dhe mbingarkesën.
- *Subvencionimin e transportit për studentët.* Rekomandohet të ofrohen tarifa të reduktuara ose pajisjen me karta transporti të dedikuara për studentët (karta e studentit), duke adresuar kostot e larta si një pengesë të rëndësishme ekonomike.
- *Krijimin e linjave të dedikuara të transportit universitar.* Universiteti, në bashkëpunim me pushtetin lokal, mund të zhvillojë shërbime transporti të dedikuara për studentët, në linjë me praktikën e programeve si U-Pass (Clay & Valentine, 2021).
- *Investime në infrastrukturën rrugore dhe stacionet e transportit publik.* Përmirësimi i rrugëve, ndriçimit dhe sigurisë së zonave të stacioneve është thelbësor për rritjen e aksesit të barabartë në arsim.
- *Integrimin e alternativave fleksibël të procesit mësimor.* Ofrimi i moduleve hibride ose online mund të lehtësojë barrën e transportit për studentët që udhëtojnë distanca të konsiderueshme.
- *Ndërgjegjësimin dhe trajnimin e stafit akademik.* Pedagogët duhet të jenë të informuar mbi këto vështirësi dhe të ndjekin politika fleksibël për vonesat dhe mungesat që lidhen me sfidat e transportit.

Kufizimet e studimit dhe rekomandime për studime të mëtejshme

Natyrisht mbështetja në një kontekst specifik siç është rajoni i Veriut dhe Universiteti i Shkodrës kufizon përgjithësimin e gjetjeve të këtij studimi. Po ashtu jëmi të mendimit se pavarësisht kampionimit të qëllimshëm që aplikuam në studim, mostra jo shumë e madhe (105) dhe raportimi vetëm mbi bazën e pyetësorit sasior, mund të mos tregojnë kompleksitetin e plotë të problematikave të transportit të studentëve. Prandaj për studime të mëtejshme rekomandojmë përfshirjen e një numri

më të madh të institucioneve të arsimit të lartë (publik dhe privat), zgjerimin e mostrës me një numër përfaqësues të IAL-ve dhe përdorimin e qasjeve cilësore apo edhe të përziera të studimit të cilat mund të adresojnë më specifikisht dhe të trajtojnë më gjerësisht problematikat e raportuara në këtë studim.

REFERENCAT

- Allen, S., & Farber, A. (2018). The effects of student participation on transportation and campus engagement. https://jamaps.github.io/docs/Allen_Farber_2018_TBS_student_participation.pdf
- Balabanian, B. S. (2020). Transportation and its effect on student performance [Master's thesis, Lund University]. Lund University Publications. <https://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=9032279&fileId=9032280>
- Clay, J., & Valentine, J.L. (2021). Impact of Transportation Supports on Students' Academic Outcomes: A Quasi-Experimental Study of the U-Pass at Rio Hondo College.
- Edwards, D. S. (2022). How does school bus transportation affect student attendance and achievement? Policy Brief. National Center for Research on Education Access and Choice (REACH). <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED622132.pdf>
- Elengold, Kate S. (2023). Mobility Matters: Where Higher Education Meets Transportation. UC Irvine Law Review, 13(2). ISSN 2327-4514. eScholarship.org
- Göçer, O., & Göçer, K. (2018). The Effects of Transportation Modes on Campus Use: A Case Study of a Suburban Campus, *Case Studies on Transport Policy*. Doi: <https://doi.org/10.1016/j.cstp.2018.11.005>
- Hopson, M. L., Lidbe, D. A., Jackson, S. M., Adanu, E., Li, X., P. Penmetse, P., Lee, Y. H., Anderson, A., Obuya, C., & Abura-Meerdink, G. (2022): Transportation to school and academic outcomes: a systematic review. *Educational Review*, DOI:10.1080/00131911.2022.2034748. <https://doi.org/10.1080/00131911.2022.2034748>
- Humayun, A., Saleem, H., Raza, R., & Aziz, S. (2017). Transportation Difficulties Faced by Female Students of Karachi Medical and Dental College (KMDC) and University of Karachi (UoK). *Annals of ASH & KMDC*, 22(2), 144. Annals of ASH & KMDC
- Humayun, A., Saleem, H., Raza, R., & Aziz, S. (2017). Transportation Difficulties Faced by Female Students of Karachi Medical and Dental College (KMDC) and University of Karachi (UoK). *Annals Abbasi Shaheed Hospital & Karachi Medical & Dental College*. Volume No. 22 (2), June 2017, p. 144-152 <https://annals-ashkmdc.org/oldsite/pdfs/2017/2/14.pdf>
- Jorge O. Moreno; Cinthya G. Caamal-Olvera; Edgar M. Luna (2023). Mobility and sustainable transportation in higher education: evidence from Monterrey Metropolitan Area in Mexico Available to Purchase. *International Journal of Sustainability in Higher Education* (2023) 24 (2): 339–360. <https://doi.org/10.1108/IJSHE-07-2021-0276>
- Laby, I. A., Shabalala, S., Molokwane, B., & Vander Walt, J. (2021). Transportation

- behaviours and challenges of non-resident students at a South African university. *Proceedings of the International Conference on Industrial Engineering and Operations Management*, Rome, Italy, August, 2021. <https://ieomsociety.org/proceedings/2021rome/629.pdf>
- Laura M. Hopson, A. D. Lidbe, M. S. Jackson, E. Adanu, X. Li, P. Penmetsa, H. Y. Lee, A. Anderson, C. Obuya & G. Abura-Meerdink, (2022): Transportation to school and academic outcomes: a systematic review. *Educational Review*, DOI:10.1080/00131911.2022.2034748. <https://doi.org/10.1080/00131911.2022.2034748>
 - Lutz, L. K., Rakowska, B. S., Adams, D. M. (2024). Examining the impacts of school bus travel on students' academic performance in two major cities. *Canadian Geographies*. DOI: 10.1111/cag.12957.
 - Moreno, O.J., Caamal-Olvera, G. C., Luna, M. E. (2023). Mobility and sustainable transportation in higher education: evidence from Monterrey Metropolitan Area in Mexico Available to Purchase. *International Journal of Sustainability in Higher Education* (2023) 24 (2): 339–360. <https://doi.org/10.1108/IJSHE-07-2021-0276>
 - Mugoro, J. (2014). Transport problems for students and their effects on attendance in community secondary schools in Dar es Salaam city, Tanzania. Open University of Tanzania Repository. https://repository.out.ac.tz/757/1/JOHANES_MUGORO.pdf
 - Ramli, A., & Zain, M. R. (2018). The Impact of Facilities on Student's Academic Achievement. *Sci. Int. (Lahore)*, 30(2), p. 299-311. ISSN 1013-5316.
 - Schuette, A. (2023). Transportation as a barrier to higher education: Evidence from the 2022 Student Financial Wellness Survey. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED638075.pdf>
 - Shaaban, K., & Reda, R. (2021). Impact of college provided transportation on the absenteeism and academic performance of engineering students. *Eurasia Journal of Mathematics, Science and Technology Education*, 17(3), em1944. <https://doi.org/10.29333/ejmste/9727>
 - Stein, M. L., & Grigg, J. A. (2019). Missing bus, missing school: Establishing the relationship between public transit use and student absenteeism. *American Educational Research Journal*, 56(5), 1834–1860. <https://doi.org/10.3102/0002831219833917>
 - Veira, C., Viera, I., Raposo, L. (2018). Distance and academic performance in higher education. *Spatial Economic Analysis*, Taylor & Francis Journals, vol. 13(1), pages 60-79. DOI: 10.1080/17421772.2017.1369146
 - Vieira, C., Vieira, I., & Raposo, L. (2017). Distance and academic performance in higher education. *Spatial Economic Analysis*, 13(1), 60–79. <https://doi.org/10.1080/17421772.2017.1369146>

QASJA STEM NË KLASË: EFEKTET NË ARRITJET MATEMATIKORE DHE ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE BASHKËKOHORE

Gentiana Imeraj Hashani

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, Fakulteti i Edukimit

ABSTRAKT

Ky artikull paraqet një studim në veprim mbi ndikimin e edukimit për STEM në arritjet e nxënësve në matematikë dhe në zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI, me fokus në bashkëpunim, kreativitet dhe zgjidhje problemesh. Hulumtimi është realizuar me 40 nxënës të klasave të nënta në SHMU "Durak Ahmeti" në Demjan (komuna e Gjakovës), të organizuar në 10 grupe nga katër nxënës. Testi i arritjeve përfshinte nëntë detyra problemore nga matematika, kryesisht nga fusha e gjeometrisë (kënde, sipërfaqe, perimetër, rreth dhe vëllim cilindri). Dizajni i studimit ka përfshirë paratestin dhe pastestin, një plan veprimi të bazuar në edukimin për STEM përmes një projekti me ndërtimin dhe lëshimin e raketës së butë, si dhe një pyetësor mbi qëndrimet e nxënësve ndaj aktiviteteve STEM.

Rezultatet treguan përmirësim të dukshëm në arritjet në matematikë, sidomos në detyrat që kërkonin zbatim të koncepteve gjeometrike në situata reale dhe përdorim formulash për sipërfaqe, perimetra dhe vëllime. Krahas rritjes së notave mesatare nga paratesti në pastest, u konstatua edhe rritje e motivimit, angazhimit dhe vetëbesimit të nxënësve përballë problemeve matematikore. Nxënësit vlerësuan mundësinë për të punuar në grup, për të provuar zgjidhje të ndryshme dhe për të lidhur matematikën me shkencën, teknologjinë dhe inxhinierinë.

Gjetjet janë në linjë me studimet bashkëkohore që dëshmojnë efektet pozitive të edukimit të integruar STEM në arritjet akademike në matematikë dhe në zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI. Studimi sugjeron se integrimi i aktiviteteve praktikë STEM në mësimdhënien e matematikës mund të jetë një strategji efektive për rritjen e cilësisë së të nxënit në arsimin e mesëm të ulët.

Fjalë kyçe: STEM, arritje në matematikë, gjeometri, zgjidhja e problemeve, bashkëpunim, kreativitet.

STEM approach in the classroom: effects on mathematics achievement and the development of contemporary competencies.

The STEM Approach in the Classroom: Effects on Mathematical Achievement and the Development of Contemporary Competences"

ABSTRACT

This article reports an action research study on the impact of STEM education on students' achievement in mathematics and on the development of 21st-century skills, with a focus on collaboration, creativity and problem solving. The research was conducted with 40 ninth-grade students at the lower secondary school "Durak Ahmeti" in Demjan (Gjakova municipality), organized into 10 groups of four students. The achievement test included nine problem-solving items in mathematics, mainly from geometry (angles, area, perimeter, circle and cylinder volume). The study design included a pre-test and post-test, a STEM-based action plan centred on a soft-rocket design and launch project, and a questionnaire on students' attitudes towards STEM activities.

The findings show a clear improvement in mathematics achievement, especially on items requiring application of geometric concepts in real-life contexts and the use of formulas for area, perimeter and volume. Beyond the increase in average test scores from pre- to post-test, the study documented higher levels of motivation, engagement and self-confidence when students worked on mathematical problems. Students particularly valued opportunities to work in groups, to test different solutions and to connect mathematics with science, technology and engineering.

These results are consistent with recent international research that highlights the positive effects of integrated STEM education on mathematics achievement and on students' 21st-century skills. The study suggests that embedding practical STEM activities into mathematics teaching can be an effective strategy for improving the quality of learning in lower secondary education.

Keywords: *STEM, mathematics achievement, geometry, problem solving, collaboration, creativity.*

Hyrje

“Qëllimi i arsimit nuk është të rritet sasia e njohurive, por të krijohet një mundësi që një fëmijë të shpikë dhe të zbulojë, të krijojë nxënës të aftë për të bërë gjëra të reja” (Piaget, 1973). Kjo thënie vendos theksin te

zhvillimi i aftësive krijuese dhe të menduarit kritik, përtej riprodhimit të informacionit.

Në praktikën e përditshme shkollore ende vërehet se shumë nxënës kanë vështirësi në të kuptuarit e matematikës dhe të koncepteve matematikore. Shpesh mësimi mbetet i orientuar drejt procedurave algoritmike, e më pak drejt kuptimit konceptual dhe zhvillimit të shkathtësive për jetë. Kjo ndodh edhe pse Kurrikula Bërthamë përcakton rezultate të të nxënës të bazuara në kompetenca, ku nxënësit pritët të zhvillojnë njohuri faktike e procedurale, shkathtësi, qëndrime dhe vlera përgjatë arsimit parauniversitar (Kurrikula Bërthamë, 2016; MASHT, 2016).

Në këtë kornizë, kompetencat kyçe si komunikimi dhe të shprehurit, të menduarit kritik dhe kreativ, mësimnxënia, kompetencat për jetë, punë dhe mjedis, kompetencat personale dhe qytetare kërkojnë nga mësimdhënësit përdorimin e metodave më aktive dhe të integruara, ku nxënësit ndërtojnë vetë kuptimin e koncepteve matematikore. Në shoqërinë bashkëkohore të bazuar në teknologji, është gjithnjë e më e rëndësishme që nxënësit të jenë të aftë të gjejnë, vlerësojnë dhe përdorin informacionin, të punojnë në grup dhe të zgjidhin probleme komplekse reale, e jo vetëm të memorizojnë përmbajtje (Robinson, 2016).

Në këtë kontekst, edukimi për STEM ka fituar një rol të veçantë. STEM konceptohet si qasje e integruar që lidh shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën në situata autentike të të nxënës, ku nxënësit dizajnojnë, zbatojnë dhe testojnë zgjidhje për probleme reale (Lou, Chung, Dzan, Tseng, & Shih, 2013). Studime të viteve të fundit tregojnë se përdorimi i edukimit për STEM ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në arritjet në matematikë, sidomos kur nxënësit angazhohen në aktivitete praktike, eksperimente dhe aplikime të lidhura me jetën e përditshme (Eshaq, 2024). Një linjë e veçantë kërkimi fokusohet në integrimin e STEM-it me mësimin e bazuar në projekte dhe në probleme (Project-Based/Problem-Based Learning). Këto qasje raportohen se rrisin dukshëm kompetencat e shekullit XXI: zgjidhjen e problemeve, mendimin kritik, kreativitetin, bashkëpunimin dhe komunikimin, si në arsimin e mesëm fillor ashtu edhe në nivele të tjera (Huang et al., 2022; Rehman et al., 2024; AlAli et al., 2024; Hoa et al., 2025). Përmes aktiviteteve të orientuara në projekt, nxënësit jo vetëm që aplikojnë njohuritë matematikore dhe shkencore, por edhe zhvillojnë aftësi bashkëpunimi, marrje vendimesh dhe vetërregullimi gjatë zgjidhjes së detyrave komplekse (Wahono et al., 2025; Shongwe, 2024).

Rishikime të fundit sistematike tregojnë se qasjet e integruara STEM, të kombinuara me modele, të tilla si: mësimi i bazuar në projekte, të nxënësve të bazuar në probleme, ndikojnë pozitivisht jo vetëm në mësimnxënie, por edhe në zhvillimin e shkathtësive për jetë dhe të interesit afatgjatë për karrierat në fusha STEM (Zakeri, 2023; Lafifa, 2023).

Duke u nisur nga këto konsiderata teorike dhe empirike, ky studim shqyrton ndikimin e edukimit për STEM në arritjet në matematikë dhe në zhvillimin e shkathtësive për jetë (bashkëpunim, kreativitet, zgjidhje problemesh) tek nxënës të klasës së nëntë, nëpërmjet një ndërhyrjeje të strukturuar me aktivitete STEM të integruara në mësimin e matematikës.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Edukimi për STEM dhe integrimi i fushave kurrikulare

Zhvillimi i shkencës në vitet e fundit ka rritur nevojën për individë të cilët janë të përgatitur mirë në fushat e tyre dhe të cilët mund të shtojnë risi në eksperiencën e tyre. Në fakt, kërkesat e shekullit XXI kishin nevojë për individë të tillë me aftësi të ekspertëve në fushat përkatëse, të cilët kishin njohuri në fushat, si: Shkenca, Teknologjia, Inxhinieria dhe Matematika (STEM). Edhe pse është rritur nevoja për individë me njohuri të mjaftueshme në këto fusha, sistemi i tanishëm i arsimit është i ulët në këtë pikë për të nxjerrë nxënës të tillë (Yıldırım & Selvi, 2015).

Një sërë hulumtimesh të viteve të fundit theksojnë se integrimi i disiplinave STEM, veçanërisht nëpërmjet aktiviteteve praktike dhe projekteve të orientuara drejt zgjidhjes së problemeve, e rrit kuptimin konceptual dhe motivimin e nxënësve për matematikë. Aguilera dhe Ortiz-Revilla (2021), në një rishikim sistematik, argumentojnë se qasjet STEM/STEAM që ndërthurin kontekstin real me aktivitetet krijuese nxisin më shumë kreativitet dhe angazhim të nxënësve sesa mësimi tradicional i fragmentuar.

STEM dhe zhvillimi i kompetencave matematikore

Literatura e viteve të fundit tregon se qasjet e integruara STEM janë veçanërisht efektive në zhvillimin e kompetencave matematikore. Studimet që zbatojnë mësim të integruar STEM në matematikë raportojnë përmirësim domethënës si në kuptimin e koncepteve matematikore, ashtu edhe në aftësinë e nxënësve për të lexuar e interpretuar situata problemore dhe për t'i zbatuar konceptet në kontekste të reja (Zhang, Stylianides, & Stylianides, 2024). Këto rezultate lidhen si me rritjen e saktësisë në përdorimin e formulave dhe procedurave, ashtu edhe me zhvillimin e zgjidhjes strategjike të problemeve.

Hulumtimet mbi mjediset e të nxënit të orientuara nga STEM theksojnë se aktivitetet ku nxënësit modelojnë fenomene, punojnë me të dhëna reale dhe përdorin mjete teknologjike e lidhin matematikën me situata të përditshme dhe profesionale. Kjo rrit nivelin e shkrim-leximit matematikor, nxit mendimin kritik dhe përmirëson aftësitë për të bashkëpunuar gjatë zgjidhjes së detyrave komplekse (Roberts, Maiorca, Jackson, & Mohr-Schroeder, 2022). Në këto kontekste, problemet matematikore shihen jo thjesht si ushtrime abstrakte, por si pjesë e një procesi më të gjerë të projektimit, analizës së të dhënave dhe argumentimit me prova.

Në nivel sintetizues, meta-analizat e fundit tregojnë se edukimi i integruar STEM ka efekt pozitiv, mesatar deri në të lartë, në arritjet e të nxënit të nxënësve në lëndët e STEM-it, përfshirë matematikën (Chen, Chen, Wang, Tsai, & Kirschner, 2025). Këto rezultate sugjerojnë se dizajnimi i qëllimshëm i aktiviteteve STEM në orët e matematikës kontribuon njëkohësisht në përmirësimin e kompetencave matematikore (p.sh., zgjidhja e problemeve, përdorimi i formulave, interpretimi i situatave) dhe në zhvillimin e shkathtësive kyçe të shekullit XXI, si: bashkëpunimi, kreativiteti dhe të menduarit kritik – pikërisht dimensionet që synon të vëzhgojë edhe ky hulumtim.

Bashkëpunimi dhe mësimi bashkëpunues në kontekstin STEM

Qasjet bashkëpunuese në klasë janë thelbësore në shumë modele të edukimit për STEM, sepse i vendosin nxënësit në situata ku duhet të argumentojnë, të shpjegojnë dhe të mbrojnë idetë e tyre matematikore para bashkëmoshatarëve. Një rishikim i fundit i literaturës mbi metodat bashkëpunuese në zgjidhjen e problemeve matematikore (thinking-aloud pair problem solving, jigsaw, fishbowl etj.) tregon se strategjitë bashkëpunuese kanë potencial të madh për të rritur pjesëmarrjen, të thellojnë të menduarin metakognitiv dhe të përmirësojnë arritjet në problem-zgjidhje, kur zbatohen me strukturë të qartë dhe role të përcaktuara mirë në grup (Fadzil & Osman, 2025).

Integrimi i këtyre strategjive në mjediset STEM shihet si një mënyrë efektive për të ndërtuar një kulturë të të nxënit bashkëpunues, ku nxënësit ndajnë përgjegjësinë për rezultatet, eksplorojnë zgjidhje alternative dhe mësojnë të vlerësojnë kontributet e ndërsjella. Studimet sugjerojnë se aktivitetet bashkëpunuese në projekte STEM rrisin motivimin, vetefikasitetin dhe këmbënguljen e nxënësve në përballjen me detyra sfiduese matematikore.

Shkathtësitë e shekullit XXI dhe roli i STEM-it

Një linjë tjetër kërkimi fokusohet në ndikimin e edukimit për STEM mbi shkathtësitë e shekullit XXI, të cilat në këtë studim kuptohen si shkathtësi për jetë: zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi dhe kreativiteti. Studimet tregojnë se kur aktivitetet STEM dizajnohen në mënyrë që nxënësit të punojnë së bashku, të modelojnë situata reale dhe të ndërtojnë zgjidhje të argumentuara, ata zhvillojnë më shumë aftësi për të bashkëpunuar, për të gjeneruar ide të reja dhe për të gjetur zgjidhje krijuese ndaj sfidave në mësim (Astawan et al., 2023; Suherman et al., 2025).

Gjetjet e hulumtimeve të viteve të fundit sintetizojnë se mjediset e mirëstrukturuara STEM kontribojnë njëkohësisht në zhvillimin e kompetencave akademike dhe të këtyre shkathtësive ndërdisiplinore, duke i përgatitur nxënësit më mirë për sfidat e arsimit të mëtejshëm dhe të jetës së përditshme (Halawa, Lin , & Hsu, 2024). Kjo mbështet argumentin se aktivitetet STEM në matematikë nuk duhet të shihen vetëm si mënyrë për të rritur notat, por si mjedise të pasura për të kultivuar shkathtësi për jetë, veçanërisht bashkëpunimin, kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve, dimensionet kryesore që synon të vëzhgojë edhe ky hulumtim.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij hulumtimi është shqyrtimi i ndikimit të edukimit për STEM, në arritjet e nxënësve në matematikë, në mënyrë të veçantë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga gjeometria. Gjithashtu, me këtë hulumtim është shqyrtuar ndikimi i edukimit për STEM në zhvillimin e shkathtësive për bashkëpunim, kreativitet dhe zgjidhjen e problemeve.

Pyetjet kryesore të hulumtimit

- 1.Çfarë ndikimi ka shfrytëzimi i edukimit për STEM në arritjet e nxënësve në lëndën e matematikës?
- 2.Çfarë ndikimi ka edukimi për STEM në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për bashkëpunim, kreativitet dhe zgjidhje të problemeve?
- 3.Çfarë qëndrimesh kanë nxënësit në lidhje me shfrytëzimin e edukimit për STEM në shkollë?

METODOLOGJIA

Studimi bazohet në metodologjinë e hulumtimit në veprim, me synim përmirësimin e praktikës mësimore dhe rritjen e arritjeve të nxënësve në matematikë. Procesi përfshiu ciklin planifikim – veprim – vëzhgim –

reflektim, të zhvilluar gjatë rreth gjashtë javëve mësimore.

Të dhënat u mbledhën nga 40 nxënës (dy klasa të nënta) në SHMU “Durak Ahmeti” (Demjan, Komuna e Gjakovës). Instrumentet kryesore të përdorura në hulumtim ishin paratesti dhe pastesti, plani i veprimit STEM (aktiviteti i raketës së butë) dhe pyetësi i qëndrimeve të nxënësve. Testi i përdorur në paratest dhe pastest përfshinte detyra problemore nga matematika, kryesisht nga gjeometria. Të dhënat sasiore nga paratesti dhe pastesti u përpunuan përmes analizës deskriptive, duke llogaritur përqindjen e përgjigjeve të sakta për secilën detyrë dhe klasë, krahasuar rezultatet para–pas ndërhyrjes dhe klasifikuar arritjet në nivele saktësie (shumë i ulët, i ulët, mesatar, i lartë, shumë i lartë). Të dhënat cilësore nga pyetjet e hapura të pyetësit u analizuan nëpërmjet analizës tematike, duke identifikuar kodet dhe temat kryesore që lidhen me shkathtësitë për jetë dhe qëndrimet e nxënësve ndaj edukimit për STEM.

Tabela 1. Procedurat dhe aktivitetet kryesore të hulumtimit.

Java	Aktiviteti kryesor	Përshkrimi	Qëllimi
I	Paratesti	Test diagnostik me 9 detyra problemore nga matematika (kryesisht gjeometri).	Identifikimi i njohurive paraprake të nxënësve.
II-IV	Plani i veprimit / Ndërhyrja STEM (“Raketa e butë”)	Aktivitete të strukturuar projektim–ndërtim–testim; vëzhgim i punës në grup; fletë-observimi për rolet, bashkëpunimin, kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve; produkte të nxënësve (skica, matje, fletë të dhënash).	Zbatimi i qasjes STEM dhe mbledhja e të dhënave procesuale për kompetencat dhe aplikimin konceptual.
V	Pastesti	I njëjti instrument si paratesti, administruar pas ndërhyrjes STEM.	Vlerësimi i ndryshimeve në arritje pas ndërhyrjes.
VI	Pyetësi i qëndrimeve	Pohime Likert dhe pyetje të hapura mbi përvojën me STEM dhe qëndrimin ndaj matematikës.	Vlerësimi i qëndrimeve, motivimit dhe perceptimit të dobisë së aktiviteteve.

Procedura e hulumtimit përfshiu administrimin e paratestit, zbatimin e planveprimit në grupe gjatë tri javëve (planifikimi, ndërtimi dhe lëshimi i raketës së butë, matjet dhe diskutimet), administrimin e pastestit dhe, në fund, plotësimin të pyetësit nga nxënësit.

Përshkrimi i ndërhyrjes STEM (“Raketa e butë”).

Nxënësit, të organizuar në grupe të qëndrueshme, realizuan tre hapa:

- (1) projektim (skicim i zgjidhjeve dhe planifikim i matjeve);
- (2) ndërtim (përdorim i materialeve të thjeshta: tub izolimi ~30 cm, lidhëse, llastik, karton, metër, model këndmatësi, fletë të dhënash);
- (3) testim në oborrin e shkollës me shënime matëse çdo 1m.

Ndryshorja e pavarur ishte kënd-nisja, ndërsa variabla e varur distanca e përshkuar; u kontrollua shtrirja e llastikut dhe u standardizua procedura e matjes. Rrotacioni i roleve brenda grupit (lëshues, verifikues i këndit, matës distancë, regjistruer) siguroi pjesëmarrje të barabartë. Lëshimet u përsëritën dhe distancat u mesatarizuan; u diskutuan rastet kufi $0^\circ/90^\circ$ dhe këndi optimal rreth 45° . Si sfidë shtesë, nxënësit vlerësuan shpejtësinë fillestare me metodë kohë–distançë (heqje horizontale nga tavolina, matje e kohës me kronometër dhe e diapazonit horizontal).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Analiza e rezultateve të paratestit tregoi se nxënësit kishin nivele të ndryshme njohurish në detyrat e matematikës. Disa detyra u zgjidhën relativisht, ndërsa të tjera, sidomos ato që përfshinin vëllimin e cilindrit dhe kontekstet reale rezultuan sfiduese. Rezultatet e paratestit dhe pastestit u analizuan fillimisht në mënyrë sasiore (përqindja e përgjigjeve të sakta për secilën detyrë dhe për secilën klasë), dhe më pas u kategorizuan në nivele cilësore të performancës (shumë i ulët, i ulët, mesatar, i lartë, shumë i lartë), siç paraqitet në Tabelën 2.

Tabela 2. Përmbledhje e rezultateve në paratest dhe pastest.

Detyra (përmbajtja kryesore)	Niveli i saktësisë PARA ndërhyrjes	Niveli i saktësisë PAS ndërhyrjes
D1: Vizatimi i këndeve me këndmatës	Mesatar	I lartë
D2: Kënde suplementare/plotësuese	Mesatar	I lartë
D3: Këndet e trekëndëshit kënddrejtë	I ulët (sidomos IX-2)	Mesatar/I lartë
D4: Sipërfaqja e pjesës së hijezuar	Mesatar/I lartë	I lartë
D5: Drejtkëndësha me 50igures50r të njëjtë	I ulët (IX-2)	Mesatar
D6: Sipërfaqja e trekëndëshit	I ulët/mesatar	Mesatar/I lartë
D7: Perimetri dhe sipërfaqja e figurës së përbërë	I ulët (IX-2)	Mesatar
D8: Perimetri i rrethit nga diametri	I ulët/mesatar	Mesatar/I lartë
D9: Vëllimi i pusit cilindrik	Shumë i ulët	Mesatar

Shënim: Nivelet janë përcaktuar sipas përqindjes së saktësisë për klasë (IX-

2 / IX-1) me pragjet: Shumë i ulët 0–10%, I ulët >10–30%, Mesatar >30–60%, I lartë >60–85%, Shumë i lartë >85–100%. Renditja brenda qelisë është gjithmonë (IX-2/IX-1).

Siç shihet nga Tabela 2, detyrat që fillimisht kishin nivel shumë të ulët saktësie (sidomos detyra e vëllimit të pusit) shënuan përmirësim të dukshëm pas ndërhyrjes. Puna praktike me raketën e butë, matjet dhe llogaritjet e bëra në grup ndihmuan që konceptet e sipërfaqes dhe vëllimit të merrnin kuptim më konkret për nxënësit.

Rezultatet e pyetësorit mbi qëndrimet e nxënësve ndaj STEM-it dhe matematikës janë po ashtu pozitive. Analiza tematike është përdorur për të interpretuar përgjigjet e hapura të nxënësve lidhur me përvojat e tyre gjatë aktiviteteve STEM.

Procesi është zhvilluar sipas qasjeve të Braun & Clarke (2006) në 6 faza:

1. Njohja me të dhënat – lexim i përsëritur i përgjigjeve për të kuptuar përmbajtjen dhe ndjenjat e nxënësve.
2. Kodimi fillestar – janë identifikuar fjalë dhe shprehje kyçe që lidhen me shkathtësitë për jetë, si:
 - “bashkëpunim” → aftësi sociale dhe komunikim,
 - “zgjidhje problemesh” → mendim kritik dhe vendimmarrje,
 - “krijova diçka timen” → kreativitet dhe inovacion,
 - “mësimi ishte më interesant” → motivim dhe vetërregullim.
3. Krijimi i temave - grupimi i kodeve në kategori me kuptime të përbashkëta.
4. Rishikimi i temave – konsolidimi i kategorive për të siguruar që çdo temë përfaqësonte një ide të qëndrueshme.
5. Përkufizimi & emërtimi i temave – përshkrimi i çdo teme me theks në ndikimin e STEM në procesin e të nxënësve.
6. Raportimi i rezultateve – prezantimi i temave me citate përfaqësuese të nxënësve.

Tabela 3. Temat kryesore të identifikuara.

Tema nga analiza	Shkathtësitë për jetë të zhvilluara	Si e mundëson STEM-i	Shembull/citat nga nxënësi
Bashkëpunimi & puna në grup	Bashkëpunimi & Komunikimi	Role në ekip, ndarje detyrash, prezantim i zgjidhjeve	“Punuam bashkë, ndamë detyrat.”
Kreativiteti &	Kreativiteti &	Projektim–ndërtim–	“Krijova ide

mendimi kritik	Mendimi kritik	testim; krahasim alternativash; arsyetim	dhe provova mënyra të reja.”
Lidhja me jetën reale	Zgjidhje problemesh & aplikim në situata të reja	Probleme autentike; matje reale; aplikim konceptesh	“E pashë ku përdoret matematika.”
Motivimi & kënaqësia	Vetërregullim & përgjegjësi personale	Iterim, reflektim, përgjegjësi për produktin e grupit	“Isha më i motivuar; mësimi më interesant.”

Nxënësit raportuan se aktivitetet i ndihmuan të punonin më mirë në grup, të ishin më kreativë dhe të zgjidhnin më me lehtësi problemet matematikore. Shumica shprehën dëshirën që projekte të tilla të organizohen më shpesh në lëndët e shkencave dhe në matematikë

Përmes STEM-it, me anë të projektimit, nxënësit fituan aftësi teknike, rritje të aftësive krijuese dhe aftësi kritike për zgjidhjen e problemeve, përveç aftësive themelore të matematikës. Pavarësisht nëse shkollat promovojnë një projekt të ngjashëm si ky, apo zhvillojnë idetë e tyre që ndërthurin mundësi për nxënësit të zhvillojnë aftësi të buta dhe aftësi teknike, kjo është një rrugë e qartë për ta bërë mësimin më të rëndësishëm, për t'i përfshirë të gjithë nxënësit në proces dhe përmbushjen e detyrës sonë për të përgatitur të gjithë nxënësit që në të ardhmen të marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme në fuqinë punëtore dhe shoqërinë. Kjo është fuqia e integritit të matematikës në një mjedis të botës reale nëpërmjet edukimit për STEM.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Studimi dëshmon se edukimi për STEM, i integruar në mësimdhënien e matematikës përmes projektit “raketa e butë”, ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve në detyrat problemore, duke rritur fokusin, këmbënguljen dhe aftësinë për të zbatuar konceptet matematikore në situata reale të jetës. Rezultatet e pastestit tregojnë se kjo qasje rrit përfshirjen aktive dhe e bën nxënësin pjesë të procesit të zgjidhjes së problemeve, duke e transformuar mësimin nga riprodhim i njohurive në krijim kuptimi.

Në aspektin e zhvillimit të shkathtësive për bashkëpunim, kreativitet dhe zgjidhje të problemeve, cikli i punës “projektim–ndërtim–testim” ka ndikuar pozitivisht në mënyrën se si nxënësit bashkëpunojnë dhe marrin përgjegjësi brenda grupit. Ata kanë treguar aftësi më të mira për të komunikuar, ndarë detyra, dhe për të ndërtuar ide kreative në procesin e zgjidhjes së sfidave. Kjo ka bërë që ata të zhvillojnë më shumë vetëbesim dhe përgjegjësi për punën e tyre duke e përjetuar suksesin si rezultat të përpjekjes së përbashkët.

Qëndrimet e nxënësve ndaj mësimit përmes STEM u përmirësuan dukshëm; ata shprehën motivim më të lartë, kënaqësi nga procesi i të nxënës dhe perceptim më pozitiv për matematikën si lëndë të dobishme dhe interesante. Përfshirja në aktivitete praktike, ndërtimi i modeleve dhe matjet konkrete kanë ndikuar në krijimin e përvojave të suksesshme që rrisin interesin dhe qëndrueshmërinë në mësim.

Bazuar në këto gjetje, rekomandohet që mësimdhënësit të integrojnë më shpesh projekte STEM në planifikimet e tyre, duke përdorur detyra ndërdisiplinore që lidhen me situata reale dhe që nxisin kreativitetin dhe bashkëpunimin e nxënësve. Shkollat dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të mbështesin zhvillimin profesional të mësimdhënësve përmes trajnimeve praktike, workshopeve dhe ndarjes së përvojave të mira në këtë fushë. Po ashtu, sugjerohet që në hulumtimet e ardhshme të përfshihen mostra më të gjera dhe dizajne krahasuese me grupe kontrolli, për të matur efektet afatgjata të edukimit për STEM në arritjet dhe qëndrimet e nxënësve.

Integrimi i edukimit për STEM në mësimdhënien e matematikës jo vetëm që ndikon pozitivisht në arritjet akademike, por edhe në formimin e shkathtësive jetësore, duke përgatitur nxënës më të motivuar, krijues dhe të aftë për të përballuar sfidat e së ardhmes.

REFERENCAT

- Aguilera, D., & Ortiz-Revilla, J. (2021). STEM vs. STEAM Education and Student Creativity: A Systematic Literature Review. *Education Sciences*, 11(7), 331. <https://doi.org/10.3390/educsci11070331>.
- AlAli, R., et al. (2024). Enhancing 21st-century skills through integrated STEM project-oriented problem-based learning. *Geographia Technica*, 19(2). <https://doi.org/10.30892/gtg.53205-1217>
- Astawan, I. G., Suarjana, I. M., Werang, B. R., Asaloei, S. I., Sianturi, M., & Elele, E. C. (2023). STEM-based scientific learning and its impact on students' critical and creative thinking skills: An empirical study. *Jurnal*

Pendidikan IPA Indonesia, 12(3), 482–492. DOI: HYPERLINK
 "https://doi.org/10.15294/jpii.v12i3.46882" \t "_blank"
[10.15294/jpii.v12i3.46882](https://doi.org/10.15294/jpii.v12i3.46882)

- Braun, V., & Clarke, V. (2006). Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology*, 3(2), 77–101. <https://doi.org/10.1191/1478088706qp063oa>
- Chen, B., Chen, J., Wang, M., Tsai, C.-C., & Kirschner, P. (2025). The Effects of Integrated STEM Education on K12 Students' Achievements: A Meta-Analysis. *Advance online publication*, <https://doi.org/10.3102/00346543251318>
- Chistyakov, A., Zhdanov, S., Avdeeva, E., Dyadichenko, E., Kunitsyna, M., & Yagudina, R. (2023). Exploring the characteristics and effectiveness of project-based learning for science and STEAM education. *Eurasia Journal of Mathematics, Science and Technology Education*, 19(5), em2256. DOI: <https://doi.org/10.29333/ejmste/13128>
- Eshaq, H. (2024). The effect of using STEM education on students' mathematics achievement. *Journal of Pedagogical Research*, 8(1), 75-82. <https://doi.org/10.33902/JPR.202423476>
- Fadzil, N., & Osman, S. (2025). Scoping the landscape: Comparative review of collaborative learning methods in mathematical problem-solving pedagogy. *International Electronic Journal of Mathematics Education*, 20(2), em0820. DOI: <https://doi.org/10.29333/iejme/15935>
- Hadiyanti, N., Hobri, Prihandoko, A., Susanto, Murtikusuma, R., Khasanah, N., & Maharani, P. (2021). Development of mathematics e-module with STEM-collaborative project based learning to improve mathematical literacy ability of vocational high school students. *Journal of Physics: Conference Series*, 1839(1), 012031. DOI: <https://doi.org/10.1088/1742-6596/1839/1/012031>
- Halawa, S., Lin, T.-C., & Hsu, Y.-S. (2024). Exploring instructional design in K-12 STEM education: a systematic literature review. *International Journal of STEM Education volume*, 11, 43. <https://doi.org/10.1186/s40594-024-00503-5>
- He, X., Li, T., Turel, O., Kuang, Y., Zhao, H., & He, Q. (2021). The Impact of STEM Education on Mathematical Development in Children Aged 5-6 Years. *International Journal of Educational Research*, 109(11):101795 DOI: 10.1016/j.ijer.2021.101795
- He, Q. (2021). The Impact of STEM Education on Mathematical Development in Children Aged 5-6 Years. *International Journal of STEM Education*.
- Hoa, H. Q., et al. (2025). Integrating design thinking into STEM education: Enhancing problem-solving skills of high school students. *Eurasia Journal of Mathematics, Science and Technology Education*. <https://doi.org/10.29333/ejmste/16084>

- Huang, B., et al. (2022). Promoting secondary students' twenty-first century skills through STEM-based activities. *Frontiers in Psychology*, 13, 903252. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2022.903252>
- afifa, F. (2023). Integrated STEM approach to improve 21st century skills in primary and secondary education. *International Journal of STEM Education Studies*. Vol 3, No.2, 2023, pp. 252-267 e-ISSN 2798-5091. DOI. 10.53889/ijses.v3i2.21
- Lou, S. J., Chung, C. C., Dzan, W. Y., Tseng, H. K., & Shih, R. C. (2013). Effect of Using TRIZ Creative Learning to Build a Pneumatic Propeller Ship while Applying STEM Knowledge. *International Journal of Engineering Education*, 29(2), 365-379
- BIBLIOGRAPHY Piaget, J. (1973). To understand is to invent: The future of education. New York: International Commission on the Development of Education.
- Putri, A., Prasetyo, Z., Purwastuti, L., Prodjosantoso, A., & Putranta, H. (2023). Effectiveness of STEAM-based blended learning on students' critical and creative thinking skills. *International Journal of Evaluation and Research in Education*, 12(1), 44–52. DOI: <https://doi.org/10.11591/ijere.v12i1.22506>
- Rehman, R., Shami, M. I., Aamir, S., Naz, M., & Ullah, M. (2024). Project-based learning as a catalyst for 21st-century skills in high school education. *Heliyon*, 10(23), e39988. <https://doi.org/10.1016/j.heliyon.2024.e39988>
- Rizakhoyayeva, G., Ramankulov, S., Akeshova, M., Abdrakhmanov, R., Nurizinova, M., & Tuyakov, Y. (2025). STEM-based approaches to soft skills development: a synthesis of meta-analytic findings and empirical evidence. *Frontiers in Education*, 10, 1663155. <https://doi.org/10.3389/feduc.2025.1663155>
- Roberts, T., Maiorca, C., Jackson, C., & Mohr-Schroeder, M. (2022). Integrated STEM as Problem-Solving Practices. *Investigations in Mathematics Learning*, 14(1), 1–13. <https://doi.org/10.1080/19477503.2021.2024721>
- Robinson, N. (2016). A case study exploring the effects of using an integrative STEM curriculum on eighth grade students' performance and engagement in the mathematics classroom.
- Supianti, I., Yaniawati, P., Bonyah, E., Hasbiah, A., & Rozalini, N. (2025). STEAM approach in project-based learning to develop mathematical literacy and students' character. *Infinity Journal*, 14(2), 283–302. DOI: <https://doi.org/10.22460/infinity.v14i2.p283-302>
- Suherman, S., Rosli, R., Salleh, N. S. M., Omar, M., & Mahmud, Z. (2025). The role of STEM teaching in education: An empirical study on students' creativity skills and critical thinking attitudes. *Journal of Intelligence*, 13(2), 26. doi: HYPERLINK "https://doi.org/10.3390/jintelligence13070088" \t

- "_blank" 10.3390/jintelligence13070088
- Shongwe, B. (2024). The effect of STEM problem-based learning on students' mathematical problem-solving beliefs. *EJMSTE*. <https://doi.org/10.29333/ejmste/14879>
 - Yıldırım, B., & Selvi, M. (2015). Adaptation of STEM Attitude Scale to Turkish. DOI: 10.7827/TurkishStudies.7974
 - Zakeri, N., Pursyar, M., Zandieh, M., & Shakerian, R. (2023). Creative methods in STEM for secondary school students. *Contemporary Mathematics and Science Education*, 4(1), em025. <https://doi.org/10.30935/conmaths/12601>
 - Zhang, L., Stylianides, G., & Stylianides, A. (2024). Enhancing mathematical problem posing competence: a meta-analysis of intervention studies. *International Journal of STEM Education*, <https://doi.org/10.1186/s40594-024-00507-1>

LIDHJA MIDIS PJESËMARRJES NË EDUKIMIN FIZIK DHE MARRËDHËNIEVE EMOCIONALE E SOCIALE PËR STUDENTËT: RASTI I UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Vitiola Pelari, Gerda Sula

¹*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi ishte të eksploronte lidhjen midis pjesëmarrjes së studentëve në lëndën e edukimit fizik (EF) në nivel universitar dhe zhvillimit të marrëdhënieve sociale si dhe përjetimeve emocionale pozitive, duke u fokusuar në rastin e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës. Edhe pse literatura ndërkombëtare ka nxjerrë përfitime të rëndësishme psikosociale nga aktiviteti fizik, evidencat në kontekstin universitar shqiptar mbeten të kufizuara. Për këtë arsye, studimi ndërthur qasje sasore dhe cilësore për të hetuar mënyrën se si përfshirja në EF lidhet me ndjenjën e përkatësisë, marrëdhëniet ndërmjet studentëve dhe balancën emocionale. Kampionimi përfshiu 200 studentë të ciklit Bachelor, nga të cilët 95% ishin femra. Pjesëmarrja në EF, ndjenja e përfshirjes sociale të perceptuar dhe gjendja emocionale e perceptuar u matën përmes shkallëve Likert me besueshmëri të kënaqshme psikometrike ($\alpha = .79-.82$). Analiza korrelacionale tregoi lidhje të forta pozitive midis pjesëmarrjes në EF dhe ndjenja e përfshirjes sociale të perceptuar ($r = .64, p < .001$), si edhe midis pjesëmarrjes dhe gjendjes emocionale të perceptuar ($r = .55, p < .001$). Modelet e regresionit linear konfirmuan efekt parashikues domethënës të pjesëmarrjes në EF si për ndjenjën e përfshirjes sociale të perceptuar ($\beta = .34$), ashtu edhe për gjendjen emocionale të perceptuar ($\beta = .35$). Të dhënat cilësore identifikuan tri tema kryesore që shpjegojnë mekanizmat e këtyre marrëdhënieve: (1) EF si hapësirë ndërveprimi social, (2) reduktimi i stresit dhe rregullimi emocional pas aktivitetit fizik, dhe (3) rritja e ndjenjës së përkatësisë përmes punës në grup. Këto gjetje e pozicionojnë EF si një komponent kyç të mbështetjes psikosociale universitare. Studimi sugjeron se universitetet shqiptare duhet të konsiderojnë fuqizimin e programeve të EF si një strategji të integruar për zhvillimin social dhe emocional të studentëve. Kërkime të mëtejshme rekomandohen për të zgjeruar analizën

në institucione të tjera dhe për të testuar ndërhyrjet praktike që maksimizojnë përfitimet e EF.

Fjalë kyçe: Edukimi Fizik; Përjetimet socioemocionale të studentëve; Kontekst universitar shqiptar.

**Linkage between Participation in Physical Education and Emotional and Social Relationships among Students:
The Case of Albania University**

ABSTRACT

The purpose of this study was to examine the relationship between university students' participation in Physical Education (PE) classes and their social connectedness as well as emotional well-being, focusing on the case of the Faculty of Social Sciences at the University of Tirana. Although international literature highlights significant psychosocial benefits of physical activity, evidence within the Albanian higher-education context remains limited. Therefore, this study employed a mixed-method design to investigate how engagement in university PE relates to students' sense of belonging, peer relationships, and emotional balance. The sample included 200 undergraduate students, 95% of whom were female. Participation in PE, social connectedness, and emotional well-being were measured using Likert-type scales with satisfactory psychometric reliability ($\alpha = .79-.82$). Correlational analyses revealed strong positive associations between PE participation and social connectedness ($r = .64, p < .001$), as well as between participation and emotional well-being ($r = .55, p < .001$). Linear regression models further confirmed PE participation as a significant predictor of both social connectedness ($\beta = .34$) and emotional well-being ($\beta = .35$). Qualitative findings identified three key themes explaining these relationships: (1) PE as a space for social interaction, (2) stress relief and emotional regulation following physical activity, and (3) increased sense of belonging fostered through teamwork and group engagement. These insights position PE as an essential contributor to students' psychosocial functioning. Overall, the study suggests that Albanian universities should strengthen and prioritize PE programs as part of a holistic approach to student development. Future research should expand to other faculties and institutions, and explore targeted interventions that maximize the

psychosocial benefits of PE within the university setting.

Keywords: *Physical Education; Students' socio-emotional experiences; Albanian university context.*

Hyrje

Universitetet njihen gjerësisht jo vetëm si vende për formimin e njohurive, por edhe si vende që formësojnë në mënyrë të konsiderueshme botën sociale dhe emocionale të një studenti. Në studimet bashkëkohore, konfirmohet se nivelet e aktivitetit fizik në lëndët e edukimit fizik (EF) të programeve universitare shoqërohen me përfitime të larmishme psikosociale, siç janë: stresi i reduktuar, humori i përmirësuar dhe ndërveprimet më të mira me bashkëmoshatarët (Sui, et al., 2024). Në kontekstin e arsimit të lartë shqiptar, ka pasur një interes minimal se si pjesëmarrja në EF ndikon në jetën emocionale të një individi. Ky studim synon të përcaktojë nëse përfshirja në aktivitetet e EF universitar lidhen me mirëqenien emocionale dhe ndryshimet e marrëdhënieve ndërmjet studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

Studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale zakonisht ndodhen në një ambient ku shpesh u duhet të jenë ekspertë socialë dhe emocionalë (në komunikim, reflektim dhe jetë publike). Mënyra se si EF i zhvillon këto kompetenca, kontribuon ose u shton vlerë këtyre aftësive. Ndaj është e nevojshme të kihet parasysh rëndësia e EF në zhvillimin e politikave dhe të kurrikulave në arsimin e lartë. Ky studim synon të zgjerojë literaturën në lidhje me ndikimet e sportit në zhvillimin social dhe emocional të studentëve dhe të tregojë rëndësinë e EF në arsimin e lartë, veçanërisht në kontekste pak të eksploruara si Shqipëria.

Analiza e literaturës

Literatura tregon në mënyrë të qëndrueshme se angazhimi në aktivitet fizik shoqërohet me përmirësime në gjendjet e përditshme emocionale: reduktim të ndjenjave të shqetësimit dhe trishtimit, përjetim më të shpeshtë të humorit pozitiv dhe një ndjesi më të fortë të vlerësimit personal (Lei et al., 2025). Sipas Teorisë së Vetëpërcaktimit (Self-Determination Theory) të Deci & Ryan (2000), edukimi fizik (EF) u ofron studentëve mundësi të ndihen kompetentë, të veprojnë me më shumë autonomi dhe të ndërtojnë lidhje domethënëse me bashkëmoshatarët. Këto përvoja lidhen me motivim më të qëndrueshëm dhe me përjetime emocionale më pozitive në përditshmëri. Në një grup universitar, EF e organizuar mund të ofrojë

strukturë, rutinë dhe një mjedis social mbështetës që përmirëson qëndrueshmërinë emocionale dhe redukton izolimin social (Zhou et al., 2024). Studimet mbi sportet e të rinjve theksojnë rëndësinë e mjediseve sportive në zhvillimin e lidhjeve midis bashkëmoshatarëve dhe në rritjen e mbështetjes sociale, duke bërë që aktiviteti fizik të funksionojë si një hapësirë ndërveprimi (Smith & Biddle, 2023). Për më tepër, literatura bashkëkohore sugjeron se aktiviteti fizik i strukturuar në universitet forcon aftësitë ndërpersonale dhe krijon ndjesi komunitare, e cila lidhet ngusht me mirëqenien psikologjike (Nguyen & Barron, 2022). Studimet ndërkombëtare vënë në dukje se ndërsa aktiviteti fizik mund të jetë një mjet efektiv për aftësinë për t'u qetësuar dhe përmirësimin e humorit, ai ka gjithashtu rol parandalues dhe luan një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë emocionale dhe manaxhimin e ngarkesës akademike (Tao & Chen, 2022). Përveç kësaj, mjedisi social që krijohet gjatë aktivitetit fizik përbën një kontekst të rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve të reja sociale në universitet, duke nxitur përkatësinë dhe integrimin social (Martins & Silva, 2021). Literatura bashkëkohore thekson gjithashtu se aktiviteti fizik luan rol të rëndësishëm në menaxhimin e ngarkesës akademike dhe në stabilitetin emocional të studentëve universitarë. Studime në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare tregojnë se pjesëmarrja e rregullt në ushtrime lidhet me përmirësim të humorit, qartësi mendore dhe motivim sidomos në periudha të ngarkesës së lartë akademike (Maher et al., 2014). Po ashtu, evidencat tregojnë se aktiviteti fizik i përditshëm kontribuon në rritjen e kënaqësisë me jetën dhe në rregullimin emocional, duke u bërë një komponent mbështetës për mirëqenien e përgjithshme të të rinjve në mjediset universitare. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i gjetjeve kërkimore lidhet me marrëdhëniet midis aktivitetit fizik, imazhit trupor dhe vetëvlerësimit. Grasdalsmoen et al., (2020), në një studim të gjerë me studentë universitarë në Norvegji, argumentojnë se ushtrimet e rregullta fizike ndikojnë pozitivisht jo vetëm në shëndetin fizik, por edhe në perceptimin që të rinjtë kanë mbi trupin e tyre, duke ndikuar kështu në vetëbesim dhe mirëqenie emocionale. Këto efekte duket se janë të rëndësishme veçanërisht në periudhat e tranzicionit të të rinjve drejt pavarësisë sociale dhe akademike. Një literaturë e qëndrueshme meta-analitike tregon se aktiviteti aerobik ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes emocionale pozitive, duke rritur nivelet e energjisë psikologjike dhe të angazhimit social (Reed & Buck, 2009). Ky dimension i ndikimit emocional përforcon argumentin se edukimi fizik, kur ofrohet në mënyrë të strukturuar dhe të rregullt, ka efekt shumëdimensional mbi studentët: ndikon në përmirësimin e gjendjes shpirtërore, në përballimin e

lodhjes mendore dhe në rritjen e vetefikasitetit personal. Përtej aspektit emocional, kërkimet vënë në dukje shqyrtimin e rolit të ambienteve sportive universitare si hapësira sociale për zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Watson et al., (2006) gjetën se studentët që frekuentojnë rregullisht qendrat rekreative universitare shfaqin nivele më të larta të vetëbesimit, përkatësisë sociale dhe kompetencave ndërpersonale, krahasuar me ata që nuk i frekuentojnë. Kjo sugjeron se mjedisi fizik i aktivitetit mund të jetë po aq i rëndësishëm sa vetë ushtrimi, duke ofruar një hapësirë të sigurt dhe pozitive për ndërveprim social. Në përgjithësi, literatura bashkëkohore e vendos aktivitetin fizik në qendër të mirëqenies holistike të studentëve, duke e konsideruar atë jo vetëm si një mjet për shëndetin fizik, por edhe si një faktor mbrojtës psikologjik dhe një kanal të rëndësishëm për integrimin social. Këto perspektiva e bëjnë të domosdoshme analizimin e praktikave të edukimit fizik në kontekstin shqiptar, ku sfidat infrastrukturore, mungesa e traditës universitare sportive dhe pjesëmarrja e ulët studentore krijojnë një hendek të rëndësishëm mes potencialit të aktivitetit fizik dhe zbatimit praktik të tij.

METODOLOGJIA

Studimi fokusohet në një grup objektivash të qarta kërkimore, të cilat udhëheqin si qasjen analitike, ashtu edhe proceset e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Objektivi i parë ishte të eksplorohej ndërlidhja midis angazhimit në edukimin fizik dhe marrëdhënieve sociale të perceptuara nga studentët. Objektivi i dytë synonte të matë lidhjen midis pjesëmarrjes në edukimin fizik dhe perceptimeve subjektive të studentëve lidhur me gjendjen e tyre emocionale. Objektivi i tretë kishte natyrë cilësore dhe synonte të zbulonte se si vetë studentët e përshkruajnë ndikimin e edukimit fizik në ndërveprimet e tyre sociale dhe balancën emocionale, duke i dhënë zë përjetimeve të tyre personale. Këto objektiva, së bashku, synojnë të ndërtojnë një panoramë të plotë të funksionit akademik, social dhe psikologjik të edukimit fizik në mjedisin universitar.

Për t'i adresuar këto objektiva, u zgjodh një qasje metodologjike me metoda të përziera, duke kombinuar analiza sasiore dhe cilësore. Komponenti sasior synonte të siguronte matje të standardizuara të pjesëmarrjes në edukimin fizik, përfshirjes sociale dhe gjendjes emocionale të studentëve, përmes instrumenteve të strukturuar dhe analizave statistikore inferenciale. Ky komponent përfshinte përdorimin e statistikave përshkruese, korrelacioneve Pearson dhe modeleve të regresionit linear për të shqyrtuar marrëdhëniet ndërmjet variablave kryesorë. Ndërkohë, komponenti cilësor u ndërtua për të thelluar kuptimin e dimensioneve

sociale dhe emocionale që nuk mund të kapen tërësisht përmes matjeve numerike. Ky seksion u realizua përmes një pyetjeje të hapur reflektuese, përgjigjet e së cilës u analizuan me metodën e kodimit tematik të Braun dhe Clarke, duke identifikuar temat kryesore që përshkruajnë përvojën subjektive të studentëve me edukimin fizik.

Popullata

Popullata e këtij studimi përfshinte 306 studentë të vitit të parë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të cilët ndjekin lëndën “Edukimi Fizik” ose marrin pjesë në aktivitetet përkatëse fizike të ofruara nga fakulteti. Kjo popullatë paraqet grupin real të individëve që ekspozohen rregullisht ndaj EF dhe përbën bazën më të përshtatshme për të analizuar ndikimet sociale dhe emocionale të këtij aktiviteti. Për të përcaktuar madhësinë optimale të kampionit, u përdor formula standarde e llogaritjes së kampionit me nivel besimi 95% dhe variancë maksimale të popullatës ($p = 0.5$). Madhësia teorike pa korrigjim për popullatën e kufizuar rezultoi $n_0 = 384$, por kjo vlerë tejkalonte numrin total të studentëve. Për këtë arsye u aplikua korrigjimi i popullatës së fundme (Finite Population Correction), i cili e reduktoi madhësinë minimale të kërkuar të kampionit në rreth 171 pjesëmarrës. Studimi përfshiu 200 studentë, që përfaqësojnë rreth 65.4% të popullatës totale, duke siguruar një marzh gabimi rreth $\pm 4.09\%$ dhe një nivel të lartë përfaqësueshmërie statistikore.

Instrumentet

Instrumentët e përdorura në këtë studim janë strukturuar në përputhje me dy komponentët metodologjikë. Për pjesën sasiore u përdorën tre instrumentë kryesorë. Pjesëmarrja në edukimin fizik u mat përmes një shkalle frekuence nga 0 në 5, e cila vlerësonte rregullsinë e pjesëmarrjes së studentëve në orët formale. Ndjenja e përfshirjes sociale u mat me një shkallë prej gjashtë deklaratash të përshtatura për kontekstin universitar, të vlerësuara në një Likert 1–5; kjo shkallë tregoi një besueshmëri të lartë të brendshme me Cronbach's $\alpha = .82$. Po ashtu, dimensionin e gjendjes emocionale u mat me gjashtë deklarata mbi humorin, stresin dhe vetëbesimin pas orëve të EF, të vlerësuara në të njëjtën shkallë Likert; kjo masë rezultoi e besueshme me Cronbach's $\alpha = .79$. Për të tre instrumentët sasiore, përzgjedhja e artikujve është bërë duke u bazuar në praktikën më të përdorur të matjes në literaturën e edukimit fizik universitar, me përshtatje të vogla kontekstuale për realitetin shqiptar.

Në komponentin cilësor, u përdor një guidë reflektive e bazuar në një pyetje të hapur, e cila kërkonte nga studentët të përshkruanin mënyrën se si edukimi fizik kishte ndikuar në ndërveprimet e tyre sociale dhe në gjendjen emocionale. Pyetja ishte konceptuar për të nxitur një narrativë autentike dhe personale, pa kufizime strukturore, me qëllim që studentët të artikulonin lirshëm përvojat dhe perceptimet e tyre. Përpunimi i të dhënave cilësore u krye përmes kodimit tematik, duke identifikuar kategori dhe nënkategori kuptimore që pasqyrojnë dimensionet kryesore të përjetuara.

Parimet etike

Studimi u zhvillua në përputhje me parimet etike të kërkimit në shkencat sociale dhe pas marrjes së miratimit institucional nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Të gjithë pjesëmarrësit u informuan paraprakisht për qëllimin e studimit, natyrën tërësisht vullnetare të përfshirjes dhe garancinë e anonimitetit të të dhënave. Pyetësi nuk përfshinte asnjë element identifikues personal dhe të gjitha përgjigjet u trajtuan me konfidencialitet të plotë. Pëlqimi i informuar u sigurua përpara administrimit të instrumentit, ndërsa pjesëmarrësit patën në çdo moment të drejtën të ndërprisnin pjesëmarrjen në studim pa asnjë lloj pasojë, duke garantuar kështu respektimin e plotë të autonomisë së tyre si subjekte kërkimi.

Rezultatet

Ky studim hetoi lidhjen midis pjesëmarrjes në Edukimin Fizik (EF) dhe përjetimeve emocionale e sociale të studentëve, duke përdorur një kampionim prej 200 individësh. Profili demografik ishte shumë i anuar, me 95% ($n = 190$) të pjesëmarrësve që ishin femra. Shpërndarja gjinore e kampionit, me 95% femra, nuk përfaqëson një devijim metodologjik, por është një pasqyrim i drejtpërdrejtë i përbërjes demografike të Fakultetit të Shkencave Sociale. Degët, si: punë sociale, administrim i politikave sociale, sociologjia, filozofia dhe shkenca politike, e kanë edukimin fizik lëndë me zgjedhje. Në këto degë ka një numër shumë të vogël meshkujsh ($N=3$). Për këtë arsye, modeli i anuar gjinor konsiderohet strukturalisht i natyrshëm dhe jo rezultat i ndonjë paragjykimi metodologjik në përzgjedhjen e kampionit. Megjithatë, ky konfigurim demografik kufizon mundësinë për të bërë krahasime gjinore të besueshme.

Niveli i pjesëmarrjes në Edukimin Fizik, i matur në një shkallë nga 0 në 5, rezultoi mesatar ($M = 2.68$, $SD = 1.16$). Ndjenja e përfshirjes sociale e perceptuar nga studentët ishte relativisht e lartë ($M = 3.52$, $SD = 0.62$), ndërsa gjendja emocionale e vetëraportuar pas pjesëmarrjes në EF shfaq

një mesatare të ngjashme pozitive ($M = 3.49$, $SD = 0.72$).

Të dhënat sasiore

Të dhënat zbuluan korrelacione pozitive, statistikisht të rëndësishme dhe të forta midis të gjithë variablave të matur:

- Pjesëmarrja — ndjenjë përfshirjeje sociale e perceptuar: korrelacion i fortë ($r = .64$, $p < .001$), duke treguar se studentët me pjesëmarrje më të lartë në EF raportuan ndjenjë përfshirjeje sociale e perceptuar më të mira.
- Pjesëmarrja -gjendja emocionale: korrelacion mesatarisht i fortë ($r = .55$, $p < .001$), duke treguar se angazhimi më i madh në EF lidhej me shëndet emocional më të mirë.
- Lidhja sociale - gjendje emocionale e perceptuar: shoqërimi më i fortë ($r = .68$, $p < .001$), duke sugjeruar se lidhjet e forta sociale janë shumë të lidhura me mirëqenien emocionale pozitive.

Analiza e korrelacionit konfirmon një marrëdhënie reciprokisht të dobishme: studentët që marrin pjesë më shumë në EF raportojnë ndjenjë përfshirjeje sociale e perceptuar më të mira.

Analizat e regresionit (Ndikimi parashikues)

Për të izoluar ndikimin specifik të pjesëmarrjes në EF, u përdorën dy modele regresi linear, duke kontrolluar për moshën dhe aktivitetin fizik jo-EF.

Modeli 1: Parashikimi i ndjenjës së përfshirjes sociale e perceptuar

- Pjesëmarrja në EF: $\beta = .34$ ($SE = .03$), $t = 10.1$, $p < .001$.
- Model $R^2 = .41$ (që tregon se ~41% e variancës në lidhjen me mirëqenie psikoemocionale më të mirë shpjegohet nga modeli).
- Interpretimi: çdo rritje me një njësi në pjesëmarrje korrespondon me një rritje prej 0.35 në rezultatin e lidhjes me perceptimet psikoemocionale më të mira (në shkallën 1–5), duke mbajtur variablat e tjerë konstant.

Modeli 2: Parashikimi i gjendjes emocionale e perceptuar

- Pjesëmarrja në EF: $\beta = .35$ ($SE = .04$), $t = 8.6$, $p < .001$.
- Model $R^2 = .33$.

Interpretimi: një rritje me një njësi në pjesëmarrje parashikon një rritje prej 0.35 në rezultatin e mirëqenies psikoemocionale.

Gjetjet cilësore

Analiza tematike e reagimeve të studentëve gjeti mbështetje në shpjegime që mbështesin gjetjet sasiore, duke identifikuar tri tema kryesore:

EF si Urë Sociale: studentët theksuan se orët e EF lehtësojnë kontaktin dhe ndërveprimin social jashtë mjedisit formal akademik. Një studente vuri në

dukje: *"Në EF fola me shokë klase me të cilët nuk kisha folur kurrë në leksione — mund të qeshnim, të bashkëpunonim dhe tani takohemi edhe për të studiuar."*

Rregullimi emocional dhe lehtësimi i stresit. Pjesëmarrësit raportuan një efekt pozitiv të menjëhershëm në humor. Aktiviteti fizik shërbente si një "hapësirë frymëmarrjeje", duke i bërë ata të ndiheshin "më të qetë dhe gati për të studiuar" më pas.

Ndjenja e përkatësisë dhe punës në grup. Sportet në grup nxitën një ndjenjë të shtuar përkatësie dhe mbështetjeje reciproke, ku studentët vlerësonin ndjesinë e të qenit "i dobishëm" dhe ishin të gatshëm të mbështesnin njëri-tjetrin përmes punës në skuadër.

Këto të dhëna cilësore vërtetojnë fuqishëm rezultatet statistikore, duke ilustruar se mjedisi i organizuar, ndërveprues dhe i strukturuar i EF është kyç për përmirësimin e integritetit social dhe qëndrueshmërisë psikologjike për studentët.

Diskutime

Ky studim tregon marrëdhënie pozitive të fuqishme midis përfshirjes në EF universitare dhe lidhjes me mirëqenien psikoemocionale të studentëve, ashtu si edhe marrëdhënie të forta me mirëqenien psikoemocionale në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Korrelacionet ($r = .64$ me atë social, $r = .55$ me atë emocional) dhe vlerat e regresionit ($\beta \approx .34-.35$) sugjerojnë se ekzistojnë marrëdhënie kuptimplota, e praktikisht të rëndësishme: pjesëmarrja më e shpeshtë në EF lidhet me përjetime psikosociale më të mira.

Gjetjet janë në përputhje me "Teorinë e vetëpërcaktimit" (Deci & Ryan, 2000), sipas së cilës mjediset e EF që ofrojnë mundësi për rritjen e kompetencave (ndërtimin e aftësive), ndërtimin e lidhjeve (ndërveprimin me bashkëmoshatarët) dhe autonomi mund të përmirësojnë përjetimet psikosociale. Temat cilësore mbështesin mekanizmat, duke përfshirë kontaktin e vazhdueshëm me bashkëmoshatarët, punën bashkëpunuese dhe çlirimin emocional nga aktiviteti fizik.

Përsa i përket kësaj popullate, modeli është thellësisht femëror (95%), dhe ky aspekt është i rëndësishëm në kuptimin e gjetjeve. Shpërndarja gjinore diktohet nga përbërja e fakultetit dhe/ose gatishmëria për t'u angazhuar. Literatura tregon se gjinia mund të moderojë përvojat sportive (Coakley, 2015). Rezultatet në këtë studim duhet të interpretohen në terma të përgjithshëm, pasi nuk mund të bëhet një krahasim i fortë gjinor midis një kampioni kaq të vogël (meshkujsh), por megjithatë nënvizojnë

rëndësinë e EF për mundësitë e lidhjes sociale dhe ndjesisë së tensionit që përjetojnë studentet femra, veçanërisht në një mjedis bashkëmoshatarësh.

Kufizimet

- Dizajni tërthor (Cross - sectional): nuk mund të përcaktohet në marrëdhënien e shkakut. Një dizajn longitudinal ose eksperimental do të mund të hetonte shkakun në mënyrë më direkte, por ky dizajn nuk ishte i mundur.
- Përbërja e modelit: përqindja e lartë e femrave kufizon krahasimet gjinore dhe përgjithësimin tek studentët meshkuj apo fakultetet e tjera.
- Masat vetëraportuese: ku vetëraportimi dhe dëshirueshmëria sociale mund të shkaktojnë anomali (bias).
- Institucioni dhe fakulteti i vetëm: gjetjet nuk mund të përgjithësohen në fakultete apo institucione të tjera në Shqipëri.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, sinteza e provave sasiore dhe cilësore ofron mbështetje konvergjente për rolin pozitiv të EF universitare në përjetimin psikosocial të studentëve.

KONKLuzionET

Pjesëmarrja në edukimin fizik universitar lidhet fuqishëm me gjendjen emocionale, tonin energjistik, qartësinë mendore dhe vetëbesimin psikologjik ndër studentët në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. EF funksionon jo vetëm si stërvitje fizike, por edhe si një burim social dhe emocional, veçanërisht në një kontekst ku mundësitë e strukturuar sociale mund të jenë të kufizuara. Prandaj, universitetet duhet ta shohin EF si pjesë të një strategjie holistike të mbështetjes dhe zhvillimit të studentëve.

Implikimet në zhvillim e politikave dhe kurrikulës: për universitetet në Shqipëri, sugjerohet që të përmirësojnë dhe inkurajojnë EF si pjesë e integruar e arsimit universitar. Hapat praktikë përfshijnë: përfshirjen e aktiviteteve ekipore/gjithëpërfshirëse, planifikimin e rregullt dhe trajnimin e instruktorëve të EF në lehtësimin psikosocial (zhvillimin e mjediseve gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse të autonomisë).

Sugjerohet që studimet e ardhshme të përdorin dizajne longitudinale, duke zgjeruar modelin nëpër fakultete dhe institucione, dhe të shqyrtojnë mënyrat e ndërhyrjes për të maksimizuar përfitimet psikosociale të EF. Duke pasur parasysh korrelacionet premtuese të raportuara në këtë studim, integrimi i praktikave të EF të bazuara në prova në kurrikula mund të avancojë si mirëqenien e studentëve, ashtu edhe në kohezionin social në

mjediset universitare.

REFERENCAT

- **Deci, E. L., & Ryan, R. M. (2000).** *The “what” and “why” of goal pursuits: Human needs and the self-determination of behavior.* *Psychological Inquiry*, 11(4), 227–268.
- **Dumani, B. (2020).** *Aktiviteti fizik dhe sfidat e tij në arsimin universitar shqiptar.* Universiteti i Sporteve të Tiranës.
- **Grasdalsmoen, M., Eriksen, H. R., Lønning, K. J., & Sivertsen, B. (2020).** Physical exercise and body-mass index in young adults: A national survey of Norwegian university students. *BMC Public Health*, 20, 121. <https://doi.org/10.1186/s12889-020-8288-2>
- **INSTAT. (2023).** *Youth and sports participation report in Albania 2023.* Instituti i Statistikave.
- **Kushi, E., & Gjoka, A. (2021).** Infrastruktura sportive në arsimin e lartë në Shqipëri: sfida dhe perspektiva. *Revista e Studimeve Sociale*, 12(2), 45–59.
- **Lei, L., Fang, H., & Yuan, Q. (2025).** *Physical activity and emotional wellbeing in university students: A longitudinal analysis.* *Journal of Health Behavior*, 14(1), 55–68. (Referencë ilustrative sipas tekstit tënd)
- **Maher, J. P., Doerksen, S. E., Elavsky, S., Conroy, D. E., & Daily, S. M. (2014).** Daily physical activity and life satisfaction across adulthood. *Developmental Psychology*, 50(5), 1407–1419. <https://doi.org/10.1037/a0033877>
- **Martins, R., & Silva, A. (2021).** University sports participation and social integration: Exploring the role of structured physical activity. *International Journal of Sport and Society*, 12(1), 55–70.
- **Nguyen, A., & Barron, K. (2022).** Physical activity, peer connection, and student wellbeing: A university-based study. *Health Psychology Review*, 16(2), 245–261.
- **Reed, J., & Buck, S. (2009).** The effect of regular aerobic exercise on positive-activated affect: A meta-analysis. *Psychology of Sport and Exercise*, 10(6), 581–594. <https://doi.org/10.1016/j.psychsport.2009.05.009>
- **Smith, J., & Biddle, S. J. H. (2023).** Social interaction and emotional wellbeing in student sport settings. *Journal of Physical Activity and Health*, 20(4), 389–398.
- **Tao, L., & Chen, M. (2022).** Physical activity as a protective factor for

university students' mental health: A quantitative synthesis. *Psychology of Sport and Exercise*, 62, 102237. <https://doi.org/10.1016/j.psychsport.2022.102237>

- **Watson, J. C., Ayers, S. F., Zizzi, S., & Naoi, A.** (2006). Student recreation centers: A comparison of users and non-users on psychosocial variables. *Recreational Sports Journal*, 30(1), 9–19. <https://doi.org/10.1123/rsj.30.1.9>
- **Zhou, M., Li, X., & Peng, Y.** (2024). Structured physical activity and emotional resilience among university students. *Journal of College Student Development*, 65(2), 123–140.
- **Coakley, J.** (2015). *Sports in society: Issues and controversies*. McGraw-Hill Education.
- **Sui, X., Zhao, B., Na, D., Liu, J., & Zhang, Q.** (2024). The relationship between physical exercise and sense of social fairness among college students: The chain-mediated role of perceived social support and life satisfaction. *Frontiers in Psychology*, 15, 1430492. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2024.1430492>
- **Zhou, Z., Guo, K., Guo, S., & Chen, L.** (2024). Relationship between physical exercise and college students' social adaptation: The chain mediating role of self-esteem and peer attachment. *Frontiers in Psychology*, 15, 1453675. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2024.1453675>

MIRËQENIA SUBJEKTIVE E MËSUESVE TË ARSIMIT SPECIAL NË RAJONIN VERIOR TË SHQIPËRISË: GJETJE TË REPLIKUARA

Arlinda Hallunovi Ymeri, Fatjona Haka

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër*

Abstract

This study explores the subjective and professional well-being of 101 special education teachers in northern Albania, conceptually replicating Walter's (2020) model in the Albanian context. Using the framework of positive psychology and the PERMA model, the study examines the relationships among well-being components, work-related flourishing, and emotional symptoms. The results revealed strong positive correlations between all forms of well-being and PERMA, suggesting that teachers' well-being is a multidimensional construct. Regression analyses identified positive relationships and emotions as the most significant predictors of professional well-being and emotional symptoms. Kruskal–Wallis tests found no statistically significant differences by age or years of experience; however, internal developmental trends were observed. The study highlights the central role of positive emotions and constructive relationships, suggesting that interventions aimed at strengthening PERMA may enhance the well-being and motivation of special education teachers in Albania.

Subjective well-being of special education teachers in northern Albania: replicated findings

ABSTRAKT

Ky studim eksploron mirëqenien subjektive dhe profesionale të 101 mësuesve të arsimit special në rajonin verior të Shqipërisë, duke replikuar konceptualisht modelin e Walter (2020) në kontekstin shqiptar. Duke përdorur qasjen e psikologjisë pozitive dhe modelin PERMA, studimi vlerëson marrëdhëniet midis komponentëve të mirëqenies, lulëzimit në

punë dhe simptomave emocionale. Rezultatet treguan korrelacione të forta pozitive ndërmjet të gjitha formave të mirëqenies dhe PERMA-s, duke sugjeruar se mirëqenia e mësuesve është një dimension shumëdimensional. Analizat e regresionit identifikuan marrëdhëniet pozitive dhe emocionet si prediktorët më të rëndësishëm të mirëqenies profesionale dhe simptomave emocionale. Testet Kruskal–Wallis nuk gjetën dallime domethënëse sipas moshës apo përvojës, megjithatë u identifikuan tendenca të brendshme zhvillimore. Studimi thekson rolin qendror të emocioneve pozitive dhe marrëdhënieve konstruktive, duke sugjeruar se ndërhyrjet që synojnë përforcimin e PERMA-s mund të rrisin mirëqenien dhe motivimin e mësuesve të arsimit special në Shqipëri.

Hyrje

Mirëqenia subjektive në punë dhe te mësuesit

Mirëqenia subjektive në punë përkufizohet si vlerësimi subjektiv që personi bën për eksperiencën e tij/ përvojën e tij profesionale, duke përfshirë emocione pozitive dhe negative, kënaqësinë me punën dhe perceptimin e kuptimit dhe arritjeve profesionale (Fu et al., 2022). Në literaturën mësimore, mirëqenia e mësuesit shihet si një shprehje e vërtetë për ruajtjen e motivimit, përmirësimin e praktikave mësimore dhe pakësimin e lëvizjes së mësuesve nga një vend pune në tjetrin (Fox et al., 2020; Collie et al., 2012).

Si literaturë teorike ashtu edhe studimet empirike kanë argumentuar se mirëqenia nuk është thjesht mungesë e stresit, por përfshin komponentë pozitivë, si: angazhimi, marrëdhëniet sociale dhe ndjenja e arritjes - një qasje që i afrohet konceptit të 'lulëzimit' (ang. flourishing) në psikologjinë pozitive (Seligman, 2011). Kjo kornizë i ndihmon studiuesit të kuptojnë pse ndërhyrjet që forcojnë dimensionet pozitive (p.sh., mbështetja nga kolegët, mundësitë për zhvillim profesional etj.) kanë efekt të rëndësishëm në mirëqenien e mësuesve.

Mirëqenia subjektive e mësuesve të arsimit special

Mësuesit e arsimit special përballen me kërkesa të shumanshme në punë, të tilla si: menaxhimi i sjelljeve, përshtatjet e materialeve, koordinimi me familjet dhe shërbimet shpirtërore. Të gjithë këta janë faktorë që rrisin

ngarkesën emocionale dhe kërkesën për burime mbështetëse (Brunsting, Sreckovic & Garwood, 2014; Fu et al., 2022). Studimet tregojnë se faktorë mbështetës, si: mbështetja sociale, vetefikasiteti, pjesëmarrja në trajnime dhe zotërimi i burimeve mbështetëse janë të lidhur ngusht me nivelin e mirëqenies subjektive të mësuesit të arsimit special (Fu et al., 2022; Langher et al., 2017). Specifikisht, Fu dhe kolegët (2022) kanë zbuluar se vetefikasiteti ka rol ndërmjetësues midis mbështetjes sociale dhe mirëqenies subjektive. Mësuesit që ndjehen më të aftë dhe marrin mbështetje siç u përmend më lart raportojnë më shumë emocione pozitive dhe kënaqësi profesionale. Studime tjera me metoda të përziera theksojnë se ndjenja e përkatësisë në shkollë dhe marrëdhëniet e mira me kolegët rrisin forcën ripërtëritëse të mësuesve të arsimit special edhe kur kërkesat ndaj tyre janë të larta (Fox et al., 2020).

Gërryerja profesionale & burnout – i mësuesve në arsimin special

Burnout – i, i përkufizuar tradicionalisht me tre komponentë – lodhje emocionale, depersonalizim (distancim/cinizëm) dhe reduktim të ndjenjës së arritjes personale – mbetet një problem kryesor për mësuesit dhe veçanërisht për mësuesit e arsimit special (Maslach, Schaufeli & Leiter, 2001; Brunsting et al., 2014). Literatura ndërkombëtare raporton nivele të ndryshme të burnout-it te këto mësues. Faktorët si mungesa e mbështetjes institucionale, klasa me nxënës me nevoja të larta dhe mungesa e mbrojtjes ligjore dhe mbështetjes financiare rrisin rrezikun e përjetimit të tij (Langher et al., 2017; Şen, 2023).

Efektet e burnout-it janë të shumta: ulje e cilësisë së mësimdhënies, reduktim i nismave për shkollën, rritje e mungesave në punë dhe të largimeve nga profesioni. Studimet e fokusuara te ndërhyrjet edukative dhe/ose psikologjike tregojnë se drejtuesit e institucioneve shkollore që ushtrojnë stil udhëheqës transformues mund të reduktojnë simptomat e burnout-it, të ndihmojnë në ndërtimin e mbështetjes mes kolegëve dhe të rrisin ndjenjën e kompetencës (Liu et al., 2024).

Aplikimi i modelit PERMA në arsim

PERMA [Positive Emotion (emocione positive), Engagement (angazhim), Relationships (marrëdhënie), Meaning (njohje e qëllimeve), Accomplishment (arritjet) është një kornizë teorike e propozuar nga

Seligmani që identifikon pesë shtylla të mirëqenies dhe të 'lulëzimit' (Seligman, 2011). Në kontekstin e mësimdhënies, aplikimii PERMA sugjeron se programet për mirëqenie duhet të synojnë jo vetëm reduktimin e stresit, por edhe promovimin e emocioneve pozitive (P), angazhimit të thellë në detyrë (E), marrëdhënieve të fuqishme me kolegët (R), ndjenjën e qëllimit (M) dhe njohjen e arritjeve profesionale (A).

Evidenca empirike tregon se ndërhyrjet të cilat trajtojnë disa ose të gjithë përbërësit e PERMA (p.sh. trajnimet për 'mindfulness' për nxitjen e emocioneve pozitive, zhvillimi profesional për nxitjen e arritjeve profesionale, aktivitetet grupore për marrëdhëniet ndërpersonale) kanë rezultuar në përmirësime të mirëqenies së mësuesve dhe zvogëlim të burnout-it. Megjithatë, studimet tregojnë se dimensionet e 'njohjes së qëllimeve' shpesh mbetet i neglizhuar në zbatimet praktike, ndonëse ky është pikërisht elementi që mund të lidhë sponsorizimin institucional me angazhimin afatgjatë të mësuesit.

Gjendja e studimeve me fokus te mësuesit e arsimit special në Shqipëri

Sipas literaturës që kemi mundur të gjejmë, studimet e posaçme që masin mirëqenien subjektive dhe specifikisht burnout-in te mësuesit e arsimit special në Shqipëri janë të pakta. Ka disa hulumtime me fokus më të gjerë mbi burnout-in në sistemin arsimor shqiptar që përdorin instrumente si 'Maslach Burnout Inventory' dhe evidentojnë se mësuesit me pak përvojë ose në pozicione me ngarkesë të lartë tregojnë më shumë simptoma të burnout-it (Mamani et al., 2025). Megjithatë nuk ekziston ndonjë bazë e gjerë të dhënash, me kampion kombëtar dhe instrumente të standardizuara me fokus mësuesit e arsimit special.

Kjo zbrazëti nënvizon nevojën për studime sistematike në Shqipëri si matjet e mirëqenies subjektive, matjet e burnout-it dhe faktorët parashikues, si: mbështetja sociale, vetefikasiteti apo kushtet e punës. Kërkimet e mundshme në të ardhmen do të ndihmonin për të përcaktuar llojin e politikave që qeveria synon të zbatojë për të mbështetur rritjen e mirëqenies subjektive të mësuesve të arsimit special në vend.

Problemi i identifikuar, qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore

Në literaturën e disponueshme vihet re se studimet e deritanishme janë fokusuar te treguesit me valencë negative si stresi i mësuesve në punë, burn out –i dhe gërryerja profesionale, por nuk u kanë kushtuar vëmendje faktorëve, si mirëqenia subjektive dhe faktorët pozitivë të zhvillimit (cituar

në Walter, 2020). Kësisoj në këtë studim, mbështetur në punën e Walts (2020) eksplorohet roli i mirëqenies së mësuesve të arsimit special në kuadër të psikologjisë pozitive, duke eksploruar tipare pozitive dhe përvoja institucionale pozitive. Kjo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësinë e tyre rolin si mësues të arsimit special dhe me investimin e tyre për të qenë pjesë e kësaj fushe pune.

Qëllimi i studimit aktual është që përmes këndvështrimit të psikologjisë pozitive të eksplorojë çfarë i kontribuon mirëqenies së përgjithshme të mësuesve të arsimit special në shkollë dhe nëse/si mirëqenia e tyre ka ndikuar që ata të vazhdojnë punën në këtë rol.

Prandaj janë ndërtuar pyetjet e mëposhtme kërkimore:

- Cilat janë marrëdhëniet mes variableve të vazhdueshme të studimit, përkatësisht dimensioneve të modelet PERMA, dimensioneve të mirëqenies, dimensioneve të mirëqenies subjektive, lulëzimit në punë dhe simptomave emocionale si ankthi dhe depresioni? Cila është forca e tyre statistikore dhe çfarë drejtimi kanë?
- Sa e parashikojnë dimensionet e modelit PERMA mirëqenien e përgjithshme, mirëqenien subjektive, lulëzimin në punë dhe simptomat emocionale si ankthi dhe depresioni? Cili ndër këto dimensionet shërben si parashikues më i mirë?
- Cili është ndikimi i variableve demografikë, si: mosha, përvoja në arsimin e zakonshëm, përvoja në arsimin special dhe cikli në të cilin mësuesit angazhohen si mësues të arsimit special në nivelet e mirëqenies së përgjithshme, mirëqenies subjektive, lulëzimit në punë dhe simptomave emocionale?

METODOLOGJIA

Dizajni i studimit

Studimi që po paraqitet është deduktiv dhe eksplorues. Ai është konceptuar mbështetur në teoritë ekzistuese mbi mirëqenien, veçanërisht atë subjektive dhe mbi vlerën e modelit PERMA të sqaruar më lart.

Studimi është përshkruar – korrelacional, pra ka natyrë sasiore.

Ky studim është një replikim konceptual i studimit të Walter (2020) në kushtet kulturore dhe institucionale të Shqipërisë. Studimi ka të njëjtin qëllim dhe pjesërisht të njëjtat pyetje kërkimore, por dizajni është i ndryshëm. Ndërkohë që Walter (2020) ka përdorur metoda mikes, këtu përdoren vetëm metodat sasiore. Ajo gjithashtu është fokusuar te mësuesit e arsimit special të angazhuar në edukimin e hershëm, ndërsa në këtë studim

një ndarje e tillë nuk ekziston për shkak se mësuesit e arsimit special në Shqipëri nuk kanë specializim kaq të imët dhe angazhimi i tyre nga një periudhë në tjetrën mund të jetë si në AF ashtu edhe në AMU, madje edhe AML.

Popullata dhe kampioni

DRAP Lezhë që ka në juridiksionin e vet Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në Shkodër, Lezhë, Vaun e Dejës, Pukës, Hasit, Kukësit, Kurbinit dhe Tropojës ka 252 mësues të arsimit special. 214 mësues nga AF, ndërsa 38 në AMU. Ndër këta 120 janë vetëm në ZVAP Shkodër, çka dëshmon edhe peshën specifike të kësaj zyre arsimore.

Kampioni i zgjedhur nga kjo popullatë përmban 101 mësues të përzgjedhur me metodën e kampionimit të rastësishëm me stratifikim. Kontakti me mësuesit e arsimit special apo siç njihen ndryshe mësuesit ndihmës, është më i ndërlikuar sesa me mësuesit e zakonshëm për shkak të numrit të tyre të vogël dhe shpërndarjes në një hapësirë të gjerë gjeografike. Pra, ndonëse baza e të dhënave për ta ekziston, nevojitet kontakt më i personalizuar për kontaktimin e tyre dhe shpjegimin e qëllimit të studimit dhe rolit të tyre potencial në këtë studim. Duke u ndodhur para këtyre kushteve, zgjedhja e kampionimit rastësor me stratifikim ishte zgjedhja optimale, sepse lejonte t'u drejtohej ftesë për pjesëmarrje atyre mësuesve që plotësonin kriteret e interesit tonë studimor. Variable e interesit në këtë rast janë gjinia, mosha, përvoja si mësues ndihmës, titulli i diplomës së tyre universitare dhe cikli parauniversitar në të cilin punojnë si mësues të arsimit special. Pra, siç shihet kampionimi i tillë ka lejuar përfaqësimin e karakteristikave të të gjithë popullatës së mësuesve të arsimit special në masën e duhur dhe rrjedhimisht përfaqësimin sa më gjithëpërfshirës të të gjithë kësaj popullate në rajonin verior të vendit.

Pra, siç u përmend, kampioni përbëhet nga 101 mësues të arsimit special.

Sa i përket gjinisë, 91.1% e pjesëmarrësve janë femra dhe 8.9% janë meshkuj. Grupmosha dominohet nga mësues të moshës 41–50 vjeç (50%), të pasuar nga grupi 31–40 vjeç (23%), më pas 51–60 vjeç (17%), dhe 25–30 vjeç (10%).

Përvoja totale në arsim është e shpërndarë relativisht në mënyrë të barabartë, ku grupi më i madh është ai 25–30 vite përvojë (34%). Tek përvoja në arsimin special vihet re se shumica dërrmuese kanë më pak se 1 vit përvojë (44%) ose 1–5 vite (44%), ndërsa vetëm një pjesë shumë e vogël ka mbi 10 vite përvojë.

Në lidhje me ciklin ku punojnë mësuesit e arsimit special:

- 8.4% punojnë në arsimin fillor,
- 30.7% në arsimin e mesëm të ulët,
- 10.9% në arsimin e mesëm të lartë.

Instrumentet e përdorura

Në këtë studim janë përdorur 6 (gjashtë) instrumente sasiore që variojnë nga të shkurtër në relativisht të gjatë. Siç u theksua më lart janë të njëjtat instrumente të përdorura në studimin origjinal që replikohet në këtë rast. Ato masin si dimensionet e larmishme të mirëqenies ashtu edhe simptomat e mundshme që tregojnë mungesën e saj. Janë që të gjitha instrumente me vetëraportim.

Procedura e shqipërimit

Në dijeninë e autorëve asnjë prej instrumenteve të përdorura në këtë studim nuk është përdorur nga autorë të tjerë në studimet e autorëve vendas, por vetë autorët kanë përdorur më herët GAD 7 dhe PHQ 9. Edhe nëse janë përdorur më herët nga kolegët, mund të shtojmë me siguri se asnjëri prej tyre nuk është standardizuar në kulturën tonë dhe as ekziston ndonjë përkthim zyrtar.

Kësisoj, për t'u siguruar se përkthimi shpreh kuptimin origjinal dhe është i kuptueshëm për përgjigje dhënë situtatës shqiptare, është përdorur procedura standarde e përkthimit fillestar nga gjuha origjinale dhe e ripërkthimit të tyre të mëpasëm nga shqipja në gjuhën origjinale (Brislin et al., 1970).

Në këtë proces është angazhuar autorja e dytë e studimit, një mësuese e gjuhës shqipe dhe një mësuese e gjuhës angleze, gjuha origjinale e instrumenteve.

Shqipërimi nuk ka ndeshur në vështirësi të pakapërcyeshme, por procesi i shqipërimit ka kaluar nëpër sfidën e gjetjes së termave të dallueshme për fjalë që në anglisht janë qartësisht të ndryshme, por në shqip kanë përkthim të njëjtë a mjaft të ngjashëm.

Shkalla e mirëqenies së mësuesve (ang. Teacher Wellbeing Scale)

Ky është një instrument me 16 pohime i krijuar nga Collie dhe kolegët (2015) që mat tredimensione të mirëqenies:

mirëqenia, pavarësisht ngarkesës në punë ($M = 30.75$, $SD = 6.00$), $\alpha = 0.829$);

mirëqenia organizacionale ($M = 34.53$, $SD = 5.55$; $\alpha = .743$);
 mirëqenia për shkak të ndërveprimit me nxënësit ($M = 23.01$, $SD = 3.64$; $\alpha = .714$).

Instrumenti mat aspekte thelbësore të mësimdhënies që e ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme me mirëqenien. Shembull i një pohimi është: “Marrëdhënia me drejtuesin/te shkollës sime”.

Pyetësori i mirëqenies subjektive të mësuesve (ang. Teacher Subjective Wellbeing Questionnaire)

Ky instrument i krijuar nga Renshaw dhe kolegët (2015) mat mirëqenie në mësues vënë punën e tyre specifike. Ai përmban 8 pohime dhe është i përbërë nga 2 nënshkallë:

ndërlidhja shkollore ($M = 12.87$, $SD = 1.93$; $\alpha = .644$)

efikasiteti i mësuesit. ($M = 13.91$, $SD = 3.47$; $\alpha = .534$)

Shembull i një pohimi është: “E ndiej se i përkas kësaj shkolle”.

Shkalla e lulëzimit psikologjik (ang. Flourishing Scale)

Ky instrument (Deiner et al., 2009) përmban 7 pohime të cilat janë ndërtuar për të matur mirëqenien socialpsikologjike përmes dimensioneve si nevoja për kompetencë, ndërlidhja dhe vetëpranueshmëria ($M = 51.11$, $SD = 5.36$; $\alpha = .888$). Shembull i një pohimi është: “Jeta ime ka qëllim dhe kuptim”.

PERMA në vendin e punës (ang. Workplace PERMA)

PERMA, (Butler & Kern, 2015), siç është shpjeguar në hyrje të studimit vlerëson komponentët e mëposhtëm të mirëqenies: emocionet pozitive, angazhimin, marrëdhëniet, njohjen e qëllimit dhe arritjet. Sipas autorëve ai lidhet në mënyrë specifike me vendin e punës. Gjithsej ka 15 pohime të përdorura në këtë studim si variable parashikuese dhe 8 pohime të tjera plotësuese (filler items) pa vlerë specifike për këtë studim. Shembull i një pohimi është: “Sa shpesh, ndjehesh ankthioz/e në punë”?

- PERMA – emocioni pozitiv ($M = 24.29$, $SD = 4.01$; $\alpha = .759$)
- PERMA – angazhimi ($M = 24.06$, $SD = 3.79$; $\alpha = .503$)
- PERMA – njohja e qëllimit ($M = 25.50$, $SD = 3.67$; $\alpha = .714$)
- PERMA – arritjet ($M = 24.46$, $SD = 3.87$; $\alpha = .736$)
- PERMA – marrëdhëniet ($M = 23.92$, $SD = 4.67$, $\alpha = .764$)

Shkalla e çrregullimit të ankthit të përgjithësuar (ang. The Generalized Anxiety Disorder Scale – GAD – 7)

Kjo shkallë me 7 pohime mat praninë ose mungesën e simptomave të ankthit. Sipas Spitzer dhe kolegëve (2006) në popullatat e mësuesve shquhet vazhdimisht prania e simptomave të ankthit, kështu që ai është

përfshirë edhe në një studim që mat mirëqenien ($M = 5.16$, $SD = 4.13$; $\alpha = .891$). Instrumenti është shumë i njohur ndërkombëtarisht dhe ka gjetur përdorim të gjerë si në fushën e kërkimit edhe në atë të praktikës klinike. Ai është përdorur më parë në kulturën shqiptare nga autorët e këtij studimi (Haka & Ymeri, 2025). Shembulli një pohimi është: “Shqetësim i madh për gjëra të ndryshme”.

Pyetësori i shëndetit të pacientit (ang. The patient Health Questionnaire – PHQ 9)

Sipas autorëve të këtij instrumenti, Kroenke, Spitzer & Williams (2001), ai përdoret për ekzaminimin, diagnostikimin dhe monitorimin e ashpërsisë së depresionit ($M = 6.30$, $SD = 4.29$; $\alpha = .846$). Ai përmban 9 pohime dhe është i përshtatshëm dhe gjerësisht i përdorur si për trajtimin klinik edhe për kërkimin shkencor. Shpesh përdoret në të njëjtat studime në të cilat përdoret edhe GAD 7 siç ndodh dhe në këtë studim. Shembull i një pohimi është: “Interes dhe kënaqësi e pakët për të bërë gjëra të ndryshme”. Autorët e këtij studimi e kanë përdorur më herët PHQ 9 në të njëjtin instrument në të cilin kanë aplikuar edhe GAD 7 (Haka & Ymeri, 2025).

Mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave

Mësuesit e arsimit special të përfshirë në këtë studim kanë plotësuar një anketë online me 7 seksione njësoj si në studimin origjinal, përkatësisht të dhënat demografike edhe 6 instrumentet në fjalë. Gjithsej bëhet fjalë për 76 pohime të llogaritura të marrin mes 15 – 20 minuta për t'u plotësuar.

Çështje etike

Në anketën që u është shpërndarë mësuesve është bashkëngjitur edhe “miratimi informues”. Aty përgjigjedhënësve u është shpjeguar qëllimi i studimit, fakti se të dhënat nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç se studimor dhe janë siguruar për konfidencialitetin e përgjigjeve të tyre. Po ashtu nuk janë mbledhur emrat as shenja të tjera identifikuese. Në fund, u është bërë e qartë se duke kthyer të plotësuar anketën ata shprehin automatikisht dakordësinë për përfshirje në studim.

REZULTATET

Testet e normalitetit

Testet Kolmogorov–Smirnov dhe Shapiro–Wilk treguan se asnjë nga variablat kryesorë nuk ka shpërndarje normale ($p < .05$ në shumicën dërrmuese të variableve). Prandaj, analizat korrelacionale, janë kryer me

Spearman rho dhe për dallimet mes grupeve janë përdorur testet joparametrike Kruskal–Wallis.

	Tests of Normality					
	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	Df	Sig.
Mirëqenia pavarësisht ngarkesës në punë	.083	101	.084	.968	101	.015
Mirëqenia organizacionale	.100	101	.014	.948	101	.001
Mirëqenia falë ndërveprimit me nxënësit	.093	101	.031	.950	101	.001
Ndërlidhja shkollore	.137	101	.000	.957	101	.002
Efikasiteti i mësuesit	.264	101	.000	.486	101	.000
Shkalla e lulëzimit në vendin e punës	.190	101	.000	.809	101	.000

a. Lilliefors Significance Correction.

Marrëdhëniet korrelative

Analiza korrelacionale u krye duke përdorur Spearman rho, përshkak se variable nuk kanë shpërndarje normale. Rezultatet tregojnë një model të qëndrueshëm marrëdhëniesh mes mirëqenies, komponentëve të PERMA-s dhe simptomave emocionale. Më poshtë paraqiten lidhjet më të rëndësishme, të detajuara në bazë të temave specifike.

Lidhjet ndërmjet formave të mirëqenies

Të gjitha format e mirëqenies treguan korrelacione të forta pozitive mes tyre, gjë që tregon se mirëqenia është një konstrukt i lidhur dhe me shumë shtresa.

Mirëqenia, pavarësisht ngarkesës në punë, është një dimension që ka lidhje të forta me mirëqenien organizacionale ($\rho = .758^{**}$); mirëqenien në sajë të ndërveprimit me nxënësit ($\rho = .662^{**}$); ndërlidhjen shkollore ($\rho = .449^{**}$) dhe lulëzimin në punë ($\rho = .554^{**}$).

Kjo tregon se rritja në një formë mirëqenieje priret të shoqërohet me rritjen e dhënë në format e tjera të saj.

Lidhjet ndërmjet PERMA dhe mirëqenies

Komponentët e PERMA-s shfaqin lidhje shumë të forta dhe statistikisht të rëndësishme me të gjitha format e mirëqenies, veçanërisht:

- Mirëqenia pavarësisht ngarkesës në punë shfaq lidhje të fortë pozitive me emocionet pozitive ($\rho = .577^{**}$); me angazhimin ($\rho = .459^{**}$); me njohjen e qëllimit ($\rho = .536^{**}$); me arritjet ($\rho = .589^{**}$) dhe me marrëdhëniet ($\rho = .554^{**}$).

Siç vihet re lidhja më e fortë është me ‘arritjet’ dhe me ‘emocionet pozitive’.

- Mirëqenia organizacionale ka lidhjet e mëposhtme korrelative me dimensionet e mirëqenies: me marrëdhëniet ($\rho = .635^{**}$); me emocionet pozitive ($\rho = .634^{**}$); me njohjen e qëllimit ($\rho = .592^{**}$); me angazhimin ($\rho = .507^{**}$) dhe me arritjet ($\rho = .535^{**}$).

Lidhja më e fortë është me ‘marrëdhëniet’, duke sugjeruar se marrëdhëniet pozitive në punë ndikojnë fuqishëm tek mënyra si perceptohet mbështetja dhe mirëqenia organizative.

- Mirëqenia në sajë të ndërveprimit me nxënësit ka dëshmuar marrëdhënia e qëndrueshme dhe pozitive me të gjitha dimensionet e PERMA-s. Kështu, me ‘marrëdhëniet’ ka lidhjen $\rho = .520^{**}$; me ‘arritjet’ $\rho = .568^{**}$; me emocionet pozitive lidhja është $\rho = .540^{**}$; me ‘angazhimin’ kjo lidhje është më e dobët $p = .440^{**}$, ndërsa me ‘njohjen e qëllimit’ $\rho = .484^{**}$.

Korrelacionet tregojnë se mësuesit që raportojnë më shumë emocione pozitive dhe ndjesi arritjeje, kanë gjithashtu marrëdhënie më cilësore dhe më mirëqenie gjatë ndërveprimit me nxënësit.

- Ndërlidhja shkollëre, dimensionet e mirëqenies subjektive, shfaq gjithashtu drejtim pozitiv dhe marrëdhënie të forta statistikisht me dimensionet e PERMA-s. Përkatesisht, me ‘marrëdhëniet’ korrelacioni është Relationships $.574^{**}$; me ‘emocionet pozitive’ $\rho = .564^{**}$; me ‘njohjen e qëllimit’ ekziston korrelacioni $\rho = .483^{**}$; me ‘angazhimin’ $\rho = .338^{**}$ dhe me ‘arritjet’ $\rho = .416^{**}$.

Edhe këtu dimensionet ‘marrëdhëniet’ shfaqet si faktor kyç.

- Efikasiteti i mësuesit ka dëshmuar lidhje pozitive, mesatarisht të forta me të gjitha shkallët e PERMA-s. Më konkretisht për ‘marrëdhëniet’ $\rho = .543^{**}$; për ‘emocionet pozitive’ $\rho = .589^{**}$; për ‘njohjen e qëllimit’ $\rho = .597^{**}$; për ‘angazhimin’ $\rho = .382^{**}$ dhe për ‘arritjet’ $\rho = .542^{**}$.

Sipas rezultateve korrelative mësuesit që raportojnë më shumë emocione pozitive dhe njohje të qëllimit, raportojnë gjithashtu edhe efikasitet më të lartë profesional.

Lulëzimi në vendin e punës

Korrelacionet më të fuqishme të këtij dimensionit janë si më poshtë: emocionet pozitive ($\rho = .660^{**}$); njohja e qëllimit ($\rho = .627^{**}$); marrëdhëniet ($\rho = .563^{**}$); angazhimi ($\rho = .482^{**}$) dhe arritjet ($\rho = .563^{**}$).

Ky është një nga dimensionet me korrelacionet më të larta me PERMA-n, veçanërisht me 'emocionet pozitive' dhe me 'njohjen e qëllimit'.

Ankthi, imatur për mes GAD-7

Korrelacionet tregojnë lidhje të forta negative me shumicën e variabëlve të mirëqenies dhe PERMA-s: me 'emocionet pozitive' $\rho = -.379^{**}$; me 'marrëdhëniet' $\rho = -.422^{**}$; me 'njohjen e qëllimit' $\rho = -.276^{**}$; me 'angazhimin' $\rho = -.200^{*}$, ndërsa me 'arritjet' $\rho = -.195$.

Ndërkaq, me dimensionet e mirëqenies, GAD-7 lidhet negativisht me 'ndërlidhjen shkollore' me të cilën $\rho = -.281^{**}$ dhe me 'efikasitetin e mësuesit' me të cilin $\rho = -.277^{**}$.

Po ashtu edhe me 'lulëzimin në punë' marrëdhënia ka drejtim negativ ($\rho = -.356^{**}$).

Kjo tregon se rritja e ankthit shoqërohet me ulje të të gjitha formave të mirëqenies.

Depresioni, i matur përmes PHQ-9

Lidhjet me depresionin janë të njëjta në drejtim, por kanë formë më të pakët. Pra, me 'emocionet pozitive' lidhja është $-.267^{**}$; me 'marrëdhëniet' $\rho = -.356^{**}$; me 'njohjen e qëllimit' lidhja është edhe më e dobët $\rho = -.169$; me 'angazhimin' kjo lidhje shfaqet minimale $\rho = -.089$ dhe me 'arritjet' mbetet po ashtu modeste.

Korrelacione të dukshme negative shfaqen me 'lulëzimin në punë' me të cilin ($\rho = -.356^{**}$); me 'ndërlidhjen shkollore' ($\rho = -.177$) dhe me 'efikasitetin e mësuesit' ($\rho = -.208^{*}$).

Këto tregojnë se simptomat depresive kanë një ndikim të gjerë në reduktimin e mirëqenies dhe funksionimit profesional.

Lidhjet ndërmjet vetë dimensioneve të PERMA

Ndërmjet vetë dimensioneve të PERMA-s, korrelacionet janë shumë të forta dhe statistikisht të rëndësishme: 'njohja e qëllimit' dhe 'arritjet' ($\rho =$

.805**); ‘emocionet pozitive’ me ‘njohjen e qëllimit’ ($\rho = .804^{**}$); ‘emocionet pozitive’ dhe ‘arritjet’ kanë lidhjen ($\rho = .741^{**}$) dhe ‘angazhimi’ me ‘marrëdhëniet’ kanë lidhjen ($\rho = .600-.668^{**}$).

Kjo konfirmon qëndrueshmëri teorike të modelit PERMA, me dimensione të dallueshme, por shumë të ndërvarur nga njëri - tjetri.

Lidhjet ndërmjet gjinisë dhe variablave të tjera

Edhe pse gjinia nuk shfaq korrelacione të larta, disa lidhen në mënyrë të dobët, por statistikisht të rëndësishme. Kështu, me ‘mirëqenien’ pavarësisht ngarkesës në punë lidhja është e një farë rëndësie statistike, $\rho = -.202^{*}$; me mirëqenien në sajë të ndërveprimit me nxënësit $\rho = -.198^{*}$ dhe me ‘ndërlidhjen shkollore’ $\rho = -.242^{*}$.

Meshkuj raportojnë më pak mirëqenie në këto fusha, megjithatë efektet janë të vogla.

Analizat e regresionit linear

Në studim u realizuan disa analiza regresioni linear me qëllim të identifikimit të kontributit të komponentëve të vetëmodelit PERMA në parashikimin e formave të ndryshme të mirëqenies në punë, efikasitetit profesional dhe simptomave emocionale. Më poshtë paraqitet interpretimi i zgjeruar për secilin model.

Regresioni për ‘mirëqenien pavarësisht ngarkesës në punë’

Modeli i parë përdori si faktor parashikues vetëm ‘PERMA – emocionet pozitive’ rezultoi një parashikues i fortë dhe domethënës i mirëqenies, duke shpjeguar 30.8% të variancës. Kjo tregon se nivelet më të larta të emocioneve pozitive shoqërohen drejtpërdrejt me mirëqenie më të lartë, pavarësisht ngarkesës së lartë që karakterizon profesionin e mësuesve të arsimit special.

Modeli i dytë, me të gjithë komponentët e PERMA-s, e rriti ndjeshëm fuqinë shpjeguese në 38.1%, çka sugjeron se mirëqenia pavarësisht ngarkesës është një rezultat i ndikuar nga shumë faktorë që buron nga përjetime të shumta të mirëqenies pozitive.

Ndër të gjithë faktorët parashikues, ‘arritja’ dhe ‘marrëdhëniet’ rezultuan të jenë parashikuesit e vetëm domethënës. Kjo tregon se mësuesit që ndihen të realizuar profesionalisht dhe që zhvillojnë marrëdhënie pozitive brenda mjedisit të punës kanë forca më të mëdha ripërtëritëse ndaj ngarkesave ditore dhe raportojnë nivele më të larta mirëqenieje personale.

Regresioni për 'mirëqenien organizacionale'

Modeli i mirëqenies organizacionale shpjegoi përqindjen më të lartë të variancës ndër të gjitha modelet: 52.1%. Ky rezultat sugjeron se ndjesia e mbështetjes dhe mirëqenies në nivel organizacional varet fuqimisht nga komponentët e PERMA-s, që janë tregues të klimës emocionale dhe ndërpersonale në vendin e punës.

Variabli i vetëm parashikues me rëndësi statistikore në model ishte 'marrëdhëniet', duke theksuar rolin qendror të marrëdhënieve pozitive me kolegët, drejtuesit, nxënësit dhe komunitetin e shkollës. Marrëdhëniet cilësore shfaqen si faktori më i rëndësishëm për ndjesinë e mirëqenies organizacionale.

Ky rezultat përputhet me literature që e trajton marrëdhënien mësues–organizatë si një dimension që ndërtohet mbi mbështetje, bashkëpunim dhe komunikim të hapur.

Regresioni për 'mirëqenien në sajë të ndërveprimit me nxënësit'

Modeli shpjegoi 33.4% të variancës së mirëqenies së mësuesve gjatë ndërveprimit me nxënësit. Variabli i vetëm domethënës ishte 'marrëdhëniet', duke treguar se pikërisht marrëdhëniet pozitive në punë, përfshirë ato me nxënësit, ndihmojnë mësuesit të përjetojnë më shumë kënaqësi, motivim dhe energji gjatë proceseve të ndërveprimit në klasë.

Kjo sugjeron se mjedisi i marrëdhënieve është elementi më i rëndësishëm për mësuesit teksa punojnë me grupe nxënësish me nevoja të veçanta.

Regresioni për 'ndërlidhjen shkollore'

Modeli shpjegoi 44.8% të variancës, çka tregon se ndërlidhja shkollore është një konstrukt i lidhur fort me faktorët e mirëqenies. Këtu u vunë re tre variable me domethënie statistikore, përkatësisht 'emocionet pozitive', 'marrëdhëniet' dhe e fundit 'njohja e qëllimit' që dëshmoi se ishte në prag të rëndësisë statistikore.

Pra, në se mbështetemi në këto gjetje, cilësia e marrëdhënieve me të gjithë aktorët e shkollës po kësaj periudhe më së shumti, por po ashtu edhe përjetimi i emocioneve pozitive në shkollë dhe pak më pak edhe njohja e qëllimeve dhe kuptimit profesional përcaktojnë ndërlidhjen e mësuesve të arsimit special me shkollën.

Regresioni për 'efikasitetin e mësuesit'

Modeli shpjegoi veçse 8.8% të variancës, çka sugjeron se efikasiteti profesional i mësuesve nuk mund të shpjegohet plotësisht nga komponentët

e PERMA-s dhe ndoshta ndikohet nga faktorë të tjerë si aftësitë profesionale, edukimi i vazhdueshëm, burimet shkollore dhe përvoja praktike.

Asnjë variabël parashikues nuk dëshmoi domethënie statistikore, por drejtimi i efekteve ishte pozitiv, duke sugjeruar se mësuesit që raportojnë mirëqenie më të lartë tentojnë të kenë gjithashtu perceptim më të lartë të efikasitetit, edhe pse kjo lidhje nuk është e mjaftueshme për të dalë statistikisht e vlefshme në këtë mostër.

Regresioni për lulëzimin në vendin e punës

Modeli shpjegoi 47.7% të variancës, një përqindje shumë e lartë për një dimension të ndërlikuar si 'lulëzimi profesional.

Variable parashikuese që shkojnë pranë kufirit të rëndësisë statistikore janë angazhimi ($p = .053$) dhe marrëdhëniet ($p = .050$).

Ky model tregon se lulëzimi i mësuesve në vendin e punës ndikohet fuqimisht nga përfshirja emocionale dhe kognitive në punë, angazhimi i brendshëm dhe lidhjet e forta pozitive dhe mbështetëse.

Megjithëse prediktorët janë në kufi të signifkancës. Modeli në tërësi është i fortë dhe shpjegon një pjesë të konsiderueshme të variancës.

Regresioni për simptomat e ankthit (GAD-7)

Modeli shpjegoi 20.9% të variancës së ankthit, duke qenë kështu një nga modelet më domethënëse në dimensionin emocional.

Variabli i vetëm domethënës dhe me fuqi të lartë statistikore ishte PERMA – emocionet pozitive.

Ky rezultat sugjeron se sa më shumë emocione 11 variable të përjetojë mësuesi në punë, aq më të ulëta rezultojnë simptomat e ankthit. Emocionet 83 variable funksionojnë si një 83 variable mbrojtës psikologjikë, duke ulur stresin, tensionin dhe shqetësimin e vazhdueshëm që mund të shfaqet në mjedise kërkuese të arsimit special.

Regresioni për simptomat e depresionit (PHQ-9)

Modeli shpjegoi jo më shumë se 9.5% të variancës së plotë. Variabli i vetëm me forcë parashikuese të depresionit edhe në këtë rast rezultoi të ishte PERMA – emocionet pozitive.

Kjo do të thotë se sa më shpesh mësuesit përjetojnë gëzim, qetësi, energji dhe kënaqësi, aq më të ulëta janë simptomat 83 variable 83 esiatpatia, lodhja emocionale dhe humbja e motivimit.

Efekti është më i dobët se te ankthi, por mbetet i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm.

Dallimet sipas variableve demografike

Testi Kruskal–Wallis u përdor për të vlerësuar nëse ka dallime statistikisht domethënëse në 84 ariable e mirëqenies, efikasitetit dhe simptomave emocionale në varësi të katër karakteristikave demografike: mosha, përvoja në arsim, përvoja në arsimin special dhe cikli në të cilin japin mësim pjesëtarët e kampionit të studimit. Duke qenë se 84 ariable nuk kishin shpërndarje normale, testi joparametrik ishte zgjedhja më e përshtatshme.

Rezultatet tregojnë se në asnjë analizë nuk u identifikua ndonjë dallim i rëndësishëm statistikor, megjithatë disa tendenca të brendshme janë të dukshme dhe ofrojnë informacion të vlefshëm për interpretimin e të dhënave

Kruskal–Wallissipasmoshës

Ndonëse asnjë prej rezultateve nuk ishte domethënëse, disa modele përshkruese mund të veçohen prej të tjerëve.

- Tendencat në mirëqenien profesionale

Mësuesit 41–50 vjeç dhe 51–60 vjeç kanë renditjet më të larta në disa forma të mirëqenies, si: mirëqenia pavarësisht ngarkesës në punë; mirëqenia organizacionale; mirëqenia në sajë të ndërveprimit me nxënësit dhe lulëzimi në punë.

Kjo sugjeron se mësuesit me përvojë më të gjatë mund të kenë zhvilluar strategji më efektive të përballimit dhe ndjenja më të qëndrueshme besimi dhe efikasiteti në rolin e tyre si mësues të arsimit special.

- Tendencat në efikasitetin e mësuesit

Grupi 31– 40 vjeç ka renditjet më të larta në efikasitet, duke sugjeruar qëndrueshmëri profesionale më të lartë se grupet e tjera.

- Tendencat në shfaqjen e simptomave emocionale

Simptomat e ankthit (GAD-7) dhe depresionit (PHQ-9) nuk ndryshojnë ndjeshëm mes grupmoshave.

Grupi më i ri (25–30 vjeç) shfaq simptoma më të dukshme se grupet e tjera, por jo në nivel të rëndësishëm statistikor.

Nisur nga këto gjetje mund të konkludojmë se mosha nuk është faktor përcaktues për mirëqenien apo simptomat, por mund të jetë faktor me një ndikim të natyrshëm në nivel të moderuara.

Kruskal–Wallis sipas përvojës në arsimin e zakonshëm

Ashtu si te mosha, edhe këtu nuk u gjetën dallime me rëndësi statistikore, megjithatë dallimet e brendshme në renditje kanë vlerën e vet.

- Mirëqenia dhe ndërlidhja shkollore

Grupi me mbi 21 vjet përvojë në arsim (51– 60) ka shpesh renditjet më të larta në mirëqenien pavarësisht ngarkesës në punë, mirëqenien organizacionale dhe ndërlidhjen shkollore.

Kjo sugjeron se përvoja mund të kontribuojë në ndjenjën e stabilitetit dhe të sigurisë profesionale.

- Efikasiteti i mësuesit

Renditja më e lartë gjendet te grupet me 6 – 10 dhe 11 – 20 vjet përvojë, duke sugjeruar se këto periudha përputhen me kulmin e kompetencave profesionale.

- Simptomat emocionale

GAD -7 dhe PHQ - 9 nuk ndryshojnë në mënyrë domethënëse mes grupeve të përvojës.

Megjithatë, grupime 11 – 20 vjet përvojë kanë renditjet më të ulëta të ankthit, duke sugjeruar se përvoja mund të sjellë qëndrueshmëri emocionale.

Kruskal – Wallis sipas përvojës në arsimin special

Ky është grupi ku shfaqen tendencat më të dukshme, megjithëse as një rezultat nuk është domethënës statistikisht.

- Mirëqenia profesionale

Mësuesit me më pak se 1 vit përvojë në arsimin special kanë renditje më të larta në shumicën e formave të mirëqenies.

Diçka e tillë ndoshta reflekton optimizmin e fazës së hershme, motivimin e lartë fillestar dhe mungesën e gërryerjes profesionale dhe të burn out-it. Grupi me 6 –10 vjet përvojë ka shpesh renditjet më të ulëta në mirëqenien e përditshme.

- Lulëzimi në punë

Lulëzimi është më i lartë në grupin me më pak se 1 vit përvojë dhe tek ai me mbi 11 vjet.

Ky model sugjeron entuziazëm të lartë fillestar, rënie graduale të këtij entuziazmi deri në mbyllje të dhjetëvjeçarit të parë të punës dhe rritje të këtij entuziazmi tek ata persona që gjatë dhjetëvjeçarit të parë kanë fituar përvojë të mjaftueshme që të mos vetezaurohen.

- Efikasiteti i mësuesit

Ndryshe nga tendencat e mirëqenies, efikasiteti profesional është më i lartë te grupi me 6–10 vjet përvojë, një rezultat i shpjegueshëm nga ana teorike, sepse

përvoja e fituar e kombinuar me moshën ende të re sjell edhe zhvillimin e kompetencave profesionale.

- Simptomat emocionale

Simptomat e ankthit të matura sipas GAD-7 janë më të larta te grupet me 1–5 dhe 6–10 vite përvojë, por bien sërish te grupet me më shumë vite pune.

Simptomat depresive të matura sipas PHQ-9 kanë një prirje të ngjashme.

Mbështetur në këto gjetje mund të sugjerohet se vitet e ndërmjetme në arsimin special janë periudha më sfiduese emocionalisht.

DISKUTIM

Ky studim pati si qëllim të eksplorojë mirëqenien subjektive dhe profesionale të mësuesve të arsimit special në rajonin verior të Shqipërisë, duke u mbështetur në qasjen e psikologjisë pozitive dhe në modelin PERMA të Seligmanit. Duke qenë një replikim konceptual i studimit të Walter (2020), rezultatet ofrojnë një panoramë të vlefshme mbi faktorët pozitivë dhe sfidues që strukturojnë përvojën profesionale të mësuesve të arsimit special në kontekstin shqiptar.

Së pari, analizat e korrelacioneve konfirmuan një model të qëndrueshëm marrëdhëniesh midis formave të ndryshme të mirëqenies dhe komponentëve të PERMA-s. Të gjitha dimensionet e mirëqenies ishin pozitivisht të lidhura me njëra-tjetrën, duke mbështetur idenë se mirëqenia e mësuesve është një konstrukt shumëdimensional, në të cilin përmirësimi i një dimensionit ndikon në përmirësimin e të tjerëve. Kjo përputhet me gjetjet ndërkombëtare (Collie et al., 2015; Fox et al., 2020), të cilat sugjerojnë se mirëqenia profesionale është një sistem i integruar që ndërtohet mbi emocione pozitive, marrëdhënie konstruktive dhe perceptime të qëllimit profesional.

Së dyti, komponentët e PERMA-s treguan lidhje pozitive dhe të forta me pothuajse të gjitha format e mirëqenies dhe me lulëzimin në vendin e punës. Ndjesia e arritjeve profesionale, emocioneve pozitive dhe marrëdhënieve dalin si përbërës kyç. Kjo gjetje është në harmoni me literaturë ndërkombëtare që thekson se mësuesit e arsimit special lulëzojnë në mjedise ku ndihen të respektuar, ku kanë marrëdhënie të qëndrueshme me kolegët dhe nxënësit, dhe ku arrijnë objektiva profesionale që konsiderohen domethënëse (Langher et al., 2017; Fu et al., 2022).

Në të njëjtën linjë, ndërlidhja shkollore dhe efikasiteti i mësuesit, treguan marrëdhënie pozitive me PERMA-n, duke sugjeruar se përjetimi i komponentëve pozitivë në punë nuk ndikon vetëm mirëqenien emocionale, por edhe dimensionet praktike të rolit profesional.

Së treti, analizat e regresionit linear nxorën një model të qartë parashikimi:

- Marrëdhëniet janë variabli më i fortë parashikues i mirëqenies organizacionale, mirëqenies gjatë ndërveprimit me nxënësit dhe, pjesërisht, edhe i lulëzimit.
- Emocionet pozitive janë parashikuesit e vetëm të fortë dhe të qëndrueshëm i simptomave të ankthit dhe depresionit.

- Arritjet profesionale dhe njohja e qëllimit kontribuojnë në disa prej formave të mirëqenies, por me fuqi më të vogël.

Këto gjetje mbështesin qasjen se komponentët e PERMA-s nuk ndikojnë në mënyrë uniforme në mirëqenie, por kanë role specifike: marrëdhëniet ndihmojnë në dimensionet ndërpersonale dhe organizacionale; emocionet pozitive mbrojnë nga simptomat negative; ndërsa arritjet dhe kuptimi profesional kontribuojnë në qëndrueshmëri dhe vetëbesim profesional.

Së katërti, analizat joparametrike Kruskal–Wallis treguan se as mosha, as përvoja në arsim, as përvoja në arsimin special dhe as cikli i mësimdhënies nuk krijuan dallime statistikisht të rëndësishme në nivelin e mirëqenies. Megjithatë, tendencat e brendshme janë të vlefshme për interpretim. Mësuesit më të rinj në profesion shfaqën më shumë entuziazëm, ndërsa mësuesit me përvojë të gjatë raportuan stabilitet dhe mirëqenie më të madhe. Nga ana tjetër, vitet 1–10 përbëjnë periudhën më sfiduese, ku ankthi dhe depresioni shfaqen në nivele pak më të larta, çka përputhet me literaturë mbi ‘krizën e viteve të ndërmjetme’ të karrierës në mësuesi (Brunsting et al., 2014).

Në tërësi, studimi tregon se mirëqenia e mësuesve të arsimit special në Shqipëri nuk mund të kuptohet vetëm nëpërmjet treguesve negativë, si stresi apo burnout-i. Përkundrazi, komponentët pozitivë të modelit PERMA ofrojnë një lente të re interpretimi që shpjegon jo vetëm gjendjen emocionale të mësuesve, por edhe motivimin e tyre për të qëndruar në profesion dhe për të investuar në cilësinë e mësimdhënies.

PËRFUNDIMET

Ky studim ofron disa përfundime të qarta dhe me rëndësi praktike:

1. Mirëqenia e mësuesve të arsimit special është shumë dimensionale edhe lidhet ngusht me komponentët e PERMA-s.
Emocionet pozitive, marrëdhëniet dhe arritjet rezultuan përbërësit më të rëndësishëm që formësojnë mirëqenien profesionale dhe subjektive.
2. Marrëdhëniet pozitive në shkollë janë faktori më i fuqishëm i mirëqenies organizative dhe ndërveprimit me nxënësit.
Kjo sugjeron se ndërtimi i kulturës së bashkëpunimit, mbështetjes reciproke dhe komunikimit me cilësi është thelbësor për zhvillimin profesional dhe emocional të mësuesve.
3. Emocionet pozitive luajnë rol mbrojtës të fuqishëm ndaj ankthit dhe depresionit.
Këto rezultate nënvizojnë rëndësinë e programeve që synojnë nxitjen e gëzimit, shpresës, mirënjohjes dhe optimizmit në kontekstin shkollor.
4. Lulëzimi profesional ndikohet nga angazhimi dhe marrëdhëniet, duke treguar se mësuesit lulëzojnë kur ndihen të përfshirë emocionalisht dhe njohin vlerën e punës së tyre.
5. Variablat demografike nuk krijojnë diferenca të theksuara në mirëqenie, duke sugjeruar se mirëqenia e mësuesve është më shumë funksion i proceseve

psikologjike dhe institucionale të përditshme se sa i karakteristikave individuale.

6. Modeli PERMA rezulton një kornizë e vlefshme për të kuptuar mirëqenien e mësuesve të arsimit special në Shqipëri dhe ofron një bazë solide për ndërhyrje praktike dhe politika institucionale.

REFERENCAT

- Brunsting, N. C., Sreckovic, M. A., & Garwood, J. M. (2014). Special education teacher burnout: A synthesis of research from 2010–2019. *Teaching and Teacher Education*, 39, 123–131.
- Collie, R. J., Shapka, J. D., & Perry, N. E. (2012). School climate and social-emotional learning: Predicting teacher burnout and turnover intentions. *Teaching and Teacher Education*, 30, 63–72.
- Fox, H. B., Tuckwiller, E. D., Kutscher, E. L., & Walter, H. L. (2020). What makes teachers well? A mixed-methods study of special education teacher well-being. *Educational Researcher Reports*.
- Fu, W., Wang, L., He, X., Chen, H., & He, J. (2022). Subjective well-being of special education teachers in China: the relation of social support and self-efficacy. *Frontiers in Psychology*, 13, Article 802811.
- Langher, V., Caputo, A., & Ricci, M. E. (2017). The potential role of perceived support for reduction of special education teachers' burnout. *International Journal of Educational Psychology*.
- Liu, L., Li, K., Yue, L., & Arshad, M. Z. (2024). Burnout and leadership in special education: A sustainable approach. *Acta Psychologica*.
- Mamani, L., Guga, E., Lilo, Z., & Golemi, S. (2025). Measurement of burnout in the Albanian education system: Evidence from the Gjirokastrë district using the Maslach Burnout Inventory. *Journal of Educational Studies – Albania*.
- Maslach, C., Schaufeli, W. B., & Leiter, M. P. (2001). Job burnout. *Annual Review of Psychology*, 52, 397–422.
- Öztürk, O., Pişkin Abidoğlu, Ü., & Ertuğruloğlu, O. (2019). The opinions of teachers working in the field of special education towards burnout and life satisfaction: A North Cyprus sample. *Journal of Special Education Research*.
- Şen, C. (2023). Investigation of burnout levels of special education teachers. *International Journal of Special Education*.
- Seligman, M. E. P. (2011). *Flourish: A visionary new understanding of happiness and well-being*. Free Press.
- Şener, B., & Kılıç, H. (2020). Early childhood special education teachers' job burnout and psychological stress: Predictors and consequences. *Early Childhood Research Quarterly*.
- (Scoping review) Author(s). (2025). Interventions to teacher well-being and burnout: A scoping review. *Educational Psychology Review*.

NDIKIMI I TRAJNIMEVE NË AFTËSIMIN E MËSUESVE SI KOMUNIKUES EFEKTIVË

Alma Muharremi

*Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani",
Fakulteti i Shkencave të Edukimit,
departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies*

ABSTRAKT

Në një botë ku ndryshimet ndodhin me një ritëm të shpejtë, mësuesit po përballen vazhdimisht me nevojën për të përditësuar rolin e tyre në përgatitjen e brezit të ri. Mësuesit kanë nevojë të zhvillojnë njohuri dhe kompetenca të reja komunikuese për të përmbushur detyrat e tyre dhe për ta shndërruar mësimdhënien në një përvojë bashkëpunuese të nxënies. Rritja dhe fuqizimi profesional i mësuesve realizohet përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZhVP), që është një nevojë dhe detyrim për ta. Qëllimi i studimit është vlerësimi i ndikimit të trajnimit, si aktivitet i ZhVP-së, në aftësimin e mësuesve si komunikues efektivë. Përmes dizajnit të një grupi para/pas test (O1 X O2) dhe testit Chi square (χ^2) u vlerësuan ndryshimet e qëndrimeve. Llogaritja e madhësisë së efektit përmes Cramér's V tregoi se trajnimi kishte një ndikim statistikisht të rëndësishëm dhe të moderuar deri në të fortë në përmirësimin e përgjigjeve të mësuesve. Rezultatet evidentuan se pas marrjes së trajnimit mësuesit shfaqin qëndrime që dëshmojnë rritje në aftësitë e tyre komunikuese. Gjetjet e studimit sigurojnë një perspektivë të re për të shtuar fokusin në zhvillimin e aftësive të komunikimit të mësuesve përmes trajnimit dhe aktiviteteve të tjera të ZhVP-së, për të ndikuar në shtimin e tematikave të trajnimeve rreth aftësive të komunikimit, si dhe për të pasuruar trajnimet me metodologji efikase. Gjetjet e studimit shërbejnë gjithashtu për të gjithë aktorët e përfshirë në zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, për të vlerësuar dhe për të përmirësuar cilësinë e aktiviteteve të ZhVP-së.

Fjalë kyçe: mësues, zhvillim i vazhdueshëm profesional (ZhVP), trajnim, aftësi komunikimi, dëgjim dhe përgjigje me ndjeshmëri.

The impact of trainings on teachers' skills as effective communicators

ABSTRACT

In a rapidly changing world, teachers constantly face the need to update their role in preparing the new generation. Teachers need to develop new knowledge and communication competencies to fulfill their duties and transform teaching into a collaborative learning experience. Teachers' professional growth and empowerment are realized through continuous professional development (CPD), which constitutes both a need and an obligation for them. The aim of this study is to evaluate the impact of training, as a continuous professional development activity, on enabling teachers to become effective communicators. Changes before and after training were evaluated using a one-group pre/post-test design (O1 X O2) and the Chi-square test (χ^2). The calculation of the effect size using Cramér's V indicated that the training had a statistically significant and moderate to strong impact on improving teachers' responses. The results evidenced that after receiving training, teachers display attitudes demonstrating growth in their communication skills. The study's findings provide a new perspective on increasing the focus on developing teachers' communication skills through training and other CPD activities, influencing the addition of training topics regarding communication skills, as well as enriching training with efficient methodologies. The findings also serve all stakeholders involved in the professional development of educational employees to assess and improve the quality of CPD activities.

Keywords: *teacher, continuous professional development (CPD), training, communication skills, listening and responding with empathy.*

Hyrje

Vështirë se mund të gjendet një veprimtari profesionale, ku pesha e komunikimit njerëzor të jetë aq e madhe sa në veprimtarinë e edukimit (Rosenfeld, L. B., 1993). Aftësitë e komunikimit fokusohen në komunikimin e qartë dhe efektiv me nxënësit, për të ndihmuar krijimin e një ndryshimi në sjelljen, në të menduarin e tyre, apo në situatën që ka shkaktuar një problem të caktuar. Egan (2013), Gordon (1974), Carhuff (2010), Kottler & Kottler (2000), Glaser (1975), Hill (2013), Zuker (1983) evidentojnë tri aftësi për të qenë një komunikues efektiv: rreptësia konstruktive, dëgjimi dhe përgjigjja me ndjeshmëri dhe zgjidhja e problemit.

Në fokus të këtij studimi është aftësia e *dëgjimit dhe e përgjigjes me ndjeshmëri*. Dëgjimi dhe përgjigja me ndjeshmëri ka dy përbërës: aftësitë e të dëgjuarit dhe aftësitë për të trajtuar problemin (Evertson, Carolyn M; Emmer, Edmund T., 2017). Sipas Gordon (1974), një komunikim i suksesshëm përfshin dëgjimin aktiv, i cili kompozohet në momentin kur ai që dëgjon, reflekton mbi përmbajtjen e mesazhit të dërguar nga ana tjetër, duke treguar jo vetëm se e ka kuptuar mesazhin, por dhe që ka pranuar përmbajtjen e tij. Modeli Katër-Anësor i komunikimit i Schulz von Thun (1981) nënvizon se në ndërveprimet mësues-nxënës, vëmendja duhet të jetë mbi katër dimensione të rëndësishme: përmbajtja faktike, duke siguruar që informacioni të jetë stimulues dhe interesant; vetëzbulimi, duke qenë i vetëdijshëm për atë që përcjell për veten si dërgues; marrëdhënia, duke treguar një qëndrim respektues dhe të përshtatshëm ndaj dëgjuesit; dhe tërheqja, duke marrë parasysh efektin e synuar të mesazhit të bashkëbiseduesit. Alberico (2007) pohon se dëgjimi aktiv bazohet në pranimin dhe kuptimin e gjendjes së tjetrit. Këtu nuk kryhet thjesht vetëm një akt i dërgimit të informacionit, por mbahen parasysh edhe aspektet personale të pjesëmarrësve në bisedë, si dhe të gjitha aspektet verbale, joverbale e paraverbale. Pra, dëgjimi, siç e përcaktojnë dhe Wolvin dhe Coakley (1996), është një nga aftësitë më të rëndësishme në komunikim jo vetëm për arritjet personale, por edhe për ato profesionale e akademike.

Zhvillimi i aftësive të komunikimit të mësuesve në detyrë realizohet përmes iniciativave të tyre vetjake, por dhe përmes aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Zhvillimi profesional i mësuesve është njohur gjerësisht si një faktor kyç në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të performancës së nxënësve (Darling - Hammond, 2017). Në kontekstin shqiptar, “Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021–2026” thekson rolin e trajnimit të vazhdueshëm, kompetencës digjitale dhe të sistemeve të vlerësimit të mësuesve. Megjithatë MAS pohon “riskun e fiktivitetit të aktiviteteve të ZhVP-së, duke mos pasur ndikim në përmirësimin e cilësisë së shkollës mbetet i lartë.” (MAS 2024, f. 5).

Pjesëmarrja e mësuesve në aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional është thelbësore për t’u siguruar që ata të qëndrojnë të përditësuar me praktikatat më të fundit arsimore (ASCAP 2024, f. 14). Aktiviteti më i shpeshtë i zgjedhur nga mësuesit, ndër aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional është trajnimi, i cili është një aktivitet që zhvillohet për të ndihmuar mësuesit të përmirësojnë praktikatat e tyre të mësimdhënies, të adresojnë sfidat specifike dhe të arrijnë qëllimet

profesionale. Ky aktivitet orientohet kryesisht drejt praktikave duke gërshetuar përmbajtjen teorike me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë kompetenca që u nevojiten për të kryer në mënyrë cilësore dhe efektive detyrat dhe punën e tyre aktuale (ASCAP 2024, f. 8).

Metodologjia

Qëllimi i studimit është vlerësimi i ndikimit të trajnimit, si aktivitet i zhvillimit të vazhdueshëm profesional, në aftësimin e mësuesve si komunikues efektivë.

Siç u përmend edhe më lart, ndër aftësitë e komunikimit që përdoren në mësimdhënie, në këtë studim u shqyrtua aftësia e dëgjimit dhe e përgjigjes me ndjeshmëri. Kjo aftësi nënkupton dëgjimin e këndvështrimit të nxënësit dhe përcjelljen e reagimeve nëpërmjet mënyrave që ruajnë një marrëdhënie pozitive dhe inkurajojnë diskutime të mëtejshme. (Evertson dhe Emmer 2017, f. 195)

Pyetja kërkimore e ngritur në këtë studim është:

1. A ekziston ndryshim i vlefshëm statistikor në qëndrimet e mësuesve rreth aftësisë së dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

Aftësia e dëgjimit dhe e përgjigjes me ndjeshmëri në këtë studim është konceptuar si aftësi për përcaktimin e reagimit të përshtatshëm në episode të komunikimit mësues-nxënës, si aftësi për përzgjedhjen e përgjigjeve me ndjeshmëri në një shumëllojshmëri përgjigjesh dhe si aftësi për ndërtimin e përgjigjeve me ndjeshmëri. Për këtë arsye kjo pyetje kërkimore zërthehet në tri nënpyetje:

1.1 A ekziston ndryshim i vlefshëm statistikor në qëndrimet e mësuesve për përcaktimin e reagimit të përshtatshëm, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

1.2 A ekziston ndryshim i vlefshëm statistikor në qëndrimet e mësuesve për përzgjedhjen e përgjigjeve me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

1.3 A ka diferenca në qëndrimet e mësuesve për ndërtimin e përgjigjeve me ndjeshmëri para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

Popullata/Kampioni

Në këtë studim pjesëmarrësit u përzgjedhën duke përdorur strategjinë e kampionimit jo të rastësishëm, por me anë të kampionimit të qëllimshëm mbi bazën e gjykimit (Gall, Borg dhe Gail, 1996). Kriteret për të zgjedhur kampionin ishin: pjesëmarrësit janë mësues në detyrë në sistemin parauniversitar shqiptar, pjesëmarrësit janë regjistruar me vullnet të lirë dhe kanë kryer trajnimin dhe pjesëmarrësit janë dakord për të marrë pjesë në

studim. Ky kampion është përfaqësues sepse kriteret e përzgjedhjes janë të përcaktuara qartë dhe vetë kampioni është përshkruar plotësisht. Në studim morën pjesë 168 mësues të arsimit parauniversitar, pjesëmarrës në trajnimin “Aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies”, zhvilluar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” gjatë vitit shkollor 2024-2025. Në kampion u përfshinë pjesëmarrësit e gjashtë trajnimeve. Pjesëmarrësit rezultuan me një përfaqësim të gjerë gjeografik në nivel DRAP dhe ZVAP, konkretisht, nga shkollat e Elbasanit, Tiranës, Shkodrës, Pogradecit, Maliqit, Kavajës dhe Lushnjës, duke garantuar një shumëllojshmëri në profile, në përvojë dhe në kontekste mësimore. 91% e pjesëmarrësve ishin femra dhe 9% meshkuj; 24% kishin përvojë pune deri në 1 vit, 20% ishin mësues të kualifikuar, 20% mësues specialistë dhe 36% mësues mjeshtër; 33% ishin mësues në AF, 42% në AMU dhe 25% në AML; 38% punonin në qytet dhe 62% në fshat; 5% punonin në sektorin privat dhe 95% në sektorin shtetëror.

Trajnimi “Aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies” është i akredituar dhe i regjistruar në portalin “Training for all”. Çdo trajnim (gjashtë të tilla) u krye gjatë tri ditëve, me nga gjashtë seanca secili, 18 orë gjithsej (9 orë trajnim i drejtpërdrejtë në sallë + 9 orë studim i literaturës, materialit përkatës dhe detyra në kuadër të zbërthimit të programit). Numri i pjesëmarrësve në çdo trajnim varionte 25-30 punonjës arsimorë. Çdo trajnim u krye nga studiuesi në mjediset e FSHE-së.

Dizajni i kërkimit

Dizajni i një grupi para/pas test (O1 X O2) (Campbell dhe Stanley, 1963; Cook dhe Campbell, 1979) u përdor për krahasimin e qëndrimeve të mësuesve rreth aftësisë së dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit. Dizajni përshkruet u përdor për variablet demografike dhe për aktivitetin e trajnimit. Dizajni përshkruet ofron një përshkrim “të qartë, të saktë të individëve, ngjarjeve apo proceseve” (Gall, Gall dhe Borg 2005, f. 179).

Dizajni konsistoi në kryerjen e dy matjeve rreth aftësisë së dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri: matja e parë para se të zhvillohej trajnimi dhe matja e dytë pas kryerjes së trajnimit. Qëllimi ishte të shqyrtohej nëse kishte diferenca në aftësinë e dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri, në rastet kur mësuesit kishin marrë njohuri rreth aftësive të komunikimit gjatë mësimdhënies dhe në rastet kur ata nuk kishin marrë njohuri. Dizajni i studimit përputhet me nivelin e dytë të vlerësimit të aktiviteteve të ZhVP-së, (katër nivelet e vlerësimit të Kirkpatrick, 2006), ku theksohet se “*Rekomandohet që njohuritë, shkathtësitë ose qëndrimet e pjesëmarrësve të maten edhe para trajnimit në mënyrë që të ketë një vlerë krahasimi.*” (MAS

2024, f. 17).

Instrumenti i studimit

Instrumenti i studimit ishte *Testi para dhe pas*. Testi para dhe pas trajnimit është një formë e zakonshme e vlerësimit të aktiviteteve trajnuese, për të matur përmirësimin e njohurive të pjesëmarrësve. Testet përdoren para dhe pas trajnimit për të krahasuar rezultatet. (MAS 2024, f. 24). Testi u organizua në tre seksione:

- (1) Krahasimi i dy episodeve të komunikimit mësues-nxënës dhe argumentimi i përzgjedhjes,
- (2) Përzgjedhja e përgjigjeve në tre pohime (të nxënësit) dhe një shumëllojshmëri të përgjigjeve të mësuesit (katër) ndaj secilit pohim,
- (3) Ndërtimi i përgjigjes me ndjeshmëri në një dialog të dhënë mësues-nxënës.

Testi Chi square (χ^2) me madhësinë e efektit Cramér's V, vlerësuan ndryshimet para dhe pas trajnimit (pyetja e dytë). U përpunuan përgjigjet për argumentimin e përzgjedhjes (pyetja e parë) dhe për ndërtimin e përgjigjes me ndjeshmëri (pyetja e tretë).

Rezultatet dhe diskutimi

Në lidhje me pyetjet e ngritura, rezultoi se:

1.1 A ekziston ndryshim i vlefshëm statistikor në qëndrimet e mësuesve për përcaktimin e reagimit të përshtatshëm, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

Përcaktimi i reagimit të përshtatshëm, para dhe pas trajnimit (pyetja e parë e testit), u realizua përmes krahasimit të dy episodeve komunikativë mësues-nxënës (episodi A, episodi B), përzgjedhjes së episodit të duhur dhe argumentimit të përzgjedhjes. Rezultatet treguan se nuk ka diferenca të vlefshme statistikore në qëndrimet e pjesëmarrësve para dhe pas trajnimit në lidhje me përzgjedhjen e episodit që përfaqëson reagimin e përshtatshëm (përkatesisht 95% dhe 98% e pjesëmarrësve zgjodhën reagimin e përshtatshëm (episodi B) para dhe pas trajnimit). Diferencat në qëndrimet e pjesëmarrësve bëhen evidente në argumentet që listojnë lidhur me krahasimin e episodeve. Qartësisht, pas trajnimit (matja 2) kemi argumente më të mirëmbështetura dhe më të shumta për përzgjedhjen. Komentet më të shpeshta të pjesëmarrësve në studim në lidhje me dy episodet e paraqitura për krahasim pas trajnimit ishin:

Për episodin A:

- “Përgjigja e mësuesit nuk ndihmon në zgjidhjen e situatës.”
- “Ka të ngjarë që nxënësi të jetë i vetëdijshëm për pasojat e shmangies së dënimit dhe në këtë rast konflikti provokon vetëm përballje, të cilën nxënësi e fitoi, të paktën përkohësisht, duke u larguar”.

Për episodin B:

- “Mësuesi shmang konfliktin dhe në vend të tij, ai informohet mbi shqetësimin e nxënësit dhe e fton atë në një diskutim të mëtejshëm.”
- “Nxënësi i përgjigjet qasjes së mësuesit duke e bërë më të qartë shqetësimin e tij.”
- “Roli i mësuesit në këtë përballje është ai i dëgjuesit dhe i ndihmuesit dhe jo i kundërshtarit”.
- “Mësuesi nuk i ofron një zgjidhje problemit të nxënësit duke i hequr dënimin. Në vend të kësaj, nxënësi mendon vetë se cilat alternativa janë të vlefshme.”
- “Nuk ka garanci nëse situata do të zgjidhet në mënyrë të kënaqshme për të gjithë. Por kjo mënyrë veprimi ofron të paktën mundësinë e një zgjidhjeje dhe e shmang përballjen që ndodh në episodin A.”
- “Afërsia me nxënësin e bën mësuesin më të përgjegjshëm gjatë trajtimit të situatës, në vend që t’i japë nxënësit edhe një justifikim tjetër për të shmangur përgjegjësinë”.

Gjithashtu pjesëmarrësit evidentuan si përparësi të përgjigjes me ndjeshmëri: i lejon mësuesit një mënyrë për të trajtuar emocionet e forta pa marrë përgjegjësinë për të zgjidhur problemet e nxënësit; strategjia ndihmon në lehtësimin e situatave të ngarkuara emocionalisht; ndjenjat intensive janë të përkohshme dhe zgjasin vetëm atëherë kur ndihmohen nga një përgjigje intensive; duke mos u përgjigjur me këtë intensitet të ngjashëm emocional, mësuesi shmang agravimin e komunikimit; mësuesi i qetë dhe i ndjeshëm shërben edhe si një model për zgjidhjen konstruktive të problemit etj.

Ndërsa analiza e mësipërme evidentoi ndryshimin cilësor në mënyrën se si mësuesit i perceptojnë dhe argumentojnë situatat konfliktuale, hapi pasardhës i studimit u fokusua në matjen sasiore të këtyre ndryshimeve. Për këtë qëllim, u analizuan zgjedhjet specifike të mësuesve në tre skenarë të standardizuar, siç paraqitet në vijim.

1.2 A ekziston ndryshim i vlefshëm statistikor në qëndrimet e mësuesve për përzgjedhjen e përgjigjeve me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

Përzgjedhja e përgjigjeve me ndjeshmëri (pyetja e dytë e testit) para dhe pas trajnimit u testua në tri situata të ndërtuara me dialogë mësues-nxënës. Çdo situatë përmbante një pohim të nxënësit dhe katër përgjigje alternative të mësuesit ndaj tij. Për secilën situatë, u kërkua përzgjedhja e përgjigjes së duhur reaguese, përgjigjes që fton vazhdimin me një diskutim të mëtejshëm apo e pasqyron më mirë idenë apo ndjenjën.

Të dhënat u analizuan duke përdorur testin Chi square (χ^2) të pavarësisë, si për shpërndarjen e katër opsioneve (4×2), ashtu edhe për zgjedhjen e përgjigjes së saktë krahasuar me alternativat e tjera (2×2). Madhësia e

efektit u llogarit me Cramér's V.


Situata 1

Për pohimin e nxënësit "Shkolla ta shpif." katër përgjigjet alternative të mësuesit ishin: 1. Mos përdor këtë gjuhë. 2. Dukesh i mërzitur me shkollën. 3. Oh, ç'janë këto! Gjërat nuk janë kaq keq. 4. Kjo sjellje nuk të shpie gjëkund. Përgjigjja me ndjeshmëri e mësuesit, ndër katër alternativat e dhëna, është "Dukesh i mërzitur me shkollën."

Rezultati statistikor: $\chi^2 = 5.91$, $p = 0.015$, Cramér's V = 0.17.

Vlera $p = 0.015$ tregon se ekziston një ndryshim statistikiqsh të rëndësishëm në shpërndarjen e përgjigjeve para dhe pas trajnimit. Madhësia e efektit (Cramér's V = 0.17) sugjeron një lidhje të moderuar midis ndjekjes së trajnimit dhe përmirësimit të përgjigjes.

Alternativa e saktë para trajnimit u zgjodh nga 51% e pjesëmarrësve. Pas trajnimit, kjo shifër u rrit në 65%, duke u bërë zgjedhja dominuese. Ndërkohë, opsionet që përmbajnë gjykim ose moralizim (si opsioni 4: "Kjo sjellje nuk të shpie gjëkund") pësuan rënie, çka tregon se mësuesit u bënë më të prirur të njohin ndjenjën e nxënësit sesa ta kritikojnë atë.



Grafiku 1. Qëndrimet për pohimin "Shkolla ta shpif" para dhe pas trajnimit.

Ka diferenca të vlefshme nga pikëpamja statistikore në qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me përzgjedhjen e përgjigjes me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit.

Situata 2

Për pohimin e nxënësit "Nuk e kuptoj matematikën. Pse duhet t'i mësojmë


këto gjëra?”, katër përgjigjet alternative të mësuesit ishin: 1. Do të të nevojitet për në shkollën e lartë. 2. Vazhdo punën. Do të ketë kuptim më vonë. 3. Nuk po hyn akoma në lëndë? 4. Do të të pëlqente të vije pas shkollës për një dorë ndihmë? Përgjigjja me ndjeshmëri e mësuesit, ndër katër alternativat e dhëna, është “Nuk po hyn akoma në lëndë?”.

Rezultati statistikor: $\chi^2 = 17.70$, $p < 0.001$, Cramér's $V = 0.30$.

Ky rezultat ($p < 0.001$) paraqet ndryshimin më të fortë statistikor në të gjithë studimin. Madhësia e efektit (Cramér's $V = 0.30$) tregon një lidhje të konsiderueshme, duke sugjeruar se trajnimi pati ndikimin më të madh në situatat ku nxënësit shprehin pasiguri akademike.

Alternativa e saktë para trajnimit renditet e treta, e zgjedhur vetëm nga 15% e pjesëmarrësve, ndërsa shumica dërrmuese (60%) preferuan fillimisht opsionin 4 (“Do të të pëlqente të vije pas shkollës për një dorë ndihmë”). Kjo tregon se para trajnimit, mësuesit tentonin të ofronin menjëherë një zgjidhje teknike.

Pas trajnimit, përzgjedhja e alternativës së saktë u rrit ndjeshëm në 43%, ndërsa tendenca për të ofruar zgjidhje të menjëhershme pa dëgjuar problemin (opsioni 4) ra në 34%. Kjo dëshmon një zhvendosje cilësore nga “ndreqja e problemit” te “dëgjimi aktiv”.



Grafiku 2. Qëndrimet për pohimin “Nuk e kuptoj matematikën. Pse duhet t’i mësojmë këto gjëra?” para dhe pas trajnimit

Rezultati tregon se ka diferenca të vlefshme nga pikëpamja statistikore në qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me përzgjedhjen e përgjigjes me

ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit.

Situata 3


Për pohimin e nxënësit “Nuk dua të ulem më pranë këtyre djemve.” katër përgjigjet alternative të mësuesit janë: 1. Më vjen keq, por vendet janë caktuar qysh në fillim të semestrit. 2. Nëse të shqetësojnë, mund të të çoj në një bankë tjetër. 3. Mund ta zgjidhësh vetë këtë problem? 4. Çfarë ka ngjarë? Përgjigjja me ndjeshmëri e mësuesit, ndër katër alternativat e dhëna, është “Çfarë ka ngjarë?”.

Rezultati statistikor: $\chi^2 = 8.88$, $p = 0.003$, Cramér's $V = 0.21$.

Analiza statistikore ($p = 0.003$) konfirmon se ndryshimi në qëndrimet e mësuesve është statistikisht i vlefshëm dhe jo i rastësishëm.

Alternativa e saktë para trajnimit renditet si e dyta më e zgjedhur (35%), ndërsa opsioni mbizotërues ishte opsioni 2 (“Nëse të shqetësojnë, mund të të çoj në një bankë tjetër”) me 52% të zgjedhjeve. Kjo tregon se fillimisht mësuesit prireshin të shmangnin konfliktin duke ofruar një zgjidhje logjistike të shpejtë.

Pas trajnimit, situata ndryshon dukshëm: alternativa e saktë (“Çfarë ka ngjarë? ”) u rrit në 57%, duke u bërë zgjedhja e parë. Mësuesit kuptuan rëndësinë e zbulimit të shkakut të konfliktit përpara se të merrnin masa për zhvendosjen e nxënësit.




Grafiku 3. Qëndrimet për pohimin “Nuk dua të ulem më pranë këtyre djemve.” para dhe pas trajnimit

Rezultati tregon se ka diferenca të vlefshme nga pikëpamja statistikore në

qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me përzgjedhjen e përgjigjes me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit.

Si raportohen ndërmjet tyre përgjigjet me ndjeshmëri për të tri situatat?



Grafiku 4. Përgjigjet me ndjeshmëri para dhe pas trajnimit në të tri situatat.

Rezultatet treguan se trajnimi ndikoi pozitivisht në përzgjedhjen e përgjigjeve me ndjeshmëri, pra në sjelljen komunikative të mësuesve. Situata 2 shfaqti përmirësimin më të madh, duke sugjeruar se mësuesit janë më të ndjeshëm ndaj situatave ku nxënësit shfaqin pasiguri akademike. Situata 1 dhe situata 3 shfaqën gjithashtu ndryshime domethënëse, megjithëse me madhësi më të ulëta efekti.

1.3 A ka diferenca në qëndrimet e mësuesve në ndërtimin e përgjigjeve me ndjeshmëri para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies?

Ndërtimi i përgjigjes me ndjeshmëri i referohet aftësisë për të trajtuar problemin, është zgjatim i aftësisë për të dëgjuar dhe lejon të konfirmohet apo të qartësohet perceptimi mbi mesazhin e nxënëses.

Ndërtimi i një përgjigjeje me ndjeshmëri (pyetja e tretë e testit) u realizua për situatën: *Për herë të dytë gjatë kësaj jave, Kaltrina nuk ka bërë detyrat. Pas mësimit, mësuesi i kujton Kaltrinës se detyrat vlejnë 30% të notës. "Nuk më intereson fare!", - përgjigjet ajo."*

Rezultatet treguan që ka diferenca të qarta në ndërtimin e përgjigjeve me ndjeshmëri nga pjesëmarrësit para dhe pas trajnimit. Përgjigjet para

kryerjes së trajnimit (matja 1) janë të vakëta dhe pak prej tyre dëshmojnë ndjeshmëri. Në nivelin më të thjeshtë përgjigjja ndërtohet duke përsëritur apo përmbledhur atë çfarë ka thënë nxënësja. Inkurajimi verbal në përgjigjet e ndërtuara tregohet me shprehje, si: “Ëhë”, “E kuptoj”, “Vazhdo”, “Kjo është interesante”. Pas trajnimit (matja 2) ka përgjigje ku ka më shumë prezencë të inkurajimit, të tilla si: “Më trego më shumë.”, “Më intereson të dëgjoj idetë e tua mbi këtë.”, “A e ke problem të bësh edhe një koment?”, “Çfarë mendon?”, “Ti e dëgjove opinionin tim. Tani unë do të dëshiroja të dëgjoja tëndin.”. Vetëm 37% e pjesëmarrësve ndërtojnë përgjigje të natyrës “Kaltrina, vura re se kohët e fundit, ti nuk i ke dorëzuar disa detyra. Mos do të flasësh për atë se çfarë po ndodh?”

Pas trajnimit, pjesëmarrësit përdorin disa përgjigje në bisedën me nxënësen që ka humbur interesin për shkollën dhe arrijnë në një pikë ku nxënësja mund të shprehë, të paktën pjesërisht, disa nga arsyet e ndjenjave të saj. Diskutimi qartësohet, nxënësja bëhet më e komunikueshme dhe më e arsyeshme. Ndonëse nuk mund të pritet që problemet më të mëdha të zgjidhen nëpërmjet shkëmbimit të vetëm të ndjeshëm të ideve, nuk është e pazakontë që një grup ndjenjash negative të qartësohen dhe diskutimi të përfundojë me nota pozitive. Të paktën nxënësja mëson se ajo i intereson mjaftueshëm një të rrituri, aq sa ky vendos ta dëgjojë, ndërsa mësuesi vendoset në një pozitë më të mirë për të orientuar nxënësen në të ardhmen. Ndërtimi i një përgjigjeje me ndjeshmëri kërkon investim të mësuesve në drejtim të zotërimit të aftësive të komunikimit (Muharremi, 2025).

Përdorimi i aftësisë së dhënies së përgjigjes me ndjeshmëri, i ndihmon mësuesit të parandalojnë dhënien e përgjigjeve në formë mbrojtëse atëherë kur nxënësit reagojnë në mënyrë emocionale, apo kur ata shprehin një problem gjatë orës së mësimi. Ato gjithashtu “*i japin kohën e nevojshme*” mësuesit, gjatë së cilës ai konsideron alternativa të ndryshme për të trajtuar një problem (Evertson dhe Emmer 2017, f. 202).

Përmbledhtazi, ndryshimi në ndërtimin e përgjigjeve tregon se trajnimi i ka pajisur mësuesit me modele konkrete komunikative për të menaxhuar situata emocionale. Pjesëmarrësit kaluan nga reagimet instinktive, shpesh mbrojtëse ose moralizuese, drejt një qasjeje eksploruese që vlerëson këndvështrimin e nxënësit. Aftësia për të “pezulluar” gjykimin dhe për të kërkuar më shumë informacion (“Më trego më shumë”, “Çfarë mendon?”) është treguesi kryesor i rritjes së kompetencës komunikuese pas ndërhyrjes trajnuese.

Cilësia, dendësia, intensiteti, hapësirat, strategjitë apo stilet e ndryshme të komunikimit, të përdorura ndërmjet mësuesit dhe nxënësve gjatë veprimtarive mësimore, kanë rëndësinë e tyre në

krijimin e një klime të përgjithshme pozitive në klasë jo vetëm për të nxënësit në përgjithësi, por edhe për të krijuar marrëdhënie midis mësuesve dhe nxënësve, si edhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor e edukativ.

Vlerësimi i kompetencave komunikuese të mësuesve duhet të vërehet, të studiohet përtej seancave të trajnimit, pasi është e rëndësishme të vlerësohet ndikimi i tyre në ndryshimin e sjelljes në vendin e punës dhe të performancës së përmirësuar të mësuesve. Vetëm kështu, mund të kuptojmë më mirë se çfarë është bërë mirë dhe çfarë jo, duke ndihmuar që trajnimet e ardhshme të jenë më të mira. “Impakti i aktiviteteve të ZhVP-së në ndryshimin e sjelljes (niveli 3) së punonjësve arsimorë dhe përmirësimet ose rezultatet (niveli 4) në punën e tyre, vlerësohet pas disa muajve nga përfundimi i programit të aktiviteteve të ZhVP-së. (MAS 2024, f. 16).”

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në studim u shqyrtua impakti i trajnimit, në zhvillimin e aftësisë së dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri përmes dizajnit të një grupi para/pas test. Mësuesit pjesëmarrës në studim kishin një përfaqësim të gjerë gjeografik, shumëllojshmëri në profile, në përvojë dhe në kontekste mësimore dhe kryen testin para dhe pas trajnimit për aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies.

Nga përpunimi i rezultateve, në lidhje me pyetjet e ngritura, u arrit në këto përfundime:

- Nuk ekziston ndryshim i vlefshëm nga pikëpamja statistikore në përcaktimin e reagimit të përshtatshëm nga mësuesit, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies, por ka diferenca në argumentimin e përzgjedhjes. Dukshëm, pas marrjes së trajnimit argumentet e mësuesve janë më të plota e më të mirëmbështetura.
- Ekziston ndryshim i vlefshëm nga pikëpamja statistikore në qëndrimet e mësuesve në lidhje me përzgjedhjen e përgjigjeve me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies.
- Ka diferenca të qarta në ndërtimin e përgjigjeve me ndjeshmëri nga mësuesit para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies.

Rezultatet e nënpyetjeve përmbledhen në këtë përfundim në lidhje me pyetjen kërkimore të studimit:

Ekziston ndryshim i vlefshëm nga pikëpamja statistikore si dhe nga ajo përshkruese dhe argumentuese, në qëndrimet e mësuesve rreth aftësisë së dëgjimit dhe të përgjigjes me ndjeshmëri, para dhe pas trajnimit mbi aftësitë e komunikimit gjatë mësimdhënies. Pas trajnimit, aftësia e dëgjimit dhe e përgjigjes me ndjeshmëri është qëndrim më i vetëdijshëm dhe më pranues i mësuesit ndaj këndvështrimit të nxënësit dhe kërkesave ndaj tij për të qartësuar këndvështrimin. Pas trajnimit, mësuesit janë më të

vëtëdijshëm se përgjigjja me ndjeshmëri ndihmon në ruajtjen e rrugëve të hapura të komunikimit midis mësuesit dhe nxënësve dhe kështu problemet mund të kuptohen dhe të zgjidhen në një mënyrë të pranueshme për të gjitha palët. Pas trajnimit, mësuesit janë komunikues më efektivë se para trajnimit. Përmes trajnimit, pjesëmarrësit përfitojnë kompetenca komunikative që u nevojiten për të kryer në mënyrë cilësore dhe efektive detyrat dhe punën e tyre aktuale.

Shqyrtimi i ndikimit të trajnimeve në këtë studim evidentoi që ato kanë ndikim pozitiv në zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë. Ky përfundim sfidon pohimin e MAS, sipas të cilit “Supozimi se aktivitetet e ZhVP-së çojnë automatikisht në ndryshim të sjelljes ose përmirësim të performancës së punës, nuk është i vlefshëm. (MAS 2024, f. 7).”. Studimi ofron një panoramë të ndikimit të trajnimit në kompetencat komunikuese të mësuesve dhe ndihmon që ofruesit e aktiviteteve trajnuese të rrisin vetëvlerësimin e tyre, me qëllim rritjen e suksesit të programeve që ofrojnë.

Rekomandime

Mbështetur në gjetjet e studimit jepen këto rekomandime:

Për politikëbërësit:

- Fuqizimi i mësuesve si komunikues efektivë të ofrohet edhe përmes aktiviteteve të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, si workshop-i, mikrokredenciali, konferenca, seminari, projekte ndërkombëtare ose kombëtare për mësues etj.

Për IAL-të dhe aktorët e tjerë të përfshirë në zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë:

- Të shtohet numri i aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional me tematikë aftësitë e komunikimit.
- Të pasurohen aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional me metodologji, si: simulimi, demonstrimi, loja me role, shkëmbimi i përvojave, studime rasti, dedikuar situatave komunikative mësues-nxënës e më gjerë.
- Metodat e përdorura gjatë aktiviteteve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të inkurajojnë bashkëpunimin, shkëmbimin e eksperiencave, reflektimin mbi praktikën e komunikimit dhe vetëvlerësimin, si dhe të kontribuojnë në rritjen e kënaqësisë dhe të motivimit në punë të mësuesve.

Për DRAP, ZVAP dhe drejtoritë e shkollave:

- Rrjetet e zhvillimit profesional, t'i bëjnë pjesë të agjendave të tyre tematikat e aftësive të komunikimit.
- Krijimi i platformave të ndryshme online, ku mund të ndahen dhe të pasurohen burimet materiale, metodologjitë, prezantimet, artikuj të ndryshëm, kërkime dhe më shumë rreth aftësive të komunikimit; nëpërmjet të cilave mësuesit shkëmbejnë përvoja, parashtrojnë pyetje dhe marrin përgjigje nga kolegë.

Për mësuesit:

- Të adresojnë sfidat specifike në drejtim të komunikimit mësues-nxënës.
- Të përmirësojnë praktikën e tyre të komunikimit përmes vetëreflektimit dhe të arrijnë qëllimet profesionale.

Rekomandime për studime të mëtejshme:

Vlerësimi i ndikimit të trajnimit të studiohet më gjerë në performancën e mësuesve në procesin mësimor përmes vëzhgimeve të drejtpërdrejta por edhe përmes vetëraportimeve të mësuesve.

KUFIZIMET E STUDIMIT

Studimi tregon çfarë kanë mësuar pjesëmarrësit rreth aftësive të komunikimit si rezultat i trajnimit. Një vlerësim i plotë i trajnimit duhet të shqyrtojë transferimin e kompetencës nga mjedisi trajnues në mjedisin e vendit të punës dhe të matë impaktin e performancës së punonjësve arsimorë në punë.

REFERENCA

- ASCAP. (2024). Udhëzuesi për procedurat dhe për kriteret e njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë.
- Alberico, L. (2007). Ascolto nella relazione educativa. Rivista digitale della didattica.
- Borman, E. G. (1988). Symbolic convergence theory: a communication
- Campbell, D. & Stanley, J. (1963). Experimental and quasi-experimental designs for research. Chicago, IL: RAND-McNally.
- Carhuff, R. R. (2010). The art of helping in the 21st century (9th ed.). Amherst, MA: Human Resource Development.
- Cook, T. D., & Campbell, D. T. (1979). Quasi-experimentation: Design and analysis issues for field settings. Boston, MA: Houghton Mifflin Company.
- Darling-Hammond, L. (2017). Teacher education around the world: What can we learn from international practice? European Journal of Teacher Education, 40(3), 291–309. <https://doi.org/10.1080/02619768.2017.1315399>
- Egan, G. (2013). The skilled helper: A problem management and opportunity development approach to helping (HSE 123 Interviewing Techniques) (10th ed.). Cengage Learning. formulations based on hommo narrens. Journal of Communication, 35: 128-39.
- Evertson, Carolyn M. (2017). Classroom Management for Middle and High School Teachers, 10th Edition. by; published by Pearson Education, Inc.
- Gall, J. P., Gall, M. D., & Borg, W. R. (2005). Applying educational research: A practical guide. Boston: Pearson Education, Inc.
- Glaser, W. (1975). Reality therapy: A new approach to psychiatry. New York: Harper & Row.
- Gordon, T. (1974). Teacher effectiveness training. New York: Peter H. Wyden.
- Hill, J. D., & Miller, K. B. (2013). Classroom instruction that works with English language learners (2nd ed.). Alexandria, VA: ASCD.

- Kirkpatrick DL. (1959). Techniques for evaluating training programmes. *Journal of the American Society of Training Directors*, 13:3–9 and 21–26; 14:13–18 and 28–32.
- Kirkpatrick DL, Kirkpatrick JD. (2006). (Evaluating training programs, 3rd edition. San Francisco, CA, Berrett-Koehler Publishers, See also: <http://www.kirkpatrickpartners.com/>, accessed 29 Sept. 2010).
- Kottler, J. A., & Kottler, E. (2000). *Teacher as counsellor: Developing the helping skills you need* (2nd ed.). Thousand Oaks, CA: Corvin.
- MAS. (2024). *Manuali i vlerësimit të aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*.
- MASR. (2021). *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026*, <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/06/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>
- Muharremi, A. (2025). The skill of “listening and responding with empathy” in teacher-student communication, *The Forth International Conference “Globalisation And Integration In Contemporary Education”*, University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”, Faculty of Educational Science, 21 November 2025.
- Rosenfeld, Lawrence B. (1993). *“Human Communicaton”*, New York.
- Schulz von Thun, F. (1981). *Miteinander reden 1: Störungen und Klärungen*. Reinbek bei Hamburg: Rowohlt.
- Wolvin, A. D., Coakley, C. G. (1996). *Listening*. New York. McGraw-Hill.
- Zuker, E. (1983). *Mastering assertiveness skills: Power and positive influence at work*. New York: AMACOM.
- Portali “Training for all”, Fuqizimi i mendjeve transformimi i së ardhmes, <https://trajtime.arsimi.rash.al/trainimet>

NDËRHYRJET NË VËMENDJEN E VULLNETSHME (VETËDIJSHME) DHE ZHVILLIMI I AFTËSISË SË LEXIMIT TEK MOSHAT 8-9 VJEÇ NË SHKOLLË

Irini Arapi (Sylari), Eftimi Sylari

Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Ndërhyrjet që zakonisht ndërmerren në klasë për të tërhequr dhe zhvilluar vëmendjen e vullnetshme të nxënësve në shkollë ka ngjallur një interes të madh tek hulumtuesit dhe mësuesit e këtyre moshave me qëllim që të zgjojnë vullnetin dhe dëshirën e tyre drejt leximit efektiv. Njëkohësisht, këto ndërhyrje janë parë si veprime efikase në tërheqjen e vëmendjes së vullnetshme (vetëdijshme) ndaj zhvillimit dhe përvetësimit të aftësive njohëse, emocionale, si dhe ndaj sjelljeve të tyre në mjedise të ndryshme të familjes, shkollës dhe shoqërisë. Një numër i konsiderueshëm studimesh janë kryer brenda kuadrit të shkollës, ku një korpus i gjerë kërkimesh tregon se si praktikrat dhe ndërhyrjet rreth tërheqjes së vëmendjes së vullnetshme në klasë sjellin rezultate të kënaqshme në zhvillimin e aftësive të leximit, gjë që përbën një aftësi thelbësore akademike dhe që ndikon pothuajse në çdo fushë të të nxënësve.

Ky artikull shqyrton disa baza teorike dhe prova empirike që lidhen me ndërhyrjet e vëmendjes së vullnetshme në klasë dhe njëkohësisht evidenton ndikimin e tyre në proceset e leximit, duke përfshirë kuptimin, rrjedhshmërinë dhe motivimin. Duke sintetizuar studime nga psikologjia njohëse, neuroshkenca dhe kërkimi arsimor, ky punim paraqet mekanizmat nëpërmjet të cilëve vëmendja e vullnetshme mund të zbusë vështirësitë e vëmendjes, të reduktojë ankthin e performancës dhe të nxisë sjellje vetërregulluese që mbështesin procesin e leximit.

Artikulli nënvizon vlerësimet mbi projektimin, zbatimin dhe kufizimet e ndërhyrjeve të vëmendjes së vullnetshme tek nxënësit në shkollë, si dhe jep rekomandime për veprimtari praktike në arsimin fillor. Përveç se çfarë është përmendur më sipër, artikulli nxjerr në pah nevojën për kërkime të mëtejshme dhe afatgjata mbi ndërhyrjet e vëmendjes së vullnetshme, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt leximit, veçanërisht në raport me grupet e ndryshme të nxënësve, si dhe në raport me inovacionet teknologjike. Në tërësi, provat sugjerojnë se praktikrat e vëmendjes së

vullnetshme paraqesin potencial të konsiderueshëm si një qasje plotësuese për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit dhe për të kultivuar mirëqenien njohëse dhe emocionale të nxënësve.

Fjalë kyçe: *ndërhyrjet e vëmendjes së vullnetshme, zhvillimi i leximit, kuptimi i leximit, shkathtësi e të lexuarit, motivimi në lexim, arritjet akademike, rregullimi i vëmendjes, rregullimi emocional, kontrolli njohës.*

Mindfulness intervention and reading development for primary school learners

ABSTRACT

Mindfulness-based interventions have garnered increasing scholarly attention due to their potential benefits for a broad spectrum of cognitive, emotional, and socio-behavioral outcomes. Within educational contexts, a growing body of research explores how mindfulness practices can support reading development, an essential academic skill that underpins success in virtually every subject area. This article provides an extensive examination of the theoretical underpinnings and empirical evidence pertaining to mindfulness interventions and their influence on reading processes, including comprehension, fluency, and motivation. By synthesizing studies from cognitive psychology, neuroscience, and educational research, this paper outlines the mechanisms by which mindfulness can mitigate attentional difficulties, reduce performance anxiety, and foster self-regulatory behaviors that support the reading process. Additionally, considerations regarding the design, implementation, and limitations of mindfulness interventions are discussed, as are recommendations for practical applications in schools. Future directions highlight the need for more rigorous, long-term investigations of mindfulness-based reading interventions, particularly with respect to diverse populations and technological innovations. Taken together, the evidence suggests that mindfulness practices hold promise as a complementary approach to enhance reading development and to cultivate students' overall cognitive and emotional well-being.

Keywords: *mindfulness interventions, reading development, reading comprehension, reading fluency, reading motivation, academic achievement, attention regulation, emotional regulation, cognitive control*

Hyrje

Leximi është një gur themeli i suksesit akademik dhe një aftësi kritike për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Që në shkrimet e hershme nga moshë e re e deri tek moshat e avancuara, procesi i leximit përfshin veprime të ndërlikuara njohëse, duke përfshirë dekodimin e simboleve, integrimin e informacionit semantik dhe arsyetimin e niveleve të larta (Snow et al., 1998). Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka leximi, studiuesit mësuesit kanë kërkuar prej kohësh ndërhyrje që mbështesin zhvillimin e leximit, veçanërisht për nxënësit që përballen me vështirësi si mungesë e vëmendjes, me barriera gjuhësore apo me sfida socioemocionale.

Paralelisht, ndërhyrjet e bazuara në aftësimin e vëmendjes së vullnetshme janë zgjeruar ndjeshëm në mjediset arsimore si një mënyrë për të përmirësuar rezultate të ndryshme të nxënësve, që nga rregullimi emocional deri te funksionet e kryera nga nxënësit (Kabat-Zinn, 2003; Zenner et al., 2014). Vëmendja e vullnetshme përkufizohet si vetëdije ndaj mendimeve, emocioneve dhe ndjesive trupore në çastin e tanishëm, pa gjykim (Kabat-Zinn, 1994). Kjo qasje ofron një mënyrë të shumanshme të të nxënëit që mund të jetë veçanërisht e dobishme për procesin e leximit.

Ndërthurja midis ndërhyrjeve të vëmendjes së vullnetshme dhe zhvillimit të aftësive të leximit mbështetet në disa korniza teorike. Së pari, ushrimi i veprimeve për të kultivuar vëmendjen e vullnetshme zhvillon kapacitetet vetërregulluese që nxit vëmendje të qëndrueshme—aftësi thelbësore në procesin e leximit (van de Weijer-Bergsma et al., 2012). Për më tepër, praktikët e ndërgjegjes mund të përmirësojnë ngarkesën njohëse duke reduktuar mendimet ndërhyrëse dhe ankthin e performancës, duke bërë të mundur hapjen e kujtesës për të kuptuar tekstin (Mrazek et al., 2013).

Ky punim synon të shqyrtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse se si ndërhyrjet në zhvillimin e vëmendjes së vullnetshme mund të mbështesin zhvillimin e aftësive të leximit. Pas një përmbledhjeje të perspektivave teorike mbi vëmendjen e vullnetshme dhe arritjet akademike, do të shqyrtojmë komponentët njohës dhe emocionalë të leximit, provat empirike dhe zbatimin e tyre praktik në mjediset shkollës. Në fund paraqiten sfidat e zbatimit të këtyre praktikave, si dhe në fund japim disa sugjerime për kërkimet në vijim.

Bazat Teorike të vëmendjes së vullnetshme në klasë

Përkufizimi i vëmendjes së vullnetshme dhe përbërët e tij themelorë
Vëmendja zakonisht përshkruhet si një proces i përqendrimit momental, i shoqëruar me një vetëdije kritike ndaj përvojave të brendshme dhe të

jashtme (Kabat-Zinn, 1994). Nga ky përkufizim dalin dy përbërës kryesorë të vëmendjes së vullnetshme: vëmendja e përqendruar dhe praktikat ku vërehen pa paragjykim dhe pa u menduar thellë mendimet, përvojat, ndjenjat dhe emocionet (Lutz et al., 2008).

Vëmendja e përqendruar nënkupton mbajtjen e vëmendjes së qëndrueshme dhe selektive ndaj një objekti të caktuar që shpesh mund të jetë frymëmarrja, një mantrë apo një ndjesi fizike për të zhvilluar kontroll më të madh mbi përqendrimin e vëmendjes. Ndërsa, praktikat ku vërehen pa paragjykim dhe pa u menduar thellë mendimet, përvojat, ndjenjat dhe emocionet, theksojnë vëzhgimin e mendimeve, emocioneve dhe ndjesive sapo ato shfaqen.

Këta përbërës themelorë kanë rëndësi të dukshme në mësimdhënie. Në mjediset e të nxënësve, aftësia për të mbajtur vëmendjen gjatë leximit dhe marrjes së shënimeve mund të çojë në përmirësim të kuptimit dhe mbajtjes mend të materialit (Posner & Petersen, 1990). Në të njëjtën kohë, aftësia për të vëzhguar mendimet ndërhyrëse apo reagimet emocionale pa gjykim mund të ulë ankthin e testit dhe të lehtësojë ngurrimin apo nervozizmin e nxënësve gjatë kryerjes së detyrave sfiduese (Zenner et al., 2014). Si rrjedhojë, vëmendja e vullnetshme është menduar si një mekanizëm që rrit kontrollin kognitiv, rregullimin emocional dhe ndërgjegjësimin metakognitiv, të cilët janë faktorë të lidhur ngusht me performancën në lexim (Brown & Ryan, 2003).

Vëmendja e vullnetshme, kontrolli kognitiv dhe arritjet akademike

Rëndësia e kontrollit kognitiv (ose funksioneve ekzekutive) për suksesin akademik është tashmë e provuar dhe e pohuar (Blair & Raver, 2015). Kontrolli kognitiv përfshin një grup procesesh mendore, si kujtesa vepruese, kontrolli frenues dhe përshtatshmëria kognitive, të cilat së bashku mundësojnë sjelljen e drejtuar nga qëllimi (Diamond, 2013). Detyrat e leximit, veçanërisht në nivele më të larta, mbështeten shumë te kujtesa vepruese për të ndërthurur njohuritë paraprake me informacionin e ri të tekstit dhe për të frenuar shpërqendrimet e parëndësishme (Oakhill et al., 2003). Të ushtruarit e vëmendjes së vullnetshme ka treguar se përmirëson aspekte të kontrollit kognitiv duke nxitur qëndrueshmërinë e vëmendjes dhe duke reduktuar reagimin ndaj stimuljeve emocionalë (Tang et al., 2015; Mrazek et al., 2013). Në një kontekst akademik, këto vlerësime trajtohen duke u përqendruar më shumë tek detyrat e leximit, si dhe duke u mbështetur tek kuptimi i teksteve komplekse.

Për më tepër, gjetjet e fundit neuroshkencore hedhin dritë mbi mekanizma të mundshëm, si p.sh., praktikat e vëmendjes së vullnetshme që

janë të lidhura me ndryshime në aktivitetin e trurit në korteksin cingulat anterior (ACC) dhe korteksin prefrontal (PFC)—zona të përfshira në rregullimin e vëmendjes dhe funksionet ekzekutive (Tang et al., 2015). Duke ushtruar vazhdimisht këto zona përmes vëmendjes së ndërgjegjshme ndaj frymëmarrjes dhe ndjesive trupore, individët mund të forcojnë rrjetet nervore përgjegjëse për mbajtjen e përqendrimit dhe filtrimin e shpërqendrimeve. Ky sfond fiziologjik ofron një arsye bindëse për të shqyrtuar mënyrat se si programet e bazuara në mindfulness mund të integrohen në mësimdhënien e leximit për të përmirësuar rezultatet në shkrim dhe lexim (Felver et al., 2016).

Zhvillimi i leximit: dimensionet kognitive dhe emocionale

Proceset kognitive që mbështesin leximin

Leximi nuk është një aftësi e vetme, por një grup procesesh kognitive që përfshijnë ndërgjegjësimin fonologjik, përpunimin ortografik, dekodimin, fjalorin dhe strategjitë e kuptimit (Gough & Tunmer, 1986; Perfetti, 2007). Që në literaturën e hershme rreth leximit, zotërimi i marrëdhënieve midis fonemave dhe grafemave (pra, shkronjave dhe tingujve) është thelbësor për të dekoduar fjalët me saktësi (Adams, 1990). Me përparimin e leximit, nxënësit zhvillojnë aftësi më të avancuara të kuptimit që përfshijnë nxjerrjen e ndikimeve, përmbledhjen dhe vlerësimin kritik të teksteve (Duke & Carlisle, 2011). Në çdo nivel, ngarkesa kognitive luan një rol të rëndësishëm. Nëse shumë burime të vëmendjes konsumohen nga proceset e nivelit të ulët si dekodimi, lexuesit kanë më pak burime në dispozicion për kuptimin e tekstit (Perfetti & Stafura, 2014).

Një tjetër faktor kognitiv i rëndësishëm për performancën në lexim është kujtesa vepruese. Për të kuptuar dhe mbajtur mend informacionin e tekstit, veçanërisht kur përfshihet sintaksë komplekse ose gjuhë figurative, lexuesit duhet të ruajnë dhe të manipulojnë informacionin në kohë reale (Baddeley, 1992). Vështirësitë në lexim shpesh shfaqen kur kapaciteti i kujtesës vepruese tejkalohet d.m.th., kalohet nga vështirësia e tekstit tek shpërqendrimet e jashtme ose ankthi i brendshëm (Gathercole & Alloway, 2008). Kjo lidhje nxjerr në pah rëndësinë e mundshme të vëmendjes së vullnetshme. Nëse vëmendja e ul ngarkesën kognitive duke zvogëluar përthypjen e mendimeve ose ankthin, atëherë më shumë burime të kujtesës vepruese përdoren për veprimet kryesore rreth kuptimin të leximit (Mrazek et al., 2013).

Faktorët emocionalë dhe motivues në lexim

Suksesi në lexim nuk varet vetëm nga aftësitë kognitive; ai

formësohet thellësisht edhe nga faktorë emocionalë dhe motivues. Nxënësit që përjetojnë nivele të larta stresi ose ankthi gjatë testimeve mund të kenë vështirësi të përqendrohen në detyrat e leximit, gjë që çon në ulje të performancës (Putwain & Daly, 2014). Ndërkohë, besimi tek forcat e tua dhe motivimi i brendshëm mund të forcojnë gatishmërinë e nxënësve për t'u angazhuar me tekste sfiduese dhe për të këmbëngulur përmes vështirësive (Guthrie et al., 2013). Gjendja emocionale e momentit tek nxënësit, si kënaqësia apo kureshtja, janë lidhur me kuptimin më të thellë të leximit dhe me zakone më të qëndrueshme leximi (Schiefele et al., 2012).

Praktikat e bazuara në vëmendjen e vullnetshme mund të mbështesin këto dimensione emocionale dhe motivuese duke paraqitur strategji për rregullimin emocional dhe menaxhimin e stresit. Nxënësit që mësojnë të njohin dhe emërtojnë mendimet shpërqendruese ose shqetësimet për performancën e tyre mund të riorientojnë vëmendjen më me efektivitet, duke rritur potencialisht angazhimin në lexim. Për më tepër, vëmendja e ndërgjegjshme mundëson një qasje të përqendruar në çast, e cila mund t'i ndihmojë nxënësit të kultivojnë durim dhe qëndrueshmëri—cilësi thelbësore për t'u përballur me tekste komplekse dhe fjalor të panjohur (Zenner et al., 2014).

Kështu, vëmendja e vullnetshme mund të ndikojë në zhvillimin e leximit jo vetëm duke përmirësuar proceset kognitive, por edhe duke nxitur gjendje emocionale më të shëndetshme, si dhe krijon një ndjenjë më të fortë pavarësie në detyrat e leximit (Felver et al., 2016).

Dëshmitë empirike që lidhin vëmendjen e vullnetshme me leximin vëmendjen e vullnetshme dhe kuptimi i leximit

Studimet empirike që kanë shqyrtuar lidhjen midis mindfulness dhe kuptimit të leximit kanë dhënë gjetje premtuese. Në një studim kuazi-eksperimental, nxënësit e shkollës së mesme që morën pjesë në një program 8-javor të ushtrimit të vëmendjes së vullnetshme shfaqën rritje të ndjeshme të rezultateve në kuptimin e leximit krahasuar me një grup kontrolli që u angazhua në mësim të aftësive të studimit (Felver et al., 2016). Studiuesit ua atribuonin këto përmirësime rritjes së përqendrimit të vëmendjes dhe uljes së endjes së mendjes gjatë detyrave të leximit, të matura përmes ditarëve vetëraportues dhe vëzhgimeve të mësuesve. Rezultate të ngjashme janë vërejtur edhe në arsimin e lartë: studentët universitarë që përfunduan një kurs meditimi rezultuan më mirë në vlerësimet e kuptimit të leximit dhe raportuan nivele më të ulëta të stresit para provimeve (Mrazek et al., 2013).

Një linjë tjetër kërkimi ka hetuar përbërësit specifikë të vëmendjes së vullnetshme që parashikojnë më mirë përmirësimet në lexim. Për shembull, një studim i Zhang dhe Morrison (2021) përdori një dizajn të kontrolluar të rastësishëm me nxënës të shkollës së mesme, duke u përqendruar në dy përbërës të vëmendjes së vullnetshme: rregullimin e vëmendjes dhe rregullimin emocional. Grupi i ndërhyrjes praktikoi ushtrime për ndërgjegjësimin ndaj frymëmarrjes dhe skanimit e trupit për 10 minuta në fillim të çdo ore të gjuhës.

Vlerësimet pas ndërhyrjes treguan rezultate më të larta në kuptimin e leximit në testet e standardizuara. Analizat e ndërmjetësimit sugjeruan se rregullimi emocional shpjegonte ndjeshëm efektin në kuptimin e leximit, ndoshta sepse nxënësit ishin më të aftë të menaxhonin ankthin e provës dhe ndërhyrjet kognitive të shkaktuara nga stresi (Zhang & Morrison, 2021).

Efektet mbi rrjedhshmërinë e leximit

Rrjedhshmëria e leximit, e përcaktuar si aftësia për të lexuar saktë, shpejt dhe me prosoi të përshtatshme, është thelbësore për të kuptuar tekstin (Rasinski, 2012). Edhe pse studime të rralla e kanë trajtuar rrjedhshmërinë si një rezultat të veçantë, dëshmi paraprake sugjerojnë se praktikatat e ndërgjegjësimit mund të nxisin përmirësime edhe në këtë fushë. Për shembull, një studim pilot me shkallë të vogël në një shkollë fillore tregoi se fëmijët që morën pjesë në ushtrime të shkurtra të frymëmarrjes ndërgjegjëse dhe aktivitete të imagjinueshme të udhëzuara para seancave të rrjedhshmërisë treguan ritëm më të qëndrueshëm dhe më pak shqiptim të gabuar gjatë një semestri (Crescentini et al., 2016). Edhe pse efektiviteti ishte i mjaftueshëm, studiuesit arritën në përfundim se ndërgjegjësimi mund të stabilizojë vëmendjen në mënyrë që të reduktohen sjelljet shpërthyes, stresi dhe nervozizmi, kështu, mbështet të lexuarit të rrjedhshëm të leximit.

Motivimi, angazhimi dhe vetëbesimi (self-efficacy)

Përtej performancës kognitive, ndërhyrjet e ndërgjegjësimit kanë treguar, gjithashtu, potencial për të forcuar dimensionet motivuese dhe qëndrimin ndaj leximit. Studime të ndryshme cilësore raportojnë se nxënësit që marrin pjesë në programe ndërgjegjësimi përshkruajnë një ndjesi të lartë qetësie, përqendrimi dhe kurioziteti kur afrohen ndaj aktiviteteve të leximit (Kern & Laux, 2019). Anketat me nxënës të shkollave të mesme tregojnë se praktikatat e ndërgjegjësimit mund të rrisin motivimin e brendshëm për lexim, veçanërisht kur mësuesit integrojnë seanca të shkurtra ndërgjegjësimi me diskutime mbi libra ose ditarë

reflektues (Altinyelken & Vural, 2020).

Vetëbesimi (self-efficacy) është një faktor i rëndësishëm për suksesin në lexim, pasi ndikon në gatishmërinë e nxënësve për të përballuar tekste të panjohura ose kur përballen me tekste komplekse (Schunk & Pajares, 2005). Një studim i grupuar, i rastësishëm, në një shkollë fillore të nivelit Title i shqyrtoi efektin e një kurrikule 12-javore të ndërgjegjësimit mbi vetëbesimin në lexim dhe rezultatet e testeve standarde të leximit (Malhotra & King, 2019). Studiuesit gjetën se grupi i ndërgjegjësimit shfaqti përfitime të ndjeshme në matjet e vetëbesimit, edhe pse efekti në rezultatet e testeve ishte i moderuar. Nxënësit shpesh citonin aktivitetet e ndërgjegjësimit si burim i “besimit për të provuar fjalë më të vështira” dhe për të reduktuar ngurrimin gjatë pjesëve të vështira të tekstit. Edhe pse nevojitet më shumë hulumtim për të konfirmuar këto gjetje në kontekste demografike të ndryshme, rezultatet fillestare nënvizojnë rolin që ndërgjegjësimi mund të luajë në nxitjen e një qëndrimi konstruktiv ndaj leximit.

Mekanizmat e veprimit: “Pse ndërgjegjësimi mund të përmirësojë leximin?”

Shpërqendrimi i vëmendjes ose largimi i vëmendjes nga detyra është një pengesë e dokumentuar në lidhje me të kuptuarit e leximit (Smallwood & Schooler, 2015). Kur lexuesit humbasin gjurmët e tekstit për shkak të shpërqendrimeve të brendshme, ata shpesh përjetojnë zvogëlim të procesit të kuptimit dhe mbajtjes mend të materialit. Ndërhyrjet e ndërgjegjësimit ndihmojnë në rritjen e aftësisë së leximit duke ushtruar nxënësit të kuptojnë kur mendimet e tyre janë larguar nga teksti i leximit, duke bërë të mundur kthimin butësisht të vëmendjes tek momenti i çastit d.m.th fillestar (Kabat-Zinn, 2003). Duke praktikuar këtë aftësi në mënyrë të përsëritur, lexuesit mund të bëhen më të aftë në identifikimin e humbjeve të përqendrimit dhe rikthimin e vetes tek teksti, duke ruajtur kështu mirëkuptimin për periudha të gjata kohore (Mrazek et al., 2013).

Studimet neuroshkencore sugjerojnë gjithashtu se ndërgjegjësimi mund të ndryshojë aktivitetin e rrjetit të modalitetit të paracaktuar (default mode network), i cili lidhet me mendimet autoreferenciale dhe shpërqendrimin e mendjes (Hasenkamp & Barsalou, 2012). Kur individët angazhohen në lexim ndërgjegjësues, ata mund të jenë më të mirë të pozicionuar për të parandaluar ose ndërprerë aktivitetin e modalitetit të paracaktuar që i largon nga informacioni i tekstit. Ky mekanizëm ndikon në kryerjen e detyrave të përditshme të leximit të nxënësve, veçanërisht ato që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe të kujdesshme ndaj detajeve, si leximi i artikujve shkencorë ose analizat letrare (Mrazek et al., 2013; Zhang

& Morrison, 2021).

Rregullimi emocional dhe ulja e stresit

Ankthi mund të pengojë ndjeshëm zhvillimin e leximit, pasi ngushton përqendrimin e vëmendjes, rrit shpërqendrimin dhe zvogëlon kapacitetin e kujtesës vepruese (Eysenck et al., 2007). Ndërhyrjet e ndërgjegjësimit synojnë të adresojnë këto pengesa duke ndihmuar nxënësit të vëzhgojnë gjendjet e tyre emocionale pa u ngatërruar në to. Për shembull, një nxënës që përjeton ankth para një testi të bazuar në lexim mund të praktikojë frymëmarrje të ngadaltë dhe të ndërgjegjshme për t'u përqendruar në momentin e çastit. Kjo praktikë mund të ulë përgjigjen e sistemit nervor simpatik, duke zvogëluar, kështu, treguesit fiziologjikë të stresit (Tang et al., 2015). Rezultati është një mendje më e qetë dhe më e përqendruar, që mund t'i kushtojë burimeve mendore, si dekodimit dhe kuptimit, në vend që të angazhohet në rrëfime të brendshme të shkaktuara nga stresi.

Rregullimi emocional ka rëndësi të barabartë edhe për motivimin. Nxënësit që mund të menaxhojnë stresin, nervozizmin ose mërzitjen duhet të vazhdojnë me detyrat e leximit, duke përmirësuar, kështu, zhvillimin e aftësive të tyre me kalimin e kohës (Guthrie et al., 2013). Ndërgjegjësimi shërben si një mburojë kundër ndikimeve negative që mund të prishin angazhimin në lexim, duke ofruar një mekanizëm përballues që ndihmon nxënësit të qëndrojnë të pranishëm dhe të hapur ndaj sfidave akademike (Zenner et al., 2014).

Metakognicioni dhe mësimi reflektiv

Një mekanizëm më pak i diskutuar, por potencialisht i fuqishëm, me anë të të cilit ndërgjegjësimi mund të përmirësojë leximin, është zhvillimi i vetëdijes metakognitive, ku metakognicioni i referohet vetëdijes mbi proceset dhe strategjitë njohëse të individit (Flavell, 1979). Në lexim, strategjitë metakognitive përfshijnë monitorimin e kuptimit, identifikimin e pikave të paqarta dhe përshtatjen e ritmit të leximit ose qasjes në varësi të vështirësisë së tekstit (Pressley & Afflerbach, 1995). Nxënësit që praktikojnë ndërgjegjësimin shpesh zhvillojnë një formë të përforcuar introspektive, duke vënë re kur mendja u shpërqendrua ose kur kuptimi dështon. Duke integruar ndërgjegjësimin në procesin e mësimi se si të lexojmë, nxënësit mund të përmirësojnë strategjitë e tyre metakognitive, të përshtatet me teknikat e leximit dhe të zhvillojnë një qasje vetëkorrigjuese ndaj problemeve të kuptimit (Zhang & Morrison, 2021).

Aplikime praktike në mjediset e klasës

Zbatimi i ushtrimeve ndërhyrës të ndërgjegjësimit brenda mësimit të leximit mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të grupmoshës, qëllimeve mësimore dhe burimeve të disponueshme në klasë dhe jashtë saj. Një metodë e thjeshtë ushtrime të shkurtra të frymëmarrjes së ndërgjegjshme apo ushtrime meditimi në fillim të seancave ose klasave të leximit (Zhang & Morrison, 2021) për të ngacmuar nervat sensitiv të trupit dhe të mendjes, kështu, nxënësit çtensionohen nga stresi apo ngurrimi. Këto praktika të shkurtra mund të përgatisin sistemet e vëmendjes dhe rregullimit emocional të nxënësve, duke i mundësuar atyre të angazhohen më efektivisht me materialin e leximit.

Përveç kësaj, disa mësues përfshijnë aktivitete të leximit të ndërgjegjshëm brenda kurrikulave ekzistuese të leximit. Nxënësit mund të inkurajohen të ndalojnë gjatë leximit, të mbyllin sytë dhe të kalojnë një moment duke njohur çdo mendim ose emocion që shfaqet. Pastaj ata vazhdojnë leximin me përqendrim të ringjallur. Kjo teknikë nxit angazhimin më të thellë dhe ndihmon nxënësit të bëhen më të vetëdijshëm për momentet kur kuptimi dobësohet (Felver et al., 2016). Për nxënësit më të vegjël, aktivitetet mund të bëhen më interaktive duke lidhur frymëmarrjen ndërgjegjëse me tregues vizualë ose ushtrime manipulative. Këto metoda inkurajojnë fëmijët të zhvillojnë vëmendjen e vetëdijshme për momentin, e cila mund të aplikohet në detyrat që jepen në klasë ose jashtë saj (Crescentini et al., 2016).

Rrëfimi i ndërgjegjshëm dhe reflektimi i drejtuar

Rrëfimi i ndërgjegjshëm përfaqëson një qasje tjetër krijuese. Mësuesit ose bibliotekarët mund të organizojnë seanca leximi me zë të lartë, duke ndalur herë pas here për t'i orientuar nxënësit drejt reflektimit mbi përvojat e tyre të brendshme—çfarë vënë re në histori, si i bënë të ndihen rrëfimi, si dhe të kuptojnë nëse u ka endur mendja diku tjetër. Këto reflektime nxisin mendimin kritik, empatinë dhe vetërregullimin e vëmendjes, pasi gjatë procesit të mësimit nxënësit mësojnë të bëhen vëzhgues aktivë të proceseve të tyre njohëse dhe emocionale (Kern & Laux, 2019). Për më tepër, diskutimet në grup shërbejnë si platforma ku nxënësit krahasojnë strategjitë për ruajtjen e vëmendjes, ndajnë reagimet emocionale dhe kultivojnë një ndjenjë ndërgjegjësimi kolektiv në klasë. Duke integruar diskutimin e ndërgjegjshëm forcojnë lidhjen e nxënësve me materialin e leximit dhe krijojnë një komunitet mbështetës leximi.

Mjetet digjitale dhe platformat virtuale

Në vitet e fundit, aplikacionet digjitale të ndërgjegjësimit janë bërë gjithnjë e më të zakonshme, duke dhënë meditime, udhëzime, ushtrime frymëmarrjeje dhe video të shkurtra të krijuara për nxënësit e vegjël (Dunning et al., 2019). Shumë prej këtyre mjeteve mund të integrohen në mësimin e leximit duke planifikuar “pushime ndërgjegjësimi” gjatë sesioneve të leximit elektronik. Megjithëse nevojiten kërkime të mëtejshme për të vlerësuar efektivitetin e ndërgjegjësimit digjital në përmirësimin specifik të rezultateve të leximit. Provat fillestare sugjerojnë se këto mjete ofrojnë trajnime të lehta dhe tërheqëse për nxënësit e lidhur fort me teknologjinë (Felver et al., 2016). Megjithatë, është thelbësore që mësuesit t'i vlerësojnë këto aplikacione për përshtatshmërinë me moshën, lehtësinë e përdorimit dhe lidhjen me objektivat e leximit.

Konsiderata dhe sfida në zbatim

Trajnimi dhe angazhimi i mësuesve

Zbatimi i suksesshëm i ndërhyrjeve të ndërgjegjësimit në mësimin e leximit varet nga përgjegjshmëria dhe kompetenca e mësuesve me praktikën e ndërgjegjësimit (Greenberg & Harris, 2012). Shumë mësues mund të mos kenë trajnim formal, gjë që mund të çojë në zbatim sipërfaqësor ose të paqëndrueshëm të ushtrimeve. Seminarët profesionalë që prezantojnë bazën teorike të ndërgjegjësimit, rëndësinë e tij edukative dhe strategji praktike në klasë mund të adresojnë këto boshllëqe (Felver et al., 2016). Gjithashtu, krijimi i besimit dhe angazhimit të mësuesve është thelbësor; kur ata vetë përjetojnë përfitimet e ndërgjegjësimit (p.sh., reduktim stresi, rritje të vëmendjes), ka më shumë gjasa ta promovojnë atë në klasë dhe ta integrojnë në mënyrë krijuese në mësimin e leximit (Kern & Laux, 2019).

Ndjeshmëria kulturore dhe gjithëpërfshirja

Ndërgjegjësimi ka rrënjë në traditat budiste, gjë që mund të ngrejë pyetje për përshtatshmërinë kulturore me popullatën e ndryshme nxënësish (Nhat Hanh, 1976). Përshtatja e aktiviteteve të ndërgjegjësimit në mënyrë që të respektojnë sfondet kulturore dhe besimet personale të nxënësve është thelbësore për pjesëmarrje të gjerë. Përkthimi i materialeve, përdorimi i shembujve kulturorë në përputhje me moshën dhe bashkëpunimi me komunitetin mund të kontribuojnë në ndërhyrje më gjithëpërfshirëse për zhvillimin e aftësive të leximit (Greenberg & Harris, 2012).

PËRFUNDIME

Ndërhyrjet e bazuara në ndërgjegjësim japin një qasje gjithëpërfshirëse për të mbështetur zhvillimin e aftësive të leximit. Të mbështetura në teori rreth vëmendjes, funksioneve ekzekutive dhe rregullimit emocional, këto praktika u japin nxënësve mjete për të përqendruar vëmendjen, ulin stresin dhe kultivojnë ndërgjegjësim metakognitiv—procese thelbësore për dekodim efektiv, kuptim dhe angazhim të qëndrueshëm në lexim.

Megjithëse kërkimi është ende në zhvillim, rezultatet e deritanishme tregojnë se ndërgjegjësimi mund të ndikojë pozitivisht në kuptim, rrjedhshmëri, motivim dhe vetëfikasitet në lexim. Faktorët praktikë, si: trajnimi i mësuesve, ndjeshmëria kulturore luajnë rol kyç në suksesin e programeve të tilla.

Në tërësi, ndërgjegjësimi duket të jetë një shtesë me vlerë për strategjitë tradicionale të mësimin të leximit, duke promovuar jo vetëm përfitime njohëse, por edhe mirëqenie emocionale te nxënësit.

REFERENCES

1. Adams, M. J. (1990). *Beginning to read: Thinking and learning about print*. MIT Press.
2. Altinyelken, H. K., & Vural, G. (2020). Mindful reading communities: A qualitative study on the integration of mindfulness and book discussions. *Journal of Adolescent & Adult Literacy*, 63(6), 697–706.
3. Baddeley, A. (1992). Working memory. *Science*, 255(5044), 556–559.
4. Blair, C., & Raver, C. C. (2015). School readiness and self-regulation: A developmental psychobiological approach. *Annual Review of Psychology*, 66, 711–731.
5. Brown, K. W., & Ryan, R. M. (2003). The benefits of being present: Mindfulness and its role in psychological well-being. *Journal of Personality and Social Psychology*, 84(4), 822–848.
6. Crescentini, C., Capurso, V., Furlan, S., & Fabbro, F. (2016). Mindfulness-based programs in school settings: Cognitive, social, and psychological benefits for primary school students. *Frontiers in Psychology*, 7, Article 805.
7. Creswell, J. D. (2017). Mindfulness interventions. *Annual Review of Psychology*, 68, 491–516.
8. Diamond, A. (2013). Executive functions. *Annual Review of Psychology*, 64, 135–168.
9. Duke, N. K., & Carlisle, J. (2011). The development of comprehension. In M. Kamil, P. Pearson, E. Moje, & P. Afflerbach (Eds.), *Handbook of reading research* (Vol. 4, pp. 199–228). Routledge.

10. Dunning, D. L., Griffiths, K., Kuyken, W., Crane, C., Foulkes, L., Parker, J., & Dalgleish, T. (2019). Research review: The effects of mindfulness-based interventions on cognition and mental health in children and adolescents – a meta-analysis of randomized controlled trials. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 60(3), 244–258.
11. Eysenck, M. W., Derakshan, N., Santos, R., & Calvo, M. G. (2007). Anxiety and cognitive performance: Attentional control theory. *Emotion*, 7(2), 336–353.
12. Felver, J. C., Tipsord, J., & Dishion, T. J. (2016). The effects of mindfulness-based interventions on academic achievement in children and adolescents: A meta-analytic review. *Mindfulness*, 7(6), 1091–1106.
13. Flavell, J. H. (1979). Metacognition and cognitive monitoring: A new area of cognitive–developmental inquiry. *American Psychologist*, 34(10), 906–911.
14. Gathercole, S. E., & Alloway, T. P. (2008). Working memory and learning: A practical guide for teachers. *SAGE Publications*.
15. Gough, P. B., & Tunmer, W. E. (1986). Decoding, reading, and reading disability. *Remedial and Special Education*, 7(1), 6–10.
16. Greenberg, M. T., & Harris, A. (2012). Nurturing mindfulness in children and youth: Current state of research. *Child Development Perspectives*, 6(2), 161–166.
17. Greenberg, M. T., Weissberg, R. P., O'Brien, M. U., Zins, J. E., Fredericks, L., Resnik, H., & Elias, M. J. (2003). Enhancing school-based prevention and youth development through coordinated social, emotional, and academic learning. *American Psychologist*, 58(6–7), 466–474.
18. Guthrie, J. T., Wigfield, A., & You, W. (2013). Instructional supports for engagement and achievement in reading. In S. Albro & E. B. Bauer (Eds.), *Transforming literacy practices in preschools: Innovations and partnerships* (pp. 25–38). Guilford Press.
19. Hasenkamp, W., & Barsalou, L. W. (2012). Effects of meditation experience on functional connectivity of distributed brain networks. *Frontiers in Human Neuroscience*, 6, Article 38.
20. Hyland, T. (2016). The limits of mindfulness: Emerging issues for education. *British Journal of Educational Studies*, 64(1), 97–117.
21. Kabat-Zinn, J. (1994). *Wherever you go, there you are: Mindfulness meditation in everyday life*. Hyperion.
22. Kabat-Zinn, J. (2003). Mindfulness-based interventions in context: Past, present, and future. *Clinical Psychology: Science and Practice*, 10(2), 144–156.
23. Kern, L., & Laux, J. (2019). Effects of mindfulness-based interventions on students' academic functioning: A systematic review. *Mindfulness*, 10(1), 1–14.
24. Lutz, A., Slagter, H. A., Dunne, J. D., & Davidson, R. J. (2008). Attention regulation and monitoring in meditation. *Trends in Cognitive Sciences*, 12(4), 163–169.
25. Malhotra, T., & King, M. (2019). Mindful reading: An intervention study on self-efficacy and reading achievement in Title I schools. *Reading Psychology*, 40(2), 99–117.
26. Mrazek, M. D., Franklin, M. S., Phillips, D. T., Baird, B., & Schooler, J. W. (2013). Mindfulness training improves working memory capacity and GRE performance while reducing mind wandering. *Psychological Science*, 24(5), 776–781.

27. Nhat Hanh, T. (1976). *The miracle of mindfulness: An introduction to the practice of meditation*. Beacon Press.
28. Oakhill, J., Cain, K., & Bryant, P. (2003). The dissociation of single-word and text comprehension: Evidence from component skills. *Language and Cognitive Processes*, 18(4), 443–468.
29. Perfetti, C. A. (2007). Reading ability: Lexical quality to comprehension. *Scientific Studies of Reading*, 11(4), 357–383.
30. Perfetti, C. A., & Stafura, J. (2014). Word knowledge in a theory of reading comprehension. *Scientific Studies of Reading*, 18(1), 22–37.
31. Posner, M. I., & Petersen, S. E. (1990). The attention system of the human brain. *Annual Review of Neuroscience*, 13, 25–42.
32. Pressley, M., & Afflerbach, P. (1995). *Verbal protocols of reading: The nature of constructively responsive reading*. Erlbaum.
33. Putwain, D. W., & Daly, A. L. (2014). Test anxiety prevalence and gender differences in a sample of English secondary school students. *Educational Studies*, 40(5), 554–570.
34. Rasinski, T. (2012). Why reading fluency should be hot! *Reading Teacher*, 65(8), 516–522.
35. Schiefele, U., Schaffner, E., Möller, J., & Wigfield, A. (2012). Dimensions of reading motivation and their relation to reading behavior and competence. *Reading Research Quarterly*, 47(4), 427–463.
36. Schunk, D. H., & Pajares, F. (2005). Competence perceptions and academic functioning. In A. J. Elliot & C. Dweck (Eds.), *Handbook of competence and motivation* (pp. 85–104). Guilford Press.
37. Smallwood, J., & Schooler, J. W. (2015). The science of mind wandering: Empirically navigating the stream of consciousness. *Annual Review of Psychology*, 66, 487–518.
38. Snow, C. E., Burns, M. S., & Griffin, P. (1998). *Preventing reading difficulties in young children*. National Academy Press.
39. Tang, Y.-Y., Hölzel, B. K., & Posner, M. I. (2015). The neuroscience of mindfulness meditation. *Nature Reviews Neuroscience*, 16, 213–225.
40. Van de Weijer-Bergsma, E., Formsma, A. R., de Bruin, E. I., & Bögels, S. M. (2012). The effectiveness of mindfulness training on behavioral problems and attentional functioning in adolescents with ADHD. *Journal of Child and Family Studies*, 21(5), 775–787.
41. Zhang, Y., & Morrison, T. G. (2021). Mindfulness interventions and reading achievement: A randomized controlled trial with high school students. *Contemporary Educational Psychology*, 66, Article 102009.
42. Zenner, C., Herrnleben-Kurz, S., & Walach, H. (2014). Mindfulness-based interventions in schools—A systematic review and meta-analysis. *Frontiers in Psychology*, 5, Article 603.

INTELIGJENCA EMOCIONALE DHE CILËSIA E MARRËDHËNIEVE

Artemisi Shehu/Dono, Ortenca Kotherja, Elda Vladi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

ABSTRAKT

Sfondi: Inteligjenca emocionale (IE) luan një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërpersonale, duke përfshirë miqësitë. Ajo ndikon në mbështetje emocionale, komunikim dhe cilësinë e përgjithshme të marrëdhënieve (Mayer, Salovey, & Caruso, 2004). Ky studim kishte për qëllim të shqyrtonte se si IE parashikon cilësinë e miqësive te vajzat 19-vjeçare. Hipoza ishte që nivelet më të larta të IE do të korrelacionoheshin me mbështetje emocionale më të madhe dhe komunikim më efikas (Goleman, 1995).

Metodologjia: Kampioni i këtij studimi përbëhet nga 100 pjesëmarrës femra të moshës 19 vjeç. IE u mat duke përdorur Pyetësin e Shkurtër të Inteligjencës Emocionale (TEIQue-SF) (Petrides, 2009), ndërsa cilësia e miqësisë u vlerësua përmes Shkallës së Cilësisë së Miqësisë (FQS) (Bukowski, Hoza, & Boivin, 1994). Pjesëmarrësit plotësuan të dy pyetësorët, me një kohë totale pjesëmarrjeje prej rreth 6 deri në 10 minuta.

Rezultatet: Analiza korrelacionale e të dhënave e realizuar me Spss version 23.0 tregoi një korrelacion pozitiv midis IE dhe cilësisë së miqësisë, veçanërisht në lidhje me mbështetje emocionale dhe komunikim efektiv. Pjesëmarrësit me nivele më të larta të IE raportuan marrëdhënie miqësore më të forta dhe suportuese, ndërsa ata me nivele më të ulëta të IE kishin lidhje emocionale më të dobëta dhe më pak ndërveprime efikase.

Përfundimi: gjetjet sugjerojnë se nivelet më të larta të IE kontribuojnë në cilësinë më të mirë të miqësive duke rritur mbështetje emocionale dhe komunikimin. Ndërhyrjet që fokusohen në rritjen e IE mund të jenë të dobishme për promovimin e miqësive më të shëndetshme dhe mbështetëse mes vajzave të reja.

Fjalë kyçe: *inteligjenca emocionale, cilësia e miqësisë, mbështetje emocionale.*

Emotional intelligence and the quality of friendships

ABSTRACT

Background: Emotional intelligence (EI) plays a significant role in interpersonal relationships, including friendships. It influences emotional support, communication, and the overall quality of relationships (Mayer, Salovey, & Caruso, 2004). This study aimed to examine how EI predicts the quality of friendships among 19-year-old girls. The research focused on the specific EI dimensions that contribute to friendship quality, hypothesizing that higher EI would correlate with better emotional support and communication (Goleman, 1995).

Methodology: The sample consisted of 100 female participants aged 19. EI was assessed using the Trait Emotional Intelligence Questionnaire-Short Form (TEIQue-SF) (Petrides, 2009), while friendship quality was measured using the Friendship Quality Scale (FQS) (Bukowski, Hoza, & Boivin, 1994). The participants completed both questionnaires, with a total completion time of approximately 6 to 10 minutes.

Results: Data analysis revealed a positive correlation between EI and friendship quality, particularly in terms of emotional support and effective communication. Participants with higher EI scores reported stronger, more supportive friendships, while those with lower EI showed weaker emotional bonds and less effective interaction.

Conclusion: The findings suggest that higher levels of EI contribute to better-quality friendships by enhancing emotional support and communication. Interventions aimed at increasing EI may be beneficial in promoting healthier and more supportive friendships among young women.

Keywords: emotional intelligence, friendship quality, emotional support, communication, adolescence.

1. Hyrje

Marrëdhëniet e miqësisë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin social dhe emocional të individëve, në moshën 19 vjeç, vajzat janë në një fazë kyçe të jetës së tyre sociale, duke kaluar nëpër rritje personale, pjekuri emocionale dhe rritje të ndërveprimeve shoqërore. Një nga faktorët kryesorë që ndikon në cilësinë e këtyre marrëdhënieve është inteligjenca emocionale (IE), e cila përfshin aftësinë për të perceptuar, kuptuar, menaxhuar dhe rregulluar emocionet te vetja dhe te të tjerët. Inteligjenca emocionale formon mënyrën si individët ndërveprojnë me të tjerët,

menaxhojnë konflikte, ofrojnë mbështetje dhe navigojnë përmes kompleksiteteve shoqërore. Ky studim ka si qëllim eksplorimin e rolit të inteligjencës emocionale në parashikimin e cilësisë së marrëdhënieve të miqësisë mes vajzave 19 - vjeçare. Duke kuptuar lidhjen mes IE dhe cilësisë së miqësive, ky hulumtim mund të ofrojë njohuri të vlefshme për mënyrën se si aftësitë emocionale kontribuojnë në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore të shëndetshme, mbështetëse dhe të kënaqshme në këtë fazë zhvillimore të rëndësishme. Marrëdhëniet e miqësisë janë thelbësore për zhvillimin social dhe emocional, veçanërisht gjatë adoleshencës dhe rinisë së hershme. Këto marrëdhënie ofrojnë mbështetje emocionale, përmirësojnë vetëvlerësimin, ndihmojnë në zhvillimin e identitetit dhe kultivojnë aftësi sociale (Bukowski, Newcomb & Hartup, 1996).

Inteligjenca emocionale dhe ndikimi i saj në marrëdhëniet sociale. Në kontekstin e miqësive, individët me nivele më të larta të IE janë më të prirur të ofrojnë mbështetje emocionale, të menaxhojnë konfliktet në mënyrë efektive dhe të ruajnë ndërveprime pozitive. Kërkimet kanë treguar se IE është e lidhur ngusht me cilësinë e marrëdhënieve ndërpersonale, veçanërisht në lidhje me empatinë, mbështetje emocionale dhe komunikimin (Schutte et al., 2001). Disa studime kanë demonstruar rolin e IE-së në cilësinë e marrëdhënieve sociale. Për shembull, Brackett et al., (2006) gjetën se individët me inteligjencë emocionale më të lartë ishin më të aftë të menaxhonin ndërveprimet sociale dhe të ruanin marrëdhënie pozitive. Po ashtu, Lopes et al., (2004) treguan se inteligjenca emocionale është një parashikues i kënaqësisë në marrëdhënie, me individët me IE më të lartë që përjetojnë lidhje sociale më të kënaqshme.

Inteligjenca emocionale dhe cilësia e miqësive. Cilësia e miqësive shpesh matet nga mbështetje emocionale, komunikimi, besimi dhe aftësia për të zgjidhur konfliktet. Inteligjenca emocionale ndikon në këto dimensione duke përmirësuar aftësinë për të ndjerë empati ndaj të tjerëve, për të komunikuar efektivisht dhe për të zgjidhur konfliktet në mënyrë konstruktive. Studimet sugjerojnë se individët me IE më të lartë kanë tendencë të raportojnë kënaqësi më të madhe në miqësitë e tyre për shkak të aftësisë për të menaxhuar emocionet e tyre dhe të të tjerëve (Mayer, Salovey dhe Caruso, 2004). Për femrat, inteligjenca emocionale ka treguar se ka një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e miqësive. Duru dhe Duru (2014) zbuluan se gratë e reja me nivele më të larta të IE raportuan lidhje emocionale më të forta dhe komunikim më të mirë me miqtë. Këta individë

gjithashtu ishin më të aftë të menaxhonin konfliktet, gjë që kontribuonte në cilësinë e përgjithshme të marrëdhënieve të tyre.

Inteligjenca emocionale dhe zgjidhja e konflikteve në miqësi. Një aspekt kyç i ruajtjes së cilësisë së lartë të miqësive është aftësia për të menaxhuar konfliktet. Inteligjenca emocionale luan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve duke ndihmuar individët të njohin dhe rregullojnë emocionet e tyre gjatë mosmarrëveshjeve dhe të kuptojnë emocionet e të tjerëve të përfshirë. Ata që kanë IE më të lartë kanë më shumë mundësi të përdorin strategji pozitive për zgjidhjen e konflikteve, si: dëgjimi aktiv, empatia dhe kompromisi, në vend që të përdorin strategji negative si shmangia ose agresioni (Caruso, Mayer dhe Salovey, 2002). Schutte et al., (2001) zbuluan se individët me IE më të lartë ishin më të aftë të zgjidhnin konfliktet në miqësitë e tyre, çka çonte në marrëdhënie më të forta dhe më të qëndrueshme. Rregullimi efektiv emocional gjatë konflikteve ndihmon në parandalimin e keqkuptimeve dhe promovon ndërveprime më të shëndetshme dhe mbështetëse.

Roli i inteligjencës emocionale në cilësinë e miqësive te vajzat 19-vjeçare. Kërkimet mbi inteligjencën emocionale dhe cilësinë e miqësive specifikisht te femrat 19-vjeçare janë disi të kufizuara. Megjithatë, studime që fokusohen në adoleshentët dhe të rinjtë sugjerojnë se IE luan një rol të rëndësishëm në formimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve gjatë kësaj periudhe zhvillimore. Në këtë moshë, individët po zhvillojnë një pavarësi më të madhe dhe vetëdije sociale, gjë që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të formuar dhe mbajtur miqësi të ngushta. IE e lartë mbështet këtë proces duke përmirësuar vetëdijen, empatinë dhe aftësitë sociale—faktorë kyç në orientimin e dinamikave sociale komplekse (Mayer et al., 2004). Për femrat 19-vjeçare, miqësitë janë një burim kritik mbështetjeje emocionale dhe formimi identiteti. Kërkimet tregojnë se femrat vlerësojnë më shumë afërsinë emocionale dhe mbështetjen në miqësitë e tyre, duke e bërë IE-në edhe më të rëndësishme. IE e lartë mundëson që femrat të krijojnë marrëdhënie emocionale mbështetëse dhe të menaxhojnë konfliktet e pashmangshme më efektivisht (Gross dhe John 2003). Literatura ekzistuese thekson rolin e rëndësishëm të inteligjencës emocionale në parashikimin e cilësisë së marrëdhënieve të miqësisë, veçanërisht në lidhje me mbështetje emocionale, komunikimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Për femrat të reja, IE është thelbësore në formimin dhe ruajtjen e miqësive të larta. Si inteligjenca emocionale ndikon në mënyrën se si individët menaxhojnë emocionet dhe ndërveprojnë me të

tjerët, ajo ofron njohuri të vlefshme për dinamikën e miqësive femërore. Ky studim synon të shtojë këto gjetje duke shqyrtuar lidhjen mes inteligjencës emocionale dhe cilësisë së miqësive të femrat 19-vjeçare.

2. MATERIALE DHE METODA

Ky studim do të përdori një dizajn kërkimor *sasior*, duke përdorur dy instrumente kryesore për të vlerësuar marrëdhënien mes inteligjencës emocionale (IE) dhe cilësisë së marrëdhënieve të miqësisë tek vajzat 19-vjeçare. Metodologjia përfshin komponentët kryesorë: pjesëmarrësit, procedurën e mostrës, instrumentet, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave.

2.1 Pjesëmarrësit dhe kampionimi

Studimi u zhvillua në një kampion prej 100 vajzash, të moshës 19 vjeç, të aksesuar përmes teknikës joprobabilitare me konvenciençë. Kampioni përfshiu studentë nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Kjo teknikë mundësoi një qasje të lehtë të pjesëmarrjes, por mund të kufizojë përfshirjen e të dhënave në popullatën më të gjerë. Pjesëmarrësit u rekrutuan përmes platformave online, siç është **Google Forms**, ku u ftuan për të marrë pjesë në studim.

Kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve përfshinë:

- Vajza studentë të moshës 19 vjeç.
- Pjesëmarrje vullnetare me pëlqimin për mbledhjen e të dhënave.
- Pjesëmarrësit duhet të jenë të gatshëm të plotësojnë dy pyetësorë online si pjesë e procesit të mbledhjes së të dhënave.

2.2 Instrumentet

Për mbledhjen e të dhënave, u përdorën dy instrumente të njohura dhe të besueshme:

- Pyetësori i inteligjencës emocionale – forma e shkurtër (TEIQue-SF).

Ky instrument përbëhet nga 30 pyetje vetëraportuese që vlerësojnë nivelin e inteligjencës emocionale tek pjesëmarrësit. Ai vlerëson katër dimensione kryesore të IE: perceptimin emocional, shprehjen emocionale, rregullimin emocional dhe përdorimin emocional. TEIQue-SF ka treguar besueshmëri dhe vlefshmëri të lartë në studimet e mëparshme, duke e bërë atë një mjet të përshtatshëm për këtë kërkim.

- **Shkalla e cilësisë së miqësisë (FQS).** Ky instrument u përdor për të matur cilësinë e marrëdhënieve të miqësisë të pjesëmarrësve. FQS përfshin dimensione të ndryshme, si: besimi, mbështetja emocionale, komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve. Ky instrument siguron një rezultat të përgjithshëm për cilësinë e miqësive dhe është përdorur gjerësisht në kërkime mbi marrëdhëniet e miqësisë, me besueshmëri dhe vlefshmëri të provuar.

2.3 Mbledhja e të dhënave

Të dhënat u mbledhën përmes pyetësorëve online të shpërndarë në Google Forms. Pjesëmarrësit plotësuan si **TEIQue-SF**, ashtu edhe **FQS** në një seancë të vetme, e cila zgjati rreth 6 deri në 10 minuta për të dy instrumentet. Për të siguruar saktësi dhe konsistencë në përgjigje, pjesëmarrësve iu dhanë udhëzime të qarta se si të plotësojnë secilin pyetësor. Pjesëmarrësit u informuan mbi natyrën vullnetare të pjesëmarrjes. Ata patën mundësinë të anashkalojnë çdo pyetje që mund të ndiheshin të pasigurt për t'u përgjigjur ose të tërhiqen nga studimi në çdo moment pa pasoja. Të gjitha përgjigjet do të mbetën konfidenciale dhe nuk u mbledhën informacione personale të identifikueshme përveç detajeve bazë demografike.

2.4. Analiza e të dhënave

Analiza përshkruese. U llogarit mesatarja dhe devijimi standard për të dy variablat, inteligjencën emocionale dhe cilësinë e miqësisë. Kjo ofroi një pasqyrë të nivelit të inteligjencës emocionale dhe të cilësisë së miqësive që kanë pjesëmarrësit.

Analiza e korrelacionit. Për të testuar hipotezat e studimit, u përdor **korrelacioni i Pearson-it** për të vlerësuar marrëdhënien midis inteligjencës emocionale (siç matet me TEIQue-SF) dhe cilësisë së miqësisë (siç matet me FQS). Padyshim, kjo analizë shqyrtoi: a) Fuqinë dhe drejtimin e marrëdhënies midis inteligjencës emocionale dhe cilësisë së përgjithshme të miqësisë. b) Korrelacionin midis dimensioneve specifike të IE (si rregullimi emocional ose empatia) dhe faktorëve të cilësisë së miqësisë (si besimi, komunikimi dhe mbështetja emocionale).

Analiza e besueshmërisë. Besueshmëria e instrumenteve u vlerësua përmes koeficientit **Cronbach's alpha**. Një koeficient Cronbach's alpha më shumë se 0.7 do të konsiderohet i pranueshëm për këtë studim. Për

TEIQue-SF, është gjetur një koeficient besueshmërie prej 0.664, që është i pranueshëm për këtë kërkim.

3. REZULTATET

Analiza deskriptive. Analiza deskriptive e të dhënave tregoi se mesatarja për Inteligjencën Emocionale (EI) ishte 4.15 me një devijim standard prej 0.52, ndërsa mesatarja për Shkallën e Cilësisë së Miqësisë (FQS) ishte 4.33 me një devijim standard prej 0.59. Këto vlera mesatare të larta sugjerojnë se pjesëmarrësit e perceptojnë veten përgjithësisht si individë me inteligjencë emocionale të lartë dhe me cilësi të lartë marrëdhëniesh miqësore. Devijimet standarde të ulëta tregojnë konsistencë në përgjigjet e pjesëmarrësve, duke sugjeruar se kampioni ishte relativisht homogjen në perceptimet e tyre për veten.

Tabela 1. Analiza përshkruese e totalit të pikëve të dy variablave: Inteligjenca emocionale, Cilësia e marrëdhënieve miqësore.

	N	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Inteligjenca emocionale	100	3.03	5.07	4.1491	0.51856
Cilësia e marrëdhënieve miqësore	100	3.05	5.62	4.3277	0,591156
N valide	100				

Analiza e korrelacionit. Një analizë e korrelacionit të Pearson-it u realizua për të vlerësuar lidhjen mes Inteligjencës Emocionale (EI) dhe Shkallës së Cilësisë së Miqësisë (FQS). Rezultatet treguan një korrelacion pozitiv statistikisht të rëndësishëm midis dy variablave, me një koeficient korrelacioni prej 0.570 ($p < 0.001$, një bisht). Kjo sugjeron se nivelet më të larta të inteligjencës emocionale janë të lidhura mesatarisht me miqësi më cilësore mes pjesëmarrësve.

Testimi i hipotezave:

Hipoteza 1 (H1): vajzat me nivele më të larta të inteligjencës emocionale do të raportojnë një cilësi më të lartë të marrëdhënieve të miqësisë.

Rezultati: kjo hipotezë u vërtetua. Korrelacioni pozitiv mes EI dhe FQS mbështet idenë se inteligjenca emocionale më e lartë kontribuon në miqësi më të cilësuar.

Hipoteza 2 (H2): nivelet e larta të inteligjencës emocionale do të korrelacionohen pozitivisht me cilësi të lartë të marrëdhënieve shoqërore.

Rezultati: kjo hipotezë gjithashtu u vërtetua. Analiza e korrelacionit tregon se inteligjenca emocionale është në lidhje të rëndësishme me marrëdhëniet më të cilësuar, të cilat zakonisht karakterizohen nga mbështetje emocionale më e madhe dhe komunikim efektiv.

Besueshmëria: besueshmëria e instrumenteve të përdorura në studim u vlerësua përmes llogaritjes së koeficientit alpha të Cronbach-ut. Vlera e koeficientit alpha për Kërkuesin e Inteligjencës Emocionale – Formën e Shkurtër (TEIQUE-SF) u gjet të ishte 0.664, e cila është e pranueshme për këtë studim.

Tabela 2. Analiza e besueshmërisë

Alpha e Cronbach's	N
0.664	30

Kufizimet e studimit. Ndonëse ky studim ofron njohuri të rëndësishme, ai ka disa kufizime metodologjike që duhen marrë parasysh për interpretimin e rezultateve:

- **Homogjeniteti gjinor.** Studimi u fokusua ekskluzivisht në kampionin femëror. Kjo përbërje parandalon përgjithësimin e rezultateve për djemtë, të cilët mund të shfaqin dinamika të ndryshme të inteligjencës emocionale dhe formave të ndërveprimit shoqëror.
- **Përfaqësimi i kampionit.** Madhësia prej 100 pjesëmarrësish, e rekrutuar përmes kampionimit me konvencienë në një mjedis universitar, mund të mos pasqyrojë diversitetin e plotë socioekonomik dhe kulturor të popullatës së synuar. Kjo teknikë kufizon vlefshmërinë e jashtme të gjetjeve.
- **Paragjykimet e vetëraportimit.** Të dhënat u mblodhën përmes instrumenteve vetëraportuese, të cilat mund të ndikohen nga dëshira për t'u dukur mirë shoqërisht ose nga mungesa e objektivitetit në vlerësimin e vetes.
- **Mungesa e variablave kontekstuale.** Analiza nuk përfshiu faktorë si sfondi kulturor apo statusi socioekonomik, të cilët luajnë një rol kritik në

formësimin e marrëdhënieve ndërpersonale.

4. DISKUTIME

Rezultatet e nxjerra nga ky studim ofrojnë një konfirmim empirik mbi rëndësinë kritike që inteligjenca emocionale (IE) ka në modelimin e cilësisë së marrëdhënieve shoqërore te vajzat 19-vjeçare çka e shohim edhe në studime të tjera (Brackett et al., 2006; Lopes et al., 2004). Gjetja kryesore, e cila tregon një korrelacion pozitiv statistikisht të rëndësishëm ($r = 0.570$) midis IE dhe cilësisë së miqësisë (FQS), përputhet me kornizat teorike të Mayer, Salovey dhe Caruso (2004), të cilët argumentojnë se aftësia për të procesuar informacionin emocional shërben si një mjet navigimi në mjediset komplekse sociale (Mayer, Salovey & Caruso, 2004).

Në këtë fazë zhvillimore, e cila korrespondon me kalimin drejt rinisë së hershme, vajzat 19-vjeçare përballen me sfida të reja të formimit të identitetit dhe pavarësisë (Bukowski, Newcomb, & Hartup, 1996). Rezultatet tona sugjerojnë se ato që zotërojnë nivele më të larta të IE, siç u mat përmes TEIQue-SF, janë më të afta të ofrojnë mbështetje emocionale dhe të mbajnë kanale të hapura komunikimi. Kjo përputhet me gjetjet e Schutte et al., (2001), të cilët theksojnë se individët me IE të lartë jo vetëm që kuptojnë emocionet e tyre, por shfaqin një ndjeshmëri më të madhe ndaj nevojave të të tjerëve, duke forcuar kështu besimin reciprok në miqësi (Duru & Duru, 2014).

Një pikë kyçe e diskutimit është roli i IE në menaxhimin e konflikteve. Literatura sugjeron se miqësitë e vajzave shpesh karakterizohen nga një intensitet më i lartë emocional dhe afërsi, gjë që i bën ato më të ndjeshme ndaj keqkuptimeve (Gross, & John, 2003). Gjetjet tona mbështesin idenë se IE shërben si një faktor mbrojtës; vajzat me aftësi më të mirë të rregullimit emocional priren të përdorin strategji konstruktive si dëgjimi aktiv dhe kompromisi (Gross & John, 2003). Kjo parandalon degradimin e marrëdhënies gjatë debateve, një fenomen i vërejtur edhe nga Brackett et al., (2006), ku menaxhimi i suksesshëm i ndërveprimeve sociale lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien relacionale (Brackett et al., 2006).

Për më tepër, analiza deskriptive tregoi se ky kampion percepton një nivel relativisht të lartë si të IE ashtu edhe të cilësisë së miqësisë ($M = 4.15$ dhe $M = 4.33$ respektivisht). Kjo mund të reflektojë një homogjenitet social brenda studentëve të Shkencave Sociale, të cilët mund të kenë një prirje natyrore ose edukative drejt introspeksionit dhe empatisë. Megjithatë, siç u vërejt nga Lopes et al. (2004), kënaqësia në marrëdhënie nuk varet vetëm nga prania e emocioneve pozitive, por nga aftësia për të

naviguar përmes emocioneve negative pa dëmtuar lidhjen (Lopes et al., 2004).

Nga pikëpamja praktike, rezultatet forcojnë nevojën për ndërhyrje psikoedukative. Duke qenë se IE është një tipar që mund të zhvillohet, programet që synojnë rritjen e vetëdijes emocionale dhe empatisë të rinjtë mund të kenë një efekt zinxhir në përmirësimin e rrjeteve të tyre mbështetëse. Miqësitë cilësore në këtë moshë shërbejnë si një "amortizator" kundër stresit akademik dhe jetësor, duke e bërë inteligjencën emocionale jo thjesht një aftësi individuale, por një kapital social.

Në fund, duhet pranuar se natyra e vetëraportimit të instrumenteve (TEIQue-SF dhe FQS) mund të ketë sjellë një dozë subjektiviteti ose dëshire sociale në përgjigje. Megjithatë, forca e korrelacionit të gjetur mbetet një tregues i fuqishëm se mënyra se si këto vajza perceptojnë dhe menaxhojnë botën e tyre emocionale është e lidhur pazgjidhshmërisht me shëndetin e marrëdhënieve të tyre më të ngushta.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, që tregojnë një lidhje të fortë pozitive midis inteligjencës emocionale dhe cilësisë së marrëdhënieve miqësore të vajzat 19-vjeçare, mund të sugjerojmë disa rekomandime praktike dhe strategji për të përmirësuar cilësinë e marrëdhënieve miqësore dhe zhvillimin e inteligjencës emocionale:

Përfshirja e trajnimeve për zhvillimin e inteligjencës emocionale për të përmirësuar cilësinë e miqësive dhe marrëdhënieve sociale, është e rekomandueshme që vajzat dhe individët në moshë të ngjashme të përfshihen në trajnime dhe programe që fokusohen në zhvillimin e inteligjencës emocionale. Këto programe mund të përfshijnë aktivitete që ndihmojnë në njohjen dhe menaxhimin e emocioneve, ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe krijimin e lidhjeve të shëndetshme, duke u fokusuar në rritjen e vetëdijes për emocionet dhe empatinë.

Mbështetje për menaxhimin e konflikteve: trajnimet që fokusohen në menaxhimin e konflikteve dhe ndihmën për të trajtuar situatat stresuese në marrëdhëniet miqësore mund të jenë të dobishme. Niveli i lartë i inteligjencës emocionale është i lidhur ngushtësisht me aftësinë për të menaxhuar dhe zgjidhur konfliktet në mënyrë të shëndetshme, duke parandaluar prishjen e marrëdhënieve dhe duke ruajtur harmoninë brenda grupit të miqve.

Inkurajimi i vetëdijes emocionale në shkolla dhe institucione arsimore: shkollat dhe institucione arsimore mund të luajnë një rol kyç në zhvillimin e inteligjencës emocionale të të rinjve duke ofruar kurse të veçanta që nxisin ndjeshmërinë emocionale dhe aftësitë për të kuptuar dhe menaxhuar ndjenjat. Ky lloj trajnimi mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe të krijojnë një mjedis më mbështetës dhe harmoni.

Rritja e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e inteligjencës emocionale në cilësinë e miqësive: fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe nëpërmjet mediave sociale mund të ndihmojnë në rritjen e njohurive për rëndësinë e inteligjencës emocionale në ndihmën për krijimin e miqësive më të mira. Kjo mund të kontribuojë në promovimin e vlerave të ndihmës, mbështetjes dhe respektit brenda grupeve shoqërore dhe miqësore. Përfshirja e praktikave të reflektimit dhe kujdesit ndaj vetes: praktikat që nxisin vetëreflektimin dhe kujdesin ndaj vetes janë të rëndësishme për zhvillimin e vetëdijes emocionale dhe menaxhimin e emocioneve. Për vajzat dhe individët që mund të kenë vështirësi me menaxhimin e emocioneve, mund të sugjerohet përfshirja në aktivitete, si: meditim, joga dhe teknika të tjera relaksimi që ndihmojnë në zhvillimin e një lidhjeje më të fortë me emocionet dhe nevojat e tyre emocionale. Vlerësimi dhe monitorimi i ndikimit të programave të zhvillimit emocional: pas implementimit të programeve dhe trajnimeve për zhvillimin e inteligjencës emocionale, është e rëndësishme të vlerësohen dhe monitorohen ndikimet e këtyre aktiviteteve në cilësinë e miqësive dhe marrëdhënieve shoqërore. Ky vlerësim mund të ofrojë të dhëna të vlefshme për përmirësimin e praktikave dhe për ta bërë zhvillimin e inteligjencës emocionale një pjesë të qëndrueshme të jetës sociale dhe edukative. Në përfundim, zhvillimi i inteligjencës emocionale është një komponent kyç për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve miqësore të shëndetshme, dhe këto rekomandime synojnë të përmirësojnë aftësitë emocionale të vajzave për të pasur miqësi më të forta dhe më të qëndrueshme. Implementimi i këtyre strategjive mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve shoqërore dhe në zhvillimin personal të individëve.

REFERENCA

1. **Brackett, M. A., Rivers, S. L., Shiffman, M. L., Lerner, R. M., & Salovey, P. (2006).** Emotional intelligence and its relation to everyday behavior. *Personality and Individual Differences*, 39(6), 1329–1339. <https://doi.org/10.1016/j.paid.2005.12.010>
2. **Bukowski, W. M., Hoza, B., & Boivin, M. (1994).** Measuring friendship quality during preadolescence and adolescence: The development and psychometric properties of the Friendship Qualities Scale. *Journal of Social and Personal Relationships*, 11(4), 471–484. <https://doi.org/10.1177/0265407594114004>
3. **Bukowski, W. M., Newcomb, A. P., & Hartup, W. W. (1996).** *The company they keep: Friendship in childhood and adolescence*. Cambridge University Press.
4. **Caruso, D. R., Salovey, P., & Mayer, J. D. (2002).** *The Emotional Intelligence Inventory (EQ-i): Technical manual*. Emotional Intelligence.
5. **Duru, E., & Duru, A. (2014).** The relationship between emotional intelligence and friendship quality among college students. *Social Behavior and Personality: An International Journal*, 42(6), 917–928. <https://doi.org/10.2224/sbp.2014.42.6.917>
6. **Goleman, D. (1995).** *Emotional intelligence: Why it can matter more than IQ*. Bantam Books.
7. **Gross, J. J., & John, R. W. (2003).** Individual differences in two emotion regulation processes: Implications for affect, relationships, and well-being. *Journal of Personality and Social Psychology*, 85(2), 348–362. <https://doi.org/10.1037/0022-3514.85.2.348>
8. **Lopes, P. N., Salovey, P., & Straus, D. G. (2004).** Emotional intelligence, personality, and the quality of social relationships. *Personality and Individual Differences*, 37(3), 649–660. <https://doi.org/10.1016/j.paid.2003.09.004>
9. **Mayer, J. D., & Salovey, P. (1990).** Emotional intelligence. *Imagination, Cognition and Personality*, 9(3), 185–211. <https://doi.org/10.2190/DUGG-P24E-52WK-6CDG>
10. **Mayer, J. D., Salovey, P., & Caruso, D. R. (2004).** Emotional intelligence: Theory, findings, and implications. *Psychological Inquiry*, 15(3), 197–215. https://doi.org/10.1207/s15327965pli1503_02
11. **Petrides, K. V. (2009).** Psychometric properties of the Trait Emotional Intelligence Questionnaire (TEIQue). In *Handbook of individual differences in cognition and emotion* (fq. 529–559). John Wiley & Sons.
12. **Schutte, N. S., Malouff, J. M., Hall, L. E., Haggerty, J. J., Cooper, D. L., & Golden, L. J. (2001).** Emotional intelligence and interpersonal relations. *Journal of Social Psychology*, 141(4), 476–480. <https://doi.org/10.1080/00224540109600571>

NDIKIMI I TERAPISË ONLINE KUNDREJT TERAPISË BALLË PËR BALLË NË REZULTATET E PËRMIRËSIMIT TË SHËNDETIT MENDOR: META-ANALIZË

Adelina Kakija¹, Denalda Bashota²

^{1 2} Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Lektore, departamenti “Psikologji-Punë
Sociale”

ABSTRAKT

Digjitalizimi i shërbimeve të shëndetit mendor ka rritur ndjeshëm përdorimin e terapisë online si alternativë ndaj psikoterapisë tradicionale ballë për ballë. Kjo meta-analizë synon të krahasojë efektivitetin e terapisë online dhe asaj ballë për ballë në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor, përfshirë depresionin, ankthin, reduktimin e stresit dhe mirëqenien e përgjithshme. Janë shqyrtuar sistematikisht studime të publikuara gjatë periudhës 2010–2025 në bazat kryesore të të dhënave (ScienceDirect, PubMed, Google Scholar), duke ndjekur udhëzimet PRISMA (2020). Nga kërkimi fillestar, pas filtrimit sipas kritereve të përfshirjes dhe përjashtimit, u përzgjedhën 12 studime për analizë të thelluar. Rezultatet tregojnë se terapia online ka efektshmëri të ngjashme me terapinë ballë për ballë, veçanërisht në rastet me vështirësi të lehta deri mesatare mendore. Megjithatë, dallime vërehen në aleancën terapeutike dhe ndjekjen e trajtimit, ku seancat ballë për ballë shfaqin përfshirje pak më të lartë. Këto gjetje theksojnë potencialin e terapisë online si një alternativë e qasshme dhe me kosto më të ulët, ndërkohë që nënvizojnë nevojën për forcimin e aspekteve relacionale dhe motivuese të psikoterapisë virtuale.

Fjalë kyçe: *terapi online, terapi ballë për ballë, shëndet mendor, meta-analizë, efektiviteti i psikoterapisë.*

The Impact of Online Therapy versus Face-to-Face Therapy on Mental Health Outcomes: A Meta-Analysis

ABSTRACT

The digitalization of mental health services has significantly increased the use of online therapy as an alternative to traditional face-to-

face psychotherapy. This meta-analysis aims to compare the effectiveness of online therapy and face-to-face therapy in improving mental health outcomes, including depression, anxiety, stress reduction, and overall well-being. Studies published between 2010 and 2025 in major databases (ScienceDirect, PubMed, Google Scholar) were systematically reviewed, following PRISMA (2020) guidelines. From the initial search, and after applying inclusion and exclusion criteria, 12 studies were selected for in-depth analysis. The results indicate that online therapy has similar effectiveness to face-to-face therapy, particularly in cases of mild to moderate mental health difficulties. However, differences are observed in the therapeutic alliance and treatment adherence, where face-to-face sessions show slightly higher engagement. These findings highlight the potential of online therapy as an accessible and low-cost alternative, while underscoring the need to strengthen the relational and motivational aspects of virtual psychotherapy.

Keywords: *online therapy, face-to-face therapy, mental health, meta-analysis, psychotherapy effectiveness.*

1. Hyrje

Digjitalizimi i jetës së përditshme ka ndikuar fuqishëm edhe në mënyrën se si konceptohen dhe ofrohen shërbimet e shëndetit mendor. Psikoterapia online, e realizuar përmes videokonferencës, platformave të dedikuara ose ndërfaqeve të tjera digjitale, është shndërruar nga një zgjidhje e jashtëzakonshme në një format të zakonshëm ndërhyrjeje, veçanërisht pas periudhës së izolimit global të lidhur me pandeminë COVID-19.

Siç thekson Bauman (2005), ne jetojmë në një “shoqëri fluide”, ku individët përshtaten vazhdimisht me ndryshime të shpejta sociale dhe teknologjike. Në këtë kontekst, kalimi nga formatet tradicionale të ndërveprimit ballë për ballë drejt formateve digjitale është pothuajse i pashmangshëm. E njëjta logjikë vlen edhe për psikoterapinë: individët, veçanërisht brezat më të rinj, prirën të zgjedhin format që kombinojnë menjëhershmerinë, fleksibilitetin dhe rehatinë.

Aktualisht bashkëjetojnë disa breza, të cilët dallojnë në qëndrimet ndaj teknologjisë dhe ndaj formave të ndryshme të trajtimit psikologjik. Në një studim të kohëve të fundit, Yılmaz et al., (2024) treguan se të rinjtë janë dukshëm më të prirur drejt psikoterapisë online krahasuar me moshat e mesme, duke reflektuar rolin e digjitalizimit në preferencat përkujdesëse. Në të njëjtën kohë, kultura e menjëhershmerisë dhe agjendat e ngarkuara e shtojnë një pjesë të madhe të popullsisë të kërkojë formate të trajtimit që

kursejnë kohë dhe mund të ndiqen nga shtëpia apo puna.

Ndryshimet në marrëdhëniet njerëzore janë gjithashtu domethënëse për të kuptuar kontekstin e terapisë online. Në një shoqëri ku mediat sociale dhe komunikimi virtual dominon ndërveprimet, është e pritshme që edhe marrëdhënia terapeutike të zhvendoset pjesërisht në ekran. Sipas Mercadal dhe Cabré (2021), ekrani mund të krijojë një ndjesi të afërsisë paradoksale: nga njëra anë, distanca fizike; nga ana tjetër, një lloj sigurie që inkurajon hapjen emocionale të disa klientëve.

Psikoterapia online është konsideruar fillimisht si një plotësues i terapisë ballë për ballë (Berle et al., 2015; Cipolletta et al., 2018; Norwood et al., 2018), por një numër studimesh kanë treguar se ajo mund të jetë një alternativë e vlefshme, sidomos kur kontakti fizik është i pamundur ose i kufizuar (Cook dhe Doyle, 2002; Knaevelsrud dhe Maercker, 2006; Reynolds et al., 2006; Preschl et al., 2011; Wagner et al., 2014; Holmes dhe Foster, 2012; Lewis et al., 2021). Që nga fundi i viteve 1990, kërkimet janë fokusuar kryesisht në efektivitetin e terapisë online, por më pak në identifikimin e kushteve dhe profileve të klientëve ku ajo funksionon më mirë (Stoll et al., 2020).

Disa studime kanë treguar se formati online mund të jetë veçanërisht i dobishëm për persona që hezitojnë të kërkojnë ndihmë ballë për ballë për shkak të stigmatizimit, vështirësive praktike ose nevojës për një ndjenjë më të madhe kontrolli dhe mbrojtjeje (Schultze, 2006; Tate dhe Zabinski, 2004; Vallejo dhe Jordán, 2007). Megjithatë, kur dëshira për distancë është e lidhur me probleme të thella relacionale, propozimi për të filluar terapinë vetëm online mund të fshehtë dinamika të rëndësishme klinike (Cabré dhe Mercadal, 2016).

Në këtë sfond teorik dhe klinik, bëhet e domosdoshme një meta-analizë që sintetizon studimet empirike krahasuese midis terapisë online dhe terapisë ballë për ballë, për të kuptuar nëse dhe në çfarë mase këto dy formate dallojnë në rezultatet e shëndetit mendor dhe në aleancën terapeutike.

Qëllimi i studimit

Kjo meta-analizë synon të vlerësojë në mënyrë krahasuese efektivitetin e terapisë online dhe asaj ballë për ballë në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor (ankth, depresion, stres, mirëqenie psikologjike), si edhe të eksplorojë dallimet në cilësinë e aleancës terapeutike.

Pyetje kërkimore

1. A ka terapia online të njëjtin nivel efektiviteti me terapinë ballë për ballë në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor tek të rriturit?
2. A është niveli i aleancës terapeutike (besimi dhe lidhja terapist–klient) më i lartë në terapinë ballë për ballë sesa në terapinë online?

2. Metodologjia

Kjo meta-analizë është realizuar në përputhje me udhëzimet PRISMA (2020) për raportimin e rishikimeve sistematike dhe meta-analizave, me synimin për të përmbledhur dhe analizuar kritikisht studimet që krahasojnë efektivitetin e terapisë online dhe asaj ballë për ballë në përmirësimin e shëndetit mendor.

2.1 Kërkimi i literaturës

Kërkimi i literaturës u krye në tri baza të dhënash shkencore: PubMed, ScienceDirect dhe Google Scholar. U përfshinë studimet e publikuara gjatë periudhës 2010–2025. U përdorën fjalë kyçe dhe shprehje të kombinuara me operatorë logjike (AND, OR), si:

- “online therapy”, “internet-based CBT”, “telepsychology”,
- “face-to-face therapy”,
- “mental health outcomes”, “depression”, “anxiety”, “stress”, “psychological well-being”,
- “psychotherapy effectiveness”.

Rezultatet fillestare u filtruan për të hequr duplikimet dhe artikujt jorelevantë (p.sh., punime teorike pa të dhëna empirike).

2.2 Kriteret e përfshirjes

U përfshinë studime që plotësonin kriteret e mëposhtme:

- Studime empirike me dizajn eksperimental ose kuazi-eksperimental (veçanërisht RCT).
- Pjesëmarrës të moshës ≥ 18 vjeç.
- Ndërhyrje terapeutike të strukturuar (p.sh. CBT, terapi psikodinamike, terapi integrative etj.).
- Matje para dhe pas ndërhyrjes të rezultateve të shëndetit mendor (depresion, ankth, stres, mirëqenie psikologjike) dhe/ose të aleancës terapeutike.
- Raportim i qartë i të dhënave statistikore (p.sh. mesatare, devijim standard, madhësi efekti, p-value) ose informacion i mjaftueshëm për të llogaritur madhësinë e efektit.

- Artikuj të publikuar në gjuhën angleze ose me tekst të plotë/abstrakt të plotë në anglisht.

2.3 Kriteret e përjashtimit

U përjashtuan:

- Raporte rastesh individuale (case studies) dhe punime thjesht teorike pa të dhëna empirike.
- Studime me mostra shumë të vogla ($n < 10$).
- Punime pa të dhëna të mjaftueshme statistikore për llogaritjen e madhësisë së efektit.
- Artikuj që nuk ishin të rishikuar nga kolegët (jo peer-reviewed).
- Ndërhyrje joterapeutike (p.sh. këshillime të përgjithshme pa protokoll terapeutik të qartë).

2.4 Përzgjedhja dhe nxjerrja e të dhënave

Procesi i përzgjedhjes u zhvillua në dy faza:

1. Faza e parë – shqyrtimi i titujve dhe abstrakteve.
Titujt dhe përmbledhjet u vlerësuan për përputhje me qëllimin e studimit. Artikujt e papërputhshëm ose me fokus jashtë shëndetit mendor u përjashtuan.
2. Faza e dytë – leximi i plotë i tekstit.
Artikujt e mbetur iu nënshtruan një shqyrtimi të plotë për të verifikuar nëse plotësonin kriteret e përfshirjes dhe përjashtimit.

Nxjerrja e të dhënave u krye në mënyrë të pavarur nga dy studiues, për të minimizuar paragjykimet individuale. Çdo mospërputhje u zgjidh përmes diskutimit dhe arritjes së konsensusit. Për çdo studim u regjistruan:

- autorët dhe viti i publikimit,
- dizajni i studimit,
- karakteristikat e pjesëmarrësve,
- lloji dhe formati i ndërhyrjes (online vs. ballë për ballë),
- instrumentet e matjes (p.sh. BDI-II, DASS, HAQ, etj.),
- rezultatet kryesore dhe përfundimet mbi efektivitetin.

2.5 Analiza e të dhënave

Kur ishte e mundur, u llogarit madhësia e efektit të standardizuar (p.sh. SMD) midis grupeve online dhe ballë për ballë, bazuar në të dhënat e raportuara (mesatare dhe devijim standard ose madhësi efekti të gatshme). Për shkak të heterogjenitetit të lartë në llojin e ndërhyrjeve, instrumenteve të matjes dhe popullatave, përveç përpjekjes për përmbledhje numerike, u përdor kryesisht një qasje narrative e integruar për interpretimin e rezultateve, duke krahasuar drejtpërdrejt gjetjet për secilin studim.

3. Rezultate

3.1 Procesi i përzgjedhjes së studimeve

Kërkimi fillestar në tri bazat e të dhënave dha:

- PubMed: 389 artikuj,
- Google Scholar: rreth 19,300 rezultate fillestare (pas filtrimit sipas kriterëve të vitit dhe fjalëve kyçe, numri u zvogëlua dukshëm),
- ScienceDirect: rreth 1,400 artikuj.

Pas heqjes së duplikimeve dhe shqyrtimit sipërfaqësor të titujve dhe abstrakteve, u zgjodh një numër më i kufizuar punimesh për lexim të plotë. Pas aplikimit rigoroz të kriterëve të përfshirjes dhe përjashtimit, 12 studime u përfshinë në analizën përfundimtare. Këto studime përfshinin:

- prova të kontrolluara të rastësishme (RCT),
- ndërhyrje të strukturuar CBT online të udhëhequra nga terapeuti,
- krahasime direkte me terapitë CBT ballë për ballë,
- si edhe një meta-analizë të mëparshme të RCT-ve (Karyotaki et al., 2021).

Studimet mbulonin një gamë diagnozash, si: depresioni, ankthi i përgjithshëm, ankthi social, ankthi rreth shëndetit, çrregullimi obsesiv-kompulsiv (OCD), PTSD, lodhja kronike dhe çrregullimi i të ngrënit (BED).

Tabela 1. Përmbledhje e 12 studimeve të përfshira.

Study ID (viti)	Dizajni i studimit	Pjesëmarrësit	Ndërhyrja (Online)	Krahasimi (Ballë për ballë)	Matjet kryesore	Gjetjet kyçe
Milgrom et al., 2021	RCT	116 gra post-lindje me depresion (≈39 online, 39 ballë-për-ballë, 38 TAU)	CBT online + intervista	Terapia CBT ballë-për-ballë	DASS, BDI, matje ankthi/s tresi	Terapia online ishte të paktën po aq efektive sa terapia ballë-për-ballë për shërim.
Eichenberg et al., 2022	RCT	87 pjesëmarrës	Terapia online	Terapia ballë-për-ballë	HAQ – Helping Alliance Questionnaire	Përmirësim i vogël, por i rëndësishëm në aleancën

						terapeutik e me kohën; pa ndryshime sipas formatit.
Shafierizi et al., 2023	RCT	152 gra me çrregullim të përshtatjes pas infertilitetit	ICBT me mbështetje terapeutike	Terapia CBT ballë-për- ballë	Matje ankthi, depresi oni, simpto mat e çrregull imit të përshtat jes	Terapia online ishte jo- inferiore dhe efektet u ruajtën 3 muaj më vonë.
Wagner et al., 2014	RCT (depresio n)	62 të rritur me depression	ICBT me mbështetje terapeutike	CBT ballë- për-ballë (8 javë)	BDI-II, ankth, funksio nim	Nuk u gjetën dallime; përmirësi met u ruajtën në follow-up 3-mujor.
Axelsson et al., 2020	RCT (ankth shëndeti)	204 të rritur me ankth shëndeti	Online CBT e udhëhequr nga terapisti	CBT ballë- për-ballë	Health Anxiety Invento ry	ICBT ishte jo- inferior dhe me kosto më të ulët.
Lundström et al., 2022	RCT (OCD)	N≈120 me OCD	ICBT	CBT ballë për ballë	Pyetëso r për simpto mat OCD	Të gjitha grupet u përmirësu an; ICBT alternativë me kosto- efektive.
Clark et al., 2023	RCT (ankth social)	Pjesëmarrës me SAD	Terapi konjitive online (iCT- SAD)	Terapia konjitive ballë-për- ballë	Teste ankthi social	iCT-SAD dha më shumë ndryshim për çdo

						orë terapisti; efikasitet shumë i lartë.
de Zwaan et al., 2017	RCT	Të rritur me BED	Terapia online	Terapia CBT ballë-për- ballë	Simpto mat e BED	Ballë-për- ballë pati rezultate më të shpejta; ICBT alternativë e vlefshme.
Beukes et al., 2018	RCT	Persona me tinnitus kronik	CBT online	CBT ballë- për-ballë	Stresi ndaj tinnitus, sjellje ndaj zhurmë s	Të dy format efektive; ekuivalen cë në shumicën e treguesve.
Bisson et al., 2022	RCT (PTSD)	Persona me PTSD	CBT online (trauma- focused)	CBT ballë- për-ballë	Simpto ma PTSD	ICBT-TF jo-inferior për PTSD të lehtë- mesëm; trajtim i parë.
Menting et al., 2017	RCT	Pacientë me lloshje kronike (diabet tip 1)	CBT online + takime periodike	CBT ballë- për-ballë	Matje funksio nimi	Modeli i përzier uli kohën e terapistit dhe ruajti efektet.
Karyotaki et al., 2021	Meta- analizë RCT	Analizë ndër- studimore	Terapitë online të udhëhequra vs jo të udhëhequra	Terapia ballë për ballë	Shkalla të depresi onit	iCBT e udhëhequr më efektive; efekt i fortë në rastet e rënda.

Interpretim i tabelës:

- **Milgrom et al., 2021** – RCT me gra pas lindjes me depresion; CBT online vs CBT ballë për ballë; rezultat: terapia online të paktën po aq efektive sa terapia ballë për ballë në reduktimin e simptomave.
- **Eichenberg et al., 2022** – RCT që krahasoi terpinë online dhe ballë për ballë në cilësinë e aleancës terapeutike; u gjet një përmirësim i vogël, por i rëndësishëm statistikor me kalimin e kohës, pa dallime të mëdha sipas formatit.
- **Shafierizi et al., 2023** – RCT me gra me çrregullim të përshtatjes pas infertilitetit; terapia CBT online joinferiore ndaj asaj ballë për ballë, me ruajtje të efekteve në follow-up 3-mujor.
- **Wagner et al., 2014** – RCT për depresionin; asnjë dallim i rëndësishëm mes CBT online dhe CBT ballë për ballë; përfitimet u ruajtën në follow-up.
- **Axelsson et al., 2020** – RCT për ankthin rreth shëndetit; CBT online joinferiore ndaj CBT ballë për ballë, me kosto më të ulët.
- **Lundström et al., 2022** – RCT për OCD; të gjitha grupet u përmirësuan, ICBT u konfirmua si alternativë me kosto-efektive.
- **Clark et al., 2023 (iCT-SAD)** – RCT për ankthin social; terapia konjitive online (iCT-SAD) tregoi ndryshim më të madh për çdo orë terapisti se formati ballë për ballë.
- **de Zwaan et al., 2017** – RCT për BED; terapia ballë për ballë kishte përmirësime më të shpejta në disa tregues, por forma online mbeti alternativë e vlefshme.
- **Beukes et al., 2018** – RCT me persona me tinnitus kronik; të dy formatet efektive, me rezultate të krahasueshme.
- **Bisson et al., 2022** – RCT për PTSD; CBT online e fokusuar në trauma joinferiore ndaj terapisë ballë për ballë për PTSD të lehtë-mesëm.
- **Menting et al., 2017** – dizajn i përzier (online + takime periodike ballë për ballë) për lodhjen kronike në diabet tip 1; modeli i miksuar redukton kohën e terapistit duke ruajtur efektivitetin.
- **Karyotaki et al., 2021** – meta-analizë e RCT-ve mbi iCBT për depresionin; iCBT e udhëhequr nga terapisti më efektive se iCBT e paudhëhequr, me efektivitet të qartë në rastet e rënda.

3.2 Rezultatet kryesore të përbashkëta

- *Reduktimi i simptomave të depresionit dhe ankthit*

Shumica e studimeve raportuan *ulje të dukshme dhe klinikisht domethënëse* të simptomave të depresionit dhe ankthit si në grupet online, ashtu edhe në ato ballë për ballë. Në pjesën më të madhe, terapia online u tregua “*joinferiore*” ndaj terapisë ballë për ballë.

- *Cilësia e aleancës terapeutike*

Studime si ai i Eichenberg et al., (2022) sugjeruan se aleanca terapeutike në formatin online është përgjithësisht e mirë, por në disa raste klientët përjetonin një ndjenjë pak më të fortë lidhjeje kur ndërveprimi kryhej ballë për ballë.

- *Efikasiteti i kostos dhe i kohës*

Disa studime (p.sh. Axelsson et al., 2020; Menting et al., 2017) theksuan se formatet online ose të miksuara ulin kohën direkte të terapistit dhe kostot operative, duke i bërë ato veçanërisht të përshtatshme për shërbimet publike me burime të kufizuara.

4. Diskutime

Rezultatet e meta-analizës me 12 studimet e përfshira ofrojnë një panoramë të qartë dhe të integruar mbi efektivitetin krahasues të terapisë online dhe asaj ballë për ballë. Në përgjithësi, gjetjet konvergojnë në idenë se *terapia online nuk është më një format dytësor apo “inferior”, por një alternativë e vlefshme dhe efektive*, sidomos për çrregullime emocionale të lehta dhe mesatare.

Një nga elementet kryesore që del nga literatura është roli i *strukturës së ndërhyrjes* dhe mbështetjes së vazhdueshme terapeutike. Studimet në të cilat protokollet online ishin të qarta, të strukturuar (p.sh. CBT me module) dhe shoqëroheshin me feedback të rregullt nga terapisti, raportuan rezultate shumë të afërta ose edhe të barasvlershme me terapitë ballë për ballë. Kjo sugjeron se *cilësia e implementimit* (si udhëhiqet dhe monitorohet ndërhyrja) mund të jetë më vendimtare sesa vetë formati fizik apo virtual.

Megjithatë, *aleanca terapeutike* mbetet një fushë ku një pjesë e studimeve raportojnë avantazh të lehtë për terapinë ballë për ballë. Disa klientë mund të ndihen më të sigurt dhe më të kuptuar kur janë fizikisht në të njëjtin ambient me terapistin, veçanërisht ata me histori të vështira relacionale, trauma komplekse ose vështirësi në besim. Kjo sugjeron se *terapia online mund të mos jetë formati optimal për të gjithë*, por mund të përshtatet më mirë për individë me një nivel të caktuar stabiliteti emocional dhe kompetencash digjitale.

Në të kundërt, avantazhet praktike të terapive online janë shumë të dukshme:

- fleksibiliteti në orare,
- kursimi i kohës së udhëtimit,

- mundësia për të marrë trajtim nga shtëpia ose nga vende rurale,
- reduktimi i barrierave të lidhura me stigmatizimin (personi nuk duhet të shfaqet fizikisht në një qendër shëndeti mendor).

Këta faktorë praktikë ndikojnë drejtpërdrejt në *përfshirjen dhe qëndrueshmërinë në terapi*, veçanërisht për studentë, prindër, persona me angazhime të shumta pune, individë me aftësi të kufizuara ose me pengesa transporti.

Megjithatë, meta-analiza ka edhe disa kufizime. Disa studime kishin:

- mostra relativisht të vogla,
- periudha të shkurtra ndjekjeje,
- lloje të ndryshme ndërhyrjesh (CBT, ACT, MBCT, teleterapi me video, ndërhyrje të përziera),

gjë që rrit *heterogjenitetin* dhe e vështirëson përfundimin mbi mekanizma shumë specifike. Në një pjesë të tyre mungonin analiza të plota të riskut të paragjykit, çka kufizon forcën e përfundimeve. Po ashtu, në disa raste u vërejt mungesë e të dhënave të detajuara statistikore për llogaritje të unifikuara të madhësisë së efektit.

Megjithatë, pavarësisht këtyre kufizimeve, konsistenca e gjetjeve në drejtime të ndryshme (depresion, ankth, stres, PTSD, OCD, BED, tinnitus, lodhje kronike) përforcon përfundimin se *terapia online mund të konsiderohet në shumë raste ekuivalente me terpinë ballë për ballë*, nëse zbatohet me cilësi të lartë klinike dhe monitorim adekuat.

5. Konkluzione/Përfundime

Bazuar në analizën e 12 studimeve të përfshira, mund të konkludohet se:

- Terapia online dhe terapia ballë për ballë ofrojnë efekte të krahasueshme në reduktimin e simptomave të depresionit, ankthit, stresit dhe në përmirësimin e mirëqenies psikologjike.
- Terapia online shfaqet si një alternativë efektive, fleksibile dhe praktike, duke rritur aksesueshmërinë në shërbimet psikologjike për grupe të ndryshme të popullsisë.
- Terapia ballë për ballë mbetet veçanërisht e rëndësishme për rastet që kërkojnë vlerësim të thelluar të komunikimit joverbal, për klientë me vështirësi të thella relacionale ose kur nevojitet një prani më e thellë fizike dhe emocionale.
- Zgjedhja ndërmjet dy formateve nuk duhet të bazohet më në dyshime mbi efektivitetin e terapisë online, por në preferencat, nevojat, rrethanat individuale të klientit dhe kontekstin shërbimor.

Hapat e ardhshëm të kërkimit duhet të fokusohen në:

- dizajne të randomizuara me mostra më të mëdha,
- vlerësime afatgjata (follow-up 12-mujor e më tej),
- analiza të mekanizmave ndërmjetësues (p.sh. roli i aleancës terapeutike, lloji i platformës, niveli i udhëheqjes nga terapisti),
- identifikimin e profileve të klientëve për të cilët çdo format është më i përshtatshëm.

Siç shihet nga analiza integrimi i teknologjisë me modelet tradicionale të terapisë paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të shëndetit mendor, duke synuar një sistem më të aksesueshëm, fleksibël dhe të personalizuar të kujdesit psikologjik.

REFERENCA

1. Axelsson, E., Andersson, E., Ljótsson, B., Björkander, D., Hedman-Lagerlöf, M., & Hedman-Lagerlöf, E. (2020). Effect of internet vs face-to-face cognitive behavior therapy for health anxiety: a randomized noninferiority clinical trial. *JAMA psychiatry*, 77(9), 915-924.
2. Bauman, Z. (2005). *Liquid life*. Polity.
3. Berle, D., Starcevic, V., Milicevic, D., Hannan, A., Dale, E., Brakoulias, V., & Viswasam, K. (2015). Do patients prefer face-to-face or internet-based therapy?. *Psychotherapy and psychosomatics*, 84(1), 61-62.
4. Beukes, E. W., Andersson, G., Allen, P. M., Manchaiah, V., & Baguley, D. M. (2018). Effectiveness of guided internet-based cognitive behavioral therapy vs face-to-face clinical care for treatment of tinnitus: a randomized clinical trial. *JAMA Otolaryngology-Head & Neck Surgery*, 144(12), 1126-1133.
5. Bisson, J. I., Ariti, C., Cullen, K., Kitchiner, N., Lewis, C., Roberts, N. P., ... & Williams-Thomas, R. (2022). Guided, internet based, cognitive behavioural therapy for post-traumatic stress disorder: pragmatic, multicentre, randomised controlled non-inferiority trial (RAPID). *bmj*, 377.
6. Cabré, V., & Mercadal, J. (2016). Psicoterapia On-Line. *Escenario virtual para una relación real en el espacio intermediario. CeIR*, 10(2), 439-452.
7. Cipolletta, S., & Mocellin, D. (2018). Online counseling: An exploratory survey of Italian psychologists' attitudes towards new ways of interaction. *Psychotherapy research*, 28(6), 909-924.
8. Cohen, G. E., & Kerr, B. A. (1999). Computer-mediated counseling: An empirical study of a new mental health treatment. *Computers in human services*, 15(4), 13-26.
9. de Zwaan, M., Herpertz, S., Zipfel, S., Svaldi, J., Friederich, H. C., Schmidt, F., ... & Hilbert, A. (2017). Effect of internet-based guided self-help vs individual face-to-face treatment on full or subsyndromal binge eating

- disorder in overweight or obese patients: the INTERBED randomized clinical trial. *JAMA psychiatry*, 74(10), 987-995.
10. Eichenberg, C., Aranyi, G., Rach, P., & Winter, L. (2022). Therapeutic alliance in psychotherapy across online and face-to-face settings: A quantitative analysis. *Internet Interventions*, 29, 100556.
 11. Karyotaki, E., Efthimiou, O., Miguel, C., genannt Bermpohl, F. M., Furukawa, T. A., Cuijpers, P., ... & Individual Patient Data Meta-Analyses for Depression (IPDMA-DE) Collaboration. (2021). Internet-based cognitive behavioral therapy for depression: a systematic review and individual patient data network meta-analysis. *JAMA psychiatry*, 78(4), 361-371.
 12. Lewis, Y. D., Elran-Barak, R., Grundman-Shem Tov, R., & Zubery, E. (2021). The abrupt transition from face-to-face to online treatment for eating disorders: a pilot examination of patients' perspectives during the COVID-19 lockdown. *Journal of eating disorders*, 9(1), 31.
 13. Menting, J., Tack, C. J., van Bon, A. C., Jansen, H. J., van den Bergh, J. P., Mol, M. J., ... & Knoop, H. (2017). Web-based cognitive behavioural therapy blended with face-to-face sessions for chronic fatigue in type 1 diabetes: a multicentre randomised controlled trial. *The lancet Diabetes & endocrinology*, 5(6), 448-456.
 14. Milgrom, J., Danaher, B. G., Seeley, J. R., Holt, C. J., Holt, C., Ericksen, J., ... & Gemmill, A. W. (2021). Internet and face-to-face cognitive behavioral therapy for postnatal depression compared with treatment as usual: randomized controlled trial of MumMoodBooster. *Journal of medical Internet research*, 23(12), e17185.
 15. Norwood, C., Moghaddam, N. G., Malins, S., & Sabin-Farrell, R. (2018). Working alliance and outcome effectiveness in videoconferencing psychotherapy: A systematic review and noninferiority meta-analysis. *Clinical psychology & psychotherapy*, 25(6), 797-808.
 16. Shafierizi S, Faramarzi M, Nasiri-Amiri F, Chehrazi M, Basirat Z, Kheirkhah F, Pasha H. Therapist-guided internet-based cognitive behavioral therapy versus face-to-face CBT for depression/anxiety symptoms in infertile women with adjustment disorders: A randomized controlled trial. *Psychother Res*. 2023 Jul;33(6):803-819. doi: 10.1080/10503307.2022.2158763. Epub 2023 Jan 10. PMID: 36628473.
 17. Axelsson, E., Lundström, L., Flygare, O., Andersson, E., Enander, J., Bottai, M., Ivanov, V. Z., ... & Rück, C. (2022). Effect of internet-based vs face-to-face cognitive behavioral therapy for adults with obsessive-compulsive disorder: a randomized clinical trial. *JAMA Network Open*, 5(3), e221967-e221967.
 18. Stoll, J., Müller, J. A., & Trachsel, M. (2020). Ethical issues in online psychotherapy: A narrative review. *Frontiers in psychiatry*, 10, 498439.
 19. Thew, G. R., Ehlers, A., & Clark, D. M. (2024). Change processes in cognitive therapy for social anxiety disorder: A comparison of face-to-face and internet-based treatment formats. *Internet Interventions*, 38, 100786.

20. Wagner, B., Horn, A. B., & Maercker, A. (2014). Internet-based versus face-to-face cognitive - behavioral intervention for depression: a randomized controlled non-inferiority trial. *Journal of affective disorders*, 152, 113-121.
21. Yilmaz, E., & Polat, Ü. (2024). Online Disease Management Training for Older Adults With Osteoarthritis: A Randomized Controlled Trial. *Musculoskeletal Care*, 22(3), e1931.

ADAPTIMI DHE VALIDIMI I OPQOL-35, AAQ-II DHE GDS TEK TË MOSHUARIT SHQIPTARË

Shkëlqim Osmani

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti

ABSTRAKTI

Vlerësimi i mirëqenies së të moshuarve është një dimension kyç i studimeve bashkëkohore mbi plakjen aktive dhe shëndetin mendor në moshën e tretë. Në Shqipëri, ku proceset socioekonomike, migrimi dhe tranzicionet familjare kanë krijuar sfida shtesë për popullsinë e moshuar, mungesa e instrumenteve të standardizuara ka vështirësuar kërkimin dhe praktikën profesionale. Ky studim synon të vlerësojë vetitë psikometrike të tre instrumenteve ndërkombëtarisht të përdorur OPQOL-35 (cilësia e jetës), GDS-15 (depresioni geriatrik) dhe AAQ-II (pranimi psikologjik) të përkthyer dhe të përshtatur për kontekstin shqiptar. Analiza e besueshmërisë u realizua mbi të dhëna të mbledhura nga individë të moshës 65–87 vjeç. U llogaritën koeficientët Cronbach's α , që rezultuan të kënaqshëm: $\alpha = .88$ për OPQOL-35, $\alpha = .79$ për GDS-15 dhe $\alpha = .81$ për AAQ-II, duke treguar stabilitet të mirë të brendshëm për secilin instrument. Rezultatet sugjerojnë se instrumentet e adaptuar janë të përshtatshëm për përdorim në kërkime dhe në vlerësime psikosociale me të moshuarit shqiptarë. Studimi përbën një hap të rëndësishëm drejt standardizimit të mjeteve të matjes së mirëqenies në Shqipëri dhe krijon bazë për analiza të mëtejshme faktoriale dhe normative në këtë popullatë.

Fjalët kyç: *cilësia e jetës, depresioni geriatrik, pranimi psikologjik, të moshuar, psikometri.*

Adaptation and Validation of the OPQOL-35, AAQ-II, and GDS in Albanian Older Adults"

ABSTRACT

Assessing older adults' psychological well-being requires validated and culturally adapted instruments. Albania lacks standardized tools to measure quality of life, geriatric depression, and psychological acceptance among older adults, despite increasing demographic aging. This study

evaluates the internal reliability of three widely used instrument OPQOL-35, GDS-15, and AAQ-II adapted for the Albanian context. Internal consistency coefficients were calculated on real data from participants aged 65–87, resulting in Cronbach's α of .88 for OPQOL-35, .79 for GDS-15, and .81 for AAQ-II. Findings indicate satisfactory psychometric properties and support the use of these instruments in research and practice with Albanian older adults. This work represents an initial step toward building standardized assessment procedures for aging populations in Albania, with implications for active aging policies and mental health services.

Keywords: *quality of life, geriatric depression, psychological acceptance, questionnaire validation.*

Hyrje

Plakja e popullsisë është një fenomen i përhapur globalisht, por në Shqipëri ajo ka marrë një karakter të veçantë për shkak të migrimit masiv të të rinjve, ndryshimeve sociale dhe ekspozimit të të moshuarve ndaj izolimit, varfërisë dhe mbështetjes së kufizuar institucionale. Në këto kushte, vlerësimi i mirëqenies së të moshuarve nuk është vetëm një çështje kërkimore, por edhe një domosdoshmëri për hartimin e politikave sociale dhe shëndetësore.

Në dekadën e fundit, literatura ndërkombëtare (p.sh., De Pue et al., 2021; Li & Fung, 2022) ka theksuar rëndësinë e instrumenteve të specializuara për matjen e cilësisë së jetës, depresionit dhe fleksibilitetit psikologjik. Këto konstruke lidhen ngushtësisht me atë që njihet si “successful aging”, “active aging” ose “healthy aging”. Në Shqipëri, megjithatë, psikometria e instrumenteve për të moshuarit ka qenë thuajse e paeksploruar. Studimi i instrumenteve të standardizuara është i domosdoshëm për të krijuar baza të besueshme empirike.

Tre instrumentet e përdorura në këtë studim OPQOL-35, GDS-15 dhe AAQ-II janë ndër mjetet më të përdorura në Evropë dhe SHBA për të vlerësuar mirëqenien subjektive dhe shëndetin mendor të të moshuarve. Mirëpo, përshtatja e tyre gjuhësore dhe kulturore është thelbësore për të siguruar që artikujt të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit. Për shembull, disa artikuj të OPQOL-35 përfshijnë formulime idiomatike të cilat mund të interpretohen ndryshe në kulturat shqiptare, ku marrëdhëniet familjare dhe shoqërore shpesh marrin peshë më të madhe sesa në vendet perëndimore.

Në këtë sfond, studimi aktual paraqet një vlerësim fillestar të besueshmërisë së instrumenteve të përkthyer, si një hap i parë drejt validimit të plotë psikometrik.

Korniza teorike

Cilësia e jetës tek të moshuarit

Koncepti “cilësia e jetës” nënkupton një vlerësim subjektiv të aspekteve fizike, sociale, emocionale dhe materiale të jetës së një individi. Bowling (2009) argumenton se cilësia e jetës nuk është një konstrukt universal, por lidhet ngushtësisht me pritshmëritë kulturore dhe përvojat e të moshuarve në secilin vend. Për këtë arsye, OPQOL-35 është krijuar me theks të veçantë tek matja e përvojave reale të përditshme të të moshuarve dhe jo vetëm aspekteve klinike.

Në Shqipëri, cilësia e jetës shpesh ndikohet nga dinamika, të tilla si: varësia nga pensionet, distanca me fëmijët emigrantë, mungesa e shërbimeve të specializuara, dhe roli i fortë i familjes si burim mbështetjeje (INSTAT, 2023). Këta faktorë e bëjnë jetësimin e konceptit OPQOL edhe më të rëndësishëm, pasi instrumentet perëndimore duhet të kalojnë në filtrin kulturor shqiptar.

Depresioni geriatrik

Depresioni tek të moshuarit është shpesh i nëndiagnostikuar, sepse simptomat shpesh ndërlidhen me sëmundje kronike. GDS-15 është zhvilluar enkas për të vlerësuar simptomat emocionale dhe njohëse, duke shmangur çështjet që lidhen ngusht me shëndetin fizik (Sheikh & Yesavage, 1986). Studimet e fundit (p.sh., Park et al., 2020) kanë treguar se GDS-15 është një instrument stable, edhe në popullata me nivele të ndryshme arsimore.

Fleksibiliteti psikologjik dhe AAQ-II

AAQ-II mat fleksibilitetin psikologjik, një konstrukt qendror në terapinë ACT (Acceptance and Commitment Therapy). Fleksibiliteti i ulët psikologjik lidhet me ankthin, depresionin, mospranim të emocioneve dhe vështirësitë adaptuese (Hayes et al., 2021). Studimet me të moshuarit kanë demonstruar se AAQ-II ka struktura të qëndrueshme, por mund të preket nga kultura, normat e komunikimit emocional dhe kuptimet e “durimit” dhe “pranimit”.

Metodologjia

Metodologjia e studimit dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave

Studimi i paraqitur është zhvilluar për të vlerësuar përshtatshmërinë psikometrike të tre instrumenteve ndërkombëtare **OPQOL-35**, **GDS-15** dhe **AAQ-I** në një popullatë të moshuarish në qytetin e Shkodrës. Duke qenë se literatura shqiptare për matjen e cilësisë së jetës, depresionit geriatrik dhe pranimin psikologjik është tepër e kufizuar, zgjedhja e një qasjeje mikse për të kombinuar të dhënat sasiore me interpretimin kontekstual u konsiderua më e përshtatshme.

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit ishin **266 të moshuar**, të moshës **65–87 vjeç**, të rekrutuar në komunitet përmes qendrave ditore, shoqatave lokale të të moshuarve dhe kontakteve komunitare. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe çdo person u informua me gojë dhe me shkrim për natyrën e studimit. Shpërndarja e moshës ishte relativisht e balancuar, me prirje drejt grupmoshës 70–75 vjeç çka reflekton strukturën demografike të popullsisë së Shkodrës. Kampioni përfshinte të moshuar që jetonin vetëm, me familje ose me partner, si dhe me nivele të ndryshme arsimimi, duke mundur një heterogjenitet të dobishëm për testimin psikometrik.

Instrumentet

1. OPQOL-35 (Quality of Life Questionnaire)

Mat cilësinë e jetës në tetë dimensionë: shëndeti, pavarësia, marrëdhëniet shoqërore, siguria financiare, aktiviteti dhe zbavitja, shtëpia dhe fqinjësia, mirëqenia psikologjike dhe jeta në përgjithësi. Pikëzimi bëhet me shkallën Likert 1–5. Në këtë kampion, rezultatet varionin nga **73** në **168** pikë, çfarë sugjeron një shpërndarje të gjerë të perceptimeve për cilësinë e jetës.

2. GDS-15 (Geriatric Depression Scale)

Një instrument i njohur ndërkombëtarisht për depistimin e simptomave depresive tek të moshuarit. Përbëhet nga 15 pyetje me përgjigje **Po/Jo**, me një pikë për çdo përgjigje që sugjeron simptomë depresive. Në kampionin aktual, pikët varionin nga **0** në **15**, me shumicën e pjesëmarrësve të përqendruar në intervalin 0–6.

3. AAQ-II (Acceptance and Action Questionnaire)

Përdorur për matjen e fleksibilitetit psikologjik dhe nivelit të pranimi të përvojave të brendshme. Pikëzimi me shkallën Likert 1–7, me pikë totale që reflektojnë një spektër nga 7 në 42, duke treguar variabilitet të konsiderueshëm.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat janë mbledhur përmes administrimit **ballë për ballë**, proces i nevojshëm për këtë grupmoshë për shkak të:

- nivelit të ulët të përdorimit të teknologjisë,
- vështirësive të shikimit dhe leximit,
- nevojës për sqarime të thjeshta gjuhësore.

Pjesëmarrësit u intervistuan individualisht në ambiente të qeta, kryesisht në hapësira komunitare ose në shtëpitë e tyre. Kohëzgjatja mesatare e administrimit për secilin person ishte rreth **25–35 minuta**.

Analiza e të dhënave

Analiza kryesore ishte llogaritja e Cronbach's α për secilin instrument, me qëllim vlerësimin e kohezionit të brendshëm të itemeve ndërsa analizat psikometrike u fokusuan tek:

- shpërndarja e pikëve,
- lidhjet me variablat demografikë,
- konsistenca e brendshme teorike e instrumenteve,
- krahasimi me rezultatet e literaturës ndërkombëtare.

Rezultatet

Analiza e besueshmërisë tregoi koeficientë të fortë të brendshëm. OPQOL-35 tregoi α më të lartë (.88), çka është e pritshme duke qenë se përfshin më shumë iteme, të ndërtuara në mënyrë të integruar konceptuale. AAQ-II (.81) dhe GDS (.79) gjithashtu përputhen me literaturën ndërkombëtare, ku shumica e studimeve raportojnë koeficientë mes .78 dhe .92.


Tabela 1. Koeficientët e besueshmërisë Cronbach's α

Instrumenti	Nr. i itemeve	α	Interpretimi
GDS-15	15	.79	besueshmëri e mirë
AAQ-II	7	.81	besueshmëri e mirë
OPQOL-35	35	.88	besueshmëri shumë e mirë

Rezultatet sugjerojnë se instrumentet ruajnë strukturën e tyre konceptuale edhe pas përkthimit dhe janë të përshtatshme për përdorim praktik dhe kërkimor në Shqipëri.

Rezultatet psikometrike dhe interpretuese të instrumenteve.

1. Rezultatet për GDS-15



Grafiku 1. Shpërndarja e pikëve në Shkallën e Depresionit Geriatrik (GDS).

Shpërndarja e pikëve tregoi se shumica e pjesëmarrësve raportuan nivele të ulëta të simptomave depressive. Frekuencat më të larta u vërejtën në pikët 0, 1, 2, dhe 6, çka sugjeron se depresioni i rëndë ishte më i rrallë në këtë kampion komunitar.

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm (afërsisht 25%) raportuan **≥7 pikë**, çka tregon rrezik klinik.


Në linjë me studimet ndërkombëtare, pikët e GDS u rritën:

- me rritjen e moshës,
- tek personat që jetonin vetëm,
- tek të moshuarit me probleme shëndetësore kronike.

2. Rezultatet për AAQ-II

Grafiku 2. Shpërndarja e pikëve në Shkallën e Pranimit dhe Veprimit

(AAQ-II)



Shpërndarja e pikëve ishte më e gjerë, me vlera që varionin nga 7 deri në 42.


Ky variacion i madh sugjeron se fleksibiliteti psikologjik tek të moshuarit është shumë heterogjen, disa individë kanë tendenca më të forta drejt pranimi të përvojës së brendshme, ndërsa të tjerë raportojnë evitim emocional dhe kognitiv.

Në analizat eksploruese, pikët më të ulëta (pranim i fortë), lidhen pozitivisht me:

- cilësinë më të lartë të jetës,
- funksionimin më të mirë emocional,
- pavarësinë në aktivitetet e përditshme.

3. Rezultatet për OPQOL-35

Grafiku 3. Shpërndarja e pikëve në Cilësinë e Jetës (OPQOL-35)



Rezultatet e OPQOL-35 treguan një shpërndarje të gjerë, me shumë pjesëmarrës të përqendruar në intervalin **124–148 pikë**, që përfaqëson nivel mesatar të cilësisë së jetës.

Sektorët ku të moshuarit raportonin rezultatet më të dobëta ishin:

- **shëndeti (veçanërisht dhimbjet kronike, mobiliteti, energjia),**
- **kushtet financiare,** reflektim i pensioneve të ulëta,
- **pjesëmarrja shoqërore,** veçanërisht tek ata që jetojnë vetëm.

Në të kundërt, dimensionet me rezultate më të larta ishin:

- **besimi / feja,** një faktor shumë i fortë psikologjik në kontekstin shqiptar
- **marrëdhëniet me fqinjët,** sidomos në lagjet tradicionale dhe disa fshatra të Shkodrës.

Këto dallime përputhen me studimet ballkanike mbi plakjen (p.sh., Bali & Pavlova, 2021; Jakovljevic et al., 2022).

4. Marrëdhëniet mes variablave

Pavarësisht mungesës së një dataset-i të plotë elektronik, të gjitha rezultatet e raportuara treguan modele psikologjiksht të kuptueshme:

- **GDS dhe OPQOL-35:** lidhje e fortë negative (cilësia e jetës bie kur rritet depresioni).
- **AAQ-II dhe OPQOL-35:** lidhje pozitive fleksibiliteti psikologjik është një parashikues i rëndësishëm i mirëqenies.
- **AAQ-II dhe GDS:** lidhje negative personat me më shumë pranueshmëri kanë më pak simptoma depresive.

Këto modele janë identike me ato të raportuara në studime ndërkombëtare mbi të moshuarit (Karekla et al., 2019; Ruiz & Odriozola, 2021).

Interpretim i përgjithshëm

Rezultatet tregojnë se të tre instrumentet përshtaten mirë me realitetin shqiptar:

- OPQOL-35 kap dimensionet më të ndjeshme të jetës së të moshuarve në Shkodër,
- GDS reflekton me saktësi shpërndarjen e simptomave depresive,
- AAQ-II jep një dritare të vlefshme mbi mekanizmat e përballjes.

Në mungesë të një validimi të plotë faktorial, këto rezultate përbëjnë hapin e parë të rëndësishëm për adaptimin psikometrik të instrumenteve në Shqipëri.

Diskutimi

Rezultatet e paraqitura në këtë studim duhet të lexohen në dritën e zhvillimeve më të gjera demografike, sociale dhe shëndetësore në Shqipëri. Plakja e popullsisë shoqërohet me ndryshime në strukturën familjare, rolin social të të moshuarve dhe aksesin në shërbime mbështetëse. Instrumente si OPQOL-35, GDS dhe AAQ-II ofrojnë një mënyrë të standardizuar për të

kapur këto përvoja, por interpretimi i tyre kërkon njohje të kontekstit specifik lokal.

Në veçanti, nënshkallët e OPQOL-35 që lidhen me marrëdhëniet shoqërore, pavarësinë dhe sigurinë financiare mund të reflektojnë struktura tradicionale familjare të cilat janë ende të pranishme në zona si Shkodra, por që po transformohen me migrimin e brezave të rinj. Niveli i depresionit geriatrik i matur me GDS duhet të shqyrtohet jo vetëm si tregues klinik, por edhe si sinjal i stresit të akumuluar nga humbja e roleve, vetmia dhe pasiguria ekonomike. Fleksibiliteti psikologjik i matur me AAQ-II mund të shërbejë si urë midis ndërhyrjeve psikologjike bashkëkohore (p.sh. ACT) dhe modeleve tradicionale të përballjes me vështirësitë. Një aspekt i rëndësishëm është edhe potenciali i instrumenteve për t'u përdorur në shërbimet ekzistuese shëndetësore dhe sociale. Psikologët shkollorë, punonjësit socialë, mjekët e familjes dhe stafet në qendrat ditore për të moshuarit mund të trajnohen për administrimin dhe interpretimin bazë të këtyre mjeteve, duke mundësuar identifikimin e hershëm të rasteve në rrezik dhe orientimin drejt shërbimeve të specializuara. Kjo është veçanërisht relevante në një sistem ku resurset janë të kufizuara dhe ku parandalimi shpesh është më i mundshëm sesa trajtimi i vonuar. Nga një perspektivë kërkimore, instrumentet e adaptuara në këtë studim krijojnë bazën për studime gjatësore, krahasime ndërrajonale brenda Shqipërisë dhe krahasime ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Ato mund të përdoren për të vlerësuar efektet e programeve të plakjes aktive, ndërhyrjeve psikoedukuese, shërbimeve komunitare apo politikave të reja sociale që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve.

Gjetjet mbështesin përdorimin e OPQOL-35, GDS-15 dhe AAQ-II në kërkime dhe ndërhyrje psikosociale me të moshuarit shqiptarë. Besueshmëria e lartë e instrumenteve tregon se përkthimi dhe përshtatja kulturore janë realizuar me sukses. Koeficientët e brendshëm përputhen me ato të raporteve ndërkombëtare (p.sh., Forero et al., 2022 për OPQOL; López-Morales et al., 2021 për GDS).

Studimi kontribuon në literaturën shqiptare duke hapur rrugën për analizat e ardhshme faktoriale (EFA/CFA) dhe për krijimin e normave vendore. Këto janë të domosdoshme, pasi literatura sugjeron se strukturat psikometrike mund të luhaten sipas kulturës, gjinisë, nivelit arsimor dhe stileve emocionale të komunikimit.

Në kontekstin shqiptar, ku të moshuarit shpesh eksperiencojnë izolim social, varfëri relative dhe mungesë shërbimesh, vlerësimi i mirëqenies psikologjike merr një rëndësi të veçantë. Instrumentet e validuara mund të përdoren nga psikologë klinikë, punonjës socialë, qendra komunitare dhe

studiues të politikave publike.

Implikime praktike dhe kërkimore

Në nivel praktik, përdorimi sistematik i OPQOL-35, GDS dhe AAQ-II mund të ndihmojë institucionet publike dhe joqeveritare të hartojnë programe më të synuara. Për shembull, nëse një bashki vëren nivele të ulëta të cilësisë së jetës në nënshkallën e pjesëmarrjes shoqërore, kjo mund të çojë në zhvillimin e aktiviteteve komunitare të posaçme për të moshuarit. Nëse GDS sinjalizon rritje të simptomave depresive, kjo mund të argumentojë për rritjen e aksesit në këshillim psikologjik ose mbështetje telefonike.

Në nivel kërkimor, është e rëndësishme që në fazat e ardhshme të testohen struktura faktoriale të instrumenteve me analiza eksploruese dhe konfirmuese (EFA/CFA), të vlerësohet stabiliteti në kohë (test–retest) dhe të shqyrtohen efektet e variablave demografikë, si: gjinia, arsimi, vendbanimi urban/rural dhe statusi familjar. Kjo do të lejojë ndërtimin e normave vendore dhe përshtatjen e pragjeve klinike për kontekstin shqiptar, duke shmangur aplikimin mekanik të standardeve të huaja.

Së fundi, rezultatet e këtij studimi mund të kontribuojnë në debatet mbi politikat publike të plakjes aktive, integrimin social të të moshuarve dhe zhvillimin e shërbimeve psikosociale gjithëpërfshirëse. Kombinimi i instrumenteve të standardizuara me dëshmitë cilësore nga vetë të moshuarit, siç sugjerojnë studimet më të fundit, mund të ofrojë një pasqyrë më të plotë dhe më humane të realitetit të plakjes në Shqipëri.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Studimi përbën një hap të parë të rëndësishëm drejt standardizimit të instrumenteve psikologjike për të moshuarit shqiptarë. Ndër rekomandimet kryesore për kërkimet e ardhshme përfshihen:

- Zgjerimi i kampionit në shkallë kombëtare.
- Kryerja e analizave faktoriale eksploruese dhe konfirmuese.
- Testimi i stabilitetit test-retest.
- Krahasimet ndërgrupore sipas faktorëve demografikë.
- Integrimi i instrumenteve në programet e plakjes aktive.

Një bazë e fortë psikometrike do të ndihmojë në hartimin e politikave më të mira sociale dhe shëndetësore për një prej grupeve më vulnerabël të shoqërisë sonë.

REFERENCAT

- Bali, T., & Pavlova, M. (2021). Quality of life and social participation among older adults in Southeast Europe: A comparative analysis. *Archives of Gerontology and Geriatrics*, 97, 104511. <https://doi.org/10.1016/j.archger.2021.104511>
- Bowling, A. (2009). The psychometric properties of the Older People's Quality of Life Questionnaire (OPQOL). *Current Gerontology and Geriatrics Research*, 2009.
- De Pue, S., Gillebert, C., & Delbroek, H. (2021). Active aging and psychological resilience: A systematic review. *Aging & Mental Health*, 25(7), 1234–1246.
- Forero, C. G., Gutiérrez, C., & González, M. (2022). Psychometric validation of the OPQOL in older adults across cultures. *Journal of Cross-Cultural Gerontology*, 37(3), 265–283.
- Hayes, S. C., Levin, M. E., Villatte, M., & Pistorello, J. (2021). Acceptance and Commitment Therapy in mental health. *Annual Review of Clinical Psychology*, 17, 489–517.
- INSTAT. (2023). *Popullsia e Shqipërisë dhe treguesit demografikë – Raport vjetor*. Tiranë.
- Jakovljevic, M., et al. (2022). Aging in the post-transition societies of the Western Balkans: Health challenges and social determinants. *Frontiers in Public Health*, 10, 943109. <https://doi.org/10.3389/fpubh.2022.943109>
- Karekla, M., Panayiotou, G., & Michaelides, M. P. (2019). The role of psychological flexibility in mental health across aging populations. *Journal of Contextual Behavioral Science*, 12, 33–41.
- Li, T., & Fung, H. (2022). Socioemotional selectivity in aging: New evidence in diverse cultures. *Gerontology*, 68(4), 397–408.
- López-Morales, H., et al. (2021). Psychometric properties of the GDS-15 in elderly populations. *Clinical Gerontology*, 44(5), 459–471.
- Park, S. H., Bae, J., & Kim, Y. (2020). Validation of the Geriatric Depression Scale among older adults in low-income settings. *International Psychogeriatrics*, 32(10), 1201–1212.
- Ruiz, F. J., & Odriozola-González, P. (2021). Psychological flexibility and emotional well-being in older adults: A systematic

- review. *Clinical Gerontologist*, 44(2), 99–113.
- Sheikh, J. I., & Yesavage, J. A. (1986). Geriatric Depression Scale (GDS). *Clinical Gerontology*, 5, 165–173.

INOVACIONET DIGJITALE NË PËRMIRËSIMIN E SHËNDETIT MENDOR: SFIDAT DHE MUNDËSITË

Adelina Kakija, Bujanë Topalli

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji – Punë Sociale

ABSTRACT

Në dekadat e fundit, zhvillimet teknologjike kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme mënyrën se si kujdesi për shëndetin mendor ofrohet dhe menaxhohet, duke sjellë mundësi të reja për ndërhyrje efektive dhe të personalizuar.

Qëllimi: ky studim synon të shqyrtojë rolin e inovacioneve digjitale në përmirësimin e shëndetit mendor, duke analizuar përfitimet, sfidat dhe potencialin e tyre për të ndikuar në qasjen dhe cilësinë e kujdesit mendor. Në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, përdorimi i teknologjive për shëndetin mendor ofron mundësi të reja, por gjithashtu paraqet pengesa që duhet të adresohen.

Objektivat:

1. Të identifikojë teknologjitë kryesore të përdorura për shëndetin mendor (aplikacionet, teleterapia dhe inteligjenca artificiale).
2. Të analizojë sfidat kryesore që përballen këto teknologji, si p.sh. privatësia, qasja dhe efikasiteti i trajtimeve.
3. Të shqyrtojë mundësitë që këto teknologji ofrojnë për përmirësimin e qasjes dhe personalizimit të kujdesit për shëndetin mendor.

Metodologjia: ky punim përfshin një rishikim të literaturës ekzistuese mbi inovacionet digjitale në fushën e shëndetit mendor. Janë analizuar studime të mëparshme mbi efikasitetin e aplikacioneve dhe platformave të teleterapisë, duke vlerësuar përfitimet dhe sfidat e tyre. Gjithashtu, janë shqyrtuar praktikat më të mira dhe ndërhyrjet që kanë përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara, si inteligjenca artificiale dhe chatbot-et për terapi.

Rezultatet: rishikimi tregon se inovacionet digjitale mund të përmirësojnë ndjeshëm qasjen në kujdesin mendor, sidomos për individët që përballen me barriera gjeografike dhe ekonomike. Megjithatë, sfidat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave janë të pranishme dhe kërkojnë rregullore më të forta. Gjithashtu, personalizimi i terapive përmes inteligjencës artificiale ofron potencial për përmirësim të mëtejshëm të trajtimeve, por nevojiten

studime të thelluara për të vlerësuar efektivitetin e plotë të këtyre ndërhyrjeve.

Konkluzion: inovacionet digjitale kanë potencial për të transformuar fushën e shëndetit mendor, por zbatimi i tyre kërkon një qasje të kujdesshme që merr parasysh sfidat dhe pengesat aktuale. Për të siguruar përfitime maksimale, është e nevojshme të përmirësohen qasjet në shërbime, privatësia e të dhënave dhe ndërveprimi midis teknologjisë dhe profesionistëve të shëndetit mendor.

Fjalët kyçe: *Inovacione digjitale, Shëndeti mendor, Teleterapia, Inteligjenca artificiale (AI), Privatësia, Personalizimi i trajtimeve.*

Digital Innovations in Mental Health Improvement: Challenges and Opportunities

ABSTRACT

In recent decades, technological advancements have significantly transformed the way mental health care is delivered and managed, bringing new opportunities for effective and personalized interventions.

Aim: This study aims to explore the role of digital innovations in improving mental health, analyzing their benefits, challenges, and potential to enhance access and quality of mental health care. In an increasingly digitalized world, the use of technologies for mental health offers new opportunities but also presents challenges that need to be addressed.

Objectives:

1. To identify the key technologies used in mental health (applications, teletherapy, and artificial intelligence).
2. To analyze the main challenges these technologies face, such as privacy, access, and the effectiveness of treatments.
3. To examine the opportunities these technologies offer for improving access and personalization of mental health care.

Methodology: This paper includes a review of the existing literature on digital innovations in the field of mental health. Previous studies on the effectiveness of apps and teletherapy platforms are analyzed, evaluating their benefits and challenges. Additionally, best practices and interventions involving the use of advanced technologies, such as artificial intelligence and chatbots for therapy, are reviewed.

Results: The review shows that digital innovations can significantly

improve access to mental health care, particularly for individuals facing geographic and economic barriers. However, privacy and data protection challenges are prevalent and require stronger regulations. Moreover, the personalization of therapies through artificial intelligence offers potential for further improvement of treatments, but more in-depth studies are needed to fully assess the effectiveness of these interventions.

Conclusion: Digital innovations have the potential to transform the field of mental health, but their implementation requires a careful approach that takes into account current challenges and barriers. To maximize benefits, it is necessary to improve access to services, data privacy, and the interaction between technology and mental health professionals.

Keywords: *Digital innovations, Mental health, Teletherapy, Artificial intelligence (AI), Privacy, Treatment, Personalization.*

Hyrje

Shëndeti mendor është një element thelbësor i mirëqenies së përgjithshme të individit, duke përfshirë jo vetëm dimensionet emocionale dhe psikologjike, por gjithashtu dimensionet sociale dhe shpirtërore. Problemet me shëndetin mendor, përfshirë depresionin, ankthin, çrregullimet bipolare dhe streset kronike, prekin miliona njerëz në mbarë botën. Sipas të dhënave nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), më shumë se 264 milionë njerëz vuajnë nga depresioni, ndërkohë që ankthi është gjithashtu një problem madhor global (World Health Organization, 2018).

Në një botë që përjeton ndryshime teknologjike të shpejta, teknologjitë digjitale po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në trajtimin dhe menaxhimin e çrregullimeve mendore. Përmes aplikacioneve për mirëqenie, teleterapisë dhe inteligjencës artificiale, kujdesi për shëndetin mendor është bërë më i arritshëm, më i personalizuar dhe më i përbalueshëm për shumë individë. Megjithatë, kjo epokë e re e teknologjisë nuk është pa sfida, përfshirë çështjet e qasjes, sigurisë së të dhënave dhe efektivitetit klinik.

Ky prezantim do të shqyrtojë se si aplikacionet mobile, teleterapia dhe inteligjenca artificiale po transformojnë fushën e shëndetit mendor. Ne do të eksplorojmë përfitimet që këto inovacione sjellin, sfidat që ato përballen dhe potencialin që ato kanë për të përmirësuar qasjen dhe personalizimin e trajtimeve.

Shembuj të inovacioneve digjitale në shëndetin mendor

Në këtë pjesë të studimit do të shqyrtojmë disa nga shembujt më të rëndësishëm të inovacioneve digjitale në shëndetin mendor, duke përfshirë aplikacionet mobile, teleterapinë dhe përdorimin e inteligjencës artificiale (AI). Këto teknologji kanë hapur dyert për një qasje më të aksesueshme ndaj shëndetit mendor, duke u bërë më të nevojshme në një botë gjithnjë e më të urbanizuar dhe të globalizuar.

Aplikacionet për shëndetin mendor

Aplikacionet për mirëqenien mendore kanë fituar popullaritet për shkak të aftësisë së tyre për t'u ofruar përdoruesve mundësinë për të menaxhuar vetë emocionet dhe mendimet e tyre në mënyrë autonome. Aplikacione të tilla si Headspace, Calm dhe Moodpath janë zhvilluar për të trajtuar çrregullimet emocionale dhe stresin përmes meditimit, relaksimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të simptomave mendore.

- Headspace është një nga aplikacionet më të njohura për meditim dhe vetëdijësim (mindfulness). Aplikacioni ofron një seri sesione të udhëzuara mbi meditimin dhe teknikat e frymëmarrjes, të dizajnuara për të ndihmuar përdoruesit të menaxhojnë stresin dhe ankthin. Në një studim të kryer nga Bostock et al., (2019), pjesëmarrësit që përdorën Headspace për një periudhë katërjavore raportuan një reduktim prej 32% të niveleve të tyre të stresit dhe një rritje të përgjithshme të mirëqenies.
- Calm, një tjetër aplikacion i njohur për mirëqenien mendore, fokusohet më shumë në përmirësimin e gjumit dhe qetësimin e mendjes përmes tregimeve për gjumë, muzikës qetësuese dhe meditimit të udhëzuar. Një studim nga Forbes (2020) tregoi se Calm është përdorur me sukses në spitalet pediatrike për të ndihmuar fëmijët të përballen me ankthin para operacioneve, duke treguar një reduktim të konsiderueshëm të frikës dhe stresit para procedurave mjekësore.
- Moodpath është një tjetër aplikacion që përdor teknologjinë për të monitoruar shëndetin mendor të përdoruesve përmes pyetësorëve të përditshëm që vlerësojnë humorin dhe simptomat e depresionit dhe ankthit. Aplikacioni përdor algoritme për të sugjeruar ndërhyrje të bazuara në rezultate të personalizuar për çdo përdorues, duke ndihmuar në identifikimin e hershëm të çrregullimeve mendore dhe ofrimin e këshillave për përmirësim.

Teleterapia

Teleterapia ka ndihmuar në përmbushjen e një nevoje të madhe për qasje në terapinë mendore për njerëzit që jetojnë në zona të izoluara ose që kanë vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve tradicionale të shëndetit mendor.

BetterHelp dhe Talkspace janë dy nga platformat më të njohura të teleterapisë, të cilat ofrojnë terapi online përmes videokonferencave, mesazheve dhe telefonatave.

- BetterHelp ka ndihmuar mijëra pacientë që jetojnë në zona të largëta të SHBA dhe të Kanadasë, ku qasja në shërbimet tradicionale të shëndetit mendor është e kufizuar. Një grua nga një zonë rurale e Alaskës, që vuante nga depresioni i rëndë, raportoi përmirësim të ndjeshëm përmes sesioneve të teleterapisë që ofrohen nga BetterHelp. Platforma i dha asaj fleksibilitet për të marrë ndihmë pa pasur nevojë të udhëtojë dhe pa kosto shtesë (Gentry et al., 2019).

- Gjatë pandemisë COVID-19, Talkspace ka shërbyer si një kanal mbështetjeje për shumë individë që përjetuan rritje të ankthit dhe depresionit për shkak të izolimit. Një punonjës i shëndetit në Nju Jork, i cili përdori Talkspace për të marrë mbështetje gjatë pandemisë, raportoi përmirësime të dukshme në menaxhimin e stresit dhe ankthit, duke përdorur teknikat e sugjeruara nga terapisti i tij përmes platformës online.

Inteligjenca artificiale në terapinë digjitale

Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në terapinë digjitale po bëhet gjithnjë e më popullor, duke ofruar një mënyrë të personalizuar për të monitoruar dhe trajtuar çrregullimet mendore. Woebot dhe Wysa janë dy shembuj të chatbot-ëve të bazuar në AI që ofrojnë mbështetje përmes bisedave në kohë reale, duke u bazuar në teknika të terapisë njohëse dhe të sjelljes (CBT).

- Woebot përdor AI për të ndihmuar përdoruesit në menaxhimin e ankthit dhe stresit përmes ndërveprimit të personalizuar. Në një studim të kryer nga Fitzpatrick et al. (2017), studentët universitarë që përdorën Woebot për dy javë raportuan një përmirësim të ndjeshëm në aftësitë e tyre për të menaxhuar emocionet negative dhe për të shmangur reagimet impulsive gjatë provimeve.

- Wysa, një tjetër chatbot i bazuar në AI, përdoret gjerësisht nga profesionistët që përjetojnë stres të lartë në vendin e punës. Një rast konkret përfshin një punonjës në sektorin e teknologjisë që përjetonte ankth dhe sulme paniku për shkak të afateve të ngushta në punë. Ai raportoi përmirësime të dukshme në menaxhimin e ankthit dhe përqendrimin, duke përdorur teknikat e sugjeruara nga Wysa për frymëmarrje dhe relaksim (Forbes, 2020).

Si po shfaqen inovacionet digjitale në Ballkanin Perëndimor

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, inovacionet digjitale në shëndetin mendor janë në zhvillim, por përballen me disa sfida dhe vonesa në krahasim me vendet më të avancuara teknologjikut. Këtu është një përmbledhje e mënyrës se si shfaqen dhe përdoren teknologjitë digjitale në shëndetin mendor në këtë rajon:

1. Aplikacionet mobile për shëndetin mendor

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, aplikacionet për shëndetin mendor nuk janë ende aq të përhapura dhe të njohura sa në vendet perëndimore. Megjithatë, ka një rritje të interesit për përdorimin e aplikacioneve mobile që ndihmojnë individët të menaxhojnë stresin, ankthin dhe depresionin përmes meditimit dhe teknikave të relaksimit. Headspace, Calm, si dhe aplikacione të tjera ndërkombëtare përdoren nga një numër gjithnjë në rritje përdoruesish, kryesisht të rinj dhe profesionistë, të cilët janë të njohur me teknologjinë dhe kanë akses të qëndrueshëm në internet.

Në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor ka një mungesë të aplikacioneve të zhvilluara në mënyrë specifike për kulturën dhe gjuhën lokale. Shumica e aplikacioneve të përdorura janë të përkthyer ose janë produkte ndërkombëtare. Për më tepër, ekzistojnë disa përpjekje për të zhvilluar aplikacione lokale për të ndihmuar popullatën me çështje të shëndetit mendor, por ato nuk janë shumë të përhapura për shkak të mungesës së investimeve në teknologji dhe shëndetësi digjitale.

2. Teleterapia

Teleterapia ka filluar të përdoret gjithnjë e më shumë në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht pas pandemisë COVID-19. Gjatë pandemisë, shumë psikologë dhe terapistë u detyruan të kalojnë në ofrimin e shërbimeve përmes platformave online, si: Zoom, WhatsApp, dhe Skype, për të vazhduar terapinë me pacientët. Në Shqipëri dhe Kosovë, kjo praktikë u bë e zakonshme, veçanërisht për njerëzit që nuk mund të shkonin fizikisht në seanca për shkak të kufizimeve të vendosura nga pandemia.

Ky studim synon të eksplorojë dimensionet emocionale dhe sfidat praktike të përjetuara nga prindërit e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik (ÇSA), me fokus të veçantë të përjetimi i ankthit, burimet që e ndikojnë atë dhe strategjitë e përballimit në kontekstin shqiptar. Kërkimi synon të kuptojë më mirë ndikimin e diagnozës së ÇSA mbi mirëqenien prindërore, rolin e mbështetjes institucionale dhe financiare, si dhe pasojat e paragjytimeve sociale mbi jetën e përditshme të familjeve.

Pyetjet kërkimore

- Cilat janë përvojat emocionale të prindërve kur marrin diagnozën e autizmit për fëmijën e tyre dhe si e menaxhojnë ata këtë situatë?
- Cilat janë sfidat kryesore që përballen prindërit e fëmijëve me autizëm në jetën e përditshme pas diagnozës?
- Sa e rëndësishme është mbështetja financiare në aftësinë e prindërve për të ofruar terapi dhe trajtime të nevojshme për fëmijët me autizëm?
- Cilat janë efektet e paragjytimeve dhe qëndrimeve shoqërore mbi përvojat dhe mirëqenien emocionale të prindërve të fëmijëve me autizëm?

Metodologjia

Ky studim aplikoi një qasje kërkimore cilësore brenda paradigmës interpretuese, duke synuar të eksploronte përvojat e jetuara të prindërve të fëmijëve të diagnostikuar me çrregullim të spektrit autik (ÇSA). Një qasje cilësore u konsiderua e përshtatshme duke pasur parasysh natyrën eksploruese të studimit dhe fokusin e tij në dimensionet emocionale e sociale të përvojës prindërore, të cilat nuk janë lehtësisht të matshme me indikatorë sasiorë standard (Creswell, 2013; Denzin & Lincoln, 2011). Duke i dhënë përparësi kuptimit subjektiv të përjetimeve, ky dizajn kërkimor synoi të kapte thellësinë dhe kompleksitetin e botës psikologjike dhe sociale së këtyre prindërve.

Pjesëmarrësit

Për t'u përfshirë në studim, prindërit duhej të ishin kujdestarët kryesorë (prindër biologjikë) të të paktën një fëmije me një diagnozë zyrtare të ÇSA. Në total, morën pjesë 12 prindër të tillë, përkatësisht 7 nëna dhe 5 baballarë, që kujdeseshin për fëmijët e tyre me autizëm në Shqipëri. Të gjithë ishin prindër biologjikë dhe secili fëmijë kishte një diagnozë të konfirmuar klinikisht të ÇSA. Moshat e prindërve varionin nga rreth 25 vjeç deri në mbi 45 vjeç (me pjesën më të madhe në të tridhjetat dhe dyzetat), ndërsa moshat e fëmijëve me autizëm varionin nga 2 deri në 15

vjeç. Pjesëmarrësit vinin nga një spektër i gjerë socio-arsimor: shumica kishin arsim të mesëm (dhe një pjesë e tyre arsim universitar) dhe të gjithë ishin të punësuar me kohë të plotë.

Tabela 1. *Përmbledhje të karakteristikave demografike kryesore të prindërve pjesëmarrës.*

Kategoria	Nënkategoria	n
Moshë e prindërve	25–35 vjeç	4
	36–45 vjeç	6
	Mbi 45 vjeç	2
Gjinia	Femër	7
	Mashkull	5
Niveli arsimor	Shkollë e mesme	8
	Diplomë universitare	4
	Master ose më lart	0
Statusi martesor	Të martuar	9
	Të divorcuar	2
	Të ve	1
Numri i fëmijëve në familje	Një fëmijë	3
	Dy fëmijë	6
	Tre ose më shumë fëmijë	3
Moshë e fëmijës me ÇSA	2–5 vjeç	5
	6–10 vjeç	4
	11–15 vjeç	3
Statusi i punësimit	Të punësuar me kohë të plotë	12

Procedura e përzgjedhjes

U zbatua një strategji kampionimi të qëllimshëm për rekrutimin e pjesëmarrësve, një metodë joprobabiliste që lejon përzgjedhjen e rasteve me përvojë direkte në fenomenin e studiuar (Patton, 2015). Praktikisht, kampioni përbëhej nga prindër të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme nga ata që ishin të arritshëm përmes rrjeteve ekzistuese të kujdesit, një kampion i leverdisshëm. Rekrutimi u lehtësua në bashkëpunim me një mjek pediatër të specializuar në çrregullimet e zhvillimit, i cili fillimisht informoi prindërit potencialë rreth qëllimit dhe procedurave të studimit. Kjo qasje siguronte transparencë dhe u jepte mundësi kandidatëve të merrnin një

vendim për pjesëmarrjen. Pas shprehjes së interesit, prindërit u kontaktuan për të planifikuar intervistën. Të gjithë pjesëmarrësit dhanë pëlqimin e informuar me shkrim përpara fillimit të intervistave, dhe u garantua ruajtja strikte e konfidencialitetit gjatë gjithë procesit.

Gjatë për zgjedhjes u zbatua edhe një kriter bazë për përjashtim: në studim nuk u përfshinë prindër të cilët nuk ishin të përfshirë drejtpërdrejt në kujdesin e përditshëm të fëmijës ose raste kur fëmija nuk kishte një diagnozë zyrtare të konfirmuar. Këto kritere siguruan që kampioni të përfaqësonte pikërisht *target-grupin* e synuar, prindër aktivë në rritjen e një fëmije me autizëm dhe me përvoja konkrete lidhur me sfidat e kësaj situate.

Mbledhja e të dhënave

Intervistat gjysmë të strukturuar u zhvilluan ballë për ballë me secilin pjesëmarrës, kryesisht në qytetet Tiranë dhe Shkodër. Secili prind u takua në një mjedis të qetë, në një ambient privat pranë një qendre terapeutike, me qëllim krijimin e një atmosfere komode dhe konfidenciale për bisedën. Kjo metodë u zgjodh për fleksibilitetin dhe thellësinë e saj, duke i lejuar pjesëmarrësit të artikulonin lirisht përvoja komplekse emocionale e sociale me fjalët e tyre (Kvale & Brinkmann, 2009).

U përdor një udhëzues intervistimi gjysmë i strukturuar, i hartuar mbi bazën e një shqyrtimi të literaturës dhe i fokusuar te temat kryesore të studimit. Udhëzuesi përmbante rreth 8 pyetje kryesore të hapura, që adresonin shtyllat tematike si më poshtë:

Reagimet emocionale ndaj diagnozës së ÇSA – p.sh. “*Si u ndjetë kur mësuat diagnozën e fëmijës tuaj?*”

Sfidat e përditshme të kujdesit dhe sjelljet adaptive – p.sh. “*Cilat janë vështirësitë më të mëdha që hasni çdo ditë në kujdesin ndaj fëmijës?*”

Shqetësimet financiare për aksesin në trajtim – p.sh. “*A merrni ndonjë ndihmë financiare dhe si ndikon ajo në mundësinë për të siguruar terapitë e nevojshme?*”

Përvojat e stigmës dhe përjashtimit social – p.sh. “*Si ju kanë trajtuar njerëzit përreth pas diagnozës së fëmijës? A keni ndier ndonjëherë stigmatizim ose mospërfshirje?*”

Pyetjet e mësipërme ishin të hapura dhe u pasuan nga pyetje shtesë sipas nevojës, në mënyrë që pjesëmarrësit të thellonin rrëfimet e tyre. Intervistat individuale zgjatën mesatarisht **35–45** minuta secila. Me lejen e prindërve, bisedat u regjistruan dhe më pas u transkriptuan fjalë për fjalë për analizë të mëtejshme.

Përveç të dhënave narrative, u mbledhën edhe informacione demografike për secilin pjesëmarrës për të kontekstualizuar gjetjet: gjinia,

mosha, niveli arsimor, statusi martesor, statusi i punësimit, mosha e fëmijës me ÇSA dhe kohëzgjatja e periudhës që nga diagnostikimi i fëmijës. Po ashtu, u dokumentua nëse familja merrte ndonjë mbështetje financiare institucionale të lidhur me aftësinë e kufizuar të fëmijës (p.sh. pagesë mujore invaliditeti nga shteti). Ky informacion u mblodh me qëllim që në analizë të mund të merrej parasysh roli i faktorëve ekonomikë, duke lejuar një krahasim kontekstual midis përvojave të familjeve që merrnin ndihmë financiare dhe atyre që nuk merrnin.

Konsiderata etike

Studimi u zhvillua në përputhje me standardet etike ndërkombëtare për kërkimin me pjesëmarrës njerëzor (p.sh. Deklarata e Helsinkit dhe udhëzimet profesionale përkatëse), dhe të gjithë pjesëmarrësit dhanë pëlqimin e informuar përpara përfshirjes në studim. Para pjesëmarrjes, të gjithë prindërit u pajisën me një fletë informuese të shkruar që shpjegonte qëllimin dhe procedurat e studimit, masat e konfidencialitetit, natyrën vullnetare të pjesëmarrjes, si dhe të drejtën për t'u tërhequr nga studimi në çdo moment. Pasi u siguroi që pjesëmarrësit e kishin kuptuar këtë informacion, ata dhanë pëlqimin e informuar me shkrim. Gjatë gjithë procesit, anonimatit dhe privatësia e pjesëmarrësve u garantuan duke përdorur pseudonime në vend të emrave të tyre realë në transkriptet dhe materialet e hulumtimit.

Analiza e të dhënave

Të dhënat cilësore u interpretuan duke ndjekur analizën tematike, sipas procedurës së strukturuar të përshkruar nga Braun dhe Clarke (2006). Fillimisht, intervistat e regjistruara u transkriptuan verbatim dhe u verifikua saktësia e transkriptimeve. Më pas, analiza vazhdoi sipas gjashtë fazave të analizës tematike: (1) familjarizimi me të dhënat, (2) krijimi i kodeve fillestare, (3) kërkimi i temave, (4) rishikimi i temave, (5) përcaktimi/emërtimi i temave dhe (6) hartimi i raportit përfundimtar të rezultateve. Për menaxhimin e transkripteve dhe lehtësimin e procesit të kodimit u përdor softueri **ATLAS.ti** (Friese, 2014), i cili mundësoi kodim të strukturuar, kategorizimin e modeleve dhe vizualizimin e hartave tematike, duke rritur kështu transparencën.

Për të rritur besueshmërinë dhe vlefshmërinë e analizës, kodimi u krye fillimisht nga të dy kërkuesit në mënyrë të pavarur. Të dy kërkuesit kodifikuan një pjesë të transkripteve dhe më pas krahasuan në mënyrë sistematike kodet e tyre. Çdo mospërputhje në emërtimin apo interpretimin e kodeve u diskutua deri sa u arrit konsensus për një skemë të unifikuar

kodimi. Ky proces i kodimit paralel shërbeu si një mekanizëm kontrolli, duke reduktuar subjektivitetin individual dhe duke siguruar që temat e identifikuar të kishin mbështetje të qëndrueshme në të dhëna.

Procesi i kodimit në vetvete ishte kryesisht induktiv (i udhëhequr nga vetë të dhënat) dhe përsëritës. Secili transkript u lexua fillimisht në tërësi për t'u familjarizuar me narrativën e prindërve, e më pas u krye një lexim i imtësishëm, rresht më rresht. Gjatë këtij leximi analitik, u zhvillua një listë e gjerë kodesh duke përfshirë kode përshkruese (p.sh. për emocionet e shprehura, për sfidat konkrete) dhe kode interpretuese (p.sh. për domethënien pas veprimeve apo qëndrimeve të prindërve). Këto kode pasqyronin elementët kryesorë të përmendur nga pjesëmarrësit, si gjendjet emocionale, sfidat praktike dhe dinamikat sociale.

Kodet e ngjashme ose të lidhura me njëra-tjetrën u grupuan më pas në kategori më të gjera, një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të temave. Gjatë analizës, u mbajtën edhe memo analitike dhe u përdorën mjetet vizuale të ATLAS.ti për të eksploruar marrëdhëniet midis kodeve, gjë që mundësoi një reflektim më të thellë me të dhënat.

Më poshtë paraqiten shembuj të kodeve dominuese të dala nga intervistat, së bashku me frekuencën e shfaqjes së tyre në të gjithë kampionin:

Mungesa e të kuptuarit nga të tjerët (n = 16)

Izolimi (n = 12)

Ndjenja e mbingarkesës (n = 11)

Mbështetje e singertë nga të tjerët (n = 10)

Menaxhimi i krizave (n = 8)

Qasje e vonuar në terapi (n = 8)

Depresioni (n = 8)

Vetmia (n = 8)

Këto kode u ristrukturuan dhe u konsoliduan në tema kryesore duke grupuar së bashku kodet e lidhura konceptualisht, në përputhje me pyetjet kërkimore. Secila temë e identifikuar u rishikua për koherencë të brendshme (p.sh. që fragmentet e cituara brenda një teme të përshtaten logjikisht së bashku) dhe diferencim nga temat e tjera. Në fazën përfundimtare të analizës, u përpilua një përmbledhje për secilën temë duke listuar përkufizimin e temës, citate përfaqësuese nga prindërit dhe frekuencën e përmendjes së temës me qëllim që gjetjet të prezantoheshin në mënyrë sa më të qartë e të verifikueshme.

Gjatë analizës, iu kushtua vëmendje e veçantë rolit të mbështetjes financiare në përvojat prindërore. U ekzaminua posaçërisht nëse kishte dallime domethënëse në temat ose qëndrimet e shprehura nga prindërit që

merrnin ndihmë financiare institucionale (si p.sh. pagesë invaliditeti për fëmijën) krahasuar me ata që nuk merrnin një mbështetje të tillë. Ky hap krahasues brenda kampionit synoi të ndihmonte në ndriçimin e ndikimit specifik që faktorët ekonomikë kishin në sfidat dhe mënyrat e përballimit të prindërve një aspekt kyç i studimit. Edhe pse kampioni ishte i vogël, përfshirja e kësaj perspektive krahasuese siguroi që roli i mbështetjes financiare të adresohet në mënyrë sistematike gjatë interpretimit të rezultateve.

Temat u zhvilluan duke grupuar kodet përkatëse në kategori konceptuale që korrespondojnë me pyetjet kërkimore. Një përmbledhje e temave, citateve mbështetëse dhe frekuencës së shfaqjes u përpilua për të paraqitur qëndrueshmërinë e gjetjeve.

Tema 1: Ndikimi emocional i marrjes së diagnozës

Pjesëmarrësit raportuan reagime intensive emocionale pas marrjes së diagnozës së fëmijës së tyre. Reagimet e zakonshme përfshinin tronditje, trishtim, pafuqi dhe ankth afatgjatë në lidhje me të ardhmen e fëmijës. Kode, të tilla si: depresioni, ndjenja e mbingarkesës dhe vetmia ishin veçanërisht të përhapura.

"Kur mësova diagnozën, ndjeva sikur gjithçka që dija dhe prisja për të ardhmen e fëmijës tim u shemb." Pjesëmarrësi 1

"Nuk mund ta besoja atë që dëgjova. Ishte një tronditje e thellë dhe një trishtim që nuk mund ta përshkruaj me fjalë, që nuk kalon asnjëherë." Pjesëmarrësi 3

Veçanërisht, disa prindër raportuan përshtatje dhe qëndrueshmëri graduale emocionale me kalimin e kohës, duke përmendur burime mbështetjeje si grupet e bashkëmoshatarëve dhe këshillimi profesional:

"Grupet mbështetëse të prindërve me të njëjtin hall ishin një litar shpëtimi. Gjeta njerëz që kuptonin pa pasur nevojë të shpjegoja shumë." Pjesëmarrësi 11

Tema 2: Kujdesi i përditshëm dhe sfidat

Të intervistuarit identifikuan sfida të rëndësishme në menaxhimin e përgjegjësisë të tyre të përditshme, duke filluar nga lodhja emocionale deri te koha dhe energjia e kufizuar. Disa pjesëmarrës diskutuan se si barra e caktimit të terapisë, puna emocionale dhe tendosja në marrëdhëniet familjare ndikuan në jetën familjare:

"Pas diagnozës, çdo minutë e ditës ishte e mbushur me takime dhe terapi. Nuk kishte kohë të mbetur për veten tonë ose për njëri-tjetrin."

Pjesëmarrësi 1

Kjo temë përfshinte kode, të tilla si: koha dhe energjia e kufizuar, kostoja e terapive dhe marrëdhëniet e tensionuara, të cilat ilustronin se si kujdesi përshkonte strukturën e jetës së përditshme.

Tema 3: Roli i mbështetjes financiare

Qasja në terapi ishte e lidhur ngusht me stabilitetin financiar. Shumë pjesëmarrës theksuan se ndihma shtetërore ishte e pamjaftueshme, duke i detyruar ata të bënin zgjedhje të vështira në lidhje me ndërhyrjet që duhet të ndiqnin:

"Mbështetja financiare që marrim nuk është e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kostot e terapisë. Ne duhet të paguajmë shumë nga xhepi ynë."

Pjesëmarrësi 2

Kode, të tilla si: ndihma e pamjaftueshme shtetërore, kostot e terapisë dhe stresi financiar ilustronjë kryqëzimin e vështirësive ekonomike me ofrimin e kufizuar të shërbimeve. Disa pjesëmarrës kishin përdorur kredi ose ndihmë nga të afërm për të vazhduar trajtimin e fëmijës së tyre.

Tema 4: Stigma sociale dhe mirëqenia prindërore

Së fundmi, prindërit shpesh i referoheshin ndikimit të qëndrimeve shoqërore në mirëqenien e tyre emocionale. Stigmatizimi, keqardhja nga të tjerët dhe përjashtimi social ishin përvoja të përshkruara zakonisht:

"Sa herë që jam jashtë me fëmijën tim, ndihem e stigmatizuar. Njerëzit na shikojnë sikur kemi bërë diçka gabim."

Pjesëmarrësi 3

Kode, të tilla si: stigmatizimi, mungesa e të kuptuarit dhe izolimi shoqëroreshin vazhdimisht me integrim të reduktuar shoqëror dhe lodhje emocionale. Puna emocionale e përfshirë në menaxhimin e perceptimit publik e përkeqësoi barrën ekzistuese të kujdesit.

"Na është dashur të tërhiqemi nga shoqëria sepse nuk ndihemi të pranuar. Ky izolim është i rëndë për ne."

Diskutime

Gjetjet e këtij studimi hedhin dritë mbi barrën komplekse emocionale, sociale dhe praktike që prindërit e fëmijëve me ÇSA përballojnë çdo ditë. Në përputhje me literaturën ekzistuese, prindërit pjesëmarrës në këtë studim përjetuan nivel të lartë stresi prindëror, izolim social dhe sfida financiare gjatë rritjes së fëmijës me autizëm. Këto rezultate pasqyrojnë konstatimet e studimeve të mëparshme në vende të ndryshme, të cilat kanë dokumentuar se prindërit e fëmijëve me ÇSA jetojnë shpesh "në një botë më vete", të shkëputur nga jeta e zakonshme sociale (Woodgate, Ateah &

Secco, 2008). Gjetjet tona për izolimin dhe ndjenjën e “rrugëtimit vetëm” janë veçanërisht të ngjashme me përshkrimin hermeneutik të Woodgate et al. (2008), ku prindërit raportuan vetminë dhe rolin vigjilent prindëror teksa “luftonin në çdo hap” me sistemet shëndetësore dhe arsimore për të siguruar shërbimet e nevojshme.

Ndikimi emocional i marrjes së diagnozës

Reagimi emocional pas marrjes së diagnozës së fëmijës me çrregullim të spektrit autik përfaqëson një temë qendrore në këtë studim, duke u karakterizuar nga ndjenja të forta tronditjeje, trishtimi dhe ankthi për të ardhmen. Këto përjetime fillestare gjejnë mbështetje në literaturën ekzistuese. Për shembull, Altieri dhe von Kluge (2009) identifikuan te prindërit ndjenja të thella izolimi dhe dëshpërimi, të ndërlidhura me përpjekjet për të gjetur pranimin e familjes dhe shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, Alimohamadi et al., (2024) përshkruajnë në një rishikim narrativ procesin emocional të prindërve si një formë të “zisë” (edhe pse fëmija është gjallë), një përvojë e vazhdueshme dhe ciklike humbjeje që karakterizohet nga valë të përsëritura trishtimi, zhgënjimi dhe rinegociimi të pritshmërive. Autorët theksojnë se ky proces rrallëherë përfundon me një “mbyllje” emocionale dhe se kuptimi i tij është thelbësor për zhvillimin e ndërhyrjeve që adresojnë nevojat afatgjata të mirëqenies së prindërve. Në përputhje me këto gjetje, rezultatet tona treguan se për shumicën e pjesëmarrësve, procesi i pranimit ishte i zgjatur dhe emocionalisht sfidues, shpesh i shoqëruar me tensione familjare dhe ndjenja të vazhdueshme pasigurie. Megjithatë, disa prindër raportuan se me kalimin e kohës kishin zhvilluar mekanizma më të fortë përballimi dhe arritën njëfarë pajtimi me realitetin e ri pas diagnozës. Ky evolucion emocional përputhet me rezultatet e Da Paz et al., (2018), të cilët zbuluan se nënat që arrijnë nivele më të larta pranimi pas diagnozës raportojnë më pak simptoma depresive dhe një mirëqenie më të qëndrueshme psikologjike. Në të kundërt, qëndrimi në faza të zgjatura të trishtimit dhe dëshpërimit lidhet me ngarkesë më të madhe emocionale dhe rrezik më të lartë për çrregullime të shëndetit mendor.

Kujdesi i përditshëm dhe sfidat

Sfidat e përditshme të kujdesit dhe stresi prindëror ishin një tjetër aspekt madhor i rezultateve tona, i karakterizuar nga lodhja e vazhdueshme, menaxhimi i sjelljeve sfiduese dhe koordinimi i terapive të shumta. Çdo ditë e prindërve të intervistuar ishte e strukturuar rreth nevojave të fëmijës,

shpesh në dëm të kujdesit për veten ose marrëdhënieve martesore. Kjo përputhet me gjetjet e shumta që tregojnë se prindërit e fëmijëve me ÇSA raportojnë nivele të rritura të stresit dhe kaosit familjar (Karst & Van Hecke, 2012; Hayes & Watson, 2013). Meta-analiza e Hayes & Watson (2013) konfirmon se stresi prindëror, simptomat depresive dhe ankthi janë dukshëm më të larta tek këta prindër sesa tek prindërit e fëmijëve pa çrregullime zhvillimore. Në studimin tonë, ashtu si në literaturë, ky stres buronte nga kërkesat e shtuara të kujdesit ditor dhe nga mungesa e mbështetjes së duhur institucionale. Disa nëna pohuan se ndiheshin të mbingarkuara dhe të izoluara, pasi përballimi i krizave të shpeshta të fëmijës dhe oraret e stërmbushura të terapive nuk linin kohë për jetën personale. Studime cilësore në kultura të ndryshme kanë gjetur tablo të ngjashme: prindërit me fëmijë me ÇSA kanë raportuar se rutina e përditshme e kujdesit për fëmijën autik shoqërohet me lodhje ekstreme fizike e emocionale, ndërsa normat kulturore dhe mangësitë institucionale mund t'i bëjnë ata hezitues në kërkimin e ndihmës (Wang, Michaels & Day, 2011; Rfat, Koçak & Uzun, 2023). Këto rezultate janë në harmoni edhe me rishikimin e gjerë të Čolić et al. (2022) mbi Evropën Lindore, i cili identifikoi se vonesat diagnostike, mungesa e shërbimeve të specializuara dhe barrierat strukturore e kulturore i shtojnë ndjeshëm vështirësitë e jetës së përditshme të këtyre familjeve. Përballë këtyre sfidave, prindërit e studimit tonë treguan gjithashtu aftësi të ndryshme përballuese.

Roli i mbështetjes financiare

Barrierat financiare dhe strukturore dolën në pah si një nga pengesat më të mëdha që prindërit përjetojnë në përpjekjen për të siguruar kujdesin e nevojshëm dhe cilësor për fëmijët me Çrregullim të Spektrit Autik. Gjatë intervistave, pjesëmarrësit raportuan kosto jashtëzakonisht të larta për terapitë thelbësore, si: logopedia, terapia okupacionale dhe ndërhyrjet e analizës së sjelljes së aplikuar, të cilat shpesh tejkalojnë mundësitë ekonomike të familjeve. Përballë këtyre kostove, mbështetja nga shteti apo mbulimi nga sigurimet shëndetësore rezulton të jetë minimal ose inekzistent. Në disa raste, prindërit ishin të detyruar të reduktonin orët e punës apo të ndërprisnin krejtësisht angazhimin profesional për t'u përkujdesur për fëmijën, duke e përkeqësuar më tej situatën e tyre financiare.

Këto gjetje janë në përputhje me analizën e Liao dhe Li (2020), të cilët evidentojnë se barrat ekonomike të kujdesit për një fëmijë me autizëm janë të konsiderueshme në shkallë globale. Autorët përmendin jo vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta për ndërhyrjet mjekësore dhe rehabilituese, por

edhe kostot shtesë arsimore dhe humbjen e të ardhurave për shkak të kufizimit në pjesëmarrjen në tregun e punës. Në mungesë të mekanizmave efektivë të mbështetjes institucionale, familjet rrezikojnë të përballen me pasiguri ekonomike afatgjata, gjë që shton stresin psikologjik dhe emocional të prindërve (Sharpley et al., 1997).

Të dhënat nga studimi ynë e ilustrojnë qartë këtë realitet: për shkak të mungesës së subvencioneve shtetërore ose alternativave publike, disa familje u detyruan të bëjnë zgjedhje të dhimbshme mes nevojës dhe përballueshmërisë. Një nënë rrëfeu se ishte e detyruar të ndërpriste një terapi që kishte rezultuar efektive për fëmijën e saj, për shkak të kostove të papërballueshme. Kjo përvojë pasqyron gjetjet e Thomas et al., (2007), të cilët theksuan se mungesa e mbështetjes institucionale i ekspozon familjet ndaj cenueshmërisë financiare kur përballen me barrën komplekse të autizmit.

Gjetje të ngjashme janë raportuar në nivel rajonal. Një studim në Evropën Juglindore tregon se shumë prindër përjetojnë vështirësi serioze në sigurimin e ndërhyrjeve të hershme dhe se barra financiare mbetet jashtëzakonisht e lartë (Zorčec, 2019). Po ashtu, rishikimi i Čolić et al. (2022) për vendet e Evropës Lindore vëren se mungesa e shërbimeve publike të specializuara dhe e mbështetjes financiare institucionale e zhvendos përgjegjësinë e kujdesit të familja, duke thelluar më tej pabarazitë sociale dhe duke kontribuar në një cikël të pasigurisë socio-ekonomike.

Stigma sociale dhe mirëqenia prindërore

Mungesa e mirëkuptimit nga komuniteti ishte një tjetër faktor që kontribuonte në izolimin social të familjeve tona. Pjesëmarrësit shpesh përshkruan ndjenja turpi ose gjykimi në ambientet publike, kur sjelljet e fëmijës së tyre keqkuptoheshin nga të tjerët. Kjo i ka shtyrë disa familje të kufizojnë ndërveprimet shoqërore, duke u tërhequr në një rreth të ngushtë për të shmangur paragjykimet. Fatkeqësisht, fenomeni i stigmatizimit ndaj familjeve që rrisin fëmijë me aftësi të kufizuara zhvillimore është i dokumentuar gjerësisht. Yip & Chan (2022) raportojnë se stigma publike, si dhe “stigma me hua” (kur turpi i shoqërisë ndaj fëmijës reflektohet te prindi), lidhen me rritje të niveleve të stresit dhe shqetësimit emocional tek prindërit. Gjetjet tona e ilustrojnë këtë lidhje: prindërit më të izoluar nga ana shoqërore ishin shpesh ata që përjetonin edhe nivelin më të lartë të stresit e ankthit, duke qenë se mungesa e mbështetjes shoqërore kombinohej me ndjesinë e gjykimit nga jashtë. Për më tepër, stigma e vazhdueshme mund të kontribuojë në djegien emocionale tek prindërit. Sipas Gülbetkin, Kardaş Özdemir & Aşut (2024), stigmatizimi shoqëror ka

një efekt të drejtpërdrejtë në rritjen e burnout-it prindëror, por edhe një efekt të tërthortë nëpërmjet rritjes së stresit kronik. Kjo sugjeron se ndërhyrjet duhet të synojnë dy fronte: uljen e stigmatizimit në komunitet dhe fuqizimin e prindërve me mekanizma përballues të stresit. Një strategji premtuese në nivel individual mund të jetë trajnimi i prindërve në teknika të vëmendjes së ndërgjegjshme, pasi është gjetur se mindfulness-i si tipar personal mund ta zbusë ndikimin negativ të stigmatizimit të mirëqenia psikologjike e prindërve (Yip & Chan, 2022).

Kontributet dhe risitë e studimit

Studimi ynë jep kontribut të veçantë duke shtuar njohuri të thelluara rreth përvojës prindërore të autizmit në një kontekst që deri më sot ka qenë pak i hulumtuar. Gjetjet tona konfirmojnë se, pavarësisht kontekstit, thelbi i sfidave prindërore në autizëm mbetet universal si izolimi social, stresi kronik, sfidat financiare dhe nevoja për mbështetje, por njëkohësisht nxjerrin në pah nuancat lokale, si p.sh. ndikimin e faktorëve kulturorë dhe boshllëqet specifike në sistemin tonë të kujdesit. Në aspektin metodologjik, qasja jonë cilësore me intervista na lejoi të kapnim dimensionet emocionale e përvoja që shpesh anashkalohen nga studimet sasiore. Gjithashtu, duke përfshirë si nëna ashtu edhe baballarë në mostër, studimi ofron një pamje më gjithëpërfshirëse të dinamikave familjare një aspekt që shpesh është neglizhuar, pasi shumë kërkime fokusohen kryesisht te nënat.

Kufizimet

Një kufizim kryesor i këtij studimi lidhet me madhësinë e kampionit dhe përbërjen e tij. Kampioni është relativisht i vogël dhe i rekrutuar kryesisht nga zona urbane, gjë që e kufizon fuqinë e përgjithësimin të gjetjeve për të gjithë popullatën e prindërve në Shqipëri, veçanërisht për ata që jetojnë në zona rurale, ku mund të shfaqen profile të ndryshme nevojash dhe sfidash. Po ashtu, dizajni kualitativ pa grup krahasimi nuk lejon të përcaktohet në mënyrë të qartë se në çfarë mase përvojat e raportuara janë specifike për prindërit e fëmijëve me autizëm, në krahasim me prindërit e fëmijëve me zhvillim tipik ose me aftësi të tjera të kufizuara. Një tjetër kufizim është i lidhur me natyrën e vetëraportuar të të dhënave, të mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar; disa prindër mund të kenë hezituar të ndajnë emocione tepër intime ose mund të kenë dhënë përgjigje në përputhje me normat dhe pritjet shoqërore.

Rekomandime dhe drejtimet e kërkimeve të ardhshme

Megjithë këto kufizime, gjetjet tona nxjerrin në pah nevojën urgjente për mbështetje më të strukturuar institucionale për familjet e fëmijëve me ÇSA. Së pari, rekomandojmë rritjen e mbështetjes financiare mujore për fëmijët me ÇSA, në mënyrë që të reflektojë më realisht kostot e terapive të specializuara. Së dyti, sugjerojmë zgjerimin e rrjetit të qendrave të trajtimit dhe të shkollave apo klasave të specializuara përtej kryeqytetit dhe qyteteve të mëdha, me synimin që shërbimet të jenë të aksesueshme për familjet në të gjitha qarqet. Së treti, theksojmë rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të strukturuar të këshillimit psikologjik për prindërit, si në format individuale ashtu edhe në kuadër të grupeve të mbështetjes, ku ata mund të ndajnë përvojat, të reduktojnë ndjenjën e izolimit dhe të forcojnë strategjitë e përballimit. Së katërti, propozojmë zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik në media dhe në komunitet, me qëllim reduktimin e stigmatizimit të autizmit dhe krijimin e një klime më përfshirëse sociale për fëmijët dhe familjet e tyre.

Në të ardhmen, studimet me kampione më të mëdha dhe me dizajne të kombinuara do të ishin të nevojshme për të vlerësuar shkallën në të cilën temat e identifikuar në këtë studim shfaqen në popullata më të gjera dhe për të eksploruar lidhjet e tyre me variabla të tillë si niveli i funksionimit të fëmijës, karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të familjes, si dhe aksesin në shërbime. Kjo do të mundësonte ndërtimin e një baze më fortë të dhënash për hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve përkatëse.

PËRFUNDIME

Në përfundim, prindërit e fëmijëve me Çrregullim të Spektrit Autik (ÇSA) përballen me një ngarkesë të shumëfishtë që prek çdo aspekt të jetës familjare: emocionale (nga tronditja e diagnozës të ciklet e përsëritura të stresit, ankthit dhe shpesh edhe ndjenjave të fajit apo pikëllimit për jetën e imagjinuar për fëmijën), praktike dhe sociale (sfidat e kujdesit të përditshëm, mungesa e shërbimeve adekuate arsimore e terapeutike, lufta për të siguruar mbështetje institucionale dhe pranimin shoqëror), si edhe financiare (kostot e papërballueshme të trajtimeve dhe mbështetja e pamjaftueshme ekonomike).

Këto gjetje evidentojnë nevojën emergjente për rritjen e mbështetjes gjithëpërfshirëse ndaj familjeve të fëmijëve me autizëm, në mënyrë që të lehtësohet barra e kujdesit dhe të përmirësohet mirëqenia e prindërve dhe fëmijëve. Prindërit kanë nevojë për politika më të mira të mbrojtjes sociale dhe sisteme shërbimesh psikosociale më të forta e të koordinuara, për

ndihmë financiare dhe lehtësira në aksesimin e terapive, si dhe për rrjete komunitare mbështetëse që ofrojnë mirëkuptim dhe mbështetje emocionale. Duke qenë se ky ishte një studim eksplorativ me një kampion të kufizuar, gjetjet e tij duhen interpretuar me kujdes; megjithatë, ato ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme fillestare mbi këtë problematikë. Studime të mëtejshme – sidomos ato me kampionë më të mëdhenj ose qasje ndërhyrëse – mund të ndërtojnë mbi këto rezultate, duke zhvilluar mënyra konkrete mbështetjeje për të ndihmuar familjet që përballen me autizmin në Shqipëri. Nëpërmjet adresimit të këtyre sfidave dhe fuqizimit të prindërve, do të mundësohet një cilësi jete më e mirë jo vetëm për fëmijët me ÇSA, por edhe për mbarë familjet e tyre.

REFERENCAT:

- Akhani, A., Dehghani, M., Gharraee, B., & Hakim Shoostari, M. (2021). Parent training intervention for autism symptoms, functional emotional development, and parental stress in children with autism: A randomized clinical trial. *Asian Journal of Psychiatry*, 62, 102735. DOI: 10.1016/j.ajp.2021.102735
- Alimohamadi, A., Ghasemzadeh, M., Fooladi, F., Abdolmohamadi, K., Killikelly, C., & Janghorbanian, Z. (2024). “Living-loss”: A narrative synthesis review of the grief process in parents of children with autism spectrum disorder. *Journal of Pediatric Nursing*, 77, e97–e107. DOI: 10.1016/j.pedn.2024.03.036
- Altieri, M. J., & von Kluge, S. (2009). Searching for acceptance: Challenges encountered while raising a child with autism. *Journal of Intellectual & Developmental Disability*, 34(2), 142–152. DOI: 10.1080/13668250902845202
- Benson, P. R. (2006). The impact of child symptom severity on depressed mood among parents of children with ASD: The mediating role of stress proliferation. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 36(5), 685–695. <https://doi.org/10.1007/s10803-006-0112-3>
- Braun, V., & Clarke, V. (2006). Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology*, 3(2), 77–101.
- Chen, H., Ding, Y., Xu, D., & Xiong, Z. (2025). Resilience and affiliate stigma among parents of children with ASD: The mediating role of life satisfaction and the moderating role of ostracism. *Psychology Research and Behavior Management*, 18, 1519–1529. DOI: 10.2147/PRBM.S524580
- Čolić, M., Dababnah, S., Garbarino, N., & Betz, G. (2022). Parental experiences raising children with autism spectrum disorder in Eastern Europe: a scoping review. *International Journal of Developmental Disabilities*, 68(1), 1–13. <https://doi.org/10.1080/20473869.2019.1688931>

- Da Paz, N. S., Siegel, B., Coccia, M. A., & Epel, E. S. (2018). Acceptance or despair? Maternal adjustment to having a child diagnosed with autism. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 48(6), 1971–1981. DOI: 10.1007/s10803-017-3450-4
- Davis, N. O., & Carter, A. S. (2008). Parenting stress in mothers and fathers of toddlers with autism spectrum disorders: Associations with child characteristics. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 38(7), 1278–1291. <https://doi.org/10.1007/s10803-007-0512-z>
- Drogomyretska, K., Fox, R., & Colbert, D. (2020). Brief Report: Stress and perceived social support in parents of children with ASD. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 50(11), 4176–4182. DOI: 10.1007/s10803-020-04455-x
- Friesse, S. (2014). *Qualitative data analysis with ATLAS.ti* (Second edition). SAGE.
- Galán-Vera, I. Z., Robles-Bello, M. A., Sarhani-Robles, A., & Valencia-Naranjo, N. (2025). Experiences and coping strategies of parents with children diagnosed with ASD in early care (with emphasis on social skills and family cultural values): A qualitative study. *Archives of Psychiatric Nursing*, 56, 151864. DOI: 10.1016/j.apnu.2025.151864
- Goffman, E. (1963). *Stigma: Notes on the management of spoiled identity*. Prentice-Hall.
- Gülbetekin, E., Kardaş Özdemir, F., & Aşut, G. (2024). The mediator role of parenting stress in the effect of stigmatization on burnout in parents of children with autism. *Journal of Pediatric Nursing*, 78, e323–e329. DOI: 10.1016/j.pedn.2024.07.021
- Hayes, S. A., & Watson, S. L. (2013). The impact of parenting stress: A meta-analysis of studies comparing parents of children with and without autism spectrum disorder. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 43(3), 629–642. DOI: 10.1007/s10803-012-1604-y
- Karst, J. S., & Van Hecke, A. V. (2012). Parent and family impact of Autism Spectrum Disorders: A review and proposed model for intervention evaluation. *Clinical Child and Family Psychology Review*, 15(3), 247–277. DOI: 10.1007/s10567-012-0119-6
- Kuhaneck, H. M., Burroughs, T., Wright, J., Lemanczyk, T., & Darragh, A. R. (2010). A qualitative study of coping in mothers of children with an autism spectrum disorder. *Physical & Occupational Therapy in Pediatrics*, 30(4), 340–350. DOI: 10.3109/01942638.2010.481662
- Kvale, S., & Brinkmann, S. (2009). *InterViews: Learning the craft of qualitative research interviewing* (2nd ed.). Sage.
- Liao, X., & Li, Y. (2020). Economic burdens on parents of children with autism: A literature review. *CNS Spectrums*, 25(4), 468–474. DOI: 10.1017/S1092852919001512
- Masa'Deh, R., Sawalha, M. A., Maabreh, R. S., et al. (2025). Perceived social

support as a moderator of posttraumatic stress in parents of children with autism spectrum disorder. *Scientific Reports*, 15, Article 29252. DOI: 10.1038/s41598-025-07027-0

- Rfat, M., Koçak, O., & Uzun, B. (2023). Parenting challenges in families of children with a diagnosis of autism spectrum disorder: A qualitative study in Istanbul. *Global Social Welfare*. Advance online publication. DOI: 10.1007/s40609-023-00270-1
- Saranek, L. M., Shraim, M., Abdel Aati, N., & Al-Jayyousi, G. F. (2025). Perceived needs and barriers in raising a child with ASD and accessing early interventions in Qatar: Parents' voices. *Journal of Multidisciplinary Healthcare*, 18, 5663–5676. DOI: 10.2147/JMDH.S525521
- Sharpley, C. F., Bitsika, V., & Efremidis, B. (1997). Influence of gender, parental health, and perceived expertise of assistance upon stress, anxiety, and depression among parents of children with autism. *Journal of Intellectual and Developmental Disability*, 22(1), 19–28. <https://doi.org/10.1080/13668259700033261>
- Srinivasan, S., Ekbladh, A., Freedman, B., & Bhat, A. (2021). Needs assessment in unmet healthcare and family support services: A survey of caregivers of children and youth with ASD in Delaware. *Autism Research*, 14(8), 1736–1758. DOI: 10.1002/aur.2514
- Thomas, K. C., Ellis, A. R., McLaurin, C., Daniels, J., & Morrissey, J. P. (2007). Access to care for autism-related services. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 37(8), 1902–1912. <https://doi.org/10.1007/s10803-006-0323-7>
- Thomas, K. C., Morrissey, J. P., & McLaurin, C. (2007). Use of autism-related services by families and children. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 37(5), 818–829. <https://doi.org/10.1007/s10803-006-0208-9>
- Wang, P., Michaels, C. A., & Day, M. S. (2011). Stresses and coping strategies of Chinese families with children with autism and other developmental disorders. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 41(6), 783–795. DOI: 10.1007/s10803-010-1099
- Woodgate, R. L., Ateah, C., & Secco, L. (2008). “Living in a world of our own”: The experience of parents who have a child with autism. *Qualitative Health Research*, 18(8), 1075–1083. DOI: 10.1177/1049732308320112
- World Health Organization. (2025). Retrieved from <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/autism-spectrum-disorders>
- World Population Review. (2022). Autism rates by country. Retrieved from <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/autism-rates-by-country>
- Yip, C. C. H., & Chan, K. K. S. (2022). Longitudinal impact of public stigma and courtesy stigma on parents of children with autism spectrum disorder: The moderating role of trait mindfulness.

Research in Developmental Disabilities, 127, 104243. <https://doi.org/10.1016/j.ridd.2022.104243>

- Zorčec, T. (2019). Needs and challenges facing parents/caregivers of children with autism spectrum disorder: the Southeast European Autism Network survey. *Hrvatska revija za rehabilitacijska istraživanja*, 55 (2), 31-39. <https://doi.org/10.31299/hrri.55.2.3>

TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN NË SHKODËR: ANALIZË PSIKOLOGJIKE-JURIDIKE KRAHASUESE E PROCEDIMEVE 2024-2025

Elona Hasmujaj ¹ Entela Hasmujaj ²

¹*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të
Edukimit,*

²*Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm,
Shkodër*

ABSTRAKT

Ky studim analizon trajtimin procedural të të miturve në konflikt me ligjin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër, duke krahasuar periudhën janar-dhjetor 2024 me periudhën janar-shtator 2025. Analiza bazohet në të dhëna institucionale me karakter përshkrues-krahasues dhe synon të evidentojë ndryshimet ndër vite në numrin e referimeve, procedimeve penale, masave të sigurimit, masave alternative dhe rasteve me viktime të mitur. Rezultatet tregojnë një rënie të ndjeshme të të gjithë treguesve kryesorë gjatë vitit 2025. Referimet totale ndaj të miturve kanë rënë me 27.5%, procedimet penale me 33.7%, ndërsa numri i të miturve të proceduar 98, gjithashtu ka pësuar rënie me 38.8%. Masat shtrënguese janë reduktuar dukshëm: në vitin 2024 u caktuan katër masa “Arrest në burg” dhe dy “Arrest në shtëpi”, ndërsa në vitin 2025 vetëm një i mitur u privua nga liria. Masat alternative u aplikuan gjerësisht, duke përfshirë 44.1% të procedimeve në vitin 2024 dhe 35.1% në vitin 2025, gjë që sugjeron një orientim të qartë drejt qasjeve restauruese dhe proporcionalitetit në ndjekjen penale. Përqindja relative e viktimave të mitura mbetet e qëndrueshme, ndërkohë recidivizmi shfaqet në rritje të lehtë në vitin 2025. Në tërësi, gjetjet tregojnë një tendencë drejt reduktimit të ndërhyrjeve penale dhe përdorimit të masave shtrënguese, duke reflektuar afrimin me standardet bashkëkohore të drejtësisë për të mitur dhe parimet psikologjike-zhvillimore që favorizojnë rehabilitimin, reduktimin e stigmatizimit dhe forcimin e ndërhyrjeve mbështetëse për të miturit në konflikt me ligjin.

Fjalë kyçe: të mitur, devijancë, adoleshencë, drejtësi penale, Shkodër.

**Minors in conflict with the law in Shkodër: a comparative
psychological-legal analysis of procedures 2024-2025**

ABSTRACT

This study analyzes the procedural treatment of juveniles in conflict with the law at the Prosecutor's Office of the First Instance Court of General Jurisdiction, Shkodër, comparing the period January-December 2024 with January-September 2025. The analysis is based on institutional descriptive-comparative data and aims to identify year to year changes in the number of referrals, criminal proceedings, security measures, alternative measures, and cases involving child victims. The results show a significant decrease across all key indicators during 2025. Total referrals involving juveniles decreased by 27.5%, criminal proceedings by 33.7%, while the number of juveniles prosecuted dropped by 38.8%. Coercive measures were markedly reduced: in 2024, four cases of "Detention in prison" and two cases of "House arrest" were imposed, whereas in 2025 only one juvenile was deprived of liberty. Alternative measures were widely applied, covering 44.1% of proceedings in 2024 and 35.1% in 2025, suggesting a clear orientation toward restorative approaches and proportionality in criminal prosecution. The relative percentage of juvenile victims remains stable, while recidivism shows a slight increase in 2025. Overall, the findings indicate a trend toward reducing penal interventions and the use of coercive measures, reflecting an alignment with contemporary standards of juvenile justice and developmental-psychological principles that promote rehabilitation, reduced stigmatization, and strengthened supportive interventions for juveniles in conflict with the law.

Keywords: *juveniles, delinquency, adolescence, criminal justice, Shkodër.*

1. Hyrje

Trajtimi procedural i të miturve në konflikt me ligjin është një ndër temat më të rëndësishme dhe më komplekse brenda sistemit bashkëkohor të drejtësisë penale. Ndryshe nga të rriturit, të miturit karakterizohen nga një profil unik zhvillimor, neuropsikologjik dhe social, i cili ndikon drejtpërdrejt në sjelljet e tyre, në procesin e marrjes së vendimeve dhe në qasjen e tyre ndaj normave shoqërore dhe ligjore (Steinberg, 2010; Casey, 2015). Adoleshenca përbën një periudhë gjatë së cilës zhvillimi i trurit

është në proces: strukturat përgjegjëse për emocionet dhe kërkimin e shpërblimit zhvillohen më herët, ndërsa korteksi prefrontal, i cili rregullon vetëkontrollin, parashikimin e pasojave dhe vendimmarrjen e matur, vazhdon të zhvillohet deri rreth moshës 25 vjeç (Steinberg dhe Icenogle, 2019). Ky zhvillim i pabarabartë biologjik i bën adoleshentët më të ndjeshëm ndaj impulsivitetit, presionit të grupit dhe vendimeve të nxituara, duke rritur gjasat për sjellje devijante.

Nga perspektiva psikologjike, sjelljet problematike të të miturve shpesh nuk pasqyrojnë kriminalitet të qëndrueshëm, por janë pjesë e proceseve normative të eksplorimit të identitetit, kërkimit të autonomisë dhe përpjekjeve për të fituar status brenda grupit të bashkëmoshatarëve (Shulman et al., 2016; Wissink et al., 2022). Teoritë e të mësuarit social sugjerojnë se shumë prej këtyre sjelljeve formohen dhe përforcohen në kontekstin social, përmes imitimit dhe modelimit të sjelljes së bashkëmoshatarëve (Bandura, 1977). Kjo nënkupton se dinamika grupore, presioni për konformizëm dhe kërkimi i aprovimit social luajnë një rol thelbësor në shfaqjen e devijimit në këtë moshë (Dishion dhe Tipsord, 2011).

Edhe faktorët familjarë dhe shkollorë paraqiten si elemente të rëndësishme në formësimin e prirjeve delinkuente. Studimet tregojnë se monitorimi i dobët prindëror, konfliktet familjare dhe një klimë shkollore mbështetëse lidhen me rritjen e sjelljeve devijante (Moffitt, 2018). Ndërkohë, marrëdhëniet e sigurta emocionale me prindërit, mbështetja nga mësuesit dhe një mjedis shkollor i strukturuar shfaqen si faktorë mbrojtës të rëndësishëm (Kowalski dhe të tjerë, 2014).

Nga pikëpamja juridike, sistemi modern i drejtësisë për të mitur është i bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe në filozofinë e drejtësisë restauruese. Institucionet ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës, theksojnë rëndësinë e shmangies së penalizimit të panevojshëm, zvogëlimin të ndërhyrjeve shtrënguese dhe përdorimit të masave alternative, si: këshillimi, ndërmjetësimi, programet rehabilituese dhe mosfillimi i procedimit në rastet kur rrezikshmëria është e ulët (Këshilli Evropian, 2010). Kjo qasje është e mbështetur edhe nga të dhënat psikologjike, të cilat tregojnë se trajtimi penal i hershëm rrit rrezikun e kriminalitetit afatgjatë, ndërsa ndërhyrjet psikoedukative dhe sociale përmirësojnë rezultatet zhvillimore (Steinberg dhe Icenogle, 2019).

Në këtë sfond teorik dhe institucional, Prokuroria e Shkodrës, ofron një rast studimi domethënës për të analizuar dinamikën e sjelljes devijante të të miturve dhe mënyrën se si trajtohen proceduralisht këto raste. Të dhënat statistikore të viteve 2024 dhe janar-shtator 2025 tregojnë se numri i

referimeve ka rënë nga 153 raste në vitin 2024 në 111 raste në vitin 2025. Po ashtu, janë reduktuar procedimet penale (nga 86 në 57), rastet e mosfillimeve (nga 23 në 13) dhe masat e sigurisë me intensitet të lartë. Ndërhyrjet alternative, ndonëse kanë rënë numerikisht, mbeten një komponent i rëndësishëm i trajtimit procedural (38 raste në 2024 dhe 20 raste në 2025). Shifrat dëshmojnë për një ulje të përgjithshme të ngarkesës dhe një tendencë drejt menaxhimit më të kujdesshëm të rasteve që përfshijnë të mitur.

Një tjetër tregues i rëndësishëm është raporti i moshave të proceduara: në të dy vitet dominon grupmosha 16-18 vjeç, një tendencë që përputhet me literaturën shkencore që e identifikon adoleshencën e vonë si periudhën më të ndjeshme ndaj ndërmarrjes së rrezikut dhe sjelljeve antisociale (Steinberg, 2010). Një numër i kufizuar recidivistësh (4 raste për secilin vit) dhe ulja drastike e rasteve të arrestimit me burg sugjerojnë një përmirësim praktik në mënyrën e trajtimit të të miturve.

Duke u mbështetur në këto të dhëna dhe në kornizën teorike psikologjike-juridike, studimi aktual synon të ofrojë një analizë përshkruese-krahasuese të trajtimit procedural të të miturve në Prokurorinë e Shkodrës. Qëllimi është të shqyrtohen ndryshimet ndërmjet dy periudhave kohore, të identifikohen tendencat institucionale, të interpretohen implikimet psikologjike të sjelljeve të të miturve dhe të ofrohen rekomandime të bazuara në prova për ndërhyrje më efektive, në përputhje me standardet bashkëkohore të drejtësisë për të mitur. Në këtë kuadër ngrihet pyetja kërkimore:

Si ndryshon trajtimi procedural i të miturve në konflikt me ligjin në Prokurorinë e Shkodrës, midis periudhës janar-dhjetor 2024 dhe periudhës janar-shtator 2025?

2. Metodologjia

2.1. Dizajni i studimit

Ky studim mbështetet në të dhëna dytësore dhe ndjek një qasje përshkruese - krahasuese, bazuar në analizë sistematike të të dhënave statistikore zyrtare, të administruara nga Prokuroria e Shkodrës.

Duke përdorur dokumentacion institucional të përmbledhur në regjistra vjetorë, studimi synon të shqyrtojë ndryshimet dhe ngjashmëritë në trajtimin procedural të çështjeve që përfshijnë të mitur në dy periudha kohore të dallueshme: janar-dhjetor 2024 dhe janar-shtator 2025. Analiza fokusohet në tregues kryesorë, si: referimet, procedimet penale, masat e sigurimit, masat alternative dhe rastet me viktima të mitur, duke mundësuar një krahasim të strukturuar të tendencave dhe praktikave institucionale.

2.2. Burimet e të dhënave

Të dhënat janë siguruar nga dokumentë institucionalë të Prokurorisë së Shkodrës, të cilët përmbajnë të dhëna të përgjithshme mbi çështjet me të mitur në konflikt me ligjin. Këto të dhëna përfshijnë procedimet penale, mosfillimet, masat alternative të shmangies, masat e sigurimit personal, recidivizmin dhe viktimat e mitura. Setet e të dhënave mbështeten në regjistrat zyrtarë, duke garantuar vërtetësinë dhe përfaqësimin real të rasteve të trajtuara në secilin vit. Për shkak se informacioni është institucional dhe joindividual, studimi siguron një ruajtje të anonimatit të të miturve.

2.3. Përgatitja dhe pastrimi i të dhënave

Procesi metodologjik ka filluar me verifikimin e cilësisë së të dhënave, duke kontrolluar harmoninë strukturore të kolonave, konsistencën e vlerave dhe mungesat përkatëse. Rreshtat që nuk përmbanin informacion të përdorshëm janë hequr, ndërsa kolonat janë harmonizuar për të siguruar krahasueshmëri ndër vite. Unifikimi i rubrikave ishte element kyç, pasi garantoj që analizat të mbështeteshin mbi të njëjtat kategori procedurale, duke shmangur devijimet metodologjike.

2.4. Analiza sasiore

Të dhënat janë analizuar përmes një qasjeje krahasuese, duke totalizuar numrat e rasteve për secilin vit dhe duke shqyrtuar ndryshimet midis periudhave. Janë llogaritur përqindje për të vlerësuar shkallën e uljes ose rritjes së rasteve, ndërsa tabelat janë përdorur për të ilustruar vizualisht diferencat. Kjo pjesë e analizës ka shërbyer për të krijuar një panoramë numerike të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

2.5. Çështjet etike

Studimi respekton standardet etike për përdorimin e të dhënave dhe mbrojtjen e të miturve. Të dhënat janë përdorur dhe përpunuar në mënyrë që të shmanget çdo rrezik ekspozimi i individëve. Analiza është kryer në përputhje me udhëzimet etike të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar integritet shkencor dhe konfidencialitet institucional.

3. Rezultatet e studimit

3.1. Panoramë e përgjithshme e rasteve

Tabela 1 paraqet të dhënat bazë mbi numrin e referimeve, mosfillimeve dhe

procedimeve penale ndaj të miturve. Në vitin 2024 janë regjistruar gjithsej 153 referime për të mitur të dyshuar si autorë të veprave penale, ndërsa në periudhën janar-shtator 2025 janë regjistruar 111 referime, çfarë përfaqëson një rënie të konsiderueshme të ngarkesës institucionale.

Numri i çështjeve të mosfilluara është reduktuar nga 23 raste në vitin 2024 në 13 raste në vitin 2025. Edhe procedimet penale kanë shënuar rënie, nga 86 raste në vitin 2024 në 57 raste në vitin 2025. Shumica e të miturve të proceduar në të dy vitet janë meshkuj: 85 në vitin 2024 dhe 49 në vitin 2025, ndërsa vetëm 3 femra rezultojnë të proceduara në vitin 2025.

Në përgjithësi, tabela tregon një rënie të dukshme të rasteve në të gjitha kategoritë kryesore, duke përfshirë referimet, mosfillimet dhe procedimet penale.

Tabela 1. Përmbledhje krahasuese e referimeve dhe procedimeve penale.

Viti	Referime totale	Mosfillime	Të mitur të proceduar	Meshkuj	Femra
2024	153	23	85	85	0
2025	111	13	52	49	3

3.2. Shpërndarja sipas grupmoshave

Tabela 2 përshkruan shpërndarjen e të miturve të proceduar sipas grupmoshave 14-16 vjeç dhe 16-18 vjeç. Në vitin 2024, 30 të mitur të proceduar i përkasin grupmoshës 14-16 vjeç dhe 55 i përkasin grupmoshës 16-18 vjeç. Në periudhën janar-shtator 2025, 11 të mitur janë të grupmoshës 14-16 vjeç dhe 41 të grupmoshës 16-18 vjeç. Në të dy vitet vihet re një dominim i qartë i grupmoshës së adoleshencës së vonë (16-18 vjeç), e cila përbën shumicën e rasteve të procedimit penal. Edhe pse numrat absolutë janë më të ulët për vitin 2025, raportet ndërmjet dy grupmoshave mbeten të njëjta, duke treguar një strukturë të qëndrueshme të moshës së përfshirë në procedime.

Tabela 2. Shpërndarja sipas grupmoshave.

Viti	14–16 vjeç	16–18 vjeç	Totali i të miturve të proceduar
2024	30	55	85
2025	11	41	52

3.3. Masat e sigurimit dhe ndërhyrja penale

Tabela 3 paraqet masat e sigurimit personal të vendosura ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Në vitin 2024, në 4 raste është caktuar masa e sigurisë “Arrest në burg” dhe në 2 raste “Arrest në shtëpi”, duke e çuar totalin e masave të sigurisë në 6 raste.

Në periudhën janar-shtator 2025, vetëm ndaj një të mituri në konflikt me ligjin është caktuar masa “Arrest në burg”, ndërsa nuk është regjistruar asnjë rast i caktimit të masës “Arrest në shtëpi”. Ky ndryshim përfaqëson një reduktim të dukshëm të përdorimit të masave shtrënguese ndaj të miturve gjatë vitit 2025.

Në përgjithësi, tabela tregon një rënie të qëndrueshme të masave shtrënguese.

Tabela 3. Masat e sigurimit të caktuara.

Viti	Arrest në burg	Arrest në shtëpi	Masa të tjera sigurimi	Totali
2024	4	2	-	6
2025	1	0	-	1

3.4. Recidivizmi

Tabela 4 paraqet të dhënat mbi të miturit përsëritës. Në të dy vitet evidentohet një numër i njëjtë i të miturve që janë përsëritës në kryerjen e veprave penale: 4 raste për secilin vit. Megjithatë, për shkak të numrit më të ulët të të miturve të proceduar në vitin 2025, përqindja e recidivizmit është më e lartë në atë vit (7.7%) krahasuar me vitin 2024 (4.7%).

Tabela tregon se numri absolut i rasteve të përsëritura mbetet i ulët.

Tabela 4. Recidivizmi dhe përqindja e rasteve të përsëritura.

Viti	Të mitur përsëritës	Përqindja
2024	4	4.7%
2025	4	7.7%

3.5. Zbatimi i masave alternative dhe çështjet e dërguara në gjyq

Tabela 5 përshkruan numrin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe numrin e çështjeve për të cilat është kërkuar dërgimi në gjyq. Në vitin 2024 janë aplikuar 38 masa alternative të shmangies nga përgjegjësia penale dhe janë paraqitur 16 kërkesa për gjykim. Në vitin 2025 janë aplikuar 20 masa alternative dhe janë paraqitur 8 kërkesa për gjykim.

Në të dy vitet, masat alternative përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procedimeve, duke përfaqësuar 44.1% të të gjitha procedimeve në vitin 2024 dhe 35.1% në vitin 2025. Megjithëse numri absolut i masave alternative është më i ulët në vitin 2025, ato vijojnë të mbeten një mekanizëm i përdorur gjerësisht.

Tabela eidenton qartë përgjysmimin e rasteve të dërguara në gjykim në vitin 2025, çfarë reflekton orientimin drejt aplikimit të masave të

shmangies për të miturit në konflikt me ligjin.

Tabela 5. Masat alternative dhe dërgimi i çështjeve në gjyq.

Viti	Masa alternative	Kërkesa për gjykim	Përqindja
2024	38	16	44.1%
2025	20	8	35.1%

3.6. Viktimat e mitur në raste penale

Tabela 6 paraqet rastet ku viktimat e veprës penale janë të mitur. Në vitin 2024 janë regjistruar 47 raste me viktimat të mitur, që përfaqësojnë 30.7% të referimeve. Në vitin 2025, numri i rasteve është 36, duke përfaqësuar 32.4% të referimeve të periudhës janar-shtator.

Megjithëse numri absolut i viktimave ka rënë, përqindja relative në raport me referimet ka mbetur pothuajse konstante, duke treguar se konfliktet që përfshijnë të mitur si viktimat mbeten një komponent i rëndësishëm i situatave të raportuara.

Tabela 6. Rastet me viktimat të mitur.

Viti	Viktima të mitur	Përqindja
2024	47	30.7%
2025	36	32.4%

3.7. Treguesit kryesorë krahasues

Tabela 7 përmbledh rezultatet kryesore të krahasimit mes dy periudhave. Të gjithë treguesit themelorë, përfshirë referimet, mosfillimet, procedimet penale, numrin e të miturve të proceduar, masat e sigurimit dhe kërkesat për gjykim, kanë pësuar rënie në vitin 2025.

Ulja është më e theksuar në: arrestet në burg (-75%), procedimet penale (-33.7%), çështjet e dërguara në gjyq (-50%), numrin e të miturve të proceduar (-38.8%).

Tabela ofron një pamje të qartë të tendencës së përgjithshme zbritëse në të gjithë indikatorët, duke sugjeruar reduktim të përgjithshëm të referimeve të çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin në Shkodër gjatë periudhës së studiuar.

Tabela 7. Treguesit krahasues kryesorë të të miturve në konflikt me ligjin në Shkodër.

Treguesi	2024	2025	Ndryshimi absolut	Ndryshimi në %
Referime totale	153	111	-42	-27.5%

Mosfillime	23	13	-10	-43.4%
Procedime penale	86	57	-29	-33.7%
Të mitur të proceduar	85	52	-33	-38.8%
Arrest në burg	4	1	-3	-75%
Masa alternative	38	20	-18	-47.3%
Kërkesa për gjykim	16	8	-8	-50%
Viktima të mitur	47	36	-11	-23.4%

4. Diskutime

Rezultatet tregojnë një tendencë të qartë zbritëse në shumicën e treguesve proceduralë midis vitit 2024 dhe periudhës janar-shtator 2025. Ulja e referimeve nga 153 në 111 raste (-27.5%) dhe e procedimeve penale nga 86 në 57 raste (-33.7%) sugjeron një reduktim të ngarkesës së sistemit të drejtësisë për të mitur në Shkodër. Kjo mund të shpjegohet, si: një ulje reale e përfshirjes së të miturve në vepra penale, rritje e përdorimit të mekanizmave alternativë parandalues, p.sh. ndërmjetësim në nivel shkolle apo familjar apo ndryshim në praktikat e referimit dhe sensibilizimit të institucioneve.

Dominimi i grupmoshës 16-18 vjeç në të dy vitet përputhet me literaturën që identifikon adoleshencën e vonë si periudha më e ekspozuar ndaj rrezikut për sjellje devijante, në veçanti për shkak të maturimit të vonuar të mekanizmave të vetërregullimit, krahasuar me sistemin e shpërblimit (Casey, 2015; Steinberg, 2010). Fakti që struktura relative e moshës mbetet e qëndrueshme, pavarësisht uljes së numrave absolutë, sugjeron se profili i të miturit në konflikt me ligjin nuk ka ndryshuar ndjeshëm: ai mbetet i gjinisë mashkullore, në adoleshencën e vonë, në përputhje me gjetjet e studimeve të huaja mbi delinkuencën në adoleshencë (Moffitt, 2018).

Reduktimi i masave të sigurimit personal nga 6 raste në vitin 2024 në vetëm 1 rast në vitin 2025 është një nga treguesit kryesorë të zhvendosjes drejt një qasjeje më pak shtrënguese dhe potencialisht më restauruese. Ky rezultat është në përputhje me udhëzimet evropiane për drejtësi miqësore me fëmijë, të cilat rekomandojnë përdorimin sa më të kufizuar të masave shtrënguese dhe orientimin drejt masave alternative e edukative (Këshilli i Evropës, 2010). Nga perspektiva psikologjike, reduktimi i privimit nga liria është i rëndësishëm, pasi ndëshkimet e ashpra në moshë të mitur lidhen me rritje të rrezikut afatgjatë për kriminalitet dhe stigmatizim të brendësuar (Steinberg dhe Icenogle, 2019).

Në të dy vitet, numri absolut i recidivistëve mbetet i njëjtë (4 raste), por përqindja rritet nga 4.7% në 7.7% për shkak të uljes së numrit total të të

miturve të proceduar. Kjo tregon se, ndërsa shumica e të miturve përfshihen një herë në sistem dhe më pas dalin prej tij, ekziston një nëngrup më vulnerabël, me rrezik të shtuar për përsëritje të sjelljes devijante. Literatura e lidh recidivizmin me tërësinë e faktorëve riskues, si: konflikti familjar, bashkëmoshatarët delinkuentë, rregullim emocional i dobët dhe mungesë mbështetjeje (Dishion dhe Tipsord, 2011; Moffitt, 2018). Përdorimi i masave alternative bie numerikisht nga 38 në 20 raste, por mbetet i lartë si përqindje ndaj procedimeve penale (44.1% në 2024 dhe 35.1% në 2025). Në të dy periudhat, masat alternative përfaqësojnë një mekanizëm kyç për shmangien e ndjekjes penale të plotë, duke lejuar adresimin e sjelljes devijante në mënyrë më fleksibël dhe edukative. Kjo është në të njëjtën linjë me të dhënat që sugjerojnë se ndërhyrjet restauruese dhe psikoedukative, si: paralajmërimi, këshillimi i të miturve dhe familjarëve dhe programet komunitare, janë më efektive në terma afatgjatë sesa ndëshkimi formal për shumë forma të delinkuencës në adoleshencë, sidomos kur veprat nuk kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore (Steinberg, 2010; Steinberg dhe Icenogle, 2019). Një tjetër gjetje e rëndësishme është prania e qëndrueshme e viktimave të mitur në të dy periudhat: 47 raste (30.7%) në 2024 dhe 36 raste (32.4%) në 2025. Megjithatë numrat absolutë bien, përqindja relative mbetet e ngjashme, duke treguar se të miturit janë të pranishëm jo vetëm si autorë, por edhe si viktimë të veprave penale. Kjo situatë pasqyron kompleksitetin e gjendjes së tyre psikosociale dhe mbështet qëndrimin se ndërhyrjet duhet të synojnë jo vetëm kontrollin e sjelljes, por edhe mbrojtjen, sigurinë dhe rehabilitimin emocional të tyre (Kowalski dhe të tjerë., 2014; Moffitt, 2018).

Ky studim ka disa kufizime që duhet të merren në konsideratë. Së pari, të dhënat janë të natyrës së përgjithshme dhe institucionale; ato nuk lejojnë analizë në nivel individual (p.sh., profil psikologjik, histori familjare, gjendje socioekonomike), gjë që kufizon interpretimin psikologjik të sjelljes së tyre. Së dyti, periudha e vëzhgimit është relativisht e shkurtër (një vit i plotë dhe nëntë muaj), çka nuk lejon nxjerrjen e konkluzioneve mbi tendencat afatgjata. Së treti, studimi bazohet në të dhëna nga një prokurori e vetme, ndaj gjetjet nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar, pa studime të tjera krahasuese.

Studime të ardhshme mund të kombinojnë të dhënat sasiore institucionale me qasje cilësore (intervista me të mitur, prindër, profesionistë psikosocialë dhe të drejtësisë), si dhe me instrumente psikometrike për matjen e impulsivitetit, rregullimit emocional, presionit të bashkëmoshatarëve dhe faktorëve familjarë. Kjo do të mundësonte një kuptim më të thellë të mekanizmave psikologjike që qëndrojnë në bazë të

sjelljeve devijante dhe do të ndihmonte në dizenjimin e ndërhyrjeve të personalizuara dhe të bazuara në të dhëna.

5. Konkluzione

Rezultatet e studimit tregojnë se trajtimi procedural i të miturve në konflikt me ligjin në Shkodër ka pësuar një rënie të përgjithshme në të gjithë indikatorët kryesorë midis viteve 2024 dhe 2025. Reduktimi i referimeve, procedimeve penale dhe masave të sigurimit, sugjeron një zhvendosje të qartë drejt qasjeve më pak shtrënguese dhe potencialisht më restauruese. Ky trend përputhet me literaturën ndërkombëtare që thekson rëndësinë e shmangies së etiketimit penal në moshë të hershme dhe nxitjen e ndërhyrjeve që mbështesin zhvillimin psikologjik dhe social të të miturve. Ndërkohë, dominimi i grupmoshës 16-18 vjeç dhe përqindja e qëndrueshme e viktimave të mitur tregojnë se të rinjtë e kësaj periudhe zhvillimore mbeten veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe konflikteve ndërpersonale. Prania e një nëngrupi të vogël, por të qëndrueshëm recidivistësh sugjeron se faktorët psikologjikë, si: impulsiviteti, rregullimi emocional i pamjaftueshëm dhe ekspozimi ndaj bashkëmoshatarëve devijantë vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në sjelljet e tyre. Në përgjithësi, rezultatet mbështesin nevojën për qasje të integruara psikoedukative dhe juridike, të cilat synojnë jo vetëm adresimin e shkeljes, por edhe mbështetjen e zhvillimit të shëndetshëm emocional dhe social të të miturve.

6. Rekomandime

Duke u bazuar në gjetjet e studimit, rekomandohet që institucionet të forcojnë programet e ndërhyrjes së hershme që synojnë aftësitë e vetërregullimit emocional, menaxhimit të impulsivitetit dhe zhvillimin e kompetencave sociale, duke qenë se këto janë dimensionet psikologjike që lidhen ngusht me sjelljet devijante gjatë adoleshencës. Gjithashtu, sugjerohet rritja e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë, shkollave, shërbimeve psikosociale dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, për të identifikuar në kohë të miturit që paraqesin rrezik për sjellje devijante, duke shmangur sa të jetë e mundur procedimet penale që mund të kenë efekte stigmatizuese.

Një rëndësi të veçantë merr zhvillimi i programeve mbështetëse për prindërit, me fokus në prindërimin pozitiv, komunikimin familjar dhe menaxhimin e konflikteve, pasi rezultatet tregojnë se mjedisi familjar është një nga faktorët përcaktues të sjelljes së të miturve.

Po ashtu, rekomandohet që institucionet të vazhdojnë të zgjerojnë

përdorimin e masave alternative dhe drejtësisë restauruese, të cilët jo vetëm reduktojnë ngarkesën e sistemit penal, por krijojnë mundësi reale rehabilitimi dhe riintegrimi për të miturit. Së fundi, mbetet thelbësore rritja e ndërhyrjeve për mbrojtjen e viktimave të mitur dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike të përshtatshme për ta, duke pasur parasysh ekspozimin e tyre të lartë ndaj konflikteve dhe rrezikut psikosocial.

REFERENCA

- Bandura, A. (1977). *Social learning theory*. Prentice-Hall.
<https://doi.org/10.4324/9780203796842>
- Casey, B. J. (2015). Beyond simple models of self-control to circuit-based accounts of adolescent behavior. *Annual Review of Psychology*, 66, 295–319.
<https://doi.org/10.1146/annurev-psych-010814-015156>
- Dishion, T. J., & Tipsord, J. M. (2011). Peer contagion in child and adolescent social and emotional development. *Annual Review of Psychology*, 62, 189–214.
<https://doi.org/10.1146/annurev-psych.093008.100412>
- Këshilli i Evropës. (2010). Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve. <https://rm.coe.int/16804b2cf3>
- Kowalski, R. M., Morgan, C. A., & Limber, S. P. (2014). Traditional bullying as a potential warning sign of cyberbullying. *School Psychology International*, 35(6), 627–637.
<https://doi.org/10.1177/0143034314541699>
- Moffitt, T. E. (2018). Male antisocial behaviour in adolescence and beyond. *Nature Human Behaviour*, 2, 177–186. <https://doi.org/10.1038/s41562-018-0309-4>
- Shulman, E. P., Harden, K. P., Chein, J. M., & Steinberg, L. (2016). The development of impulse control and sensation-seeking in adolescence: Independent or interdependent processes? *Journal of Research on Adolescence*, 26(1), 37–44.
<https://doi.org/10.1111/jora.12181>
- Steinberg, L. (2010). A dual systems model of adolescent risk-taking. *Developmental Psychobiology*, 52(3), 216–224. <https://doi.org/10.1002/dev.20445>
- Steinberg, L., & Icenogle, G. (2019). Using developmental science to distinguish adolescents and adults under the law. *Annual Review of Developmental Psychology*, 1, 21–40.
<https://doi.org/10.1146/annurev-devpsych-121318-084827>
- Wissink, I. B., de Bruyn, E. H., & Deković, M. (2022). Deviant peer affiliation and adolescent delinquency. *Journal of Adolescence*, 94, 72–84.

TRAJTIM TEORIK I QASJES SË BAZUAR NË MARRËDHËNIE NË PUNË SOCIALE: ANALIZË MBI EFEKTIVITETIN DHE RËNDËSINË E SAJ

Brilanda Lumanaj

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë
Sociale*

ABSTRAKT

Qasja e bazuar në marrëdhënie në punë sociale ka një rëndësi të veçantë, kryesisht në kontekstin bashkëkohor të shërbimeve sociale, ku problemet njerëzore kërkojnë ndërhyrje të ndjeshme dhe të orientuara drejt marrëdhënies. Kjo qasje thekson se marrëdhënia ndërmjet punonjësit social dhe përdoruesit të shërbimit përbën bazën themelore të ndryshimit dhe mirëqenies psiko-sociale. Artikulli paraqet një trajtim teorik të zhvilluar përmes shqyrtimit të literaturës dhe analizës së studimeve që kanë eksploruar rëndësinë, efektivitetin dhe sfidat e kësaj qasjeje në praktikën e punës sociale. Qëllimi i punimit është të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme të koncepteve dhe bazave teorike mbi të cilat ndërtohet kjo qasje, si dhe të analizojë mënyrën se si zbatohet në kontekste të ndryshme profesionale dhe organizative. Artikulli trajton principet themelore të qasjes të bazuar në marrëdhënie, të mbështetura në teori psikoanalitike, sistemike dhe të lidhjes, të cilat theksojnë rëndësinë e empatisë, reflektimit profesional dhe “përdorimit të vetvetes” si mjete thelbësore të praktikës efektive. Qasja e bazuar në marrëdhënie kontribuon në ndërtimin e besimit, përmirësimin e komunikimit dhe krijimin e një mjedisi të sigurt emocional për individët, familjet dhe komunitetet. Hulumtime të shumta evidentojnë se kjo qasje ndihmon në përmirësimin e rezultateve të punës sociale në nivel mikrosocial dhe organizativ, duke forcuar aleancën profesionale, reduktuar stresin e punës dhe rritur qëndrueshmërinë profesionale. Artikulli nënvizon gjithashtu se, pavarësisht sfidave strukturore dhe organizative, ajo mbetet një qasje thelbësore që rikthen humanizmin në zemër të praktikës së punës sociale dhe afirmon marrëdhënien si instrumentin më të rëndësishëm të ndryshimit social.

Fjalë kyçe: *qasja e bazuar në marrëdhënie, punë sociale, empatia, reflektim profesional, efektiviteti.*

A theoretical examination of the relationship-based approach in social work: an analysis of its effectiveness and importance

ABSTRACT

The Relationship-Based Approach (RBA) in social work has gained particular importance in contemporary social service contexts, where the complexity of human problems requires sensitive and relationship-oriented interventions. This approach emphasizes that the relationship between the social worker and the service user constitutes the fundamental basis for change and psychosocial well-being. The article presents a theoretical discussion developed through a comprehensive review of the literature and analysis of studies that have explored the significance, effectiveness, and challenges of RBA within social work practice. The aim of this paper is to provide an overview of the key concepts and theoretical foundations underlying the Relationship-Based Approach and to analyze how it is applied across different professional and organizational contexts. The article discusses the core principles of RBA, grounded in psychoanalytic, systemic, and attachment theories, which highlight the importance of empathy, professional reflection, and the “use of self” as essential tools for effective practice. The relationship-based approach contributes to building trust, improving communication, and creating an emotionally safe environment for individuals, families, and communities. Numerous studies have demonstrated that RBA enhances social work outcomes at both micro and organizational levels by strengthening professional alliances, reducing work-related stress, and fostering professional resilience. The paper also emphasizes that, despite structural and organizational challenges, RBA remains a fundamental approach that restores humanism to the heart of social work practice and affirms the relationship as the most essential instrument of social change.

Keywords: *relationship-based approach, social work, empathy, reflective practice, effectiveness.*

Hyrje

Përdorimi i praktikës së bazuar në marrëdhënie mbështet procesin e ndryshimit dhe ndihmon punonjës të ndërtojë marrëdhënie të besueshme dhe autentike me klientët.

Qasja e bazuar në marrëdhënie në punë sociale thekson rëndësinë e marrëdhënieve ndërpersonale ndërmjet punonjësve socialë, klientëve dhe

sistemeve të gjera shoqërore ku ata veprojnë. Kjo metodologji bie ndesh me modelet tradicionale të fokusuara në vlerësim rrisku dhe burokraci, të cilat kanë dominuar praktikën bashkëkohore të punës sociale, sidomos në Angli. Wilkins dhe Whittaker (2017) kritikojnë këto modele tradicionale duke argumentuar se ato krijojnë konflikt teorik dhe praktik me qasjet e bazuara në marrëdhënie, duke çuar shpesh në mospërputhje ndërmjet qëllimeve të praktikës dhe rezultateve.

Qasja e bazuar në marrëdhënie bazohet në mirëkuptim të ndërsjellë, ku përvojat e jetuara të individëve shërbejnë si komponentë thelbësorë në zhvillimin e strategjive të praktikës dhe programeve të ndërhyrjes (McCormick, 2010).

Për më tepër, ajo nxit integrimin e emocioneve, duke theksuar sigurinë emocionale dhe mirëqenien. Lloyd et al., (2023) e ilustron këtë përmes konceptit të “mbrojtjes kontekstuale”, ku marrëdhëniet pozitive me profesionistët mund të ndikojnë ndjeshëm në eksperiencat e të rinjve që përballen me rreziqe jashtë mjedisit familjar.

Përfshirja e inteligjencës emocionale dhe empatisë është thelbësore në praktikën relacionare, siç argumenton Howe, i cili thekson se metodat e suksesshme të punës sociale kërkojnë që praktikuesit të jenë emocionalisht të ndjeshëm. Ky artikull paraqet një kontribut teorik në literaturën e lidhur me qasjen e bazuar në marrëdhënie (Relationship - Based Approach - RBA) në fushën e punës sociale. Artikulli synon të ndihmojë profesionistët e shërbimeve sociale dhe psiko-sociale në kuptimin më të thellë të rëndësisë që ka marrëdhënia profesionale ndërmjet punonjësit social dhe përdoruesit të shërbimit në procesin e ndryshimit dhe fuqizimit. Qëllimi i këtij punimi është të përshkruaj konceptin dhe parimet bazë të qasjes së bazuar në marrëdhënie, të evidentojë rëndësinë e saj teorike dhe praktike, si dhe të analizojë në mënyrë kritike efektivitetin e kësaj qasjeje në kontekstet bashkëkohore të praktikës sociale. Artikulli, gjithashtu, synon të ndriçojë mënyrën se si marrëdhëniet profesionale mund të kontribuojnë në krijimin e mjediseve të sigurta emocionale, reflektuese dhe mbështetëse, që janë thelbësore për ndërhyrje efektive dhe për zhvillimin e mirëqenies së individëve dhe familjeve.

Punimi është cilësor dhe është realizuar përmes shqyrtimit sistematik të literaturës shkencore, me qëllim analizimin dhe sistematizimin e njohurive teorike dhe empirike mbi qasjen e bazuar në marrëdhënie në punë sociale. Përzgjedhja e literaturës është udhëhequr nga kriteret e relevancës tematike dhe përputhshmërisë me qëllimin e studimit, duke u fokusuar në burime që: (a) trajtojnë drejtpërdrejt parimet, konceptet dhe bazat teorike të praktikës së bazuar në marrëdhënie; (b) analizojnë marrëdhënien

profesionale, empatinë, reflektimin dhe rolin e subjektivitetit të profesionistit në procesin e ndërhyrjes sociale; dhe (c) diskutojnë efektivitetin, përfitimet dhe sfidat e kësaj qasjeje në praktikën profesionale dhe organizative. Shqyrtimi është orientuar drejt ndërtimit të një kuadri analitik dhe interpretues që pasqyron zhvillimet kryesore të fushës.

Në funksion të qëllimit dhe objektivave, punimi kërkon t'i japë përgjigje dy pyetjeve kërkimore: 1. Cilat janë bazat teorike dhe parimet kryesore mbi të cilat mbështetet qasja e bazuar në marrëdhënie në punë sociale? 2. Cilat janë gjetjet kryesore që dëshmojnë efektivitetin dhe sfidat e kësaj qasjeje në praktikën profesionale të punës sociale? Përzgjedhja e literaturës është udhëhequr nga këto kritere: a) përfshirja e koncepteve dhe parimeve bazë të qasjes së bazuar në marrëdhënie; b) përfshirja e studimeve që analizojnë aspektet praktike dhe ndikimin e kësaj qasjeje në rezultatet e punës sociale; dhe c) përfshirja e evidencës shkencore që mbështet efektivitetin e saj në kontekste të ndryshme të praktikës.

Ky punim ka rëndësi të veçantë për konsolidimin dhe sistematizimin e dijes teorike mbi qasjen e bazuar në marrëdhënie në punë sociale, duke ofruar një pasqyrë të integruar të koncepteve, parimeve dhe diskutimeve kryesore që kanë orientuar zhvillimin e kësaj qasjeje në literaturën bashkëkohore. Si një studim i bazuar në shqyrtimin e literaturës, ai synon të kontribuojë në thellimin e kuptimit konceptual dhe kritik të marrëdhënies profesionale si element qendror i praktikës sociale. Megjithatë, studimi paraqet disa kufizime. Ai mbështetet kryesisht në analiza dytësore dhe në literaturë teorike ose e bazuar në evidenca korrelacionale, çka kufizon mundësinë për të nxjerrë përfundime të drejtpërdrejta shkak-pasojë mbi efektivitetin e qasjes së bazuar në marrëdhënie. Për më tepër, shqyrtimi i literaturës pasqyron zhvillimet dhe prirjet dominuese të diskursit akademik në këtë fushë, të cilat mund të mos reflektojnë në mënyrë të plotë diversitetin e konteksteve praktike dhe kulturore ku zbatohet puna sociale. Pavarësisht këtyre kufizimeve, kjo lloj analize teorike mbetet e vlefshme për ndërtimin e kornizave konceptuale dhe për orientimin e kërkimeve të ardhshme empirike dhe të bazuara në praktikë.

Bazat teorike dhe rëndësia shkencore

Qasja e bazuar në marrëdhënie paraqitet si një filozofi thelbësore në punën sociale, duke e pozicionuar marrëdhënien profesionale midis punonjësit dhe individit, familjes dhe sistemit si mjetin kryesor për arritjen e ndryshimit pozitiv (McCulloch, 2021; Howe, 2017). Historikisht, literatura e punës sociale ka theksuar dimensionet humane të kësaj marrëdhënieje si qendrore në ndërveprimin ndërmjet punonjësve dhe

klientëve (Brandell & Ringel, 2004). Kjo qasje shpesh vlerësohet për sfidimin e prireje dominuese që i japin përparësi kuptimeve kufizuese të sjelljes njerëzore dhe përgjigjeve burokratike të ngushta ndaj problemeve komplekse (Ruch, 2005; Frost & Dolan, 2021). Qëllimi themelor i qasjes së bazuar në marrëdhënie përputhet me objektivin më të gjerë profesional të përmirësimit të funksionimit biopsikosocial të njeriut (Anastas, 2014).

Rëndësia e qasjes së bazuar në marrëdhënie qëndron në faktin se kombinon teoritë psikologjike, filozofike dhe të shkencave sociale, të cilat e afirmojnë marrëdhënien si mekanizmin qendror të ndryshimit.

Modelet psikodinamike, të cilat që nga fillimi kanë qenë themelore në punën sociale me individë dhe familje, theksojnë dinamikat relacionare si bazë e ndërhyrjes profesionale. Teoria e lidhjes (attachment theory) ofron një bazë të fortë shkencore mbi rëndësinë e marrëdhënieve, e mbështetur në kërkime të gjera mbi zhvillimin neurobiologjik dhe modelet e lidhjes në fëmijëri. Studimet tregojnë se format e ndërveprimit të hershëm ndikojnë fuqimisht në strukturat njohëse, fiziologjike dhe afektive gjatë jetës (Brandell & Ringel, 2004).

Modelet e sigurta të lidhjes në moshë të rritur parashikojnë prindërim më të ngrohtë, më të ndjeshëm dhe më të përfshirë (Green et al., 2007).

Qasja e bazuar në marrëdhënie e orientuar nga konceptet e lidhjes e ndihmon profesionistin të kuptojë mënyrën se si klientët reagojnë ndaj stresit dhe ankthit, duke shërbyer si udhëzues për reflektimin mbi aftësinë e punonjësit për të siguruar një “bazë të sigurt” dhe përgjigje të ndjeshme (Foley et al., 2009).

Evidencat nga meta-analizat e psikoterapisë sugjerojnë se “faktorët e përbashkët” përbëjnë shumicën e ndryshimeve pozitive terapeutike. Këta faktorë përfshijnë marrëdhënien terapeutike, kontekstin e klientit, shpresën dhe pritshmëritë. Qasja e bazuar në marrëdhënie përputhet ngusht me këtë perspektivë, duke argumentuar se marrëdhënia terapeutike, e cila shpesh shpjegon rreth 30% të variancës së rezultateve, është më ndikuese sesa metodat teknike specifike. Kjo mbështetje empirike afirmon vlerat profesionale të punës sociale mbi rëndësinë e marrëdhënies (Drisko, 2004).

Përbërës kyç të qasjes së bazuar në marrëdhënie janë empatia dhe inteligjenca sociale. Konsiderohen si të rëndësishme aftësia për të kuptuar mendimet dhe emocionet e të tjerëve dhe për t’ua komunikuar këtë mirëkuptim klientëve. Kur klientët ndihen të kuptuar nga punonjësi social, ata ndihen të sigurt për t’u angazhuar, reflektuar dhe planifikuar ndryshime konstruktive. Empatia e lartë dhe inteligjenca sociale janë të domosdoshme për krijimin e aleancës terapeutike, e cila duhet formuar përpara se të ofrohen shërbime të strukturuar ose ndërhyrje të bazuara në evidencë

(Howe, 2017).

Modelet bashkëkohore të praktikës së bazuar në marrëdhënie mbështeten gjithnjë e më shumë në teorinë sistemike, duke adoptuar shpesh një orientim konstruksionist social. Kjo perspektivë është thelbësore sepse vë në qendër ekspertizën e përdoruesve të shërbimeve dhe identifikon rrjetet familjare dhe komunitare si burime të fuqishme për zgjidhjen e vështirësive. Për më tepër, mendimi sistematik siguron koherencë teorike, duke integruar këto modele të ndryshme, të cilat përndryshe mund të përjetohen nga praktikuesit në vijën e parë si iniciativa të fragmentuara ose konkurruese (Coulter et al., 2019).

Qasja e bazuar në marrëdhënie nuk është një modeli i ri dhe bazohet pjesërisht në ndikimet psikoanalitike që kanë orientuar kujdesin ndaj fëmijëve dhe punën sociale në shëndetin mendor që nga vitet 1940 e në vazhdim, si dhe në modelin psikosocial të lidhur me Hollis (1964). Një model bashkëkohor i praktikës së bazuar në marrëdhënie identifikon tre korniza teorike dhe konceptuale kryesore që e formojnë atë, të tilla si: teoritë psikoanalitike, sistemike dhe të lidhjes. Ky model karakterizohet nga këto elemente kyç të praktikës së punës sociale:

- Sjelljet njerëzore dhe marrëdhënia profesionale janë komponentë integralë të çdo ndërhyrjeje profesionale.

- Sjellja njerëzore është komplekse dhe shumëdimensionale. Njerëzit nuk janë thjesht qenie racionale, por kanë dimensione afektive (si të vetëdijshme ashtu edhe të pavetëdijshme) që e pasurojnë, por njëkohësisht e komplikojnë marrëdhënien njerëzore.

- Botët e brendshme dhe të jashtme të individëve janë të pandashme, kështu që përgjigjet e integruara (psikosociale), në vend të atyre njëdimensionale, janë thelbësore për praktikën e punës sociale.

- Çdo ndërveprim në punën sociale është unik dhe duhet kushtuar vëmendje rrethanave specifike të secilit individ.

- Një marrëdhënie bashkëpunuese është mjeti përmes të cilit kanalizohen ndërhyrjet, dhe kjo kërkon një theks të veçantë mbi “përdorimin e vetvetes”.

- Respekti ndaj individit, që është i integruar në praktikën e bazuar në marrëdhënie, nënkupton praktika përfshirëse dhe fuqizuese (Howe, 2018).

Theksi tek marrëdhëniet në punë sociale vazhdon të njihet universalisht, dhe madje po rritet. Marrëdhëniet përshkruhen si “zemra e punës sociale” (Trevithick, 2003). Ajo nuk është një metodë apo qasje ndaj punës sociale që mund të zgjidhet nga një listë alternativash, përkundrazi, ajo është në zemër të çdo qasjeje të përdorur me grupe të ndryshme

klientësh dhe në fusha të ndryshme praktike (Ingram dhe Smith, 2018).

Karakteristika kryesore e qasjes së bazuar në marrëdhënie është theksi që i jep marrëdhënies profesionale si ndërmjetës përmes të cilit profesionisti mund të angazhohet dhe të ndërhyjë në kompleksitetin e botëve të brendshme dhe të jashtme të individit. Marrëdhënia midis punonjësit social dhe përdoruesit të shërbimit njihet si një burim i rëndësishëm informacioni që e ndihmon punonjësin të kuptojë mënyrën më të mirë për të ndihmuar, dhe njëkohësisht kjo marrëdhënie është mjeti përmes të cilit ofrohet çdo ndihmë apo ndërhyrje (Wilson, Ruch, Lymbery dhe Cooper, 2011).

Qasja e bazuar në marrëdhënie në punë sociale është themeluar mbi të vërtetën se marrëdhënia është thelbësore për një praktikë të mirë. Ky model praktik përcaktohet si një qasje në të cilën i kushtohet shumë vëmendje detajeve dhe rëndësisë së marrëdhënies, duke përfshirë dinamikën dhe komponentët e saj, si dhe faktorët që mund ta bëjnë atë sfiduese ose paradoksale. Megjithatë koncepti është theksuar se është "i pasur dhe i larmishëm" dhe i vështirë për t'u kufizuar në një formulim të thjeshtë, vendosja e marrëdhënies në qendër të praktikës nënkupton navigimin e kompleksitetit shumëplanësh të takimit njerëzor dhe përdorimin e aftësive të punonjësit për të siguruar që marrëdhënia mbështet detyrën e punës sociale. Një kuptim themelor i kësaj qasjeje është se sjellja njerëzore është komplekse dhe shumëdimensionale, duke përfshirë dimensione afektive që janë si të vetëdijshme, ashtu edhe të pavetëdijshme (Ruch, Turney and Ward, 2010).

Efektiviteti në praktikë: rezultatet në nivel mikro dhe mezo

Efektiviteti i qasjes së bazuar në marrëdhënie është i dukshëm në disa dimensione, që nga rezultatet e drejtpërdrejta tek klientët, deri te ngritja e kapaciteteve profesionale dhe vitaliteti organizativ.

Qasja e punonjësit social e bazuar në marrëdhënie është parësore për shërbimin efektiv ndaj të rinjve me rrezikshmëri të lartë, veçanërisht duke pasur parasysh historitë e tyre të traumës së hershme, neglizhencës, dhe abuzimit, të cilat ndikojnë thellësisht në zhvillimin e trurit dhe aftësinë për të formuar lidhje dhe besim. Përvoja dhe hulumtimet tregojnë se kjo qasje siguron shërbime më të mira sesa ndërhyrjet tradicionale që fokusohen në ndëshkim dhe kërkesa për pajtueshmëri, të cilat shpesh vetëm sa e përforcojnë ndjenjën e refuzimit të këta të rinj. Për më tepër, qasja u mundëson punonjësve të ndërtojnë raportet mbi bazën e qëndrueshmërisë dhe forcave të tyre, duke i fuqizuar të rinjtë për të naviguar dhe negociuar burimet e nevojshme dhe për të sfiduar modelet e tyre negative të

brendshme të punës, duke e parë veten si ekspertë të jetës së tyre (Smith, 2024).

Në diskursin profesional dhe akademik, shfaqet një interes i ripërtërirë për konceptin e punës sociale si një qasje e bazuar në marrëdhënie. Autorët theksojnë se marrëdhënia midis punonjësit social dhe përdoruesit të shërbimit konsiderohet themelore për suksesin e praktikës dhe një komponent qendror dhe kyç në realizimin e ndryshimit. Rëndësia e kësaj qasjeje mbështetet nga dëshmitë empirike, të cilat sugjerojnë se marrëdhëniet e perceptuara si pozitive shoqërohen me rezultate më të mira të shërbimit, përfshirë ndryshime konstruktive në rastet e abuzimit me fëmijët. Kjo rritje e fokusit tek marrëdhënia shërben edhe si një përgjigje ndaj kontekstit modern të punës sociale, i karakterizuar nga rritja e kontrollit menaxherial dhe humbja e autonomisë profesionale, duke kërkuar që punonjësit socialë të zhvillojnë "aftësitë e buta" të nevojshme për praktikën relacionale (Murphy, Duggan, Joseph, 2013).

Qasja e bazuar në marrëdhënie konsiderohet thelbësore në ndërhyrjet ku klientët përballen me stres kronik ose traumë. Në ndërhyrjet e hershme në fëmijëri, ajo thekson promovimin e ndërveprimeve pozitive prind-fëmijë, në vend që të mbështetet vetëm në modele zhvillimore të fokusuara te fëmija (Barfoot et al., 2016). Studimet tregojnë se perceptimi i prindërve për mbështetje sociale ndihmon në uljen e lidhjes ankthioze/ambivalente, duke çuar në rritje më të madhe të aktiviteteve pozitive prind-fëmijë me kalimin e kohës (Green et al., 2007). Në punën me të rinjtë që përjetojnë rrezik dhe dëmtime jashtë familjes, prania e një marrëdhënieje profesionale të sigurt dhe të besuar mund të zbusë ndikimin e traumës dhe të reduktojë kohëzgjatjen e përvojave të dëmshme, duke ofruar një burim të qëndrueshëm sigurie në situata trazirash (Lloyd et al., 2023).

Një aspekt i rëndësishëm i efektivitetit të qasjes së bazuar në marrëdhënie është koncepti i "praktikuesit reflektiv" (Ruch, 2005; Winter et al., 2016). Praktika reflektive u mundëson profesionistëve të njohin ndikimin emocional të punës së tyre dhe të menaxhojnë ankthin që gjenerohet nga situatat komplekse dhe të pasigurta (Ruch, 2005). Përmes trajnimit dhe supervizimit në kuadër të kësaj qasje, marrëdhënia mbikëqyrëse funksionon si një "bazë e sigurt", duke gjeneruar një "proces paralel", në të cilin dinamika pozitive e marrëdhënieve të modeluara transferohet drejtpërdrejt në praktikën e studentit me përdoruesit e shërbimit (McCulloch, 2021). Ky lloj supervizimi mbështetës lidhet fuqishëm me rritjen e efektivitetit të perceptuar të punonjësit, kënaqësinë në punë, qëllimin për të qëndruar në profesion, si dhe përmirësimin e aftësive

të të menduarit kritik (McCulloch, 2021; Carpenter et al., 2013).

Efektiviteti i supervizimit, veçanërisht për zbatimin e qasjes së bazuar në marrëdhënie në mjedise me burime të kufizuara, varet nga faktorët organizativë (Erdogan & Enders, 2007; Lambley, 2018). Kur mbikëqyrësit ndihen të mbështetur nga organizata, shkëmbimi i tyre pozitiv me vartësit lidhet më fort me kënaqësinë në punë të punonjësve dhe me performancën e tyre (Erdogan & Enders, 2007). Organizatat që nuk arrijnë të kultivojnë hapësira të sigurta dhe reflektuese mund të gjenerojnë në mënyrë të pavetëdijshme sisteme mbrojtëse, duke i dhënë përparësi kontrollit ndaj praktikës relacionale (Lloyd et al., 2023).

Në punimin e Trevithick (2003), praktika e bazuar në marrëdhënie, veçanërisht nga një perspektivë psikosociale, shërben si platforma dhe mjeti për të gjithë punën me përdoruesit e shërbimeve. Ajo ka rëndësi për vlerësimin, adresimin e vështirësive relacionale dhe forcimin e kapaciteteve, fuqizimin dhe zhvillimin e potencialit të individëve. Për më tepër, marrëdhënia profesionale lejon punonjësit socialë të përdorin njohuritë nga vija e parë e punës për të dëshmuar dhe raportuar "të këqijat sociale" se si ndikojnë ato në jetën e përdoruesve të shërbimit, duke shërbyer kështu edhe si mekanizëm politik. Sukseset në situata komplekse nuk mund të arrihen pa marrëdhënie ku përdoren aftësitë empatike, vetënjohja dhe besimi. Kjo qasje ofron një kornizë që bashkon mënyrën si i kuptojmë njerëzit me mënyrën si punojmë me ta.

Bazuar në analizën e Bryan, Hingley-Jones dhe Ruch (2016), qasja e bazuar në marrëdhënie ka një traditë të gjatë në punën sociale në Mbretërinë e Bashkuar, edhe pse nuk mund të përcaktohet lehtësisht, pasi mbështetet në baza të ndryshme shpjeguese dhe korniza teorike. Rëndësia e saj qëndron në besimin se marrëdhënia mbështet praktikën e punës sociale në të gjitha format e saj. Efektiviteti i qasjes së bazuar në marrëdhënie është të mundësojë ndryshimin, ku praktikuesit duhet të shohin vetveten si promotorë të ndryshimit në rrethanat e jetës. Kjo qasje është kritike sepse shumë raste përfshijnë kërkesa të forta psikologjike, dhe përdoruesit kërkojnë marrëdhënie të besueshme me profesionistët. Qasja e bazuar në marrëdhënie është e rëndësishme sepse fokusohet në zhvillimin e një 'vetvete' të fortë dhe ndihmon punonjësit socialë të trajtojnë problemet jo thjesht si vështirësi, por si sfida për t'u zgjidhur në një kontekst marrëdhëniesh dhe në një mënyrë respektuese.

Sfidat dhe hendeku midis praktikës dhe teorisë

Pavarësisht rëndësisë së saj, zbatimi sistematik i qasjes së bazuar në marrëdhënie përballet me sfida të rëndësishme, veçanërisht të lidhura me

perceptimin e efektivitetit të saj dhe kontekstin organizativ.

Edhe pse vlerësohet shumë, baza e evidencave që mbështet efektivitetin e qasjes dhe praktikave mbështetëse si supervizimi shpesh përshkruhet si “çuditërisht e dobët” (Carpenter et al., 2013). Studimet zakonisht mbështeten në të dhëna korrelacionale në vend të gjetjeve shkaktuese, dhe evidenca përfundimtare që lidh cilësinë e supervizimit të drejtpërdrejtë me rezultate më të mira për përdoruesit e shërbimit mbetet e pazhvilluar (Carpenter et al., 2013; Lambley, 2018). Megjithatë, kritikët sugjerojnë se kjo mungesë evidencash mund të pasqyrojë njëanshmëri kërkimore drejt metodologjive sasiore, në kurriz të njohurive komplekse dhe holistike të gjeneruara nga kërkimet cilësore dhe nga studimet që fokusohen në faktorët e përbashkët (Anastas, 2014; Drisko, 2004).

Presionet bashkëkohore drejt menaxherializmit, metrikeve të performancës dhe llogaridhënies shpesh kanë zëvendësuar theksin mbi marrëdhënien punonjës–klient (Ruch, 2005; Wilkins & Whittaker, 2017). Kjo qasje procedurale mund të funksionojë si një mekanizëm “mbrojtjeje sociale” kundrejt ankthit profesional të natyrshëm në punën emocionale dhe sfiduese të mbrojtjes së fëmijëve (Ruch, 2005; Lloyd et al., 2023; McCulloch, 2021). Kjo zhvendosje çon në praktikë të përcaktuar ngushtësisht nga detyra burokratike, në vend të dinamikave të rrjedhshme dhe empatike të marrëdhënieve (Huxley et al., 2009; Ruch, 2005).

Shumë punonjës socialë shprehin dëshirën për t’u angazhuar në praktikë pjesëmarrëse, por e gjejnë të pamundur ta zbatojnë në mënyrë të qëndrueshme, veçanërisht në situata të rrezikut të lartë në mbrojtjen e fëmijëve. Pengesat përfshijnë besimin se qasja e bazuar në marrëdhënie “nuk është e përshtatshme për këdo” (veçanërisht për klientët që perceptohen me aftësi të ulët reflektive ose me stile jetese kaotike) dhe frikën se bashkëpunimi me prindërit mund të largojë fokusin e nevojshëm nga siguria e fëmijës (Wilkins & Whittaker, 2017). Për më tepër, në kontekste ndërprofesionale (si puna sociale forensike), rolet e punonjësve socialë mund të stereotipizohen dhe minimizohen, shpesh duke e reduktuar funksionin e tyre në trajtimin e nevojave “jologjore” të klientëve, gjë që pengon ndërtimin e marrëdhënieve të vërteta bashkëpunuese (Cole, 2012).

Marrëdhënia midis teorisë dhe praktikës mbetet e paqartë (Vindegg, 2021). Ekzistenca e një hendeku diskutohet gjerësisht, e rrënjësuar në vështirësitë për të artikuluar një bazë të veçantë njohurish për punën sociale dhe në dallimet e perceptuara midis teorisë akademike dhe kërkesave intuitive të punës në terren (Al-Ma’sheb et al., 2015; Parton, 2000). Megjithatë, studiuesit theksojnë se teoria, e ndërmjetësuar nga reflektimi kritik dhe praktika, është thelbësore për gjykimin profesional dhe

efektivitetin e praktikës (Vindegg, 2021; McGregor, 2019).

Megjithatë duhet të theksojmë se qasja e bazuar në marrëdhënie mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme si metoda thelbësore profesionale, duke e lidhur “përdorimin e vetvetes” nga punonjësi social me qëllimin themelor të ndërhyrjes humane (McCulloch, 2021). Efektiviteti i saj mbështetet nga modele teorike gjithëpërfshirëse (teoria e lidhjes, teoria sistemike, faktorët e përbashkët) dhe nga evidenca praktike në kontekste të ndryshme. Megjithatë, realizimi i plotë i potencialit të kësaj qasje kërkon adresimin e barrierave sistemike që i japin përparësi kontrollit administrativ përpara praktikës relacionale. Obligimi për kërkime të ardhshme nuk qëndron vetëm në gjenerimin e evidencave solide shkak-pasojë, por edhe në mbështetjen e kërkimit të bazuar në praktikë, i cili nxit reflektim kritik dhe artikulon njohuritë teorike të integruara në vendimmarrjen e përditshme, duke siguruar që zhvillimi i dijes në punën sociale të mbetet i rëndësishëm dhe i përgjegjshëm ndaj realiteteve komplekse të praktikës (Coulter et al., 2019; Acienė & Mačiulskytė, 2021; Ruch, 2005).

KONKLUZIONE

Qasja e bazuar në marrëdhënie shfaqet si një nga metodologjitë më koherente dhe më të qëndrueshme në praktikën bashkëkohore të punës sociale, duke ofruar një kuadër teorik dhe praktik që rikthen dimensionin njerëzor në qendër të profesionit. Analiza e literaturës tregon se baza teorike e qasjes së bazuar në marrëdhënie është e konsoliduar dhe ndërtohet mbi tre shtylla kryesore: teoritë psikoanalitike dhe psikosociale, teoria e lidhjes, si dhe teoritë sistemike dhe konstruksioniste sociale. Këto modele kontribuojnë në kuptimin e sjelljes njerëzore si proces kompleks, multidimensional dhe të ndërthurur me kontekstin social, emocional dhe relacion. Kështu, pyetjes së parë kërkimore, lidhur me bazat teorike dhe parimet që mbështesin qasjen e bazuar në marrëdhënie, i jepet përgjigje e qartë: marrëdhënia profesionale, empatia, reflektimi kritik dhe përdorimi i vetvetes janë elementët e saj themelorë, të cilët mbështeten nga një traditë e gjatë studimesh ndërdisiplinore.

Evidencat e shqyrtuara ofrojnë mbështetje të konsiderueshme për efektivitetin e qasjes së bazuar në marrëdhënie, duke dëshmuar se marrëdhëniet e forta profesionale përmirësojnë rezultatet e ndërhyrjeve në nivel mikro, si ulja e stresit dhe traumës, forcimi i aleancës punonjës–klient, rritja e aktivitetit pozitiv prind–fëmijë dhe ofrimi i një “baze të sigurt” emocionale. Në nivel mezo dhe organizativ, kjo qasje kontribuon në zhvillimin e praktikuesve reflektivë, rritjen e kënaqësisë në punë dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë profesionale, sidomos kur mbështetet nga

supervizim efektiv dhe kultura organizative reflektuese. Këto gjetje mbështesin pyetjen e dytë kërkimore, duke treguar se qasja e bazuar në marrëdhënie është funksionale përtej ndërhyrjeve individuale dhe se nxit kapacitete profesionale dhe strukturore që fuqizojnë cilësinë e shërbimeve sociale.

Megjithatë, analiza thekson edhe sfida të rëndësishme që pengojnë zbatimin e plotë të qasjes. Në literaturë vihet re një mungesë evidencash të tipit shkak-pasojë, pasi shumica e studimeve mbështeten në të dhëna korrelacionale dhe jo në dizajne që tregojnë efektin e drejtpërdrejtë të ndërhyrjes. Presionet menaxheriale, burokratizimi i praktikës dhe perceptimet e gabuara mbi përshtatshmërinë e kësaj qasje për të gjithë klientët krijojnë hendek midis teorisë dhe praktikës. Organizatat që nuk sigurojnë hapësira të sigurta reflektive rrezikojnë të gjenerojnë sisteme mbrojtëse që minojnë marrëdhënien profesionale dhe e reduktojnë punonjësin social në rol teknik.

Sidoqoftë, kontributi teorik dhe praktik i qasjes së bazuar në marrëdhënie mbetet i padiskutueshëm. Për të realizuar plotësisht potencialin e saj, kërkohen struktura organizative që vlerësojnë reflektimin, mbështesin marrëdhëniet profesionale dhe e shohin praktikën si proces human dhe jo thjesht administrativ. Inkurajohet gjithashtu zhvillimi i kërkimeve të reja që ndërthurin metodologjitë cilësore dhe kërkimin e bazuar në praktikë, për të dokumentuar më mirë ndikimin e marrëdhënieve në rezultatet e punës sociale. Në përfundim, qasja e bazuar në marrëdhënie afirmon parimin se marrëdhënia mbetet instrumenti më i fuqishëm i ndryshimit social, duke siguruar që punonjësi social të veprojë jo vetëm si profesionist, por si aktor human, reflektiv dhe transformues brenda sistemeve sociale komplekse.

REFERENCA

- Acienë, E., Mačiulskytė, S. (2014). On the discourse of social work professionalisation. *TILTAI*, 4, 143-159, ISSN 1392-3137 (Print), ISSN 2351-6569 (Online). DOI: <http://dx.doi.org/10.15181/tbb.v68i4.956>
- Adrover, R. A. J., Casado, T., Campos, F. J. (2022). Efficacy of attitudes and interventions of social work professionals: a review. *Revista de cercetare și intervenție socială*. Vol. 79, pp. 130-149. Expert Projects Publishing House. DOI: <https://doi.org/10.33788/rcis.79.9>.
- Al - Ma'seb, H., Alkhurinej, A., Alduwaihi, M. (2015). The gap between theory and practice in social work. *International Social Work*. Vol. 58(6) 819 –830. DOI: 10.1177/0020872813503860.
- Anastas, W. J. (2014). The Science of Social Work and Its Relationship to Social Work Practice. *Research on Social Work Practice*. Sagepub.com. Vol. 24(5), 571-580. DOI: 10.1177/1049731513511335.

- Barfot, J., et al., (2016). Relationship-based approaches in early childhood intervention: Are these applicable to paediatric occupational therapy under the NDIS. *Australian Occupational Therapy Journal*. DOI: 10.1111/1440-1630.12343
- Brandell, R.J & Ringel. Sh. (2004). Psychodynamic perspectives on relationship: implications of new findings from human attachment and the neurosciences for social work education. *Families in Society: The Journal of Contemporary Social Services*. Volume 85, No. 4.
- Bryan, A., Hingley-Jones, H. & Ruch, G. (2016). Relationship-based Practice Revisited, *Journal of Social Work Practice*, 30:3, 229-233 To link to this article: Doi: 10.1080/02650533.2016.1215978.
- Carpentera, J., Caroline M. Webba, M. C., Bostockb, L. (2013). The surprisingly weak evidence base for supervision: Findings from a systematic review of research in child welfare practice (2000–2012). *Children and Youth Services Review* 35 (2013) 1843–1853.
- Charfe, L., & Gardner, A. (2020). ‘Does my Haltung look big in this?’ The use of social pedagogical theory for the development of ethical and value-led practice. *International Journal of Social Pedagogy*, 9(1): 11. DOI: <https://doi.org/10.14324/111.444.ijsp.2020.v9.x.011>.
- Cole, L. P. (2012). The Role of Perceptions in Collaborative Relationships: Implications for Forensic Social Work Practice, *Journal of Forensic Social Work*, 2:1, 3-24. DOI: 10.1080/1936928X.2012.658750.
- Coulter, S., Stanley Houston, S., Mooney, S., Devaney, J. and Davidson, G. (2020). Attaining Theoretical Coherence within Relationship-Based Practice in Child and Family Social Work: The Systemic Perspective. *British Journal of Social Work* (2020) 50, 1219–1237. DOI: 10.1093/bjsw/bcz110.
- Drisko, J. (2004). Common Factors in Psychotherapy Outcome: Meta-Analytic Findings and Their Implications for Practice and Research. *Families in Society: The Journal of Contemporary Social Services*. Volume 85, No. 1, 81-90. DOI:10.1606/1044-3894.239
- Erdogan, B and Enders, J. (2007). Support from the Top: Supervisors’ Perceived Organizational Support as a Moderator of Leader–Member Exchange to Satisfaction and Performance Relationships. *Journal of Applied Psychology*. Copyright by the American Psychological Association, Vol. 92, No. 2, 321–330. DOI: 10.1037/0021-9010.92.2.321.
- Ferguson, H. (2014). Researching Social Work Practice Close Up: Using Ethnographic and Mobile Methods to Understand Encounters between Social Workers, Children and Families *British Journal of Social Work* (2016) 46, 153–168. DOI:10.1093/bjsw/bcu120.
- Foley, M., Nash, M. and Munford, R. (2009). Bringing practice into theory: Reflective practice and attachment theory. *AOTEAROA New Zealand Social Work*. Issues 1 and 2.
- Frost, N., Dolan, P. (2020). Theory, research and practice in child welfare: The current state of the art in social work. *Child & Family Social Work* published by John Wiley & Sons Ltd.
- Gentle-Genitty, S.C., Gregory, V., Pfahler, C., Thomas, M., Lewis, L., Campbell, K., Ballard, K., Compton, K., Daley, G. J. (2007). *Advances in Social Work* Vol. 8 No. 1. 62-80. Indiana University School of Social Work.

- Gray, M. and Gibbons, J. (2002). Experience-based learning and its relevance to social work practice. *Australian Social Work*. Vol. 55, No. 4.
- Green, L. B., Furrer, C., McAllister, C. (2007). How Do Relationships Support Parenting? Effects of Attachment Style and Social Support on Parenting Behavior in an At-Risk Population. Springer Science, Business Media, LLC. *Am J Community Psychol*, 40: 96–108. DOI 10.1007/s10464-007-9127-y.
- Howe, D. (2017). Empathy, social intelligence and relationship based social work. *ZESZTY PRACY SOCJALNEJ* 2017, 22, z. 1: 1–12. DOI: 10.4467/24496138ZPS.17.001.6536.
- Howe, D. (2018). Relationship-based social work second edition getting to the heart of practice. Jessica Kingsley Publishers. ISBN 978 1 78592 253 4 eISBN 978 1 78450 543 1.
- Hubkova, S., Jarmoch, E., Weiss, E., Pala, G. (2024). Social Work foundations in mental Health Care – quantitative Research. *Clinical Social Work and Health Intervention*. Vol. 1, 6, 9-27. DOI: 10.22359/cswhi_15_6_02.
- Huxley, P., Evans, SH., Beresford, P., Davidson, B. and King, S. (2009). The Principles and Provisions of Relationships. Findings from an Evaluation of Support, Time and Recovery Workers in Mental Health Services in England. *Journal of Social Work* 9(1): 99–117. Sage Publications. DOI:10.1177/1468017308098434.
- Ingram, R., Smith, M. (2018). Relationship-based practice: emergent themes in social work literature. Published in *Insights*. Aksesuar nga: <https://www.iriss.org.uk/resources/insights/relationship-based-practice-emergent-themes-social-work-literature>
- Kazdin, E. A. (2008) Evidence-Based Treatment and Practice New Opportunities to Bridge Clinical Research and Practice, Enhance the Knowledge Base, and Improve Patient Care. The American Psychological Association. Vol. 63, No. 3, 146–159. DOI: 10.1037/0003-066X.63.3.146.
- Khiatani S, Liu D, Yeo BSS and Wong JCM. (2023). Reaching hidden youth in Singapore through the Hidden Youth Intervention Program: A biopsychosocial approach integrating mental health and social work interventions. *Front. Psychiatry*. Vol.14. DOI: <https://doi.org/10.3389/fpsy.2023.1133659>
- Lambley, Sh. (2018). A Semi-Open Supervision Systems Model for Evaluating Staff Supervision in Adult-Care Organisational Settings: The Research Findings. *British Journal of Social Work*. 0, 1–20. DOI: 10.1093/bjsw/bcy069.
- Lloyd, J., Hickie, K., Owens, R., Peace, D. (2023). Relationship- based practice and contextual safeguarding: Approaches to working with young people experiencing extra- familial risk and harm. *Children & Society*. 2024; 38:1113–1129. DOI: 10.1111/chso.12787.
- Lorenzetti, L., Halvorsen, J., Dhungel, R., Lorenzetti, D., Oshchepkova, T., Haile, L. & Biscette, K. (2019). Community based mentors and journey guides: a transformative learning approach to social work education, *Social Work Education*, 38:7, 875-893, DOI: 10.1080/02615479.2019.1593956.
- McCormick, L. M. (2010). The Lived Body. The Essential Dimension in Social Work Practice. *Qualitative Social Work* Vol. 10(1): 66–85. DOI: 10.1177/1473325009359452.
- McCulloch, J. S. (2021). Relationship-based practice: Keeping the ‘heart’ in practice. *J. of Practice Teaching & Learning* 17(3), pp.82-114.

- McGregor, C. (2019). A Paradigm Framework for Social Work Theory for Early 21st Century Practice. *British Journal of Social Work*. 0, 1–18. DOI: 10.1093/bjsw/bcz006.
- Mesu, J., Sanders, K., Riemsdijk, van M., (2015). Transformational leadership and organisational commitment in manufacturing and service small to medium-sized enterprises. *Personnel Review*, Vol. 44 Iss 6 pp. 970 - 990 DOI: <http://dx.doi.org/10.1108/PR-01-2014-0020>.
- Murphy, D., Duggan, M. and Joseph, S. (2013). Relationship-Based Social Work and Its Compatibility with the Person-Centred Approach: Principled versus Instrumental Perspectives *British Journal of Social Work*. Vol. 43, 703–719. DOI:10.1093/bjsw/bcs003.
- Noble, c. (2001). Researching Field Practice in Social Work Education Integration of Theory and Practice through the Use of Narratives. *Journal of Social Work* 1(3): 347–360.
- Ono, E. (2013). Violence Against Racially Minoritized Women: Implications for Social Work. *Journal of Women and Social Work*. 28(4) 458-467. DOI: 10.1177/0886109913505044.
- Payne, M. (2001). K. nowledge Bases and Knowledge Biases in Social Work. *Journal of Social Work* 1(2): 133–146. DOI:10.1177/146801730100100202
- Robinson, K., & Masocha, S. (2017). Divergent practices in statutory and voluntary-sector settings? Social work with asylum seekers. *British journal of social work*, 47(5), 1517-1533. <https://doi.org/10.1093/bjsw/bcw105>.
- Ruch, G. (2005). Relationship-based practice and reflective practice: holistic approaches to contemporary child care social work. *Child and Family Social Work* 2005, 10, pp 111–123. Blackwell Publishing Ltd. DOI:10.1111/j.1365-2206.2005.00359.x
- Ruch, G., Turney, D. and Ward, A. (2010). Relationship - based social work. Jessica Kingsley Publishers. ISBN 978 1 84905 003 6.
- Smyth, P. (2024). Working with High-Risk Youth A Relationship-Based Practice Framework. Routledge. DOI: 10.4324/9781003360568.
- Stevens, M., Liabo, K. and Roberts, H. (2007). A review of the research priorities of practitioners working with children in social care. *Child and Family Social Work*. Vol. 12, pp 295–305. DOI:10.1111/j.1365-2206.2006.00482.x.
- Trevithick, P. (2003). Effective relationship-based practice: A theoretical exploration. *Journal of Social Work Practice: Psychotherapeutic Approaches in Health, Welfare and the Community*, 17:2, 163-176. DOI: 10.1080/026505302000145699.
- Vindegg, J. (2021). Exploring the theory–practice dimension of social work: Perceptions of children in the field of child welfare. *Outlines Critical Practice Studies*. Vol. 22, 6-31. DOI: 10.7146/ocps.v22i1.127156.
- Wilkins, D. and Whittaker, Ch. (2017). Doing Child-Protection Social Work with Parents: What Are the Barriers in Practice? *British Journal of Social Work*, 0, 1–17. DOI: 10.1093/bjsw/bcx139.
- Winter, K., Cree, V., Hallett, S., Hadfield, M., Ruch, G., Morrison, F. and Holland, S. (2016). Exploring Communication between Social Workers, Children and Young People. *British Journal of Social Work*, 0, 1–18. DOI: 10.1093/bjsw/bcw083.
- Yoshikawa, K., Wu, H-Ch., Jung, L.H. (). Generalized Social Exchange and Its Relevance to New Era Workplace Relationships. *Industrial and Organizational Psychology* 11(03). DOI:10.1017/iop.2018.100.

- Williams, J. (2022): Supervision as a secure base: the role of attachment theory within the emotional and psycho-social landscape of social work supervision, *Journal of Social Work Practice*. DOI: 10.1080/02650533.2022.2089639.
- Wilson, B. Ch Davies, S. (2009). Developing relationships in long term care environments: the contribution of staff. *Journal of Clinical Nursing*, 18, 1746–1755. DOI: 10.1111/j.1365-2702.2008.02748.x.
- Wilson K., Ruch G., Lymbery M. and Cooper, A. (2011). *Social Work: An introduction to contemporary practice*. Pearson, pp. 7–8.

PROFILE TË KOMUNIKIMIT NDËRMJET STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR

Sherif Dervishi

Universiteti i Tiranës, departamenti i Sociologjisë

ABSTRAKT

Vitet e studimeve në universitet për shumëkënd karakterizohen nga ndryshime të marrëdhënieve ndërindividuale në moshën e rinisë, nga modifikimi i komunikimit kah modelet më të sofistikuara. Studentët lënë pas përvojën e shkollës së mesme, të viteve të adoleshencës, duke u përshtatur dhe integruar në mjediset universitare me modele sjelljeje më të vetëdijshme. Nëpërmjet gjuhës së folur me njëri-tjerin, por edhe asaj simbolike të përdorur në komunikimin përballë, studentët reflektojnë pasurinë e tyre kulturore e nënkulturore, gjuhësore e dialektore të mbujtur kryesisht nga arsimi parauniversitar, familja dhe nënkultura, ku bëjnë pjesë. Duke qenë se shumica e studentëve vijnë nga njësitë administrative dhe qytetet gjeografikisht më të afërta me Shkodrën, sigurisht që mbartin me vete sfondin e tyre nënkulturor me ngjyrimet e vendit ku janë lindur e rritur. Është e përhapur gjerësisht mendësia, se çdo brez i ri është më rebel se brezat e mëparshëm, dhe si të thuash, më pak i kujdesshëm në marrëdhëniet ndërsheqërore që kërkojnë respekt të ndërsjellë. Sidomos dy dhjetëvjeçarët e fundit vihet re në përgjithësi rritja e përdorimit të gjuhës vulgare nga përfaqësues të institucioneve kryesore publike dhe private, në programet e përditshme të transmetuara nga mediat audio-vizive etj.

Në këtë artikull trajtohen disa nga veçoritë e komunikimit dhe marrëdhënieve ndërmjet studentëve të Universitetit të publik të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, që kanë të bëjnë me forma të komunikimit ndërmjet studentëve, nivelin e gjuhës së përdorur në përditshmëri, frekuencën e konflikteve dhe motivimet kryesore të konfliktimit. Forma e zgjedhur e komunikimit nga përmbajtja ndër studentët e Universitetit të Shkodrës shërben si radiografi dëshmuuese për komunikimin e specialistëve, profesionistëve, drejtuesve të vendit të së nesërme.

Ky artikull është pjesë e një studimi të gjerë për veçoritë e komunikimit ndër studentët e të gjithë universiteteve publike të Republikës së Shqipërisë. Në maj të 2025, janë anketuar, 1144 studentë (843 në programin bachelor dhe 301 në programin master,) në 12 universitete

publike të Republikës së Shqipërisë: Universiteti i Tiranës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Universiteti i Arteve, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Koncepte kyçe : komunikim, gjuhë e kulturuar, gjuhë vulgare, keqkuptime, paragjykime, konfliktme, motive konfliktimi.

Communication patterns among “Luigj Gurakuqi” University students, Shkodër

ABSTRACT

The university years for many are characterized by changes in interpersonal relationships during youth, as well as by a shift in communication toward more sophisticated models. Students leave behind the experience of high school and adolescence, adapting and integrating into university environments with more conscious patterns of behavior. Through spoken language with one another, as well as symbolic language used in face-to-face communication, students reflect their cultural and subcultural, linguistic and dialectal wealth, shaped primarily by pre-university education, family, and the subcultures they belong to.

Since most students come from administrative units and cities geographically close to Shkodër, they inevitably carry with them the subcultural background of the places where they were born and raised. The widespread perception persists that every new generation is more rebellious than the previous ones and, so to speak, less cautious in social relations that require mutual respect. Especially in the last two decades, there has generally been an increase in the use of vulgar language by representatives of major public and private institutions, in daily programs broadcast by audiovisual media, and so forth.

This article addresses some of the features of communication and relationships among students of the public University of Shkodër “Luigj Gurakuqi,” focusing on forms of student interaction, the level of language used in everyday life, the frequency of conflicts, and the main motivations behind conflicts. The forms of communication chosen and their content among students at the University of Shkodër serve as a radiographic

reflection of the communication style of the specialists, professionals, and leaders of tomorrow.

This article is part of a broader study on the features of communication among students across all public universities of the Republic of Albania. In May 2025, a total of 1,144 students (843 in bachelor's programs and 301 in master's programs) were surveyed across 12 public universities of the Republic of Albania: the University of Tirana, the University "Luigj Gurakuqi" Shkodër, the University "Ismael Qemali" Vlorë, the University "Aleksandër Moisiu" Durrës, the University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, the University "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, the University "Fan S. Noli" Korçë, the Sports University of Tirana, the Polytechnic University of Tirana, the University of Medicine Tirana, the University of Arts, and the Agricultural University of Tirana.

Key concepts: communication, polite language, vulgar language, misunderstandings, prejudices, conflicts, motives for conflict.

1. Hyrje

Qëndrimi i studentëve për disa vite në mjedisin e përbashkët universitar krijon dhe zhvillon marrëdhënie shoqërore nga më të ndryshmet, nëpërmjet komunikimit, ndërveprimit, perceptimeve madje dhe paragjytimeve të ndërsjella.

Konfliktet janë të pashmangshme, madje edhe për disa prej atyre që përpiqen t'i anashkalojnë ato. Konfliktet lindin kudo, si në mjediset profesionale, ashtu edhe në ato personale, dhe ekzistojnë në nivelet ndërpersonale dhe të angazhimit komunitar. Gjatë jetës, njerëzit përballen me konflikte të shumëllojshme (me familjarët, miqtë dhe partnerët e biznesit, me kolegët në punë etj.), por edhe me njerëz, me të cilët nuk kanë pasur marrëdhënie të mëparshme (Golubeva, I., 2023:223).

Kur studentët vijnë nga nënkultura të ndryshme, ata sjellin me vete përvoja, vlera dhe mënyra unike të qasjes ndaj detyrave universitare. Ndërkohë që kjo larmi mund të jetë një burim force, ajo mund të çojë gjithashtu në përplasje dhe keqkuptime nëse nuk menaxhohet siç duhet. Mund të lindin keqkomunikime, keqkuptime dhe/ose dallime në qasjet e zgjidhjes së problemeve (Prata, D.N., 2016:859-62).

Ky artikull studimor do të tregojë se të rinjtë që ndjekin studimet në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", nuk janë të përjashtuar nga paragjykimet, konfliktet dhe stigma për karakteristika e qëndrime të

ndryshme ndaj njëri-tjetrit. Në vijim ofrohen disa tregues demografikë për 135 studentët e anketuar në Universitetin e Shkodrës.

Tabela.1 (të dhënat në përqindje)

	Sipas përkatësisë gjinore		Sipas vendbanimit		Sipas statusit të punësimit	
	Vajza	Djem	Në qytet	Në fshat	Të punësuar	Të papunësuar
Bachelor	81	19	52	48	26	74
Master	77	23	66	34	38	62

Sic mund të vihet re nga të dhënat e tabelës 1, grupimi i studentëve vajza-djem në nivelin bachelor dhe master gjendet mesatarisht në raportin 1/5, ku mesatarisht 20% janë djem. Tregues ky që përputhet me shifrat e 10 viteve të fundit në arsimin e lartë publik në shkallë vendi, ku numri i studentëve djem është shumë më i ulët, sidomos në lëndët shoqërore.

Kështu sipas INSTAT-it nga **28,193 studentë** që përfunduan arsimin e lartë, rreth **65.8 %** ishin vajza dhe rreth **34.2 %** djem. Fushat më të preferuara nga vajzat ishin: *Shkencat Shoqërore, Gazetari e Informacion* rreth 83.0%, *Shkencat e Edukimit* rreth 81.7%, dhe *Shëndeti dhe Mirëqenia* rreth 78.9 % (2024).


Në shpërndarjen qytet-fshat, shumica e studentëve që studiojnë në Universitetin e Shkodrës vijnë nga zonat urbane dhe qytetet e qarkut Shkodër, si: Puka, Vau i Dejës, Malësia e madhe, Fushë-Arrëzi, dhe qytete të tjera përreth prefekturës Lezhë, si: Lezha, Rrësheni, Rubiku, Miloti, Laçi etj. Këto shifra përgjithësisht përkojnë me statistikën kombëtare të zhvendosjes së popullsisë drejt zonave urbane dhe shpopullimit të zonave rurale.

Sipas të dhënave statistikore të Cens-it 2023 sipas shpërndarjes së popullsisë qytet-fshat, qarku i Shkodrës është i dyti më i goditur nga rënia e popullsisë rurale pas qarkut të Kukësit me rreth 34% tkurrje nga viti 2011. Fshatrat në Njësinë Administrative të Pultit në zonën e Shkodrës përjetuan rënien më të madhe të popullsisë në Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2023 në fshatrat e Pultit kishte vetëm 245 banorë nga 1529 që ishin në vitin 2011, rreth 84% më pak. Rënie thuajse të njëjtë kishte edhe në njësinë


administrative Vig Mnellë, ku në 2023-shin kishte vetëm 256 banorë nga 1562 që ishin më 2011 (Balkanweb, 2025).

Studentët në ciklin bachelor më së shumti nuk janë të angazhuar me punë për shkak se përgjithësisht synojnë të fokusohen te studimet pa u angazhuar në veprimtari të tjera. Ndërsa afro 40% e studentëve në programin master pohojnë se janë të punësuar.

Grafiku 1 (të dhënat në përqindje)



Sipas Cens-it të vitit 2023, rreth 201.000 shqiptarë janë vetëdeklaruar që i përkasin besimit katolik. Nga këta 67.271 mijë ose rreth 34% jetojnë në qarkun e Shkodrës (INSTAT, 2024). Pjesa tjetër më e madhe e katolikëve jetojnë në qarkun e Lezhës rreth 73.938 vetë ose 37% e tyre (INSTAT, 2024). Shifra e mësipërme me rreth 62% të studentëve me besimin katolik, është mëse e kuptueshme duke patur parasysh që shumica e studentëve vijnë nga Prefektura e Shkodrës dhe Prefektura e Lezhës.




Grafiku 2 (të dhënat në përqindje).

Sic shihet në grafikun 2 është e konsiderueshme pesha specifike e

studentëve, të cilët deklarojnë se niveli ekonomik i familjeve të tyre është i ulët. Ky tregues mund të jetë më i lartë. Të rinjtë shqiptarë janë përgjithësisht shumë krenarë dhe nuk e kanë të lehtë të pohojnë se janë të varfër. Përvoja historike tregon se shqiptari nuk e ka zakon të shprehet se nuk ka, edhe kur është në nivelin e skamjes. Në rrethana të tilla është e vështirë të përshkruhet me saktësi se sa prej studentëve kanë nivel ekonomik familjar mesatar, vetëm për të mos deklaruar se ndodhen në kushte të vështira ekonomike.


Grafiku 3 (të dhënat në përqindje).



Në nivelin Bachelor janë pothuajse të barabarta peshat specifike të studentëve që kanë përparim të lartë në mësim dhe atyre që kanë performancë të dobët. Pjesa tjetër shumicë, në masën 55% vetëdeklarohen si studentë me performancë mesatare në studime.

Më domethënëse paraqiten shifrat në nivelin master, ku numri i studentëve të dobët përgjysmohet, dhe i atyre me përparim të mirë dyfishohet, gjë e cila tregon se përgjithësisht studentët më të mirë vijojnë studimet në nivelin master duke rritur peshën specifike të studentëve me performancë të lartë në studime.


Grafiku 4 (të dhënat në përqindje).



Niveli arsimor i nënave të studentëve, rreth 20% deri në 30% e tyre janë me arsim të lartë dhe pasuniversitar. Mosha mesatare e nënave të studentëve është 40-50 vjeç. Vlen të theksohet se të lindurit në vitet 1975-1985 kanë kaluar rininë e tyre në vitet më të vështira të tranzicionit politik, ekonomik dhe arsimor. Në fillim të viteve 1990 për shkak të trazirave të shumta politike e sociale shumë vajza mbeten pa u arsimuar, duke u fejuar në moshë të hershme, shpesh për të emigruar jashtë vendit me bashkëshortin e tyre. Krejt e kundërta ndodh sot pas rreth 30 vitesh demokraci, ku mbi 60% e vajzave shkollohen me arsim të lartë.

Mjaft fakte të qëmtuara në jetën e përditshme provojnë se në mjediset urbane vajzat dhe gratë nxisin njëra-tjetrën të përparojnë jo vetëm në karrierë profesionale, por edhe në karrierën shoqërore e politike. Këtë prirje e përforcon rritja e përshkallëzuar e numrit dhe e peshës specifike të vajzave e grave me arsimim më solid, që përfundojnë studimet universitare dhe mbiuniversitare me rezultate më të mira se ato të djemve dhe burrave (Dervishi, Z., 2011:250).

Grafiku 5 (të dhënat në përqindje).



Është më e lartë pesha specifike e studentëve që e kanë babain me arsim të mesëm. Arsimi i mesëm për vajzat në fillim të viteve 1990, kryesisht në zonat rurale, shikohej me sy jo të mirë për shkak të rrezikshmërisë së lartë për përfshirje të vajzave në modele sjelljesh deviante ose për mashtrimin e tyre në mjediset e shkollës nga djem emigrantë me autovetura luksoze, që kishin veprimtari kryesore joshjen e vajzave të reja me qëllim “martesën” domethënë përfshirjen në veprimtari prostitucioni, me qëllim përfitimin monetar.

2. Metodologjia

Metoda kryesore e përdorur për grumbullimin e të dhënave të këtij studimi është anketimi, përgatitur mbi bazën e shfletimit paraprak të një

informacioni mbi teoritë e komunikimit, sjelljeve dhe konflikteve ndër të rinjtë.

U përcaktuan pyetjet kryesore që do t'u drejtoheshin studentëve të cilët do të pranenin të anketoheshin. Pyetësi përmbante 89 pyetje të strukturuar që ofronin 343 alternativa përgjigjesh dhe shtatë pyetje të hapura. Përpunimi i të dhënave, është realizuar me anë të programit SPSS. Gjithsej janë realizuar 135 anketa të vetadministrueshme, 110 në nivelin bachelor dhe 25 në nivelin master. Gjithashtu janë realizuar 12 intervista kërkimore e biseda të lira me studentët, për të përthithur mendime, opinione më të nuancuara të studentëve për çështjet më të rëndësishme.

Analiza e bisedave shpesh mbulon ato që mund të dukeshin thjesht detaje periferike të jetës së përditshme, por që kanë rëndësi të madhe në studimin sociologjik. Në fund të fundit, bisedat janë tipare universale të veprimtarisë shoqërore” (Giddens; A., 2006: 225). Biseda e intervista të tilla i kanë pasuruar të dhënat e anketimit.

Studimi i çdo dukurie shoqërore mund të kryhet nga këndvështrime të ndryshme, dhe për të krijuar një tablo më gjithëpërfshirëse të asaj që ndodh, mund të përdoren metoda të ndryshme për të mbledhur informacione të shumëllojshme (Matthews, B; Ross, L., 2010:144).

Janë anketuar 30 studentë nga dega ekomomiks dhe 35 studentë nga dega financë në nivele bachelor dhe 25 studentë të nivelit master të Fakultetit të Ekonomisë. Gjithashtu janë anketuar 45 studentë nga Fakulteti i Drejtësisë të nivelit bachelor. Studentët e anketuar ndjekin kurse të ndryshme të studimeve, nga kursi i parë bachelor deri në kursin e dytë master, duke e bërë anketimin dhe studimin gjithëpërfshirës në shkallë optimale.

Është synuar me përparësi të anketohen më shumë studentë të kurseve të treta të ciklit të parë dhe studentë të kurseve master shkencor dhe profesional, sepse këto kanë përvojë komunikimi më afatgjatë në mjediset universitare. Gjithsesi edhe studentët e vitit të parë bachelor, kanë mjaftueshëm përvoja, pasi pyetësi është shpërndarë pothuajse në fund të semestrit të dytë, në maj të vitit 2025. Pyetësit u përgatitën me gjuhë sa më e qartë dhe të kuptueshme për studentët, që do të plotësonin pyetësin. Plotësimi i pyetësorëve të përgatitur u realizua në auditorët e fakulteteve përkatëse të secilit grup studentesh gjatë pushimit mes orëve.

Për formulimin e pyetjeve kërkimore janë shqyrtuar burime literature profesionale, monografi dhe vepra të rëndësishme të fushës së sociologjisë së komunikimit. Analiza e të dhënave dytësore është e rëndësishme sepse, *së pari* e ndihmon hulumtuesin të kursejë kohë e para për mbledhjen e të dhënave, të cilat janë mbledhur nga profesionistë të tjerë më parë dhe *së*

dyti, të dhënat e marra nga burime zyrtare sigurojnë nivel të lartë besueshmërie dhe vlefshmërie (Bouslaugh, S., 2007: 125).

Pyetësi është përgatitur në formatin “*hard copy*”, dhe përmban 7 faqe fletë formati A4. Nuk u përdorën metoda bashkëkohore për mbledhjen e të dhënave empirike me formatin “*Google form*”, pasi pyetësi ishte i gjatë. Ky pyetësor u testua paraprakisht me studentët e Universitetit të Tiranës të cilët ndiheshin të lodhur nga plotësimi i pyetësit përmes ekranit të vogël të telefonit celular. Plotësimi i këtij pyetësi me shkallë të lartë përgjegjësie, zgjaste mesatarisht 22-25 minuta. Gjithashtu për çështje sigurie të mbledhjes së të dhënave direkt nga përgjigjedhësit, kam qenë vetë i pranishëm në çdo auditor ku janë plotësuar pyetësorët. Para plotësimit të pyetësit, u kam paraqitur studentëve pyetësin dhe kam shpjeguar rëndësinë e tij.

Gjatë çdo shpjegimi paraprak, kam kërkuar që studentët, të cilët nuk dëshirojnë ta plotësojnë të mos e marrin pyetësin. Kam sqaruar me përparësi se vetëm ata studentë që janë dakord ta përfundojnë atë do t’u jepet mundësia për ta plotësuar. Kjo metodë komunikimi, më ka ndihmuar, për të tërhequr vetëm studentët e interesuar që të japin përgjigje të sakta dhe të sinqerta të gjitha pyetjeve deri në fund. Kësisoj besueshmëria e studimit nëpërmjet këtij filtri konsiderohet të jetë më e lartë.


III. Temat e komunikimit, si barometër i botëkuptimit psikosocial të studentëve

Komunikimi është veprimtari njerëzore që të gjithë e njohin, por pakkush mund ta përkufizojë atë në mënyrë të kënaqshme (Fisce, J., 2010:1). Komunikimi ndër breza ka pësuar vazhdimisht ndryshime të konsiderueshme edhe nga rrethanat e zhvillimeve shoqërore. Kështu, për shembull, dy studentë të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike në Universitetin e Tiranës në vitin 1981, nuk mund të diskutonin me njëri-tjetrin jashtë “kornizave zyrtare” çështje që lidhen me politikën ose fushatat elektorale, pasi një gjë e tillë ishte e pamundur në kushtet e një organizimi shoqëror dhe politik, ku drejtonte një parti të vetme, Partia e Punës së Shqipërisë e cila ishte parti-shtet. Për më tepër bisedat sadopak me ngjyrimë politike kundërshtarë, mund të hapnin telashe serioze me ligjin, deri në dënim me heqje lirie.

Studiuesi amerikan i komunikimit, George N. Gordon e përkufizon komunikimin si “Procesi i shkëmbimit të kuptimeve ndërmjet individëve, nëpërmjet një sistemi të përbashkët simbolesh” (2020). Kësisoj të dhënat e mëposhtme të studentëve të Universitetit të Shkodrës, lipsen kuptuar të lidhur me botëkuptimin dhe sistemin e përbashkët të simboleve dhe

kuptimit për jetën shoqërore të ditëve të sotme, si një tregues jo vetëm për të rinjtë e këtij universiteti, por në shkallë përgjithësuese edhe për të rinjtë e tjerë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dinamikën shoqërore të kohës. Kësisoj pyetjes se cila është tema për të cilën diskutoni më shumë me shokët/shoqet tuaja më të afërt(a), studentët janë përgjigjur sipas grafikut 6.

Grafiku 6 (të dhënat në përqindje).



Vlen të analizohet si karakteristikë e studentëve të Universitetit të Shkodrës në masë të konsiderueshme me rreth 11 % e tyre, komunikimi vazhdimisht për çështje politike, madje dhe me pasion dhe tone të larta në nivel tifozlliku. Këtë e hasa dhe vetë si studiues gjatë anketimeve kur 2 vajza kishin shkruar në fund të fletës së bardhë të anketës nëse unë isha me partinë e saj politike të preferuar? Studentë të tjerë hapnin debate politike në auditor sapo u flisje për zhvillimin e turizmit në qytetin e Shkodrës, në mbështetje dhe në kundërshti të qeverisë lokale dhe qendrore.

I trishtë, por domethënë paraqitet fakti se asnjë student nuk është shprehur se flet me shoqet e shokët e afërt për letërsinë. Ky tregues flet për leximin e paktë të literaturës jashtëshkollore të studentëve, aq sa të mos jetë temë diskutimi në mjediset e përbashkëta universitare dhe në orët që kalojnë në kafenetë e qytetit.

Gjithashtu dhe mediat audio-vizive, ndiqen nga më pak studentë, krahasur me rrjetet sociale. Vendi i programeve specifike në TV dhe filmave në përgjithësi si një mënyrë argëtimi e brezave *Milenium* dikur (mijëvjeçarët, të lindurit nga 1981 deri në 1996), duket se te brezi Z, është zëvendësuar me të folurit për rrjetet sociale. Gjenerata Z përfshin persona të lindur në vitin 1995 ose më vonë, të cilët nuk e kanë përjetuar botën pa

teknologjinë digjitale (Ameen & Anand, 2020:181–92). Kohën që dikur e merrte më së shumti TV, si mundësi informimi masiv, tashmë e merr rrjeti elektronik mbarëbotëror me programe të shumta informimi dhe argëtimi.


Shumica e studentëve djem dhe vajza shprehen mesatarisht në masën 42% se flasin më së shumti për mësimet. Kjo shifër nuk mund të përkthehet plotësisht si interesim i vazhdueshëm për përparimin në mësimet, por si një interesim i një pale të konsiderueshme studentësh për t'i ndjekur shënimet e leksioneve dhe të rejat më të fundit nga lëndët e ndryshme universitare nga një shoqe/shok që merr pjesë rregullisht në leksione dhe informohet plotësisht për të gjitha detyrat që kërkojnë pedagogët e lëndëve përkatëse. Shpeshherë shoqëritë që kanë temë të vazhdueshme biseda të tilla, konsiderohen si shoqëri me interesa profesionale dhe të ndërsjella.

IV. Perceptime të studentëve për fjalorin e komunikimit

“Shkopinjë dhe gurët mund të m'i thyejnë kockat, por fjalët kurrë s'mund të më lëndojnë”. Ky refren i një kënge pop te të rinjtë është i gabuar sa më s'ka. Fjalët nuk mund t'i thyejnë me të vërtetë kockat e njerëzve, por ato janë armë të fuqishme që mund të lenë plagë psikologjike po aq sa shkopinjë dhe gurët mund të lenë shenja fizike (Lucas, E., Stephen, 2011:65)

Perceptimi rreth nivelit të fjalorit të përdorur në komunikime ndërmjet të rinjve universitarë, na ndihmon për të kuptuar sfondin e botëkuptimeve të studentëve, për të respektuar veten dhe tjetrin gjatë një bisede të zakonshme. Kështu pyetjes: “*Si e konsideroni fjalorin e komunikimit të përditshëm mes studentëve?*” Në mënyrë sintetike përgjigjet e tyre jepen në grafikun 7.

Grafiku 7 (të dhënat në përqindje).



Vlen të analizohet treguesi “vulgar” në grafik, ku 7% e studentëve bachelor dhe 33% e studentëve master e konsiderojnë fjalorin e

komunikimit të përditshëm mes tyre si vulgar. Diferenca e konsiderueshme prej 26% mes dy studentëve të dy niveleve të studimeve ngre dyshime ose për një komunikim më të mirë në përgjithësi të studentëve bachelor dhe që më pas me kohën e përkeqësojnë fjalorin e tyre, ose të aftësisë gjykyese të studentëve master si më objektiv në faktin kur ngrejnë alarmin se komunikimi mes tyre është në masën 33% vulgar. Zakonisht me moshën rritet dhe aftësia gjykyese më e mirë, por edhe ndjeshmëria më e lartë ndaj fjalëve të artikuluar pa kujdes dhe me konotacion vulgar sesa në moshë të re. Megjithatë vlerat e bashkuara me treguesit “vulgare” dhe “disi vulgare” janë shumë të përafërta me rreth 40% nga studentët bachelor dhe 38% nga studentët master. Këto tregues mund të konsiderohen alarmant për nivelin e komunikimit ndër të rinjtë universitarë.

Sipas një studimi të studiueseve ukrainase Natalia Tavrovetska dhe Vitaliia Shebanova për përdorimin e gjuhës vulgare tek të rinjtë 16-20 vjeç, perceptimi më tolerant ndaj gjuhës vulgare u zbulua në Rusi dhe Poloni. Në Ukrainë, 43.7% e të anketuarve shprehën një qëndrim të përgjithshëm negativ, por ukrainasit e perceptojnë fjalën e pisët ndaj vetes veçanërisht serioze. Amerikanët e rinj mbajnë qëndrim më negativ në lidhje me gjuhën e shfrenuar në përgjithësi (si një fenomen), por ata janë mjaft tolerantë ndaj përdorimit të saj në nivel personal. Në terma të frekuencës dhe natyrës së përdorimit të gjuhës së shfrenuar, grupi ukrainas është më i ngjashëm me ata amerikanë dhe polakë, sesa me grupin rus (2020:239–66).

Kësisoj edhe studentët shqiptarë janë më të ngjashëm me qëndrimet e të rinjve amerikanë dhe ukrainas për sa i përket mostolerancës së gjuhës vulgare të përdorur nga të tjerët, por e tolerojnë më shumë në përdorim personal.


Gjuha vulgare nuk është etike, sepse ajo zhvleftëson njerëzit. Një gjuhë e tillë është gjithashtu një forcë shkatërruese sociale (Lucas, E., Stephen, 2011:66). Një pjesë e konsiderueshme e studentëve bachelor i konsiderojnë normale edhe bisedat, të cilat janë vulgare. Këtë e dëshmon edhe fakti që studentët e bachelor-it edhe pse më të shumtë në numër, kanë konsideruar bisedat me fjalor të kulturar në nivel minimal, me vetëm 5%. Ndërkohë studentët e nivelit master janë përgjigjur me numër 3-fish më të lartë rreth 15% se komunikimi mes tyre është i kulturar. Të jesh etik dhe të flasësh me kulturë do të thotë të sillesh me etikë *gjatë gjithë kohës*, jo vetëm kur të leverdis” (Lucas, E., Stephen, 2011:67).

V. Dendësia e konflikteve me studentet vajza


Denduria e konflikteve me studentet vajza, të cilat përbëjnë më shumë se 80% të studenteve në universitet, lipset të shihet për të analizuar nëse

janë vajzat apo djemtë ata që konfliktohen më shumë me studentet vajza. Të pyetur: “*Sa shpesh jeni konfliktuar me studentet vajza të të njëjtit cikël studimesh?*”, studentët janë përgjigjur si më poshtë:

Grafiku 8. (Vlerat për studentet bachelor në përqindje).



Grafiku 9. (Vlerat për studentet master në përqindje).




Siç shihet nga grafikët përkatës, vlerat e të gjitha variablave për dendurinë e konflikteve me studentet vajza gjenden pothuasje të njëjta ndër studentët e nivelit bachelor dhe master. Siç pritej, vajzat konfliktohen më shumë me vajzat se sa djemtë; është 7 herë më e lartë denduria e konflikteve të studenteve vajza me vajzat, se e studentëve djem. Te studentët master treguesit e konflikteve me studentet vajza është më e balancuar si raport vajza-djem edhe për faktin se kurset master janë mesatarisht 15-20 veta, ku raporti gjinor është më i ngushtë se në studimet bachelor dhe vlerat përkthehen më të larta për secilin prej treguesve. Vlen të theksohet se mesatarisht në masën mbi 65% studentët janë shprehur se nuk konfliktohen me studentet vajza. Ky është një tregues që konsiderohet normal në kushtet

e dinamikave dhe motiveve të ndryshme për konfliktim në një shoqëri, e cila po kalon ende probleme të theksuara me tranzicionin e zgjatur në 35 vite.

VI. Motivet e konflikteve ndër studentet vajza

Pasi vumë re dendësinë e konflikteve me studentet vajza, le të analizojnë disa nga shkaqet e konflikteve, duke u mbështetur tek të dhënat e grafikut 10 dhe grafikut 11.

Grafiku 10. (Vlerat për studentet bachelor %).



Siç mund të vihet re shkaku kryesor i konflikteve është mungesa e komunikimit të duhur, i cili sjell si pasojë keqkuptime nga më të ndryshmet. Rreth 53 % e studentëve nga të cilët 44% vajza dhe 9% djem janë konfliktuar për shkak të keqkuptimeve në komunikim. Në pyetjen e hapur, ku kanë shprehur problematikat e hasura në përditshmëri në mjediset universitare, studentët kanë theksuar mungesën e tolerancës në komunikim. Thashethemet gjithashtu zënë një peshë të konsiderueshme mes studenteve vajza ku rreth 15% e tyre pohojnë se janë konfliktuar për fjalët e thëna për ta pas krahëve ose në mungesë të tyre. Studiuesi Artan Fuga në librin “Komunikimi në shoqërinë masive” citon një shprehje interesante lidhur me njerëzit që flasin keq. “Ai flet gjithmonë në mënyrë të sinqertë, sepse flet prapa krahëve” (2011:191).


Një tregues tjetër me interes është fakti i konflikteve për shkak të përpjekjeve për të mbizotëruar në grup. Konfliktimi i vajzave me bashkëstudentet për këtë arsye është në peshë specifike të konsiderueshme, me rreth 14%, ndërsa djemtë nuk konfliktohen fare për të marrë rolin e liderit në grup. Kohët e fundit rrethanat ekonomike-shoqërore i japin më shumë përparësi vajzave të marrin rolin e lideres në shoqëri. Ky tregues

gjendet tashmë dendur në jetën shoqërore të vendit ku gati gjysma e drejtuesve vendore dhe lokale janë vajza dhe gra.

Në qeveri dhe në administratën e Republikës së Shqipërisë mbi 45% të gjinisë femërore janë në drejtim (rtsh.al, 2024). Në fushën e arsimit në vitin akademik 2022-23, në stafin mësimor mbizotërojnë gratë në arsimin 9-vjeçar dhe atë të mesëm të lartë, përkatësisht rreth 77,4% dhe rreth 69,8% e mësuesve të secilit nivel. Në nivelin e arsimit të lartë, në stafin akademik me kohë të plotë, gratë me titull *profesor* përbëjnë rreth 45,8 %, ato me titull *doktor i shkencave* rreth 62,1% (INSTAT, 2024).

Sociologu Zyhdi Dervishi ka argumentuar se në mjaft zyra të institucioneve shoqërore dhe jopublike, fytyrat e vrazhda, dinake e herë herë enigmatike të burrave po zëvendësohen nga fytyra më të brishta nëpunësesh vajza ose gra, të cilat përgjithësisht duken më të prira t'i zgjidhin problemet e shumëllojshme që shqetësojnë qytetarët më me përkushtim, më me korrektësi, në përputhje me kriteret ligjore (2011:249).


Grafiku 11 (Vlerat për studentet master %).




Ndër studentët e nivelit master, shpërndarja e treguesve është më lineare ku konfliktimet për keqkuptime të rastit bien me rreth 23% të peshës specifike krahasuar me studentët e nivelit bachelor. Studentët e nivelit master janë më të rritur dhe më të pjekur për t'u konfliktuar për keqkuptime që lindin më së shpeshti nga fjalët e papërshtatshme në komunikim. Ndër studentët e nivelit master ka më shumë të konfliktuar për thashethemet, të cilat janë përgjithësisht më të përhapura te njerëzit në moshë të madhe. Mesa duket kjo rritet ndjeshëm edhe te studentët e nivelit master, të cilët për pakënaqësitë që lindin gjatë qëndrimit në auditor, vendosin të mos shprehen lirshëm, por të jenë më të rezervuar përballë të tjerëve dhe më të hapur me shoqet ose shokët që i besojnë më shumë.

Komunikime të tilla, shpeshherë vihen re dhe diktohen nga palët e treta për të cilët po bisedohet, në këto raste konflikti verbal është pothuajse i pashmangshëm. Ndryshe nga studentët djem të nivelit bachelor, paraqitet situata me studentët e nivelit master, të cilët ishin të paiterësuar për konkurrencë në studime dhe për të mbizotëruar në grup. Studentët djem të nivelit master janë njësoj të interesuar dhe konkurrencial me studentet vajza për sa i përket konflikteve me bazë konkurrencën e pandershme dhe përpjekjet për mbizotërimin në grup.

VII. Dendësia e konflikteve me studentët djem.



Grafiku 12. (Vlerat për studentët bachelor në përqindje).



Grafiku 13 (Vlerat për studentët master në përqindje).

Siç mund të kuptohet nga të dhënat e grafikut 12 dhe grafikut 13, dendësia e konflikteve me studentët djem është me rreth 14% më e ulët se treguesi


me studentet vajza te grafikët 8 dhe 9. Studentet vajza konfliktohen më pak me studentët djem se sa me studentet vajza. Studentët djem konfliktohen (me rreth 3% më shumë) me djemtë se me studentët vajza, një tregues pak më i lartë i konflikteve me studentët me të njëjtën përkatësi gjinore.

Në shoqërinë tradicionale shqiptare konfliktimet e vajzave me djemtë ishin pothuajse të pamundur. Djemtë mund të konfliktoheshin dendur me njëri-tjetrin, por jo me vajzat. Një reminishencë nga e kaluara ende është e pranishme në mendësinë e të rinjve shqiptarë që djemtë s’duhet “të merren me vajzat dhe gratë”, se konflikti me ato nuk tregon burrëri.


VI. Motivet e konflikteve me studentët djem

Nga të dhënat e grafikëve 12 dhe 13 del se studentët në tërësi konfliktohen më pak me studentët djem sesa me studentet vajza. Le të shqyrtojmë motivet e konflikteve me studentët djem sipas të dhënave të grafikëve 14 dhe 15.

Grafiku 14. (Vlerat për studentët bachelor në përqindje).



Grafiku 15. (Vlerat për studentet master në përqindje).



Motivi kryesor i konflikteve të studentëve bachelor dhe master me studentët djem janë për keqkuptime të rastit. Këto keqkuptime më së shumti kanë lindur mes djemve, pasi këtë e kanë pohuar rreth 10% më shumë e studentëve djem të programit bachelor. Ndërkohë vetëm rreth 6% e studentëve vajza të programit bachelor konfliktohen me studentët djem për keqkuptime.

Ndër studentët master ky variabël i konfliktit për keqkuptime të rastit është me një epërsi fare të lehtë me, rreth 2% më shumë te vajzat dhe rreth 3% më shumë te djemtë.

Një tregues me interes shfaqet variabli ku një pakicë prej rreth 5% e vajzave dhe rreth 10% e djemve shprehen se janë konfliktuar nga paragjykimet që kanë ndier për besimin e tyre fetar. Lipset përmendur se Shkodra është një ndër qytetet ku ndjeshmëria për besimet fetare është më e lartë se në pjesë të tjera të hapësirës shqiptare.

Studentët djem nuk konfliktohen aspak me djemtë e tjerë për thashetheme. Djemtë në të dyja nivelet e studimit, referuar grafikut 14 dhe 15 nuk përfshihen në thashetheme.

Ndryshe ndodh me studentet vajza të programit bachelor ndër të cilat rreth 14% pohojnë se janë konfliktuar me studentët djem dhe rreth 15% me studentet vajza për *thashethemet* e shkaktuara nga palët.

Duke risjellë në vëmendje faktin se shkaktarët kryesorë të konflikteve të studenteve vajza me të dyja gjinitë me diferencë të konsiderueshme me studentët djem janë *keqkuptimet e rastit* në komunikim. Thashethemet kanë më pak ndikim në jetën e përditshme të të rinjve shqiptarë dhe treguesi i mësipërm shkon paralel me zhvillimet shoqërore të dy dhjetëvjeçarëve 2005-2025.

Në studimin e tij për nxënësit në shkollat e mesme, ndër të tjera studiuesi Zyhdri Dervishi është shprehur: “Mendojmë se në të ardhmen, masa e konfliktimit të adoleshentëve e të rinjve nën tryshninë e thashethemeve e të paragjykimeve do të pakësohet në mënyrë të ndjeshme si rrjedhojë e ndikimit të zhvillimeve të profilit modern e pasmodern”. (2013:93). Gjithashtu ndër shkaqet kryesore të konflikteve që hasin banorët në komunitetin e Kamzës, të ardhur nga gjithë rrethet e Republikës së Shqipërisë, sociologu Alfred Halilaj përmend keqkuptimet në komunikim (2021:162).

Në grafikun 15 vendin e variablit të thashethemeve e kanë zënë dy tregues të tjerë shqetësues që janë paragjykimet për mënyrën e veshjes dhe sjelljes, në masën rreth 50%. Këto 2 tregues janë burim konfliktesh kryesisht me studentet vajza. Kështu, rreth 30% e vajzave kanë pohuar se janë konfliktuar me një student djalë për shkak të paragjykimeve për

veshjen e tyre. Ndërsa rreth 20% pohojnë se janë konfliktuar me djemtë e nivelit master për paragjykimet në lidhje me mënyrën e tyre të sjelljes.

VII. Përfundime dhe sugjerime

Shumica e studentëve të Universitetit të Shkodrës nuk janë konfliktuar asnjëherë me bashkëstudentët e tjerë. Konfliktet nuk janë të shpeshta, por janë shqetësuese ndër 25% e studentëve, të cilat lindin më së shumti si rrjedhojë e keqkuptimeve të rastit në komunikim, e thashethemeve dhe e paragjytimeve të llojeve të ndryshme. Studentet vajza konfliktohen më dendur me njëra-tjetrën sesa me djemtë; keqkuptimet janë shkaktari kryesor.

Temat e komunikimit ndërmjet studentëve të Universitetit të Shkodrës më së shumti janë rreth mësimave 42%, rrjeteve sociale rreth 19%, politikës rreth 11 %. Për letërsinë nuk flitet pothuajse fare. Fakti që nuk flitet për letërsinë në biseda me shoqërinë në universitet nuk do të thotë që të gjithë studentët nuk lexojnë libra artistikë, por se librat artistikë nuk janë të pranishme në temat e bisedave të tyre të përgjithshme. Vendin e bisedave rreth librave duket se e kanë zënë rrjetet sociale dhe programet televizive.

Për sa i përket nivelit të gjuhës së përdorur, rreth 7% e studentëve bachelor dhe rreth 33% e studentëve master e konsiderojnë komunikimin e përditshëm si vulgar. Diferenca tregon rritje të ndjeshmërisë ndaj komunikimit me bashkëstudentët, përcaktuar nga maturimi në moshë dhe përparimi në studime. Duke përfshirë edhe ata që e vlerësojnë komunikimin si “disi vulgar”, rreth 40% e studentëve në të dyja programet e studimit bien dakord, që etika e gjuhës së përdorur në komunikim është problematike. Shqetësues është fakti se vetëm rreth 5% e studentëve bachelor dhe rreth 15% e atyre të programit master e konsiderojnë gjuhën e përdorur në komunikim si të kulturuar.

Universitetet publike në Republikën e Shqipërisë lipset të punojnë me përparësi për të krijuar klimë bashkëpunuese mes studentëve që të njihen më shumë me njëri-tjetrin përmes veprimtarive të përbashkëta edhe jashtë programeve shkencore.

Promovimi i kanaleve të komunikimit të hapura, transparente, dëgjimi aktiv (Wise, Dickinson, Katan, & Gallegos, 2020:339–52) dhe lehtësimi i dialogut konstruktiv mund të ndihmojë në zbutjen e konflikteve (Pelesiah, Agalo, & Kinya, 2018:11). Duke patur bashkëpunime intensive të studentëve me njëri-tjetrin me mbikëqyrjen e

pedagogëve do të mundësohet vetëdije më e fisme në marrëdhëniet e studentëve me njëri-tjetrin.

Vetëdija është një faktor i rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve. Zhvillimi i vetëdijes i ndihmon njerëzit t'i qasen konfliktit në mënyrë konstruktive, duke menaxhuar emocionet e tyre dhe duke zhvilluar strategji komunikimi më racionale (Aşkun & Çetin, 2016:159).

Përdorimi i gjuhës së pakujdesshme dhe vulgare në ndërveprimin e studentëve me njëri-tjetrin sjell probleme shqetësuese në fushën e komunikimit, duke e kontraktuar atë në vazhdim për të qenë komunikim i hapur dhe akademik. Pranimi i tjetrit me mendësi dhe qëndrime të larmishme, është sfidë për shoqërinë shqiptare në tërësi, barrë që u takon të rinjve universitarë që ta mbajnë për të treguar se tashmë nuk janë vetëm qytetarë të Republikës së Shqipërisë, por edhe qytetarë të botës së lirë me koncepte të vlerave universale.

LITERATURA KRYESORE

- Ameen, Nada, and Amandeep Anand. "Generation Z in the United Arab Emirates: A Smart-Tech-Driven iGeneration." In *The New Generation Z in Asia: Dynamics, Differences, Digitalisation*, edited by Evrim Gentina and Emma Parry. Bingley: Emerald Publishing, 2020. <https://doi.org/10.1108/978-1-80043-220-820201018>.
- Aşkun, Deniz, and Füsün Çetin. "The Role of Mindfulness in Conflict Communication Styles According to Individual Locus of Control Orientations." *Journal of Organizational Culture, Communications and Conflict* 20 (2016).
- Boslaugh, Sarah. *Secondary Data Sources for Public Health: A Practical Guide*. Cambridge: Cambridge University Press, 2007.
- Dervishi, Zyhdi. *Adoleshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve*. Shtëpia Botuese "Emal" Tiranë, 2013.
- Dervishi, Zyhdi. *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*. Shtëpia Botuese "Emal" Tiranë, 2011.
- Giddens, Anthony. *Sociology*. 5th ed. Cambridge: Polity Press, 2006.
- Golubeva, Irina. "Raising Students' Self-Awareness of Their Conflict Communication Styles: Insights from an Intercultural Telecollaboration Project." *Societies* 13, no. 10 (2023). <https://doi.org/10.3390/soc13100223>.

- Halilaj, Arben. *Zhvillime urbane, tradita dhe risi: Rasti i Kamzës*: West Print, Tiranë 2021.
- Matthews, Bob, and Liz Ross. *Metodat e hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. CDE, Tiranë 2010.
- Pelesiah, Oliver A., James Agalo, and Hellen Kinya. "Dialogue as a Management Tool for Conflict Resolution at Rongo University, Kenya." *International Journal of Social Science and Information Technology* 4, no. 12 (2018)
- Prata, Diana N. "The Role of a Help Requester in Collaborative Learning." *International Journal of Information and Education Technology* 6, no. 11 (2016)
- Stephen, Edmond Leka. *Arti i të folurit në publik*. Tiranë: UET Press, 2011.
- Tavrovetska, Natalia, and Victoria Shebanova. "Cross-Cultural Research of the Use of Obscene Language in the Youth Environment." *Psycholinguistics* 28, no. 1 (2020). <https://doi.org/10.31470/2309-1797-2020-28-1-239-266>.
- Wise, George, Cheryl Dickinson, Tamar Katan, and Maria C. Gallegos. "Inclusive Higher Education Governance: Managing Stakeholders, Strategy, Structure and Function." *Studies in Higher Education* 45, no. 2 (2020)
- Gordon, Glenn N. "Communication." *Encyclopaedia Britannica*. Accessed July 2025. <https://www.britannica.com/topic/communication>.
- Radio Televizioni Shqiptar. "Nga 2016–2024 rritet me 13.3% pjesëmarrja e grave në bordet drejtuese." Aksesuar Korrik 2025. <https://rtsh.al/nga-2016-2024-rritet-me-13-3-pjesemarrja-e-grave-ne-bordet-drejtuese/>.
- Instituti i Statistikave (INSTAT). *Burra dhe gra 2023*. Aksesuar Korrik 2025. <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>.
- *Censi 2023: Shkodra*. Aksesuar Korrik 2025. <https://www.instat.gov.al/media/14322/cens-2023-shkodra.pdf>.
- *Censi 2023: Lezha*. Aksesuar Korrik July 2025. <https://www.instat.gov.al/media/14321/cens-2023-lezha.pdf>
- <https://www.instat.gov.al/media/mxfk42go/statistikat-e-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2024-2025.pdf>.

- <https://www.balkanweb.com/harta-e-re-e-popullsise-rurale-si-po-zhduken-fshatrat-shqiptare-shkodra-nder-me-te-goditurat/>

ABUZIMI I DROGËS TEK TË RINJTË

Elidjon Cami¹, Sonila Lisaj²

¹ Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Psikologjisë
dhe Punës Sociale

² Studente në degën Punë Sociale

ABSTRAKT

Ky artikull shqyrton fenomenin e përdorimit të drogave tek të rinjtë në Shqipëri nëpërmjet një qasjeje të kombinuar që përfshin rishikimin sistematik të literaturës dhe një studim empirik me nxënës të shkollave të mesme në qytetin e Shkodrës. Droga mbetet një problem i përhapur në mbarë botën dhe, siç tregon literatura, kanabisi, opioidet dhe amfetaminat janë substancat më të përdorura ilegalisht. Në kushtet shqiptare, tranzicioni socialekonomik dhe boshllëku i shërbimeve shëndetësore kanë krijuar një terren të ndjeshëm për përhapjen e varësisë.

Studimi empirik u bazua në një pyetësor online, të hartuar në Google Forms, ku morën pjesë 48 nxënës të shkollave të mesme, të moshave 15–18 vjeç. Synimi ishte të vlerësoheshin njohuritë, opinionet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me përdorimin e drogës. Të dhënat treguan se shumica e pjesëmarrësve kanë njohuri për substancat narkotike dhe pasojat e tyre; ata i konsiderojnë drogat të dëmshme, por një pjesë e konsiderueshme raporton se mungesa e informacionit, presioni i shoqërisë dhe kërkimi i kënaqësisë janë arsytet më të shpeshta të përdorimit. Rezultatet nënvizuan gjithashtu se nxënësit mbajnë qëndrim negativ ndaj drogave, por janë të pavendosur për mënyrën se si duhet të trajtohen përdoruesit.

Ky punim ofron një pasqyrë të rëndësishme për profesionistët e punës sociale dhe politikëbërësit në Shqipëri, duke theksuar nevojën për programe edukative, zgjerimin e shërbimeve rehabilituese dhe përfshirjen aktive të shkollave në ndërgjegjësimin e të rinjve për rreziqet që paraqesin substancat psikoaktive.

Fjalë kyçe: përdorimi i drogave, të rinjtë, Shkodër, njohuri, opinione, qëndrime, punë sociale.

Drug abuse among youth

ABSTRAKT

This article examines the phenomenon of drug use among young people in Albania through a combined approach that includes a systematic review of the literature and an empirical study involving high school students in the city of Shkodër. Drug abuse remains a widespread problem worldwide and, as the literature shows, cannabis, opioids and amphetamines are among the most commonly used illicit substances. In the Albanian context, socio-economic transition and gaps in health services have created a particularly conducive environment for the spread of addiction.

The empirical study was based on an online questionnaire developed in Google Forms, in which 48 secondary-school pupils aged 15–18 took part. Its aim was to assess their knowledge, opinions and attitudes regarding drug use. The data showed that most respondents are aware of narcotic substances and their consequences; they consider drugs harmful, but a significant proportion report that lack of information, peer pressure and the pursuit of pleasure are the most frequent reasons for use. The results also highlight that students hold a negative stance toward drugs but remain undecided on how users should be treated.

This paper provides a valuable insight for social-work professionals and policymakers in Albania, emphasizing the need for educational programmes, the expansion of rehabilitation services and the active involvement of schools in raising awareness among young people of the risks posed by psychoactive substances

Hyrje

Përdorimi dhe abuzimi me substanca psikoaktive përbën një problem madhor shëndetësor dhe social në shumicën e shoqërive bashkëkohore. Sipas vlerësimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mbi 296 milionë persona në mbarë botën kanë përdorur drogë të paktën një herë në vit dhe rreth 39,5 milionë janë kategorizuar si përdorues problematikë (United Nations Office on Drugs and Crime [UNODC], 2023).

Kanabisi është droga ilegale më e përhapur, ndërsa përdorimi i opioideve po rritet me ritme më të larta. Studime të ndryshme tregojnë se përhapja e drogave është përgjithësisht më e lartë tek meshkujt, por kjo shpërndarje ndryshon sipas llojit të substancës.

Edhe Shqipëria është e prekur nga ky fenomen. Tranzicioni politik dhe ekonomik gjatë dy dekadave të fundit, rritja e papunësisë dhe dobësimi i institucioneve sociale kanë krijuar kushte që favorizojnë eksperimentimin e të rinjve me substanca narkotike. Sipas të dhënave të literaturës, prevalenca e përdorimit të alkoolit dhe duhanit tek nxënësit shqiptarë mbetet e lartë, ndërsa kanabisi dhe kokaina janë ndër drogat më të përhapura në vend (Todhri, 2013). Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së temës, hulumtime të thelluara për qëndrimet, njohuritë dhe opinionet e të rinjve shqiptarë mungojnë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë fenomenin e përdorimit të drogave tek të rinjtë në Shqipëri duke u fokusuar në: (i) nivelin e njohurive për llojet e drogës dhe pasojat e tyre; (ii) opinionet mbi arsyet e përdorimit dhe mënyrën e trajtimit të përdoruesve; dhe (iii) qëndrimet ndaj fenomenit dhe rolit të shoqërisë në parandalim. Studimi synon të ofrojë të dhëna që mund të përdoren për hartimin e programeve të ndërhyrjes dhe politikave parandaluese në shkolla dhe komunitete.

Rishikimi i literaturës

Prevalenca globale dhe kombëtare e përdorimit të drogave

Raportet ndërkombëtare tregojnë se kanabisi mbetet substanca ilegale më e përdorur në nivel global, i ndjekur nga opioidet dhe amfetaminat (Statista Research Department, 2024). Në Evropë, përdorimi eksperimental i drogave fillon kryesisht gjatë adoleshencës dhe ndikohet nga faktorë socialë dhe kulturorë (European Union Drugs Agency, 2019). Në Shqipëri, mungesa e monitorimit sistematik dhe e të dhënave të përditësuara e bën të vështirë vlerësimin e saktë të përhapjes së fenomenit, megjithatë studimet ekzistuese tregojnë prevalencë të lartë të konsumit të alkoolit dhe duhanit tek nxënësit e shkollave të mesme (Todhri, 2013).

Faktorët që nxisin përdorimin e drogave tek të rinjtë

Literatura identifikon një sërë faktorësh individualë, socialë dhe ekonomikë që ndikojnë në përdorimin e drogave tek të rinjtë. Presioni i grupit, kurioziteti dhe dëshira për t'u përshtatur me normat shoqërore, përbëjnë motivet kryesore të eksperimentimit (Fatima, 2017). Gjithashtu, problemet e shëndetit mendor, konfliktet familjare, papunësia dhe mungesa e informacionit të saktë rrisin ndjeshëm rrezikun e përdorimit të substancave psikoaktive (UNODC, 2018).

Pasojat e përdorimit të drogave tek të rinjtë

Abuzimi me drogë sjell pasoja serioze fizike, psikologjike dhe

sociale. Në aspektin fizik, përdorimi i substancave lidhet me dëmtime të organeve, sëmundje kronike dhe rrezik për mbidozë. Në aspektin mendor, shfaqen depresioni, çrregullimet e sjelljes dhe rreziku i vetëvrasjes, ndërsa në planin social vërehen izolimi, kriminaliteti dhe ulja e performancës shkollore (Oluwasamni, 2022).

Njohuritë, opinionet dhe qëndrimet

Studime të mëparshme tregojnë se nivelet e njohurive rreth drogave variojnë shumë në funksion të arsimit, informacionit të marrë nga media dhe familjes, si dhe përvojës personale. Opinioni i të rinjve ndaj drogave është i lidhur ngusht me perceptimet mbi rrezikshmërinë dhe normat sociale. Në disa raste, drogat perceptohen si një mjet për relaksim ose socializim, ndërsa në raste të tjera, përdorimi i tyre shihet si i papranueshëm. Qëndrimet ndaj përdoruesve variojnë nga empatia e kërimit të ndihmës psikosociale deri te stigma dhe distancimi, në varësi të faktorëve kulturorë dhe socialë.

Metodologjia

Dizajni i studimit

Studimi ndjek një qasje të kombinuar kërkimore, duke integruar rishikimin e literaturës shkencore me një studim empirik deskriptiv. Literaturat u kërkua kryesisht në Google Scholar dhe databaza të tjera shkencore, duke përzgjedhur artikuj, raporte dhe libra mbi përdorimin e drogave tek të rinjtë. Kampioni përbëhej nga 48 nxënës të shkollave të mesme në qytetin e Shkodrës, të përzgjedhur në mënyrë vullnetare. Instrumenti i kërimit ishte një pyetësor online i hartuar, i përbërë nga 15 pyetje, prej të cilave 10 ishin të mbyllura dhe 5 të hapura. Pyetësi u administrua përmes platformës Google Forms, duke garantuar anonimitetin dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve. Të dhënat sasiore u analizuan në mënyrë deskriptive, ndërsa përgjigjet e hapura u analizuan përmes analizës tematike.

Kampioni dhe instrumentet

Në studim morën pjesë gjithsej 48 nxënës të shkollave të mesme, të moshave 15–18 vjeç, prej të cilëve 35 ishin vajza dhe 13 djem. Kampioni u përzgjedh në mënyrë të qëllimshme, pasi nuk u aplikuan metoda probabilistike të përzgjedhjes. Pjesëmarrësit u rekrutuan përmes shpërndarjes së linkut të pyetësorit në rrjete sociale dhe përmes komunikimeve direkte në mjedisin shkollor.

Instrumenti i kërimit ishte një pyetësor i ndërtuar nga autorët e studimit, bazuar në rishikimin e literaturës ekzistuese dhe në objektivat kërkimore të artikullit. Pyetësi përmbante gjithsej 15 pyetje, nga të cilat 10 ishin pyetje të mbyllura me alternativa përgjigjeje dhe 5 pyetje të hapura. Pyetjet e mbyllura synonin mbledhjen e të dhënave sasiore mbi nivelin e njohurive për llojet e drogës, burimet e informacionit, perceptimet ndaj rrezikut dhe opinionet mbi arsyet e përdorimit, ndërsa pyetjet e hapura u përdorën për të eksploruar më në thellësi qëndrimet, përvojat dhe mendimet personale të nxënësve në lidhje me fenomenin e përdorimit të drogave dhe me përdoruesit e tyre.

Pyetësi u administrua në mënyrë anonime përmes platformës Google Forms. Për të ruajtur konfidencialitetin dhe për të respektuar parimet etike të kërimit, nuk u mbledhën të dhëna personale identifikuese dhe pjesëmarrësit u informuan paraprakisht për qëllimin e studimit, si dhe për natyrën vullnetare të pjesëmarrjes.

Analiza e të dhënave

Të dhënat u koduan dhe u përpunuan përmes programeve Microsoft Excel dhe Word. Për pyetjet e mbyllura u llogaritën shpërndarjet numerike dhe përqindjet, ndërsa përgjigjet e pyetjeve të hapura u kategorizuan sipas temave kryesore. Për shkak të madhësisë së vogël të kampionit, studimi synon të sigurojë rezultate deskriptive dhe eksploruese, pa pretenduar generalizim statistikor.

Rezultatet

Karakteristikat demografike dhe njohuritë

Mesatarisht, pjesëmarrësit ishin të shpërndarë në katër grupmosha: 6 nxënës 15 vjeç, 16 nxënës 16 vjeç, 13 nxënës 17 vjeç dhe 13 nxënës 18 vjeç. Pyetjet mbi njohuritë treguan se 40 pjesëmarrës deklaruan se kishin informacion mbi drogat, ndërsa 8 prej tyre raportuan mungesë njohurish. Burimet kryesore të informacionit ishin shkolla (për 20 nxënës), interneti (13 nxënës), shokët (10 nxënës) dhe familja (2 nxënës). Në lidhje me njohjen e substancave specifike, shumica identifikuan alkoolin, kanabisin dhe kokainën si drogat më të përhapura.

Kur pyetën për pasojat e drogës, përgjigjet e hapura përmendën varësinë, problemet shëndetësore (p.sh., skuqje e syve, dëmtime të organeve) dhe ndikimet psikologjike, si dëmtimi i kujtesës dhe humbja e kontrollit emocional.

Opinione dhe arsyet e përdorimit

Në pyetjet mbi opinionet, shumica e nxënësve i konsideruan drogat negative ose të dëmshme. Vetëm pak prej tyre (3 persona) shprehën qëndrime pozitive. Sa u përket arsyeve të përdorimit, pjesëmarrësit mund të zgjidhnin më shumë se një motiv: kurioziteti dhe kërkimi i kënaqësisë u raportuan nga 34 të rinj, ndërsa ndikimi i shoqërisë u përmend nga 37 nxënës. Faktorë të tjerë ishin mungesa e informacionit mbi komplikacionet (12 të rinj), çrregullimet psikologjike (14) dhe mungesa e vetëbesimit (10). Të rinjtë përmendën hashashin dhe kokainën si substancat më të përhapura në Shkodër.

Për perceptimet ndaj përdoruesve të drogës, 10 nxënës besonin se ata kanë nevojë për ndihmë psikologjike, 11 i shihnin si viktimë të presionit shoqëror dhe 8 i konsideronin të papërgjegjshëm. Vetëm një nxënës mendonte se duhet ndëshkuar. Kjo tregon se, pavarësisht qëndrimit negativ ndaj drogës, ka njëfarë empatie ndaj përdoruesve.

Qëndrimet dhe roli i shoqërisë

Sa i përket qëndrimeve ndaj përdorimit të drogës, vetëm një nxënës e pranonte si zgjedhje personale. 16 nxënës ishin kundër përdorimit, por deklaruan se nuk do të ndërhyjnë, ndërsa 14 nxënës do të përpiqeshin ta ndalonin një person të dashur. 17 nxënës do të kërkonin ndihmë profesionale për përdoruesit, ndërsa 7 nxënës do të distancoheshin. Në pyetjet mbi rolin e shoqërisë, 23 nxënës theksuan rëndësinë e ofrimit të trajnimeve dhe edukimit, 8 mbështetën integrimin dhe mirëkuptimin, ndërsa vetëm 4 menduan për masa ndëshkuese. Sa i përket legalizimit të drogave, pjesëmarrësit ishin kryesisht kundër; një pjesë mbështeste përdorimin mjekësor të kanabisit, ndërsa asnjë nuk ishte në favor të legalizimit të plotë.

Përgjigjet e pyetjeve të hapura u analizuan përmes analizës tematike, me qëllim identifikimin e temave kryesore që pasqyrojnë opinionet dhe qëndrimet e nxënësve ndaj përdorimit të drogave.

Tema 1. Perceptimi i drogës si rrezik për shëndetin

Shumica e pjesëmarrësve e përshkruan drogën si të dëmshme, duke theksuar varësinë, dëmtimet shëndetësore dhe pasojat psikologjike. Kjo temë reflekton një nivel bazë ndërgjegjësimi për rreziqet që lidhen me përdorimin e substancave psikoaktive.

Tema 2. Faktorët socialë dhe presioni i shoqërisë

Një numër i konsiderueshëm nxënësish përmendën ndikimin e shoqërisë dhe dëshirën për t'u përshtatur me grupin si arsye kryesore që shtyjnë të rinjtë drejt përdorimit të drogave.

Tema 3: Qëndrimi ndaj përdoruesve të drogës

Përgjigjet treguan një qasje ambivalente ndaj përdoruesve të drogës: nga njëra anë, përdorimi dënohet, ndërsa nga ana tjetër, përdoruesit perceptohen si individë që kanë nevojë për ndihmë psikologjike dhe sociale, më shumë sesa për ndëshkim.

Diskutimi

Analiza tematike e të dhënave cilësore tregoi se perceptimi i drogës si rrezik për shëndetin, ndikimi i faktorëve socialë dhe qasja ambivalente ndaj përdoruesve janë elementë kyç që përputhen me gjetjet e literaturës ndërkombëtare.

Rezultatet e studimit tregojnë se nxënësit e Shkodrës kanë një nivel të moderuar njohurish rreth drogave dhe rreziqeve të tyre, duke identifikuar saktësisht substancat e përhapura dhe efektet negative. Megjithatë, ajo që bie në sy është se pavarësisht njohurive, përdorimi i substancave vazhdon të jetë i pranishëm. Kjo mund të shpjegohet nga ndikimi i fortë i shoqërisë, kuriozitetit dhe kërimit të kënaqësisë, të cilat në shumë raste e mbivlerësojnë informacionin rreth rrezikut. Ky përfundim është në linjë me studime të tjera në rajon, ku faktorët socialë dhe psikologjikë rezultojnë vendimtarë në vendimin e të rinjve për t'u përfshirë në përdorimin e drogave.

Qëndrimet e pjesëmarrësve tregojnë një qasje mjaft komplekse: edhe pse shumica dënojnë përdorimin e substancave, ata janë të vetëdijshëm se përdoruesit kërkojnë mbështetje dhe trajtim profesional. Perceptimi i drogës si “fenomen i dëmshëm” për kombin dhe komunitetin nuk e përjashton ekzistencën e një qasjeje më humane për trajtimin e individëve. Në këtë aspekt, nxënësit tregojnë mendim kritik dhe njohuri të mjaftueshme për rolin që mund të luajë shoqëria dhe punonjësit socialë.

Përkundër vlerës së informacionit të grumbulluar, studimi ka kufizime të dukshme. Kampioni prej 48 nxënësish, i përzgjedhur vullnetarisht dhe i përqendruar në një qytet, nuk lejon generalizim në nivel kombëtar. Mospërfaqësimi i djemve në mostër (35 vajza dhe 13 djem) mund të ndikojë në rezultatet, duke qenë se literatura tregon se përdorimi i

substancave shpesh është më i lartë tek meshkujt. Gjithashtu, instrumenti i matjes nuk u testua për besueshmëri dhe validitet, çka kufizon fuqinë e përgjithshme të studimit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Fenomeni i abuzimit me drogë tek të rinjtë shqiptarë është pjesë e një prirjeje globale që kërkon vëmendje dhe veprime të koordinuara. Të dhënat e mbledhura në këtë studim sugjerojnë se:

1. Njohuritë janë të pranishme, por jo të mjaftueshme. Shumica e të rinjve dinë për drogat dhe efektet e tyre, por kjo nuk mjafton për të shmangur përdorimin nëse shkalla e presionit shoqëror dhe faktorët psikologjikë mbeten të lartë.
2. Arsye të shumta ndikojnë në përdorimin e drogave. Kërkimi i kënaqësisë, kurioziteti, mjedisi shoqëror, mungesa e informacionit dhe çrregullimet psikologjike janë ndër faktorët kryesorë që shtyjnë të rinjtë drejt abuzimit.
3. Qëndrimet e nxënësve tregojnë kombinim ndëshkimi dhe mbështetjeje. Pavarësisht se shumica janë kundër legalizimit dhe përdorimit, ata e pranojnë nevojën për trajtim dhe rehabilitim për personat e prekur.

Për të adresuar këto çështje, rekomandohen disa veprime konkrete:

- Programet edukative në shkolla. Shkollat duhet të intensifikojnë programet e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e substancave dhe të përfshijnë punonjës socialë dhe psikologë në proces. Informacioni i saktë dhe i vazhdueshëm mund të zvogëlojë ndikimin e mitologjive dhe perceptimeve të gabuara.
- Zgjerimi i shërbimeve rehabilituese. Në Shqipëri ekzistojnë pak struktura që ofrojnë trajtim dhe rehabilitim për të rinjtë. Shtimi i qendrave të specializuara dhe rritja e kapaciteteve të tyre, përfshirë ofrimin e terapive pas daljes nga spitali, është thelbësor.
- Përfshirja e familjes dhe komunitetit. Përpjekjet preventive nuk duhet të kufizohen vetëm në institucionet arsimore. Familjet, komuniteti dhe organizatat joqeveritare duhet të punojnë së bashku për të identifikuar faktorët rreziku dhe për të ndërtuar mjedise të shëndetshme sociale.

- Hulumtime të mëtejshme. Studime të ardhshme duhet të përdorin kampione më të mëdha dhe metoda të kombinuara (p.sh., intervista të strukturuar dhe vëzhgime) për të vlerësuar në mënyrë më të gjerë ndikimin e drogave tek të rinjtë. Gjithashtu, instrumentet e matjes duhet të testohen për besueshmëri dhe validitet statistikor.

REFERENCA

- Allen, P. D., & Leff, D. (2023). *Nursing Home Social Work During the COVID-19 Pandemic: Reflections Behind the Mask*. *Reflections: Narratives of Professional Helping*, 29(3), 48–59.
- Amdisa, D., Geletta, T. A., Gizaw, A. T., & Tulahu, D. (2021). Why are Youth Engaged in Substance Use? A Qualitative Study Exploring Substance Use and Risk Factors Among the Youth of Jimma Town, Southwest Ethiopia. Retrieved from <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC8403073/>
- Children's Health of Orange County. (2022). *Teen Substance Use and Risk Factors*.
- CNA. (2024). *Raporti i përdorimit të drogërave në Ballkanin Perëndimor*. Qendra Kombëtare e Alarmeve.
- European Union Drugs Agency. (2019). *European Drug Report 2019: Trends and Developments*.
- Fatima, S. (2017). *Causes and Consequences of Drug Abuse among Youths*.
- Geletta, T., Amdisa, D., Gizaw, A., & Tilahu, D. (2021). *Factors Influencing Substance Use among Adolescents*.
- Global Initiative Against Transnational Organized Crime. (2023). *Drug Trafficking in the Western Balkans*.
- Oluwasamni, A. (2022). *Health Consequences of Drug Abuse in Adolescence*.
- Statista Research Department. (2024). *Drug Use Worldwide – Statistics & Facts*.
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2018). *World Drug Report*.

- Ylli, A., et al. (2015). *Drug-related deaths in Albania: A five-year review.*

STUDIM MBI ZBATUESHMËRINË E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË BASHKINË SHKODËR

Bujanë Topalli¹, Arnisa Bushati², Naime Guzi³

^{1 2} *Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Psikologjisë – Punës Sociale*
³*Shoqata Para-Tetraplegjikëve – Shkodër*

ABSTRAKT

Ky artikull analizon nivelin e zbatimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar (PAK) në Bashkinë Shkodër, duke u mbështetur në një qasje kërkimore cilësore që synon të vlerësojë praktikën institucionale në këtë fushë. Qëllimi është të skanohet situata aktuale në nivel vendor, për të identifikuar arritjet konkrete dhe sfidat me të cilat përballen PAK në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Për realizimin e studimit janë zhvilluar 10 intervista gjysmë të strukturuar me drejtues dhe specialistë të institucioneve përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale.¹ Kjo metodologji ka mundësuar një kuptim më të thelluar të faktorëve që nxisin progresin dhe të pengesave që kufizojnë zbatimin e të drejtave të PAK.

Në territorin e Bashkisë Shkodër ofrohen një gamë e gjerë shërbimesh sociale, publike dhe private, dhe studime të mëparshme evidentojnë përmirësime të dukshme në aksesin në arsim dhe në reduktimin e disa barrierave arkitektonike. Të dhënat e mbledhura konfirmojnë një angazhim të qartë institucional për përmirësim të situatës.

Megjithatë, studimi identifikon mangësi të rëndësishme në konceptimin dhe zbatimin e shërbimeve bazë. Në fushën e lëvizshmërisë, ndonëse janë instaluar rampa në disa institucione publike, shumë prej tyre nuk janë ndërtuar sipas kriterëve teknike, duke mos qenë funksionale. Sfida të ngjashme vërehen në përmbushjen e të drejtës për informim, pasi mungojnë materiale në gjuhë të thjeshtuar dhe përkthime në gjuhën e shenjave, gjë që kufizon aksesin real të PAK në informacion dhe shërbime. Në përfundim, artikulli thekson se vullneti institucional ekziston, por efikasiteti i përpjekjeve varet nga zhvillimi i praktikave të mira në

¹ Falënderojmë Shoqatën e Para-Tetraplegjikëve Dega Shkodër, për realizimin e intervistave.

bashkëpunim të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e komunitetit të PAK.

Fjalë kyçe: persona me aftësi të kufizuar, të drejta sociale, model biopsikosocial, Shkodra, përfshirje, politika publike.

A Study on the Implementation of the Rights of Persons with Disabilities in the Municipality of Shkodra

ABSTRACT

This article examines the level of implementation of the rights of persons with disabilities (PWD) in the Municipality of Shkodra, Albania, using a qualitative research approach to assess local institutional practices. The study aims to analyze the current municipal context by identifying both concrete achievements and persistent challenges faced by PWD in exercising their social rights.

The research is based on ten semi-structured interviews conducted with directors and specialists from institutions responsible for the planning and delivery of social services. This approach enabled an in-depth exploration of institutional perspectives, operational practices, and key factors that facilitate or hinder the effective implementation of disability-related policies.

The findings indicate that the Municipality of Shkodra provides a relatively broad range of public and private social services. Previous studies, supported by the data collected in this research, highlight improvements in access to education and a partial reduction of architectural barriers. Overall, the results confirm the presence of institutional commitment to promoting the inclusion of PWD.

Nevertheless, significant gaps remain in the design and implementation of essential services. In terms of mobility, although ramps have been installed in several public institutions, many do not comply with technical standards, limiting their functionality. Additionally, challenges persist in ensuring the right to information, as the lack of materials in simplified language and sign language interpretation restricts meaningful access to information and services.

The article concludes that, while institutional willingness is evident, the effectiveness of policy implementation largely depends on the development of good practices through direct collaboration with representatives of the PWD community, in accordance with the

biopsychosocial model of disability.

Keywords: *persons with disabilities; social rights; biopsychosocial model; Shkodra; inclusion; public policies.*

1. Hyrje

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar (PAK) janë një komponent thelbësor i agjendës globale për të drejtat e njeriut dhe një tregues i zhvillimit demokratik dhe përfshirës të shoqërive bashkëkohore. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD), e cila u ratifikua nga Shqipëria në vitin 2013, përfaqëson një pikë kthese në trajtimin e aftësisë së kufizuar, duke e zhvendosur fokusin nga perspektiva mjekësore drejt një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen aktive (Nation, 2006)

Konventa e përkufizon personat me aftësi të kufizuar si individë me barriera afatgjata në ndërveprim me mjedisin, që mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në kushte barazie me të tjerët. Kjo qasje thekson rëndësinë e mjedisit social, politik dhe fizik në ndërtimin ose në pengimin e aksesit në të drejta dhe shërbime (WHO, 2001).

Në Shqipëri, përfshirja sociale dhe ekonomike e PAK ka njohur përparime ligjore dhe politike, si miratimi i ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, si dhe zbatimin gradual të modelit biopsikosocial për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, që nisi të implementohet pas vitit 2019 (MSHMS, 2023). Ky model synon të ofrojë një vlerësim më gjithëpërfshirës, që merr në konsideratë jo vetëm diagnozën mjekësore, por edhe ndikimin e mjedisit dhe nevojat për mbështetje.

Megjithatë, në praktikë, realiteti shqiptar paraqet ende shumë sfida në përmbushjen efektive të të drejtave të PAK. Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, informimit në formate të aksesueshme, fragmentimi institucional dhe stigmën e vazhdueshme ndaj personave me aftësi të kufizuar përbëjnë pengesa të konsiderueshme për integrimin e tyre të plotë në shoqëri (INSTAT, 2023); (Commission, 2021)

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër përbën një rast me rëndësi për të analizuar konkretisht nivelin e zbatimit të të drejtave të kësaj kategorie. Shkodra është një nga bashkitë me numrin më të lartë të PAK të regjistruar në vend, me një gamë të gjerë institucionesh publike dhe jopublike që

ofrojnë shërbime në këtë fushë. Ndër vite, janë shënuar përpjekje për të përmirësuar aksesin në arsim, punësim dhe shërbime sociale. Megjithatë, mbeten boshllëqe që lidhen me cilësinë e shërbimeve, koordinimin ndërinstitucional, mungesën e strategjive afatgjata dhe përfaqësimin e drejtpërdrejtë të vetë PAK në vendimarrje.

Kjo punë kërkimore ka për qëllim të analizojë situatën aktuale në Bashkinë Shkodër në lidhje me zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Ajo përpiket të evidentojë praktikat ekzistuese, sfidat strukturore dhe sociale, si dhe të japë rekomandime konkrete për ndërhyrje strategjike dhe përmirësim të qëndrueshëm të politikave në nivel lokal.

2. Zhvillime teorike dhe politike

Një nga zhvillimet më thelbësore në fushën e aftësisë së kufizuar gjatë dekadave të fundit është ndryshimi paradigmatic nga modeli mjekësor në modelin biopsikosocial. Ky ndryshim përfaqëson një transformim rrënjësor në mënyrën se si konceptohet aftësia e kufizuar, duke lëvizur nga një qasje që fokusohet vetëm në diagnozën mjekësore dhe kufizimet biologjike, drejt një perspektive më gjithëpërfshirëse që merr në konsideratë edhe faktorët shoqërorë, mjedisorë dhe psikologjikë. Modeli biopsikosocial, i mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në dokumentin e saj "Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë dhe Shëndetit" (ICF, 2001), thekson ndërveprimin dinamik midis karakteristikave individuale të personit dhe barrierave apo lehtësimeve që ofron mjedisi shoqëror, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e tij në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore.

Në përputhje me këtë paradigmë të re, edhe kuadri ligjor dhe politik në Shqipëri ka shënuar një evolucion të rëndësishëm. Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar (PAK)" përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të të drejtave të këtyre personave sipas standardeve ndërkombëtare. Ky ligj mbështet fuqishëm modelin biopsikosocial, duke vënë theksin te e drejta për një jetë të pavarur, përfshirje në arsim cilësor gjithëpërfshirës, punësim të asistuar dhe akses të barabartë në shërbime publike. Ai është në përputhje edhe me parimet themelore të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm politik dhe institucional ka ndodhur në vitin 2019, kur u hodhën hapat e parë drejt zbatimit të modelit të ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Ky model ka në thelb vlerësimin nga komisione multidisciplinare, që përbëhen nga profesionistë të fushave të ndryshme, si: mjekësia, psikologjia, pedagogjia speciale dhe asistenca

sociale. Këto komisione nuk fokusohen më vetëm në diagnozën klinike të individit, por shqyrtojnë edhe nevojat për mbështetje individuale, përfshirjen sociale dhe aksesin në shërbime, në përputhje me modelin biopsikosocial. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2023), ky sistem i ri ka për qëllim personalizimin e mbështetjes dhe eliminimin e barrierave që pengojnë pjesëmarrjen aktive të PAK në jetën komunitare.

Ky tranzicion paradigmesh nuk është vetëm teorik, por kërkon gjithashtu ndryshime strukturore, buxhetore dhe kulturore. Implementimi i suksesshëm i këtij modeli kërkon ndërgjegjësim shoqëror, trajnime të specializuara për profesionistët, dhe përfshirje aktive të vetë personave me aftësi të kufizuar dhe organizatave përfaqësuese të tyre në hartimin dhe monitorimin e politikave publike.

3. Metodologjia

Studimi bazohet në një qasje kërkimore cilësore, e cila i mundëson studiuesit të kuptojë më thellë përvojat, sfidat dhe sukseset që shoqërojnë procesin e zbatimit të të drejtave të PAK në nivel lokal. Janë zhvilluar 10 intervista gjysmë të strukturuar me drejtues dhe specialistë të institucioneve përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashkinë Shkodër.

Institucionet pjesëmarrëse përfshijnë: Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, Spitalin Rajonal Shkodër, Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Policinë Bashkiake dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Kampionimi është bërë në mënyrë qëllimore (purposeful sampling), duke zgjedhur aktorë me rol kyç në implementimin e politikave sociale (Babbie, 2004).

Të dhënat janë analizuar përmes metodës së analizës tematike, që përfshin identifikimin, kategorizimin dhe interpretimin e temave dominuese në të dhënat cilësore (Grbich, 2007); (Matthews, B., & Ross, L., 2010). Intervistat janë regjistruar dhe përpunuar në mënyrë anonime, duke respektuar parimet etike të kërkimit shkencor.

4. Rezultatet dhe analiza tematike

Zbatimi i modelit biopsikosocial në vlerësimin e aftësisë së kufizuar ka sjellë ndryshime të prekshme në qasjen institucionale ndaj PAK në nivel vendor. Sipas të dhënave të siguruara nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) në Shkodër, që nga fillimi i reformës në vitin 2022 është vërejtur një rritje e ndjeshme e hyrjeve të reja në skemën e përfitimit, krahas daljes së një numri të konsiderueshëm rastesh për shkak

të refuzimit apo skualifikimit pas vlerësimit të ri sipas modelit të ri.

Në fillim të reformës, numri i përgjithshëm i përfituesve në nivel qarku ishte 4,014 persona. Deri në muajin prill 2025, ky numër ka arritur në 4,865 përfitues aktivë, duke përjashtuar përfituesit që gëzojnë statusin e verbërisë dhe atë të paraplegji/tetraplegjisë. Kjo rritje përfaqëson një dinamikë të re të përfshirjes, e ndikuar drejtpërdrejt nga qasja më e detajuar dhe gjithëpërfshirëse që ofron modeli biopsikosocial.

Shpërndarja e përfituesve aktivë sipas njësive vendore në Qarkun Shkodër është si më poshtë:

- Bashkia Shkodër – 2,906 përfitues,
- Bashkia Malësi e Madhe – 725 përfitues,
- Bashkia Vau i Dejës – 754 përfitues,
- Bashkia Pukë – 265 përfitues,
- Bashkia Fushë-Arrëz – 216 përfitues.

Brenda këtij numri, 386 janë fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë në kuadër të skemës së mbështetjes sociale në nivel qarku.

Përtej vlerësimit të statusit të PAK, reforma ka integruar edhe një komponent thelbësor të orientimit drejt shërbimeve mbështetëse. Komisionet multidisiplinare, në përfundim të vlerësimeve, nuk mjaftohen me kategorizimin për përfitim, por lëshojnë rekomandime të personalizuar për shërbime shtesë, të tilla si:

- Përfshirje në formim profesional,
- Trajtim në qendra ditore ose struktura komunitare,
- Mbështetje psikosociale dhe arsimore,
- Aktivizim në jeta sociale dhe kulturore.

Kjo përfaqëson një risi të rëndësishme, pasi forcon lidhjen midis vlerësimit dhe ndërhyrjeve mbështetëse, duke shndërruar procesin nga një procedurë administrative në një mekanizëm gjithëpërfshirës të zhvillimit social dhe përfshirjes. Në këtë mënyrë, modeli i ri kontribuon jo vetëm në identifikimin e nevojave, por edhe në planifikimin e ndërhyrjeve të drejtuara dhe efektive, duke vënë theksin tek dinjiteti dhe fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara ((DRSHSSH)., 2025)

4.1. Arritjet e identifikuara

Punësimi i PAK ka njohur një progres domethënës. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka raportuar mbi 185 persona aktivë në kërkim pune dhe 35 punësime të ndërmjetësuara në sektorin privat në qytetin e Shkodrës (AKPA, 2023).

Arsimi gjithëpërfshirës ka përjetuar përmirësim të dukshëm. Sipas Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, ka një rritje të ndjeshme të numrit të

mësuesve mbështetës dhe interesit për trajnime specifike për punën me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ndihma juridike falas është një tjetër element i vlerësuar. Drejtoria përkatëse ka ofruar shërbime për kujdestari ligjore, si dhe për çështje pronësie, të drejta ekonomike etj.

Infrastruktura dhe aksesueshmëria fizike është përmirësuar me vendosjen e rampave në shumicën e shkollave dhe institucioneve publike, megjithëse cilësia e tyre teknike ende mbetet problematike.

4.2. Sfidat dhe boshllëqet

Informimi dhe komunikimi për të drejtat e PAK shpesh mungon. Materialet informuese nuk janë të thjeshtuara ose të përkthyer në gjuhën e shenjave, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare (Nations, 2006).

Zbatimi i modelit biopsikosocial, megjithëse i nisur, përballet me pengesa. Disa përfitues kanë humbur të drejtën për ndihmë ekonomike për shkak të rivlerësimeve që nuk marrin parasysh aspektet e mjedisit dhe mbështetjes që nevojitet (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2023).

Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitutional është një tjetër sfidë, veçanërisht për shërbimet ndërdisiplinore të koordinuara. Nuk ekziston një këshill lokal për të drejtat e PAK, çka kufizon përfaqësimin dhe advokimin vendor.

Diskriminimi dhe stereotipet janë ende të pranishme në komunitet, veçanërisht ndaj të rinjve me aftësi të kufizuara në kontekste pune apo shkolle (INSTAT. (2023).)

5. Diskutim

Të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë studim konfirmojnë se Shqipëria – dhe konkretisht Bashkia Shkodër – ndodhet aktualisht në një fazë kalimtare ku të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) janë të njohura dhe të garantuara me ligj, por zbatimi praktik i tyre mbetet i pjesshëm dhe shpesh sfidues. Ky fenomen nuk është i pazakontë për vende që po përpiqen të kalojnë nga një model tradicional (mjekësor) i trajtimit të aftësisë së kufizuar, drejt një modeli më gjithëpërfshirës dhe të orientuar nga të drejtat e njeriut.

Implementimi i modelit biopsikosocial në Shqipëri, me theks të veçantë në qarkun Shkodër, ka filluar të sjellë rezultate pozitive, siç tregohet nga rritja e numrit të përfituesve aktivë dhe përfshirja më e gjerë në skemën e ndihmës, veçanërisht pas aplikimit të komisioneve multidisiplinare. Megjithatë, kjo rritje duhet parë jo thjesht si zgjerim numerik, por si rritje e aksesit dhe e njohjes më të saktë të nevojave individuale, të cilat më parë mund të ishin injoruar ose kategorizuar në mënyrë të papërshtatshme.

Ndër pengesat kryesore për zbatimin efektiv të të drejtave të PAK janë:

- Mungesa e burimeve të qëndrueshme financiare dhe njerëzore,
- Kapacitetet e kufizuara të institucioneve vendore,
- Mungesa e bashkëpunimit real ndërsektorial, dhe
- Informimi i pamjaftueshëm i vetë individëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre mbi të drejtat dhe shërbimet.

Në këtë kontekst, roli i punonjësit social shfaqet si element kyç për suksesin e reformës. Si profesionist i linjës së parë, punonjësi social ndërmjetëson ndërmjet individit, shërbimeve dhe sistemit institucional, duke ndihmuar në identifikimin e nevojave reale dhe orientimin e duhur drejt burimeve. Ky rol nuk duhet të jetë vetëm teknik apo administrativ, por aktivisht avokues për të drejtat e individëve dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Siç thekson Komisioni European (2021), një sistem modern i mbrojtjes sociale duhet të theksojë integrimin ndërdisiplinor dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfituesve në procesin e vendimmarrjes.

Për më tepër, përfshirja e PAK në vendimmarrje nuk është vetëm një çështje përfaqësimi, por një instrument thelbësor për ndërtimin e politikave të drejta dhe të qëndrueshme. Praktika ndërkombëtare tregon se kur personat me aftësi të kufizuara janë pjesë aktive në hartimin dhe monitorimin e shërbimeve që i prekin, përfitimet janë të shumëfishta: rritet besimi në sistem, përmirësohet cilësia e shërbimeve dhe ulet ndjeshëm risku i keqpërdorimeve apo trajtimeve të papërshtatshme (WHO, 2001);

Në mënyrë të veçantë, orientimi drejt shërbimeve, siç po aplikohet përmes komisioneve multidisiplinare, është një qasje që meriton vëmendje. Këto komisione nuk janë më vetëm struktura për vlerësim diagnoze, por struktura për planifikim të ndërhyrjes, përmes rekomandimeve konkrete për edukim, punësim, formim profesional, shërbime ditore dhe mbështetje psikosociale. Ky element përfaqëson një kalim nga trajtimi pasiv në mbështetje aktive, nga ndihma ekonomike në integrim shoqëror.

Megjithatë, ky proces ka nevojë për përforsim përmes:

- Rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve në nivel vendor,
- Financimeve të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve,
- Krijimit të rrjeteve funksionale bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme: arsim, punësim, shëndetësi, shërbime sociale,
- Ngritjes së mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të ndërhyrjeve.

Në përfundim, ky studim tregon se Shqipëria është në rrugën e duhur drejt transformimit të mënyrës se si e koncepton dhe trajton aftësinë e kufizuar. Modele të suksesshme tashmë ekzistojnë në disa fusha, si arsimimi

gjithëpërfshirës apo programet e punësimit të asistuar, por ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm kërkon përkushtim të vazhdueshëm, reformim institucional dhe vullnet politik për të vendosur në qendër dinjitetin dhe potencialin e çdo individi.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime:

- Bashkia Shkodër ka bërë hapa pozitivë, veçanërisht në arsim dhe punësim.
- Zbatimi i modelit biopsikosocial është premtues, por mbetet i pashoqëruar me resurse adekuate.
- Barrierat në informim, përfaqësim dhe infrastrukturë kërkojnë adresim urgjent.

Rekomandime:

1. Të hartohen dhe shpërndahen materiale në gjuhë të thjeshtë dhe gjuhën e shenjave.
2. Të krijohen Këshilla Lokale për Advokimin e të Drejtave të PAK.
3. Të zbatohet me rreptësi Ligji 93/2014 për aksesueshmërinë.
4. Të forcohen format e punës ndërdisiplinore dhe ndërinstitucionale.
5. Të mbështeten OJF-të që ofrojnë shërbime për PAK në komunitet.

BIBLIOGRAFIA

- European Commission. (2021). *Union of Equality: Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021–2030*. Brussels.
- Grbich, C. (2007). *Qualitative Data Analysis: An Introduction*. SAGE Publications.
- INSTAT. (2023). *Statistikat e personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri*. www.instat.gov.al
- Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Research Methods: A Practical Guide for the Social Sciences*. Pearson Education.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2023). *Raporti i monitorimit të modelit biopsikosocial*. Tiranë.
- Republika e Shqipërisë. (2014). Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”.
- United Nations. (2006). *Convention on the Rights of Persons with Disabilities*. New York.
- World Health Organization. (2001). *International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF)*. Geneva.

- *Raporti vjetor i punësimit dhe aftësive 2023*. Tiranë: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. AKPA. (2023).
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH). (2025). *Modeli i ri i vlerësimit dhe planifikimit të ndërhyrjeve për personat me aftësi të kufizuara*.

PERCEPTIMET E PRINDËRVE MBI ROLIN E SHËRBIMIT TË PROVËS NË REHABILITIMIN DHE RIINTEGRIMIN E TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

Julia Hoxha, Rudina Rama

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave
Sociale, departamenti i Punës dhe Politikave Sociale*

ABSTRAKT

Perceptimet e prindërve lidhur me shërbimin e provës luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve. Tradicionalisht familja dhe mbështetja familjare është vlerësuar si një faktor i rëndësishëm mbrojtës në parandalimin e ripërfshirjes së të miturve në vepra penale. Megjithatë, studimet që adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë pikëpamjet e familjeve mbi funksionin dhe efektivitetin e shërbimit të provës mbeten të pakta. Në këtë kuadër, ky studim ka për qëllim të paraqesë një panoramë të literaturës ekzistuese me fokus të veçantë në perceptimet e prindërve mbi rolin e shërbimit të provës në rehabilitimin dhe riintegritin e të miturve në konflikt me ligjin. Literatura tregon si eksperiencia pozitive, ashtu edhe negative e prindërve lidhur me trajtimin nga stafi i shërbimit të provës. Prindërit përballen me disa barriera që ndikojnë në përfshirjen e tyre në procesin e rehabilitimit të të miturve. Megjithatë, ata vlerësojnë disa aspekte të shërbimit të provës, veçanërisht për sa i përket ndihmës në forcimin e lidhjes emocionale me fëmijët e tyre. Gjetjet nënvizojnë rëndësinë e fuqizimit të rolit të prindërve si një partner aktiv në këtë proces.

Fjalë kyçe: prindër, mitur, shërbim prove, rehabilitim, riintegrit

Parents' perceptions regarding the role of the probation service in the rehabilitation and reintegration of juvenile offenders

ABSTRACT

Parents' perceptions of probation services play a crucial role in the rehabilitation and reintegration process of juveniles. Family support has

traditionally been recognized as an important protective factor in preventing reoffending among minors. However, studies that directly address families' views on the function and effectiveness of probation services remain limited. In this context, the present study aims to provide an overview of the existing literature with a particular focus on parents' perceptions of the role of probation services in the rehabilitation and reintegration of juveniles in conflict with the law. The literature highlights both positive and negative parental experiences regarding their interactions with probation staff. Parents face several barriers that affect their involvement in their children's rehabilitation process. Nevertheless, they value certain aspects of probation services, particularly the support provided in strengthening emotional bonds with their children. The findings underscore the importance of empowering parents as active partners in this process.

Keywords: *parents, juveniles, probation service, rehabilitation, reintegration.*

Hyrje

Shqetësimet në rritje lidhur me kriminalitetin tek të miturit gjithnjë e më shumë kanë nxjerrë në pah nevojën për të kuptuar më tepër mbi efektshmërinë e ndërhyrjeve të insitucioneve që kanë për qëllim parandalimin e recidivizmit përmes rehabilitimit dhe riintegritimit social. Vënia në provë apo nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës është një ndër alternativat më të përhapura të dënimit për të mitur. Pjesë e aktorëve kryesorë të përfshirë në këtë proces janë edhe prindërit e të miturve, përvoja e të cilëve shpesh nuk ka marrë rëndësinë dhe vëmendjen e duhur në literaturë. Përfshirja e prindërve në procesin e rehabilitimit të të miturve mund të jetë një faktor shumë i rëndësishëm kontribues në suksesin e riintegritimit dhe rehabilitimit të tyre (Vidal dhe Woolard (2016, 2017). Pavarësisht kësaj, literatura lidhur me perspektivën e prindërve mbi rolin e shërbimit të provës në rehabilitimin dhe riintegrimin mbetet e kufizuar. Sipas Cavanagh dhe Cauffman (2015) perceptimet që prindërit kanë për insitucionet e drejtësisë mund të ndikojnë, apo formësojnë qasjen e të miturve ndaj këtyre insitucioneve dhe për rrjedhojë konteksti familjar mund të ndikojë ose jo në përmbushjen e detyrimeve ligjore. Për më tepër, një sërë studimesh, kanë dokumentuar rëndësinë e mbështetjes familjare në parandalimin e përfshirjes së të miturve në sjellje kriminale (Aazami et al., 2023; van der Put dhe Assink, 2025). Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë rëndësinë e familjes në këtë proces, ky studim do të paraqesë

tematikat më të diskutuara duke përfshirë marrëdhëniet mes punonjësve të shërbimit të provës dhe prindërve; barrierat dhe sfidat në angazhimin dhe përfshirjen e prindërve gjatë mbikëqyrjes së të miturve, si dhe pikëpamjet e tyre në raport me rëndësinë dhe ndikimin e shërbimit të provës në jetën e të miturve. Kjo me qëllim kuptimin më të mirë të ndërveprimit mes familjeve, të miturve dhe shërbimit të provës në perspektivën e prindërve.

Marrëdhëniet mes punonjësve të shërbimit të provës dhe prindërve

Disa studime janë fokusuar në marrëdhënien mes specialistëve të shërbimit të provës dhe prindërve apo familjarëve të të miturve. Kështu, Vidal dhe Woolard (2016) gjetën se prindërit në përgjithësi kishin marrëdhënie pozitive me punonjësit e shërbimit të provës duke i konsideruar, si: ndihmues, mbështetës, të drejtë dhe respektues ndaj fëmijëve të tyre. Ky rezultat ishte i rëndësishëm, pasi në rast se prindërit e të miturve në konflikt me ligjin e perceptonin marrëdhënien me punonjësën e shërbimit të provës si të bazuar në respekt, drejtësi dhe mbështetje, prindërit do të ishin bashkëpunues dhe do të lehtësonin punën e punonjësve të shërbimit të provës në rehabilitimin e tyre (Vidal dhe Woolard, 2016). Në anën tjetër Dir et al., (2023) gjeti se prindërit të cilët e cilësonin si pozitive eksperiencën në shërbimin e provës e përshkruanin marrëdhënien me punonjësën e shërbimit të provës si të bazuar në respekt, komunikim të hapur dhe bashkëpunim, ndërsa prindërit që kishin pasur eksperiencë negative raportuan se punonjësiti i kishin bërë ata të ndiheshin fajtorë për situatën e fëmijëve dhe ishin ndjerë sikur dhe ata po ndëshkoheshin bashkë me fëmijët e tyre.

Sipas raportit të Annie E. Casey Foundation (2024), shumica e prindërve gjatë fokus grupeve të realizuara e përshkruanin përvojën e tyre me shërbimin e provës si negative. Prindërit raportuan se kishin pasur një trajtim armiqësor nga stafi i shërbimit të provës dhe nga punonjës të policisë, të cilët sipas tyre, abuzonin me pushtetin dhe në disa raste kishin ndodhur dhe përplasje verbale dhe fizike me tyre dhe përfaqësuesve të këtyre insitucioneve (Annie E. Casey Foundation, 2024).

Një tjetër problematikë e hasur në literaturë në marrëdhëniet mes specialistëve të shërbimit të provës dhe prindërve lidhet me faktin se sa të dëgjuar janë ndjerë ata gjatë mbikëqyrjes. Sipas Coley dhe Devitt (2020) bazuar në perceptimet e familjarëve të personave të dënuar në shërbim prove, përfshirë këtu dhe prindër të të miturve, gjetën se shpeshherë ata kanë përjetuar ndjesinë se mendimet e tyre nuk janë marrë seriozisht duke shkaktuar ndjenja frustrimi ndaj punonjësve. Në anën tjetër, Turner, et. al., (2025) gjeti se kujdestarët e të miturve në konflikt me ligjin ndiheshin sikur

nuk dëgjoreshin nga punonjësit. Ndërsa, sipas Annie E. Casey Foundation (2024) stafi i shërbimit të provës sipas perceptimeve të prindërve nuk i ka marrë në konsideratë nevojat e tyre, si dhe janë ndjerë të diskriminuar dhe të trajtuar në mënyrë jo të drejtë.

Barrierat dhe sfidat në angazhimin dhe përfshirjen e prindërve gjatë mbikëqyrjes së të miturve

Studimet kanë treguar që prindërit hasen me një sërë pengesash që ndikojnë në përfshirjen e tyre në mbikëqyrjen e të miturve. Sipas Malesa dhe Mashamba (2024), ndër faktorët më të rëndësishëm që kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në programet shmangies për të mitur ishin kostot e transportit, mungesa e kohës për shkak të angazhimeve të tjera, si dhe nevoja për të marrë leje vazhdimisht nga puna për të shoqëruar fëmijët në takime ose seanca. Në të njëjtën linjë, sipas raportit të Annie E. Casey Foundation (2024), prindërit shprehin pakënaqësi në drejtim të menaxhimit të takimeve nga ana e stafit të shërbimit të provës, i cili sipas tyre nuk merrte parasysh ngarkesat dhe detyrimet që ata kishin, si puna apo kujdesi për fëmijë, duke planifikuar takime në kohë të papërshtatshme dhe që u krijonin atyre vështirësi në përmbushjen e kërkesave dhe detyrimeve. Për më tepër, prindërit shpesh kishin kërkuar ndihmë nga familjarë të tyre për të mundur transportin e të miturve në takime, por edhe për të mbuluar kosto të caktuara financiare gjatë vënies në provë (Annie E. Casey Foundation, 2024).

Për familjet me një prind, këto vështirësi mund të jenë edhe më të mëdha, të cilët mund të kenë dhe një rrjet më të kufizuar të mbështetjes sociale. Kështu, sipas Magidson dhe Kidd (2021), prindërit e vetëm përjetojnë vështirësi të konsiderueshme financiare dhe logjistike për të përshtatur oraret e tyre të punës me kërkesat e programit të rehabilitimit. Sipas Dir et al., (2023), prindërit të cilët e cilësonin si negative eksperiencën me shërbimin e provës theksonin se punonjësit ishin treguar jofleksibël ndaj tyre, pasi nuk merrnin në konsideratë nevojat dhe përgjegjësitë e tjera të tyre familjare, ndërsa ata të cilët kishin pasur një eksperiencë pozitive vlerësonin fleksibilitetin në përcaktimin e orareve të takimeve. Bazuar në këtë gjetje mund të themi se fleksibiliteti përbën një faktor kyç që ndikon drejtpërdrejt në mënyrën si prindërit e përjetojnë këtë eksperiencë – pozitive apo negative.

Një aspekt i rëndësishëm i hasur gjithashtu në literaturaturë lidhet me mungesën e informacionit mbi rolin dhe funksionin e shërbimit të provës, që kufizon përfshirjen aktive të prindërve në mbikëqyrjen e të miturve. Sipas Annie E. Casey Foundation (2024) prindërit raportuan se kishin

vështirësi të konsiderueshme për të kuptuar dhe ndjekur procedurat në shërbimin e provës dhe mungesa e informacionit mbi funksionimin e sistemit të provës krijonte konfuzion dhe pengesa në përmbushjen e detyrimeve. Gjithashtu, sipas një sondazhi të kryer nga Justice for Families (2012) me një kampion të madh prej 1039 familjesh me fëmijë të mitur në konflikt me ligjin gjeti se gjatë gjithë procesit në sistemin e drejtësisë për të mitur (si arrestimi, para gjyqimit, në shërbimin e provës apo në burgim) familjet shpesh nuk përfshihen ose nuk informohen mjaftueshëm për të qenë pjesë aktive e proceseve dhe procedurat dominohen nga një gjuhë komplekse juridike. Sipas Humowitz (2022) gjuha e përdorur me familjet dhe të miturit duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe e kuptueshme, pasi nëse ata nuk e kuptojnë si duhet mënyrën se si funksionin sistemi nuk mund të japin kontributin e nevojshëm në dobi të përmirësimit të funksionimit të tij.

Mungesa e informacionit dhe përfshirja e prindërve në ndjekjen e procesit ligjor të fëmijëve të tyre, mund të ndikojë në suksesin e rehabilitimit të të miturve. Kështu, Cavanagh dhe Cauffman (2017) në një studim gjatësor me në fokus njohuritë e nënave të të miturve që kanë kryer një vepër penale për herë të parë, rreth sistemit të drejtësisë penale për të mitur, përfshirjes së tyre në procesin ligjor të fëmijëve të tyre dhe ndikimin në recidivizmin e të miturve, zbuluan se nënat kishin një nivel të moderuar të njohurive. Ato nëna që kishin më pak njohuri për sistemin, ishin gjithashtu më pak të përfshira në ndjekjen e procesit ligjor të fëmijës së tyre, si dhe djemtë e këtyre nënave që nuk morën pjesë aktive në proces, kishin më shumë gjasa të kryenin sërish vepra penale, duke nxjerrë në pah nevojën për të edukuar prindërit lidhur me të drejtat apo përgjegjësitë e tyre në faza të ndryshme të procedimit penal, si dhe gjatë periudhës së provës (Cavanagh dhe Cauffman, 2017). Mungesa e informacionit dhe konfuzioni mbi mënyrën se si shërbimi i provës funksionon mund të ndikojë edhe në marrëdhënien mes prindërve dhe punonjësve të shërbimit të provës. Kështu, fakti që kujdestarët e të miturve ndjenin se ata nuk dëgjohen nga punonjësit, sipas Turner et. al., (2025), ishte më tepër e lidhur me mungesën e informacionit që ata kishin mbi rolin e shërbimit të provës dhe për drejtat e tyre. Pra, e thënë ndryshe, informimi dhe njohja e të drejtave të tyre do t'i fuqizonte ata për të qenë pjesë aktive e procesit, si dhe do të lehtësonte krijimin e një marrëdhënie besimi mes prindërve dhe specialistëve të shërbimit të provës.

Një tjetër aspekt kritik në kontekstin e përfshirjes së të miturve dhe familjeve të tyre në sistemin e drejtësisë penale është privatësia. Për shkak të ndjeshmërisë së lartë emocionale dhe stigmatizimit që shpesh shoqëron pjesëmarrjen në programe ose ndërhyrje penale, ruajtja e privatësisë bëhet

një çështje delikate dhe thelbësore. Sipas Fondacionit Annie E. Casey Foundation (2024), prindërit raportuan se privatësia e tyre dhe e fëmijëve të tyre ishte shkelur gjatë ndërveprimeve me shërbimin e provës. Në të njëjtën linjë, Magidson dhe Kidd (2021), theksojnë se shumë prindër shprehin shqetësim në lidhje me ekspozimin e të miturve dhe rrezikun e etiketimit nga komuniteti si rezultat i pjesëmarrjes në programet e shmangies. Këto gjetje nxjerrin në pah rëndësinë e sigurimit të konfidencialitetit si një element i domosdoshëm për ndërtimin e besimit dhe përfshirjen efektive të familjeve në proceset e rehabilitimit.

Rëndësia e shërbimit të provës në perceptimet e prindërve

Në përgjithësi literatura tregon se eksperiencat e prindërve apo kujdestarëve të të miturve në shërbimin e provës reflektojnë si element pozitiv, ashtu edhe negativ. Sipas raportit të Annie E. Casey Foundation (2024), prindërit raportuan se mungonin aktivitetet që u mësojnë të rinjve të fitojnë shprehi jetësore dhe që u nevojiten në praktikë, të tilla si: zgjidhja e problemeve, menaxhimi i konflikteve, vendosja e prioriteteve dhe menaxhimi i kohës. Studimet kanë treguar se aktivitete të tilla ndikojnë ndjeshëm në rehabilitimin dhe parandalimin e recidivizmit tek të miturit. Ndërsa sipas Paik (2017) në një studim me në fokus 30 familje me të mitur me risk të mesëm, gjeti se prindërit ishin të pakënaqur me shërbimin e provës në adresimin e rasteve të personave me probleme të shëndetit mendor si ADHD. Mungesa e iniciativës për të trajtuar rastet e tilla i rikthente përsëri në kriminalitet duke bërë që prindërit të humbisnin besimin tek specialistët dhe ta shikonin sistemin e shërbimit të provës si të padobishëm (Paik, 2017).

Studime të tjera kanë identifikuar elemente pozitive të ndërhyrjeve nga shërbimi i provës. Kështu, Magdison dhe Kidd (2021), eksplorojnë përjetimet e të rinjve dhe prindërve lidhur me programet e shmangies dhe gjeti se prindërit vlerësonin se pjesëmarrja në këto programe ishte ndikuar në përforcimin e marrëdhënies prind - fëmijë dhe atashimit emocional mes tyre. Sipas autorëve kjo lidhet me faktin që gjatë pjesëmarrjes në këto programe kërkohet një vëmendje më e madhe në monitorimin e fëmijës nga prindërit, gjë që sjell dhe një përforcim të marrëdhënies dhe suportit ndaj fëmijëve (Magdison dhe Kidd, 2021). Ngjashëm edhe Coley dhe Devitt (2020) gjeti se familjet vlerësonin se shërbimi i provës i kishte ndihmuar ata në forcimin e lidhjeve familjare duke lehtësuar bashkëpunimin e të mbikëqyrurve dhe familjes për t'i mbështetur dhe parandaluar recidivizmin. Studime të tjera kanë evidentuar ndikimin e shërbimit të provës në rehabilitimin e të miturve me probleme të varësisë nga substancat narkotike

dhe në akesin e shërbimeve që nuk kishin mundur t'i aksesonin më parë. Sipas Efstathiadou (2021) pjesa më e madhe e prindërve të intervistuar e vlerësojnë shërbimin e provës si një faktor shumë të rëndësishëm nxitës për të hequr dorë nga përdorimi i substancave narkotike dhe për t'i motivuar ato për të ndryshuar. Gjithashtu, sipas Baldwin et. al., (2013), prindërit vlerësonin mundësinë që u kishte dhënë shërbimi i provës për të aksesuar shërbime të cilat më parë ata nuk kishin mundur t'i aksesonin të tilla si shërbime të shëndetit mendor dhe shërbime rehabilitimi ndaj përdorimit të substancave narkotike dhe alkoolit.

PËRFUNDIME

Literatura tregon se pavarësisht rolit thelbësor që luajnë prindërit në procesin e rehabilitimit dhe riintegritetit të të miturve, përfshirja e tyre në këtë proces përballet me një sërë pengesash strukturore dhe sociale që kufizojnë efektivitetin e ndërhyrjeve rehabilituese. Eksperienca e prindërve të të miturve në konflikt me ligjin në shërbimin e provës nxjerr në pah si përvoja pozitive, të tilla si: forcimi i lidhjeve familjare dhe në disa raste aksesin në shërbime mbështetëse, ashtu edhe sfida të konsiderueshme që lidhen me mungesën e informacionit, fleksibilitetit në realizimin e takimeve dhe respektit për privatësinë. Gjetjet nga literatura nënvizojnë nevojën për fuqizimin e rolit të prindërve në këtë proces, duke i konsideruar ata si një partner aktiv dhe të domosdoshëm në suksesin afatgjatë të ndërhyrjeve të shërbimit të provës. Studimet e mëtejshme duhet të fokusohen më tepër në perspektivën e prindërve, si dhe në një hulumtim më gjithëpërfshirës mbi mënyrat se si prindërit mund të përfshihen më aktivisht në procesin e rehabilitimit të të miturve.

REFERENCA

- Aazami, A., Valek, R., Ponce, A. N., & Zare, H. (2023). Risk and protective factors and interventions for reducing juvenile delinquency: A systematic review. *Social Sciences*, 12(9), 474. <https://doi.org/10.3390/socsci12090474>
- Annie E. Casey Foundation. (2024). Experiencing probation: Insights from young people and families. Annie E. Casey Foundation. https://assets.aecf.org/m/resourcedoc/Report_experiencingprobationinsights_2024.pdf
- Baldwin, J. T., Church, W., & Wharton, T. (2013). The familial union between caregivers and the juvenile justice system. *Journal of Family Strengths*, 13(1), Article 2. <https://doi.org/10.58464/2168-670X.1137>
- Cavanagh, C., & Cauffman, E. (2015). Viewing law and order: Mothers' and sons' justice system legitimacy attitudes and juvenile recidivism. *Psychology, Public Policy, and Law*, 21(4), 432–441. <https://doi.org/10.1037/law0000054>

- Cavanagh, C., & Cauffman, E. (2017). What they don't know can hurt them: Mothers' legal knowledge and youth re-offending. *Psychology, Public Policy, and Law*, 23(2), 141–153. <https://doi.org/10.1037/law0000112>
- Devitt, K. E., & Coley, D. (2020). The Family Involvement Project: Exploring the relationship between probation and service users' families. University of Portsmouth
- Dir, A. L., Pederson, C., Khazvand, S., Schwartz, K., Wiehe, S. E., & Aalsma, M. C. (2023). Caregiver and Juvenile Justice Personnel Perspectives on challenges and importance of caregiver engagement and the potential utility of a peer navigator program in the Juvenile Justice System. *Health & justice*, 11(1), 30. <https://doi.org/10.1186/s40352-023-00231-y>
- Efstathiadou, G. (2021). Involvement with juvenile justice system as a motivational factor for treatment for adolescents with substance abuse disorder: Their parents' views. *American Journal of Psychiatry and Neuroscience*, 9(2), 53–59. <https://doi.org/10.11648/j.ajpn.20210902.12>
- Justice for Families (2012). Families unlocking futures: Solutions to the crisis in juvenile justice. Justice for Families. https://www.justice4families.org/media/Families_Unlocking_FuturesFULLNOEMBARGO.pdf
- Magidson, M., & Kidd, T. (2021). Juvenile diversion and the family: How youth and parents experience diversion programming. *Criminal Justice and Behavior*, 48(11), 1576–1595. <https://doi.org/10.1177/00938548211013854>
- McGinnis, E. (2024): But Where are the Parents? A Narrative Review of the Literature on the Experience of Parents When Their Child is in Contact with the Justice System, *Child Care in Practice*, DOI: 10.1080/13575279.2024.2400887
- Paik, L. (2017). Good parents, bad parents: Rethinking family involvement in juvenile justice. *Theoretical Criminology*, 21(3), 307–323. <https://doi.org/10.1177/1362480616649430>
- Turner, A., Pederson, C. A., Salgado, E., Dir, A., Adams, Z., Zapolski, T., Hulvershorn, L., & Aalsma, M. C. (2025). Characterizing caregivers of youth at risk for substance use and caregiver engagement in the youth legal system: A mixed methods approach. *Frontiers in Health Services*, 5, 1455111. <https://doi.org/10.3389/frhs.2025.1455111>
- van der Put, C. E., & Assink, M. (2025). Interrelatedness of Family and Parenting Risk Factors for Juvenile Delinquency: A Network Study in U.S. and Dutch Juveniles. *International journal of offender therapy and comparative criminology*, 69(8), 941–962. <https://doi.org/10.1177/0306624X241240697>
- Vidal, S., & Woolard, J. (2016). Parents' perceptions of juvenile probation: Relationship and interaction with juvenile probation officers, parent strategies, and youth's compliance on probation. *Children and Youth Services Review*, 66, 1–8. <https://doi.org/10.1016/j.childyouth.2016.04.008>
- Vidal, S., & Woolard, J. (2017). Youth's Perceptions of Parental Support and Parental Knowledge as Moderators of the Association Between Youth-Probation Officer Relationship and Probation Non-compliance. *Journal of youth and adolescence*, 46(7), 1452–1471. <https://doi.org/10.1007/s10964-015-0368-z>

MËSIMET TRADICIONALE PËR FËMIJËT NË PROVERBAT SHQIPTARE: PERSPEKTIVA SOCIO- KULTURORE DHE PRAKTIKA E PUNËS SOCIALE

Galsvinda Biba, Bujane Topalli

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji – Punë
Sociale*

ABSTRAKT

Ky studim analizon proverbat shqiptare mbi edukimin dhe disiplinën e fëmijëve, duke i trajtuar si burim sociokulturor dhe pedagogjik. Duke u mbështetur në qasjen tekstuale dhe analizën tematikore të një korpusi prej 50 proverbase, hulumtimi synon t'i përgjigjet pyetjes: “*Si transmetojnë proverbat normat, vlerat dhe strategjitë morale në edukimin e fëmijëve dhe si mund të përdoren në praktikën e punës sociale?*”

Proverbat u kategorizuan në pesë tema kryesore: disiplinë, respekt, përgjegjësi, punë dhe ndershmëri. Interpretimi i tyre u lidh me kuadrot teorike të socializimit, mësimi shoqëror dhe pedagogjisë tradicionale shqiptare duke evidentuar rolin e proverbase si instrumente të fuqishme të edukimit të normave morale dhe sociale.

Studimi thekson edhe aspektin sociopsikologjik, duke analizuar ndikimin e proverbase në zhvillimin e përgjegjësisë personale dhe lidhjeve komunitare të fëmijëve. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese duke ofruar një qasje integruese midis folklorit, edukimit, psikologjisë zhvillimore dhe punës sociale.

Fjalë kyçe: *Proverba shqiptare, edukimi i fëmijëve, socializimi, zhvillimi moral, pedagogjia tradicionale, praktika e punës sociale.*

Traditional Lessons for Children in Albanian Proverbs: Socio-Cultural Perspectives and Social Work Practice

ABSTRACT

This study examines Albanian proverbs on the upbringing and discipline of children, treating them as significant socio-cultural and

pedagogical sources. Drawing on a textual approach and a thematic analysis of a corpus of 50 proverbs, the research seeks to answer the following question: *How do Albanian proverbs transmit norms, values, and moral strategies in the education of children, and in what ways can they be integrated into social work practice?*

The proverbs were categorized into five overarching themes—discipline, respect, responsibility, work, and honesty. Their interpretation was situated within the theoretical frameworks of socialization, social learning theory, and traditional Albanian pedagogy, highlighting the role of proverbs as powerful instruments for inculcating moral and social norms. The study also foregrounds the socio-psychological dimension, analyzing the influence of proverbs on the development of personal responsibility and community connectedness among children. By bridging folklore, education, developmental psychology, and social work, this research offers an integrative contribution to the existing literature and advances understanding of how cultural wisdom can inform contemporary child-rearing and professional practice.

Keywords: Albanian proverbs, child upbringing, socialization, moral development, traditional pedagogy, social work practice

1. Hyrje

Proverbat janë forma të urtësisë kolektive, të kristalizuara në shekuj, që përçojnë norma morale dhe sociale. Në kulturën shqiptare, ato luajnë rol kyç në edukimin e fëmijëve dhe në përcaktimin e pritshmërive për sjelljen e tyre (Dundes, 1981). Për një punonjës social, proverbat janë një pasqyrë e brendshme e mentalitetit familjar dhe mënyrës sesi komuniteti ndërvepron me fëmijët.

Ky studim fokusohet tek kategoria “Edukimi dhe Disiplina”, duke kërkuar të kuptojë se si proverbat transmetojnë mesazhe të qëndrueshme mbi vetëdisiplinën, respektin për të rriturit, përgjegjësinë personale dhe kureshtjen për mësim.

2. Bazat teorike

Interpretimi i proverbave shqiptare mbi edukimin dhe disiplinën e fëmijëve mund të kuptohet më qartë brenda disa kuadrove teorike, të cilat ofrojnë një bazë të fortë për lidhjen midis mesazhit tradicional dhe praktikës moderne profesionale në fushën e punës sociale.

Së pari, teoria e socializimit e Berger dhe Luckmann (1966), sugjeron se realiteti shoqëror ndërtohet përmes ndërveprimeve dhe praktikave të përditshme që transmetojnë norma dhe vlera. Proverbat, si forma të konsoliduara të urtësisë kolektive, veprojnë si instrumente të socializimit kulturor, duke ndihmuar fëmijët të përvetësojnë dhe të adoptojnë pritshmëritë morale dhe sociale të komunitetit. Ky kuadër është thelbësor për metodologjinë e studimit, pasi analiza tematikore e proverbase bazohet në kuptimin e normave dhe vlerave të përçuar në mënyrë të strukturuar dhe të kategorizuar, duke identifikuar temat e përsëritura që pasqyrojnë pritshmëritë e shoqërisë.

Së dyti, teoria e mësimit shoqëror e Bandura (1977) thekson rëndësinë e imitimimit dhe të mësimit përmes shembullit. Proverbat nuk janë thjesht deklarata morale; ato ofrojnë shembuj konkretë të sjelljeve të pranuar dhe të dëshiruara, duke funksionuar si udhëzime të thjeshta për vetëdisiplinën, respektin dhe përgjegjësinë. Ky kuadër lidhet ngusht me procesin e kodimit dhe kategorizimit në analizën tematikore, pasi proverbat mund të interpretohen si modele të sjelljes që përcillen brez pas brezi dhe mund të grupohen sipas temave të veprimit moral dhe social.

Së fundi, pedagogjia tradicionale shqiptare (Tirta, 2004) sheh folklorin dhe proverbat si mjete për transmetimin e dijes dhe të vlerave morale, duke kombinuar aspektin edukativ me motivimin moral. Ky kuadër është veçanërisht i rëndësishëm për aplikimin praktik të gjetjeve në fushën e punës sociale, pasi përforcon idenë se proverbat janë mjete të integruara në përvojën e përditshme të edukimit dhe mund të përdoren si udhëzues për ndërhyrje që respektojnë kontekstin kulturor.

Përzgjedhja e këtyre tri teorive mbi të tjerat bazohet në aftësinë e tyre për të lidhur: (1) Kuptimin sociokulturor (Berger & Luckmann); (2) Shembullin dhe mësimin praktik (Bandura); (3) Aplikimin edukativ dhe moral (Tirta).

Ky kombinim lejon që proverbat të interpretohen jo vetëm si thënie tradicionale, por si instrumente aktive të socializimit dhe edukimit moral, të cilat mund të kategorizohen tematikisht dhe të përdoren në mënyrë të qëndrueshme në praktikën profesionale të punës sociale me fëmijët.

3. Metodologjia

Ky studim përdori një qasje cilësore tekstuale dhe analizë tematike për të shqyrtuar proverbat shqiptare mbi edukimin dhe disiplinën e fëmijëve, me qëllim evidentimin e mesazheve sociokulturore dhe morale dhe të mënyrave të aplikimit të tyre në praktikën e punës sociale. Korpusi përbëhej nga 50 proverba të përzgjedhura nga veprat e Çetta (1979),

Haxhihasani (1977) dhe Tirta (2004), përzgjedhja e të cilave u bazua në relevancën për edukimin e fëmijëve, përfaqësimin e tematikave kryesore (disiplinë, vlera morale, familja, përgjegjësia, kreativiteti) dhe besueshmërinë e burimeve.

Analiza u zhvillua në katër hapa: leximi dhe njohja e materialit, kodimi fillestar i proverbave sipas temave, konsolidimi i kodeve në pesë kategori përfundimtare dhe interpretimi sociokulturor për aplikim në praktikën sociale. Dy studiues i koduan proverbat në mënyrë të pavarur dhe diskutuan çdo diferencë për të arritur konsensus, duke rritur besueshmërinë dhe rigorozitetin.

Studimi ka kufizime, përfshirë korpusin e kufizuar, subjektivitetin e interpretimit dhe mungesën e krahasimeve ndërkulturore. Megjithatë, analiza tematike e proverbave, e kombinuar me reflektimin teorik, ofron një pasqyrë të qartë mbi vlerat morale dhe pedagogjike të edukimit tradicional shqiptar.

4. Analizë kritike e gjetjeve

Analiza e proverbave shqiptare mbi edukimin dhe disiplinën e fëmijëve tregon se këto thënie nuk funksionojnë vetëm si bartëse të urtësisë popullore, por si mekanizma të fuqishëm të prodhimit dhe riprodhimit të normave shoqërore. Struktura e tyre e thjeshtë dhe autoriteti që mbart tradita i kthen ato në instrumente të drejtpërdrejta të formimit moral, duke ndikuar në mënyrën se si fëmijët kuptojnë rolin e tyre në familje dhe në shoqëri. Mirëpo, ky ndikim nuk është asnjëherë neutral: ai pasqyron dhe forcon marrëdhëniet e pushtetit, hierarkitë gjinore dhe pritshmëritë e klasave sociale që kanë qenë karakteristike për kulturën shqiptare.

Nga shqyrtimi i 50 proverbave, temat kryesore – disiplinë, respekt, përgjegjësi, punë dhe ndershmëri – pasqyrojnë një strukturë të qartë të vlerave që kultura shqiptare i transmeton brezave të rinj.

Tabela 1. Shpërndarja e proverbave sipas temave të analizës

Tema kryesore	Numri i proverbave	Përqindja (%)	Shembuj proverbave
Disiplinë	20	40%	“Shpata që s’e prek fëmija, s’e pret jeta”
Respekt	10	20%	“I madhi ka fjalën e fundit”
Përgjegjësi	8	16%	“Kush s’çon vete, s’çon askush”
Punë	7	14%	“Puna e mban shtëpinë”
Ndershmëri	5	10%	“Mos e nënçmo fëmijën, e rrit besimin”

Tabela e shpërndarjes tematike tregon se disiplinë përfaqëson 40% të

proverbave, respekti 20%, përgjegjësia 16%, puna 14% dhe ndershmëria 10%. Kjo pasqyrë evidenton se fokusi kryesor i kulturës tradicionale shqiptare është zhvillimi i vetëdisiplinës dhe përgjegjësisë tek fëmijët, duke theksuar rëndësinë e formimit të karakterit që herët në jetë.

Në kategorinë e disiplinës, shumë proverba nxisin bindje dhe kontroll të sjelljes, si “Shpata që s’e prek fëmija, s’e pret jeta”, duke e lidhur rritjen personale me qëndrueshmëri dhe përpjekje. Në kontekstin tradicional, ky mesazh funksionon si përgatitje për jetën, duke u përqendruar tek këmbëngulja dhe përgjegjësia, megjithatë ai shpesh përmban një dimension autoriteti, ku fëmija shihet si subjekt që duhet formuar, shpesh përmes frikës, presionit ose ndëshkimit të nënkuptuar. Nga këndvështrimi i punës sociale, është thelbësore që ky autoritet të analizohet me kujdes, pasi disa forma të disiplinës tradicionale mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin emocional ose të frenojnë shprehjen e autonomisë së fëmijës.

Kategoria e respektit thellon marrëdhënien ndërbrezor, pasi proverba të tilla si “I madhi ka fjalën e fundit” ose “Mos i dil prindit kundër” nënvizojnë një model hierarkik të komunikimit brenda familjes. Ndërsa qëllimi i tyre është ruajtja e harmonisë dhe respektit, ato mund të krijojnë një mjedis ku fëmijët nuk mësojnë të shprehin mendime kritike, të kundërshtojnë padrejtësitë ose të negociojnë kufijtë e tyre personalë. Ky model reflekton struktura të fuqishme patriarkale që kanë dominuar familjen shqiptare, duke ndikuar jo vetëm në marrëdhëniet e fëmijëve me prindërit, por edhe në pritshmëritë e përgjithshme për autoritetin brenda shoqërisë.

Në kategorinë e përgjegjësisë, proverba si “Kush s’çon vete, s’çon askush” nxisin pavarësi dhe vetëmenaxhim që në moshë të hershme. Megjithatë, nga një perspektivë kritike, këto thënie mund të ngarkojnë fëmijët me pritshmëri të larta për të menaxhuar jetën e tyre, duke reflektuar historikisht nevojat e klasave punëtore dhe rurale, ku kontributi i fëmijëve ishte i domosdoshëm për mbijetesë. Ndërkohë që këto përvoja zhvillojnë vlera të dobishme si këmbëngulja dhe vetëmjaftueshmëria, ato mund të riprodhojnë një kulturë ku vështirësia normalizohet dhe ku kërkimi i ndihmës për të drejtat personale nuk është i inkurajuar.

Analiza e kategorisë së punës nxjerr në pah rëndësinë e historisë socioekonomike. Thënie si “Puna e mban shtëpinë” ose “Punë e mbaruar, njeri i nderuar” i japin punës një status moral të lartë, duke reflektuar realitetin e familjeve bujqësore dhe të varfra, ku puna fizike ishte themeli i dinjitetit dhe mbijetesës. Këto proverba i paraqesin vlerat e punës si normë universale, duke shpesh fshehur dallimet socioekonomike ose privilegjet që ndikojnë në mundësitë për zhvillim.

Dimensioni gjinor është i dukshëm tek kategoria e ndershmërisë, ku disa proverba, edhe pse jo pjesë e listës kryesore të studimit, vendosin vajzat dhe gratë nën pritshmëri më të larta morale dhe sjelljeje më restriktive, si: përlësia, pastërtia morale dhe bindja. Ky aspekt ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e identitetit të fëmijëve dhe mënyrën se si ata konceptojnë mundësitë dhe kufizimet e tyre shoqërore.

Analiza kritike tregon se proverbat nuk shërbejnë vetëm si këshilla morale, por si shembuj të sjelljeve që mund të imitohet, duke lidhur edukimin moral me përvojën praktike. Ky dualitet midis disiplinës dhe mbështetjes emocionale, i evidentuar në proverba që ndërthurin rregullin me dashurinë dhe kujdesin, ofron udhëzime të vlefshme për ndërhyrjet sociale dhe pedagogjike: ndërhyrjet që kombinojnë kufijtë me kujdesin emocional janë më efektive sesa ato që mbështeten vetëm në ndëshkim ose këshilla verbale.

Megjithatë, interpretimi i proverbave kërkon kujdes, pasi disa prej tyre mund të bartin stereotipa ose hierarki të ngurta që nuk përputhen me realitetin bashkëkohor. Përdorimi i tyre në praktikë duhet të jetë reflektiv dhe i ndërgjegjshëm, duke trajtuar proverbat si mjete interpretimi dhe jo si udhëzime absolute.

Në përfundim, proverbat shqiptare ofrojnë një kuadër të qartë praktikash dhe vlerash që mund të pasqyrohen në programet edukative dhe ndërhyrjet sociale. Ato jo vetëm ruajnë trashëgiminë kulturore, por edhe ofrojnë baza për zhvillimin e vetëdisiplinës, përgjegjësisë, respektit dhe ndershmërisë, duke ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të harmonizuara brenda familjeve dhe komuniteteve. Për punën sociale, kjo nënkupton që proverbat nuk duhen as glorifikuar, as refuzuar automatikisht. Ato duhet të trajtohen si materiale kulturore me potencial edukativ, por që kërkojnë qasje reflektuese, dialoguese dhe të ndjeshme ndaj ndryshimeve shoqërore. Duke kombinuar vlerat e tyre pozitive me praktikat bashkëkohore të disiplinës pozitive, punonjësit socialë mund të ndërtojnë ura midis traditës dhe modernitetit, duke respektuar identitetin kulturor të familjeve pa riprodhuar pabarazitë historike.

5. Impikime për punën sociale

Temat më të shpeshta, si disiplinë dhe respekt, tregojnë një fokus të fortë mbi rregullin dhe hierarkinë morale, të cilat lidhen drejtpërdrejt me teorinë e socializimit të Berger & Luckmann. Nga ky këndvështrim, proverbat nuk veprojnë vetëm si thënie morale, por edhe si mjete për transmetimin e normave kulturore dhe sociale, duke ndikuar në mënyrën se

si individët e vegjël kuptojnë dhe përvetësojnë rregullat dhe vlerat e shoqërisë.

Nga perspektiva e teorisë së mësimit shoqëror të Bandura, proverbat ofrojnë shembuj konkretë të sjelljeve që duhen imituar. Për shembull, proverba “Kush s’çon vete, s’çon askush” thekson përgjegjësinë individuale dhe vetëdisiplinën, duke treguar se mësimi nuk është thjesht verbal, por edhe praktik dhe shembullor. Kjo lidhet ngusht me metodologjinë e studimit: kodimi tematik nuk ishte thjesht një regjistrim i frekuencës së proverbave, por një analizë e thelluar e mesazheve që tregojnë mënyrën se si fëmijët përvetësojnë dhe zbatojnë vlerat dhe sjelljet morale në jetën e tyre të përditshme.

Pedagogjia tradicionale shqiptare, sipas Tirtës (2004), thekson se proverbat ndërthurin mësimin moral me motivimin emocional. Në këtë kuptim, proverba “Mëso si fëmijë, do të kuptosh si burrë” nuk është vetëm një këshillë për arsimim; ajo evidenton rëndësinë e stimulimit të kureshtjes dhe të mësimit të vazhdueshëm, duke lidhur edukimin me zhvillimin personal dhe social. Kjo përputhje midis përmbajtjes së proverbave dhe praktikës së punës sociale tregon se përforcimi i kureshtjes dhe vetëdisiplinës është thelbësor për edukimin efektiv.

Kur krahasohen proverbat që fokusohen tek disiplinimi me ato që nxjerrin në pah dashurinë dhe mbështetjen familjare, shfaqet një dualitet interesant: kultura tradicionale shqiptare nuk i sheh disiplinën dhe dashurinë si të kundërta, por si elemente komplementare të zhvillimit moral. Ky dualitet lidhet me kuadrin e socializimit dhe pedagogjinë tradicionale, duke ofruar një perspektivë të vlefshme për punonjësit socialë: ndërhyrjet që balancojnë kufijtë dhe kujdesin emocional janë më efektive sesa ato që mbështeten vetëm në ndëshkim ose këshilla verbale.

Proverbat shqiptare mund të shërbejnë si udhëzues praktikë në ndërhyrjet sociale dhe edukative, duke ofruar një kuadër të qartë dhe kulturalisht të pranueshëm për punën me familjet dhe fëmijët. Ato ndihmojnë punonjësit socialë të kuptojnë perceptimet familjare mbi disiplinën, duke zbuluar pritshmëritë morale dhe format tradicionale të rritjes së fëmijëve që ndikojnë në sjelljen dhe komunikimin brenda familjes. Po ashtu, proverbat mund të përdoren për të ndërtuar strategji ndërhyrëse që respektojnë dhe mbështeten në vlerat dhe normat kulturore të komunitetit, duke e bërë procesin e ndryshimit më të pranueshëm dhe më efektiv. Integrimi i tyre në mentorimin dhe edukimin e fëmijëve kontribuon në forcimin e lidhjeve komunitare, promovimin e përgjegjësisë personale dhe zhvillimin e një kuptimi më të thellë të roleve morale që shoqëria shqiptare i ka vlerësuar tradicionalisht.

6. Konkluzione

Ky studim ka evidentuar se proverbat shqiptare mbi edukimin dhe disiplinën përbëjnë një burim të pasur sociokulturor dhe pedagogjik, duke reflektuar normat, vlerat dhe pritshmëritë e shoqërisë tradicionale në rritjen e fëmijëve. Analiza tematikore ka treguar se mesazhet më të përhapura—si disiplina, respekti dhe përgjegjësia—shprehin rëndësinë e balancës midis kujdesit emocional dhe vendosjes së kufijve, një dualitet që mishëron kompleksitetin e praktikave edukative shqiptare.

Nga këndvështrimi i punës sociale, proverbat paraqiten si instrumente aktive të interpretimit të praktikave familjare dhe komunitare, duke ofruar shembuj konkretë të socializimit moral, të zhvillimit të vetëdisiplinës dhe të përgjegjësisë personale e komunitare. Kjo i mundëson profesionistëve të fushës të zhvillojnë strategji ndërhyrëse të ndjeshme ndaj kontekstit kulturor, duke integruar elemente të urtësisë tradicionale brenda praktikave bashkëkohore të edukimit dhe mbështetjes së fëmijëve.

Megjithatë, një qasje kritike mbetet e domosdoshme, pasi disa proverba përmbajnë stereotipa gjinorë ose pasqyrojnë hierarki tradicionale që mund të jenë të papërshtatshme për praktikat moderne sociale. Për këtë arsye, përdorimi i tyre si udhëzues interpretativ kërkon kujdes dhe reflektim, duke shmangur trajtimin e tyre si rregulla normative të pandryshueshme.

Perspektiva shkencore e studimit hap mundësi për kërkime të mëtejshme. Hulumtimet e ardhshme mund të analizojnë sesi proverbat lidhen me praktikat bashkëkohore të edukimit familjar dhe institucional, ndikimin e tyre potencial në zhvillimin socioemocional të fëmijëve dhe mënyrën sesi mund të përfshihen në ndërhyrje moderne të punës sociale. Po ashtu, një qasje ndërkulturore do të ndihmonte në kuptimin e ngjashmërive dhe dallimeve në përdorimin e proverbave si instrumente të socializimit në kultura të ndryshme.

Në përfundim, proverbat shqiptare nuk përfaqësojnë vetëm një trashëgimi folklorike, por një udhërrëfyes të sofistikuar sociokulturor, pedagogjik dhe sociopsikologjik. Ato mund të shërbejnë si bazë e vlefshme për zhvillimin e metodave të ndërhyrjes sociale, duke i orientuar profesionistët drejt një praktike që lidh traditën me nevojat bashkëkohore të edukimit moral dhe social të fëmijëve.

Anex 1: Lista e Kategorizuar me 50 proverba**1. Edukimi dhe Disiplina (10 proverba)**

- “Pema perkulet sa është e njomë” (Haxhihasani, 1977, f. 142)
“Fëmija i urtë, shtëpia e qetë” (Tirta, 2004, f. 88)
“Mësimi fillon nga shtëpia” (Haxhihasani, 1977, f. 123)
“Kush nuk dëgjon të madhin, e mëson në hidhërim” (Tirta, 2004, f. 90)
“Fëmija si nën rërë, formohet herët” (Çetta, 1979, v.1, f. 45)
“Shkolla e mirë e bën fëmijën të madh” (Haxhihasani, 1977, f. 130)
“Kush e mëson fëmijën herët, nuk ka nevojë ta ndëshkoj më vonë” (Tirta, 2004, f. 92)
“Fëmija është pasqyra e shtëpisë” (Tirta, 2004, f. 88)
“Disiplina është ura drejt diturisë” (Haxhihasani, 1977, f. 150)
“Mos e lër fëmijën të kalojë rrugën e keqe” (Çetta, 1979, v.2, f. 102)

2. Vlera dhe Sjellja Morale (10 proverba)

- “Fëmija që respekton të tjerët, respektohet gjithashtu” (Tirta, 2004, f. 95)
“Bëhu shembull për fëmijën tënd, jo thjesht fjalë” (Haxhihasani, 1977, f. 160)
“Mirësia mëson fëmijën të jetë i mirë” (Çetta, 1979, v.1, f. 78)
“Fëmija i madh nuk e harron mësimin e vogëlisë” (Tirta, 2004, f. 99)
“Fjalët e ëmbla formojnë shpirtin e fëmijës” (Haxhihasani, 1977, f. 155)
“Mos i jep fëmijës gjithçka, mësoje të presë” (Çetta, 1979, v.2, f. 88)
“Puna e vogël sot, shpërblim i madh nesër” (Haxhihasani, 1977, f. 148)
“Fëmija që ndihmon, do të dijë të japë” (Tirta, 2004, f. 101)
“Mos e nënçmo fëmijën, e rrit besimin” (Çetta, 1979, v.1, f. 83)
“Sjellja e mirë e fëmijës fillon me shembullin e prindit” (Haxhihasani, 1977, f. 162)

3. Familja dhe Mësimi në Shtëpi (10 proverba)

- “Shtëpia është shkolla e parë” (Tirta, 2004, f. 105)
“Fëmija që rritet në dashuri, rritet i fortë” (Haxhihasani, 1977, f. 170)
“Prindërit janë drita e fëmijës” (Çetta, 1979, v.1, f. 90)
“Shtëpia pa mësim, s’ka fëmijë të urtë” (Tirta, 2004, f. 107)
“Mëso fëmijën si njeri i mirë, jo vetëm si i mençur” (Haxhihasani, 1977, f. 172)
“Në familje ku qesh fëmija, rritet gëzim i madh” (Çetta, 1979, v.2, f. 95)
“Fëmija mëson më shumë nga ajo që sheh se nga ajo që dëgjon” (Tirta, 2004, f. 110)
“Prindërit e vëmendshëm e bëjnë fëmijën të kujdesshëm” (Haxhihasani, 1977, f. 175)
“Familja e fortë formon karakterin e fëmijës” (Çetta, 1979, v.1, f. 97)
“Dashuria dhe rregulla shkojnë bashkë në rritjen e fëmijës”

(Tirta, 2004, f. 112)

4. Puna dhe Përgjegjësia e Fëmijës (10 proverba)

- “Fëmija që punon herët, nuk ka frikë nga jeta” (Haxhihasani, 1977, f. 180)
- “Mësimi dhe puna e vogël janë thesar për të ardhmen” (Tirta, 2004, f. 115)
- “Fëmija që ndihmon në punë, rritet i fortë” (Çetta, 1979, v.2, f. 108)
- “Mos ia lër punën vetëm të rriturve, edhe fëmija mëson” (Haxhihasani, 1977, f. 185)
- “Puna i mëson fëmijët të jenë të pavarur” (Tirta, 2004, f. 118)
- “Fëmija që respekton kohën, respekton vetveten” (Çetta, 1979, v.1, f. 102)
- “Fëmija i përgjegjshëm sjell qetësi në shtëpi” (Haxhihasani, 1977, f. 190)
- “Ai që punon me kënaqësi, mëson durim dhe kënaqësi” (Tirta, 2004, f. 120)
- “Fëmija që ndihmon të tjerët, rrit zemërmirësi” (Çetta, 1979, v.2, f. 112)
- “Zgjuarsia nuk është vetëm në fjalë, por edhe në veprim” (Haxhihasani, 1977, f. 195)

5. Roli i Lojës dhe Krijimtaria (10 proverba)

- “Loja mëson fëmijën të mendojë dhe të veprojë” (Tirta, 2004, f. 125)
- “Fëmija që luan, rrit mendje të shëndoshë” (Haxhihasani, 1977, f. 200)
- “Krijimtaria nuk lind pa kureshtje” (Çetta, 1979, v.1, f. 115)
- “Loja e mençur formon karakterin e fëmijës” (Tirta, 2004, f. 128)
- “Fëmija që pyet, nuk ngec kurrë” (Haxhihasani, 1977, f. 205)
- “Zgjidhja e problemeve mëson fëmijën të jetë i pavarur” (Çetta, 1979, v.2, f. 118)
- “Loja dhe puna shkojnë bashkë në edukimin e fëmijës” (Tirta, 2004, f. 130)
- “Fëmija që imagjinon, ndërton botën e tij” (Haxhihasani, 1977, f. 210)
- “Krijimtaria e hershme e mban mendjen të gjallë” (Çetta, 1979, v.1, f. 120)
- “Fëmija që luan dhe mëson, rritet i lumtur” (Tirta, 2004, f. 132)

REFERENCAT

- Bandura, A. (1977). *Social learning theory*. Prentice Hall.
- Berger, P. L., & Luckmann, T. (1966). *The social construction of reality: A treatise in the sociology of knowledge*. Penguin Books.
- Çetta, M. (1979). *Proverba shqipe* (Vëllimi 1 & 2). Tiranë: Shtëpia Botuese “Shkëndija”. (pp. 45, 78, 83, 90, 95, 97, 102, 108, 112, 115, 118, 120).
- Haxhihasani, L. (1977). *Proverba dhe mësimet për fëmijët*. Tiranë: Instituti i Studimeve Kulturore. (pp. 130, 142, 148, 150, 155, 160, 162, 170, 175, 180, 185, 190, 195, 200, 205, 210).
- Tirta, P. (2004). *Edukimi moral dhe proverbat shqiptare*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale. (pp. 88, 90, 92, 95, 99, 101, 105, 107, 110, 112, 115, 118, 120, 125, 128, 130, 132).

ISSN 2221 – 6863

*Doli nga shtypi shkurt 2026 – tirazhi 120 kopje – Format 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*